RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

TETOR 2021

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
I. 1 PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT TË AUDITIMIT 3
I. 2 PËRSHKRIM I GJETJEVE KRYESORE DHE REKOMANDIMEVE 3
I.3 KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT 13
II. Hyrja 16
II. 1 OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI I AUDITIMIT 17
II. 2 IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES 17
II. 3 PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE DREJTUESE TË SUBJEKTIT TË AUDITUAR LIDHUR ME ÇËSHTJEN NËN AUDITIM 17
II. 4 PËRGJEGJËSIA E AUDITUESVE TË KLSH 18
II. 5 KRITERET E VLERËSIMIT 19
II. 6 STANDARDET E AUDITIMIT 19
II. 7 MEDODAT E AUDITIMIT 20
II. 8 DOKUMENTIMI I AUDITIMIT 20
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT 21
III. 1 INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM 21
III. 2. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT 21
III. 3 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE 63
III. 4 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE 73
III. 5 AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT 88
III. 6 PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE 122
III. 7 MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT DHE VLERËSIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM. 179
III. 8 AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM. 184
III. 9 TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT 191
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 218
V. ANEKSE 240

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. 1 PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT TË AUDITIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në vijim të njoftimit për fillim auditimi nr. 527, prot., datë 07.05.2021 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 527/1 prot, datë 14.05.2021, i ndryshuar me shkresën nr. 527/2, prot., datë 21.06.2021 dhe me shkresën nr. 527/3, prot., datë 12.07.2021, në Institutin e Shëndetit Publik (më tej ISHP), nga data 10.05.2021 deri në 30.07.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri në 30.03.2021, u krye auditimi Financiar dhe Përputhshmërie në këtë institucion.

Instituti i Shëndetit Publik është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë. ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni.

Organet drejtuese të ISHP-së janë drejtori dhe këshilli shkencor. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të ISHP-së bëhet nga Ministri i Shëndetësisë. Kushtet dhe kriteret për emërimin e lirimin e drejtorit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Këshilli shkencor është organ këshillimor i ISHP-së ngritur me VKM nr. 380, datë 18.05.2011, ñPër ngritjen, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të këshillit shkencor të institutit të shëndetit publikò. Veprimtaria e institucionit kryet në përputhje me ligjin nr. 10138, datë 11.05.2009 ñPër shëndetin publikò, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetit publik.

Misioni i ISHP, si qendra kombëtare në fushën e shëndetit publik, konsiston në zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjensi/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Grupi i auditimit, mbështetur në programin e audititimit cituar më sipër, përfundoi auditimin në subjekt në përputhje me drejtimet kryesore të auditimit për të cilat evidentoi problematikat e konstatuar në gjetjet përkatëse dhe rekomandimet për secilën prej tyre. Në dy rubrikat e mëposhtje paraqiten gjetjet kryesore të këtij auditimit sipas rëndësisë dhe Opinioni i auditimit financiar dhe ai i përputhshmërisë.

I. 2 PËRSHKRIM I GJETJEVE KRYESORE DHE REKOMANDIMEVE

Në tabelën më poshtë paraqiten gjetjet kryesore të auditimit në formë të shkurtuar së bashku me rekomandimet përkatëse. Në këtë raport auditimi gjetjet dhe rekomandimet trajtohen në trajtë të plotë në paragrafin IV, si dhe i dërgohen subjektit me shkresën përcjellëse të këtij raporti përfundimtar auditimit.

NR	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i përcaktimit të personit përgjegjës për prokurimet publike në ISHP, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, është caktuar si Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) znj. A.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, dhe njëkohësisht Nëpunës Zbatues i ISHP, si dhe në cilësinë e PPP është anëtare e Njësisë së Prokurimit për të gjitha procedura e zhvilluara nga ISHP. Për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, si dhe nenin 22, pika 3/b, ku parashikohet se veprimtaritë e kontrollit duhet të përmbajnë minimalisht ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.		E Lartë	Drejtori i ISHP të marrë masa për ndryshimin e Urdhrit nr. 1, nr. 13 prot., datë 06.01.2021, me qëllim heqjen si Person Përgjegjës për Prokurimet, të Nëpunësit Zbatues znj. A.M.. Për të gjitha rastet në vijim, drejtori i ISHP të marrë masa për ngritjen e sistemeve efektive të kontrollit, të tilla që të parashikojnë ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin,

				miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.
2	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatua sa më poshtë: **3.1** Sa i takon ndarjes së detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, u konstatua se për procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt: - ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, Tetor 2020, si dhe - ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi për ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid -19 ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, Tetor 2020; Titullari i AK, ka ngarkuar znj. A.R., me detyrë shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, e cila për këto procedura: - Ka hartuar kërkesën për materiale. - Ka hartuar fondin limit limit dhe specifikimet teknike. - Është anëtare e KVO. - Është caktuar si personi përgjegjës për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër. Sa më sipër ka bërë që detyrat e mësipërme të jenë përqendruar tek i njëjti nëpunës, duke e ngarkuar me përgjegjësi në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin dhe kontrollin, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 20, pika 1 dhe pika 2/c, si dhe neni 22, pika 3/b.		E Lartë	Me qëllim përmirësimin e mjedisit të kontrollit për procedurat e prokurimit publik, Titullari i AK të marrë masa që të sigurojë një ndarje të qartë dhe të drejtë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve, të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.
3	Nga auditimi i ligjshmërisë së hartimit të specifikimeve teknike, u konstatua se: - **në 2 raste**, nga njësia e prokurimit janë përdorur emra markash, të tilla si teknologjia Hybrid Capture, teknologjia TaqMan, si dhe sistemi Rapid Capture, **por pa shtuar tog - fjalëshin "*ose ekuivalent*",** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e konkretisht: në procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt: *(1)* ñBlerje e kiteve dhe materialeve te konsumit për Depistimin e HPV-sëò, me fond limit 26,663,857 lekë pa tvsh, Tetor 2018; dhe *(2)* në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt:ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh, Shkurt 2018. - **në 4 raste** AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por **nuk** i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, në procedurat me objekt: *(1)* ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH; *(2)* ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH; *(3)* ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH; dhe *(4)* ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan*		E Lartë	-Nga Njësia e Prokurimit të merren masa që për procedurat e zhvilluara në të ardhmen, të shmanget përdorimi markave dhe aty ku nuk është e mundur, gjithmonë të përdoret tog-fjalëshi ñ*ose ekuivalent*ò, me qëllim rritjen e konkurrencës e sigurimin e eficiencës në përdorimin e fondeve publike. -Me qëllim shmangien e problematikave në argumentimin teknik të kërkesave të veçanta për kualifikim, grupi i përllogaritjes se fondit limit në ISHP të marrë të gjitha masat, që në të gjitha rastet në vijim të dokumentojë në procesverbalet përkatës, argumentimet teknike nga specialistët e fushës për secilën kërkesë të veçantë për kualifikim.

	*Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH. **- në 3 raste** kërkesat për kualifikim janë hartuar jo në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publike (RRPP), e konkretisht: ***(1)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një* ***vlerë jo më e vogël se 40%*** *e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiros jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë* ***jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/*** *vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashme me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4. ***(2)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid - 19ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiro jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet...*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashmë me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4. ***(3)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt:ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh: Në Shtojcën 9, pika 2.2.1.b, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet te zotëroje vlerën monetare prej 10% te fondit limit të lotit/loteve për të cilat ofrojnë e cila do të mbuloje shpenzimet paraprake për fillimin e zbatimit te kontrates. Kjo vertetohet me anën e një Deklarate të Gjendjes Financiare të tij të lëshuar nga një ose më shumë banka jo më shumë se 20 ditë përpara datës së hapjes së procedurës së tenderit.*ò. Vendosja e kësaj kërkese, duke qenë se nuk parashikohet më në Rregullat e Prokurimit Publik si rezultat i ndryshimit të tyre në vitin 2017, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27.			-Për rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, Titullari i AK të marrë masa që t`i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

4	Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, **me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh**, Tetor 2020, u konstatua se në këtë procedurë prokurimi, kanë ofertuar 10 OE. Nga këta 10 OE, 6 prej tyre kanë qenë gjithashtu pjesë e OE-ve të përzgjedhur në procesin e studimit të tregut, gjatë hartimit të fondit limit. Për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se kontrata është lidhur me 25.12% të vlerës së fondit limit të përllogaritur **(ose rreth 74.88% më pak nga fondi limit),** pasi 6 nga OE - të e përzgjedhur përgjatë fazës së studimit të tregut, rezultuan të kenë ofertuar vlera shumë më të larta duke fryrë artificialisht vlerën e fondit limit, ndërsa gjatë fazës së tenderimit, po të njëjtët OE kanë ofertuar vlera më të ulëta, e konkretisht sipas tabelës së mëposhtme: 	Operatori Ekonomik	Farma-Net	OES-Distrimed	Montal	Biometric Albania	Krijon	Euromed (shpallur fitues)
---	---	---	---	---	---	---
Studim Tregu	171,660,000	177,300,000	152,400,000	172,800,000	141,600,000	181,800,000
Procedurë prokurimi	56,862,000	50,280,000	64,560,000	55,500,000	93,810,000	41,760,000
%	33%	28%	42%	32%	66%	23% | Kjo sjellje e OE të mësipërm, konsiderohet si një sjellje e dyshimtë dhe mund të përbëjë shkak për ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në oferta, sipas interpretimit zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ku në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë, përcaktohet se: ñ*Marrëveshjet e ndaluara në oferta çojnë në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar. Referuar sa më sipër, mbajtur në konsideratë parimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, sjellim në vëmendje të operatorëve ekonomikë që të jenë sa më të përgjegjshëm gjatë përllogaritjes së vlerës së fondit limit, me qëllim përllogaritjen sa më të saktë të tij. Paraqitja nga operatorët ekonomikë të ofertave me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender për të njëjtin objekt prokurimi, **mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t`i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës, në rast të konstatimit të këtyre diferencave**ò. ISHP, me konstatimin e këtyre diferencave duhej tëi ishte drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, për kryerjen e verifikimit e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në oferta, në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019.		E Lartë	ISHP menjëherë tëi drejtohet Autoritetit të Konkurrencës, për të marrë masa për verifikimin e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, nga Operatorët Ekonomikë F.N.SHPK, O.D. SHPK, M. SHPK, B.A. SHPK, K. SHPK dhe E. SHPK, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, për arsye se këta 6 OE, gjatë fazës së studimit të tregut kanë ofertuar vlera shumë të larta, ndërsa gjatë fazës së tenderimit kanë ofertuar vlera më të ulëta.
5	Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh në buxhetin e ISHP, që kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së MSHMS për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin e ISHP, duke ia alokuar këto fonde njësive vendore të shëndetit publik, apo institucioneve të tjera nën varësinë e ISHP, situata këto që reflektojnë një rol pasiv të institucionit në planifikimin buxhetor të saj. - Nga auditimi i shpenzimeve të kryera në kuadër të **pandemisë COVID-19,** me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është përcaktuar krijimi i fondit anti-Covid-19 prej 2,500 milion lekë, i cili është detajuar me VKM nr. 249/2020, ku është përcaktuar se 150 milionë lekë i kalojnë		E Lartë	ISHP të marrë masat për një monitorim më efektiv të fondeve buxhetore, duke identifikuar produktet që janë me realizim më të ulët në mënyrë që të përcillen kërkesat pranë MSHMS për rishpërndarjen e këtyre fondeve në produkte apo institucione të tjera brenda programit sipas nevojës, në funksion të përmbushjes së misionit të

	ISHP në programin ñShërbimet e shëndetit publikò për shpenzime korente. Në zbatim të VKM-së nr. 249/2020, ISHP-së i janë alokuar në llogarinë 600, konkretisht projektit me kod 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò fondet në vlerë 150 milion lekë, një pjesë e të cilave përgjatë vitit është shpërndarë në njësitë vendore të shëndetit publik për shpërblimin e personelit të angazhuar për përballimin e situatës së pandemisë në këto njësi (76.9 milion lekë); një pjesë është përdorur nga ISHP për shpërblimin financiar të stafit të angazhuar gjatë pandemisë (26.6 milion lekë); dhe një pjesë ka mbetur e pa realizuar (46.5 milion lekë). Konkretisht, nëse i referohemi planit fillestar buxhetor, atij të rishikuar dhe realizimit nga ISHP për këtë fond, konstatohet se nga ky fond janë përdorur gjithsej 26,625 mijë lekë, ose **46,558 mijë lekë më pak** se fondet disponibël deri në fund të vitit (ose 36%). Nga ISHP nuk është inciuar asnjë kërkesë për kryerjen e rialokimeve të këtyre fondeve, në institucione të tjera të programit të shëndetit publik, apo produkte të tjera ku nevoja për fonde ka qenë më e lartë. Për sa i përket fondeve për shpenzime operative përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID, në buxhetin e ISHP, për blerjen e tamponeve, kiteve dhe reagenteve me 2 operatorët ekonomikë **nuk** janë alokuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit për kryerjen e likuidimit të kontratës së lidhur (trajtuar më hollësisht në pikën e prokurimeve) dhe nuk është përdorur buxheti i pa realizuar i alokuar nga fondi Anti Covid për shpenzime shpërblimi personeli, por **institucioni ka përdorur tepricat e disponueshme në dispozicion, alokuar për aktivitetin rutinë, duke kryer ri-alokime brenda programit të institucionit, në produkte të ndryshme, pa efekt në totalin e vlerës së buxhetit në dispozicion për vitin 2020**. Më hollësisht, kanë qenë në dispozicion rreth 60 milion lekë nga produkti i çelur për kryerjen e pagesave për vaksina sipas Programit Kombëtar të Vaksinimit me kod 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò (rialokimi në SIFQ i datës 23.11.2020), 4.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e gjiritò, me kod 91305AD (rialokimi i datës 18.11.2020), dhe rreth 10.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò, me kod 91305AF (rialokimi i datës 18.11.2020). Nga këto fonde janë likuiduar më pas dy fatura me vlerë rreth 50 milion lekë për blerje tamponësh, reagent dhe kite në zbatim të kontratës së lidhur. Këto shpenzime janë kryer nën projektin ñNumër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò, duke mbartur kështu riskun e mos përllogaritjes së tyre në totalin e shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë, për të cilin duhet të ishte çelur kodi jo vetëm në llogarinë 600 për dhënie shpërblimesh të personelit, por edhe për blerje mallrash apo shërbimesh në funksion të situatës shkaktuar nga Covid (602), sikundër është realizuar edhe shpenzimi i trajtuar më sipër për blerje tampon kite, reagent. Pra, nga auditimi rezultoi se buxheti fillestar total (shpenzime korente dhe kapitale) për vitin 2020, për ISHP ka qene 788,262 mije leke ose 85,746 mijë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019 (702,516 mijë lekë), konkretisht: me shkresën e MSHMS nr. 247/2, prot datë 28.01.2020, është bërë çelja e buxhetit fillestar për shpenzime korrente të ISHP, në vlerë totale 775,262 mijë lekë (nga 695,953 mijë lekë **të realizuara** fillimisht 1 vit më parë); ndërsa me shkresën nr. 307/3, prot datë 28.02.2020 të MSHMS janë çelur shpenzime për investime në vlerën 13,000 mijë lekë për vetëm 1 projekt investimi (nga 49,752 mijë lekë të planifikuara fillimisht 1 vit më parë).			institucionit. Për sa i përket buxhetit për financimin e investimeve kapitale, strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit pranë ISHP dhe MSHMS, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit me tyre veçanërisht në kuadër të buxhetit për investimet kapitale në mënyrë që të shmangen fenomenet e rishikimeve të shpeshta të fondeve situata këto me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit. Strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS të marrë masa të menjëhershme për të sistemuar planin buxhetor të vitit 2021, të projektit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, duke rakorduar me degën e thesarit, me qëllim shmangien e risqeve të marrjes së angazhimeve, pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion. ISHP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS dhe MFE, të marrin masat në vijim për të sistemuar fondet e shpenzuara në funksion të situatës së shkaktuar nga Covid-19, në dallim me ato që i përkasin veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese, me qëllim që ato të evidentohen me kod produkti të identifikueshëm më vete me qëllim monitorimi dhe raportimi.

	Pavarësisht se planifikuar me rritje (rreth 86 milionë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019), ky buxhet, si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, në fund të vitit 2020 rezultoi në rënie, në vlerën 707,532 mijë lekë (ose rreth 81 milion lekë më pak **më pak** nga sa u parashikua me ligjin nr.88, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò). Në fund të vitit 2020, buxheti i ISHP u realizua në vlerën 648,670 mijë lekë, ose 58,862 mijë lekë më pak nga sa planifikuar, dhe 53,846 mijë lekë më pak nga sa realizuar një vit më parë, pavarësisht shtesës në fonde për llogari të Covid19. Në kushtet kur buxheti i ISHP jo vetëm që nuk ka pësuar rritje nga viti i mëparshëm, po dhe shtesat që iu alokuan në buxhet si pasojë e Covid (150 milionë leke vetëm me **VKM nr. 249, date 27.03.2020**) nuk reflektuan rritje ne buxhet, përkundrazi buxheti i ISHP u tkurr me 81 milionë leke nga plani fillestar dhe me rreth 5 milion leke më pak nga fakti i vitit 2019), për shkak të mos realizimit të projekteve të planifikuara që lidhen me aktivitetin normal të ISHP si : 1. 91305AD ñ*Gra te depistuara për kancerin e gjiritò*, planifikuar fillimisht 14,302 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 9,772 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 9,284 mijë lekë (488 mijë lekë më pak). 2. 91305AF ñ*Gra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò* planifikuar fillimisht 40,560 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 62 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 62 mijë lekë. 3. 91305AA ñ*Fëmijë të vaksinuar 0-18ò* planifikuar fillimisht 400,000 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 271,000 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 270,760 mijë lekë (240 mijë lekë më pak). 4. 91305AB ñ*Numër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò* për paga dhe sigurime të personelit të institucionit (llog 600,601) planifikuar fillimisht 193,100 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 179,630 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 172,023 mijë lekë (7,607 mijë lekë më pak); dhe për këtë produkt për shpenzime për shërbime (llog 602) planifikuar fillimisht 127,300 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 172,076 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 168,446 mijë lekë (3,630 mijë lekë më pak) Nga auditimi u konstatua se Projekti **18BB701** ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi"* është planifikuar në PBA 2020-2022 të MSHMS në vlerën 13,000 mijë lekë dhe është çelur në buxhetin e vitit 2020 po në atë vlerë. Përgjatë vitit nga MSHMS janë kryer ndryshime në buxhetin në dispozicion të ISHP dhe ky projekt deri në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0, shkak për të cilin sipas ISHP është bërë situata e pandemisë dhe ky projekt është gjykuar të përfshihet në planin buxhetor të viteve pasardhëse. Nga auditimi konstatojmë se kërkesa për rishpërndarje fondesh nuk është bërë nga ISHP, por është kryer nga organi epror ï MSHMS; e si pasojë ISHP si njësi shpenzuese që menaxhon këtë projekt nuk ka nja analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, sikundër dikton Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, paragrafi 74. Në vitin 2021 janë konstatuar se ekzistojnë diferenca në			

	disa produkte mes planit që rezulton në rakordimin mujor me degën e thesarit, dhe planit të rishikuar që rezulton pas shtesave dhe pakësimeve që janë kryer gjatë vitit. Më hollësisht, diferencat në llogarinë e pagave 600 janë sistemuar në rakordimin e muajit Prill, ndërsa diferenca e konstatuar në projektin e investimit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, ka vijuar të mbartet. Më hollësisht u konstatua se referuar shkresës së përcjellë nga MSHMS me nr.142/3, prot datë 02.02.2021 ñ***çelja e fondeve për këtë projekt është kryer për vitin 2022 dhe 2023 respektivisht me nga 13,680 mijë lekë"*****, dhe jo për vitin 2021, ndërsa vëmë re se, referuar** rakordimit mujor me degën e thesarit, për periudhën Janar-Mars 2021, faktikisht këtë projekt rezulton si plan buxheti për vitin 2021, vlera prej 13 milion lekë, duke mbartur riskun e fillimit të procedurave të prokurimit pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion.			
6	Nga auditimi u konstatua se për periudhën Janar-Mars 2021, nga ISHP është kryer likuidimi i pagesave për vaksinat kundër Covid-19 në vlerë **1,074,862 mijë lekë**, sipas 3 urdhër shpenzimeve, por nëse i referohemi rakordimit me degën e thesarit, vlera e shpenzimeve të kryera deri në këtë periudhë në projektin 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò është 1,083,538 mijë lekë. Diferenca prej rreth 8.7 milionë lekë leke, e raportuar më shumë sipas thesarit vjen si pasojë e përfshirjes së gabuar në këtë produkt të urdhër shpenzimit të kryer në vlerë 8,673,987 lekë të pagesës së shiringave në kuadër të programit kombëtar të vaksinimit, i cili faktikisht duhet të raportohej si shpenzim në kodin 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò. **Si rezultat, raportimi për shpenzimet buxhetore për personat e vaksinuar nga Covid 19, është i gabuar duke u raportuar rreth 8.7 milion lekë më shumë se niveli faktik i shpenzimeve,** me impakt kjo në analizën e indikatorëve të buxhetit bazuar në të dhënat e konsoliduara nga MSHMS në rang spitalor për programin e shëndetit publik.		E Lartë	ISHP të marrë masat për raportimin e saktë të shpenzimeve sipas produkteve ku është çelur plani buxhetor, në mënyrë që edhe analiza e performancës së produktit të reflektojë nivelin real të realizimit të planit.
7	Nga auditimi i fletë hyrjes nr. 17, datë 17.12.2020 për furnizimin me kite reagonte, materiale konsumi për QIA Symphony, janë bërë hyrje në magazinë artikujt sipas faturës tatimore nr. 2765, datë 17.12.2020, me nr. serial 84227763 në vlerën 28,499,088 lekë me TVSH, të O..A. shpk. Po në të njëjtën ditë, me fletë daljen nr. 113, datë 17.12.2020 është konstatuar se ISHP ka bërë dalje të gjithë sasinë e furnizuar, në laboratorin e virologjisë, në mungesë të fletë kërkesës së laboratorit, apo plan shpërndarjes ose kartelës limit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 38, ku citohet se: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve".* Nga ana e institucionit dalja e kësaj sasie në mënyrë të menjëhershme për në laborator është justifikuar me kushtet e situatës së paparashikueshme Covid-19 dhe kushtet e këqija të gjendjes fizike të magazinës, pra nuk janë tërhequr për përdorim laboratorik, por për tu ñmagazinuar përkohësishtò në laborator deri në përdorim. Nisur nga sa më sipër, nga institucioni **nuk** është marrë asnjë masë për inventarizimin e këtyre sasive dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Gjatë auditimit, grupi i auditimit kërkoi në rrugë zyrtare nga laboratori i virologjisë gjendjen e sasisë së kite reagentëve në datën 31.12.2020, nga ku u konstatua se gjendja e kiteve dhe reagenteve ishte në **vlerën e konsiderueshme 40,793 mijë lekë**, pasi në laborator gjendeshin sasi dhe nga blerje të mëparshme.		E Lartë	Titullari i institucionit të marr masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e gjendjes së kiteve dhe reagenteve që ndodhen aktualisht në Laboratorin e Virologjisë, dhe që janë transferuar në këtë laborator nga magazina pa fletë kërkesë, me qëllim rakordimin e vlerës aktuale me sasinë gjendje në fillim të periudhe, sasinë e bërë hyrje, dhe sasinë e përdorur. Pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse, dhe nxjerrja e përgjegjësive dhe marrja e masave për mosrakodrime (nëse do të konstatohen), e gjithë sasia e këtyre artikujve: - ose të ribëhet hyrje në magazinën qendrore, sipas rregullave që parashikon Udhëzimi nr. nr. 30,

	Dalja në mënyrë të menjëhershme, pa kërkesë dhe pa iu nënshtruar procesit të inventarizimit për sasitë e furnizuara si më sipër, shtrembëron pasqyrimin e saktë të gjendjes së magazinës në fund të vitit me impakt në pasqyrat financiare.			datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. - ose nëse magazina qendrore nuk plotëson kushtet e magazinimit, si dhe për shkak të situatës Covid 19, këto artikuj të bëhen hyrje në Laboratorin e Virologjisë, vetëm pasi Nëpunësi Autorizues i ISHP të miratojë procedura te qarta të lëvizjes së tyre, te shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Në secilin prej rasteve që do të konkludohet, sasitë gjendje në këtë laborator të inventarizohen me qëllim paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Në asnjë rast të mos bëhet më, dalje e menjëhershme e sasive të furnizuara për laboratorët, por dalja nga magazina të jetë gjithmonë e justifikuar nga kërkesat përkatëse, bazuar në konsumin real të kiteve, materialeve dhe reagenteve. Në kushtet kur magazina nuk plotëson kushtet për magazinimin e artikujve, MSHMS si institucion epror të marr masa për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së ISHP për fonde për investime, për rregullimin e magazinës në mënyrë që të plotësohen kushtet e nevojshme për magazinimin e kiteve dhe reagentëve dhe/ose artikujve të tjerë laboratorik për qëllime të shëndetit publik.
8	Nga auditimi janë konstatuar mangësi në dokumentacionin hyrës dhe dalës të magazinës si më poshtë: - Nga auditimi i fletë hyrjeve në magazinë është konstatuar se subjekti harton fletë hyrjet e magazinës pa bashkëlidhur kopje të dokumentacioneve shoqëruese të cilat të përshkruajnë saktësisht arsyen e hyrjes së aktivit në magazinë sikundër kërkohet edhe nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 37 e cila parashikon se: *"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të*		E Lartë	ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen hyrja e aktiveve në magazinë të dokumentohet në çdo rast jo vetëm me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, por të jetë edhe e shoqëruar me

	tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)" . Në të gjitha rastet fletë hyrja nuk është e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE dhe me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit. - Nga auditimi është konstatuar se subjekti ka një kuptim të gabuar të mënyrës se si duhen hartuar dokumentacionet shoqëruese dhe vërtetuese të lëvizjeve të magazinës. Për këtë arsye konstatohet se në të gjitha fletë daljet e audituara për periudhën objekt auditimi dalja e aktivit nga magazina shoqërohet me një format urdhër dorëzimi në të cilin lëshuesi i urdhrit të dorëzimit është shefi i departamentit ose laboratorit, ndërkohë që ky duhet të nënshkruhet nga nëpunësi i cili autorizon magazinën për të bërë daljen e aktivit. Shefi i departamentit dhe/ose laboratorit duhet të jetë personi i cili bën kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar e jo ai që nënshkruan urdhrin e dorëzimit. Asnjë nga fletë daljet nga magazina nuk është e shoqëruar me kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar. Në shumë raste është konstatuar gjithashtu se personi i autorizuar për të tërhequr aktivin nga magazina nuk është i njëjtë me atë që ka tërhequr në fakt aktivin. Konstatohet se nëpërmjet kësaj praktike të krijuar në institucion, janë ndërthurur në një dokument (pra në urdhër dorëzimin cituar më sipër) edhe vendimmarrja për dorëzimin e aktivit edhe kërkesa duke krijuar konfuzion dhe duke mos lënë gjurmë të qarta auditimi mbi arsyet dhe mënyrën e lëvizjes së aktiveve nga magazina. Lidhur me sa më sipër udhëzimi 30, në pikën 38 kërkon sa më poshtë: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve"* . Pra fletë dalja duhet të shoqërohet gjithmonë me urdhër dorëzim nënshkruar nga punonjësi i institucionit i cili autorizon magazinën për nxjerrjen e aktivit, nga fletëkërkesa për furnizimin me atë aktiv, si edhe me planin e shpërndarjes në raste kur ka një të tillë. Në asnjë rast fletë daljet nga magazina shoqërohen me kërkesën përkatëse.			kopje të faturës tatimore të prerë nga OE, me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit, për të evidentuar saktësisht arsyen e hyrjes së aktiveve në magazinë. ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen dalja e aktiveve nga magazina të bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe të dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve, ku të jenë lehtësisht të identifikueshëm kërkuesi, miratuesi, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i aktivit për një menaxhim sa më efektiv të këtij procesi.
9	Nga auditimi i procedurës së prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etjò, me fond limit 8,159,500 lekë lekë pa tvsh, Mars 2020, u konstatua se nga verifikimi i Urdhër-Shpenzimeve të Kontratës së Furnizimit nr. 373/9, datë 14/05/2020, si dhe dokumentacionit përkatës, konstatohet se për Urdhër-Shpenzimet nr. 420, datë 13.10.2020, me vlerë **1,386,000 lekë**, nr. 464, datë 29.10.2020, me vlerë **1,269,600 lekë** dhe nr. 570, datë 28.12.2020, me vlerë **3,969,000 lekë**, nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues të praktikave, **nuk** konstatohet të jetë e dokumentuar data e skadencës së mallrave të furnizuar. Në procesverbalet e marrjes në dorëzim, grupi i marrjes në dorëzim është shprehur vetëm se malli është në përputhje me skadencën, **por që një fakt i tillë nuk provohet** nga dokumentacioni shoqërues i faturave tatimore të sipërcituara, nisur nga fakti që data e skadencës duhet të jetë 6-8 muaj nga data e marrjes së mallit në dorëzim. Për sa më sipër, gjatë fazës së auditimit në terren, grupi i auditimit nuk mundi të shprehej mbi ligjshmërinë e materialeve të furnizuara nga O..A. SHPK në vlerën 6,624,600 lekë, për arsye të mos identifikimit të datës së skadencës së këtyre mallrave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 1.		E Lartë	Titullari i institucionit, në cilësinë e NA, të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që komisionet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara të dokumentojnë dhe të shprehen specifikisht për respektimin e afateve të skadencave për çdo artikull të furnizuar në ISHP me qëllim që të dokumentohet saktësisht ky fakt, për të shmangur në të ardhmen riskun e skadencës së parakohshme të mallrave të furnizuara për shkak të mos respektimit të afatit të skadencës me pasoja efekte në buxhetin e shtetit.

10	Nga auditimi janë konstatuar mangësi në dokumentacionin dalës të karburanit në magazinën e ISHP si më poshtë: Për vitin 2018, nga auditimi i fletë daljeve të karburantit dhe dokumentacionit shoqërues nga magazina për muajt prill, shtator dhe tetor është konstatuar se: përgjegjësi i sektorit të financës nuk ka nënshkruar urdhër dorëzimet përkatëse; praktika e daljes nga magazina të karburantit nuk shoqërohet nga kërkesa apo autorizimi për kryerjen e shërbimit. Këto dokumente menaxhohen në një set tjetër dokumentacioni i cili përpilohet nga secili shofer për makinën që ka në përdorim. Pavarësisht kësaj, ky dokumentacion ka mangësi pasi, shumica e kopjeve të autorizimeve për kryerjen e shërbimit janë pa numër protokolli, një pjesë e tyre janë edhe pa datë. Në rastin e automjetit me targë T. A fleta përmbledhëse e konsumit të karburantit për muajin prill 2018 është mbajtur me korrigjime të shumta, disa rreshta janë fshirë me korrektor, gjë kjo e cila le shkas për gabime në raportimin e lëvizjeve të automjetit. Fletë daljet pa nënshkrimin e sektorit të financës të evidentuara me këtë problematikë janë **146 në numër** për një total prej **5483 litrash në vlerën 922,443 lekë, e cila përbën menaxhim jo efektiv për buxhetin e shtetit.**		E Lartë	ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse dhe arsyeve të cilat kanë çuar në menaxhimin e gabuar të daljes së karburantit nga magazina në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në vitin 2018. ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që procesi i daljes së karburantit nga magazina të jetë gjithmonë i dokumentuar me autorizimin përkatës, fletë kërkesën, urdhër dorëzimin dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që të justifikojnë këtë veprim. ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që plotësimi i fletëve përmbledhëse të karburantit nga përgjegjësit për automjetet në ISHP të kryet duke respektuar kushtet minimale të një dokumenti të lexueshëm, të kuptueshëm dhe të auditueshëm, me qëllim promovimin e përgjegjshmërisë institucionale për daljen e aktiveve nga magazina si edhe konsumin e tyre.
11.	Në procedurën e prokurimit me objekt: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefekturat Shkodër, Lezhëò, me fond limit 9,943,883 lekë pa tvsh dhe ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefektura Vlorëò, me fond limit 30,509,969 lekë pa tvsh, Gusht, 2018, në lidhje me vlerësimin e kryer për O.N.SHPK u konstatua se: - O.N.SHPK ka paraqitur listëpagesën për muajin korrik ku vërteton se ka 14 punonjës, nga të cilët, D.C.me detyrë Menaxhere e Përgjithshme, D.R.me detyrë nëpunës informacioni dhe A.P. me detyrë ekonomiste, pranë këtij OE. Për të tre këta punonjës, sipas CV së paraqitur, kanë kryer një trajtim 5 ditor (mars 2019), me temë Teknik Shërbimesh DDD, pranë Akademisë së Shëndetit Publik. Në kërkesat e parashikuara në Shtojcën 8, për Lotin 1 dhe Lotin 4, kërkohen gjithsej, 1 Drejtues Teknik (Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1), 4 Teknikë Aplikimi (1 Loti 1 dhe 3 Loti 4) dhe 8 Aplikues (2 Loti 1 dhe 6 Loti 4), pra minimumi 13 punonjës. O.N.SHPK ka paraqitur, 2 Drejtues Teknik G.M.dhe F.N.), ndërsa ka paraqitur edhe CV për 12 punonjësit e tjerë, ku është përcaktuar që kanë kryer një trajnim 4-6 ditor me		E Lartë	ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse sa i takon mospërcaktimit në DT të kërkesave mbi kualifikimin, trajnimin, certifikatat dhe licencat e punonjëave të OE fitues të cilët do të kryejnë shërbimin e dizinsektimit. Të shmanget në të ardhmen nga Njësia e prokurimit vendosja e kritereve evazive sa i takon kapacitetit profesional të punonjësve që angazhohen nga OE në kryerjen e këtij shërbimi.

	objekt Teknik Shërbimesh DDD, ku 3 nga këta punonjës e kanë kryer pranë OE G. srl ndërsa 9 të tjerët pranë OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK. Si konkluzion, OE do e kryerjë shërbimin e Dezinsektimit të këtyre procedurave, me punonjës për të cilët ISHP nuk ka asnjë siguri mbi kualifikimet, certifikatat dhe licencat e tyre, dhe për më tepër, ka paraqitur si teknikë/aplikues, menaxheren e përgjithshme, nëpunësin e informacionit dhe ekonomisten e shoqërisë. Ndikimi në këtë situatë, ka patur fakti i mos kërkimit në DT të kërkesave të tilla nga Njësia e Prokurimit, si dhe vlerat e likuiduara për kontratat respektove për lotin 1: 8,411,364 lekë dhe për lotin 4 25,886,844 lekë **në total 34,298,208 për bëjnë menaxhim jo efektiv i fondeve vendosur në dispozicion nga buxheti i shtetit.** - Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në SPE krahasuar me DST për procedurën e prokurimit me objekt ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH është konstatuar se: - vërtetimi i debisë nr. 5880, datë 27.06.2019 lëshuar nga OSHEE është vetëm për kontratën nr. x, ndërkohë që nga ekstrakti historik i këtij subjekti vërehet se ky subjekt ka dy adresa të ushtrimit të aktivitetit të tij të deklaruara: zyra qendore Njësia Bashkiake nr. 11.... Lidhur me sa më sipër, OE ka paraqitur vërtetim debie vetëm për njërën nga dy adresat në të cilat ushtron aktivitetin pa specifikuar se cilës prej tyre i përket kontrata e cituar në vërtetimin e paraqitur. Ky veprim bie në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në shtojcën 8, pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, 1/d, e për pasojë nuk duhet të ishte kualifikuar për këtë kriter. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, pika 1 e LPP i cilin përcakton se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese"*, si edhe me nenin 66, pika 3 e VKM nr. 914 e cila citon se: *"Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit."* Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte OE S. shpk e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se: ñ*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*.ò e për rrjedhojë vlera prej **7,992,500 lekë pa TVSH përbën menaxhim jo efektiv të buxhetit të shtetit.**			

I.3 KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të aparatit të ISHP (I pakualifikuar me theksim të çështjes)[1]

[1] *Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2 , fq 139: "Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar: ISSAI 2706.5 - Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare*

Ne audituam pasqyrat financiare të Institutit të Shëndetit Publik, më datë 31.12.2020, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivet Afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.
Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi (ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike (kriteret)), por për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñTheksimi i Çështjesò.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ñPërgjegjësitë e Audituesve të KLSH-sëò, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe INTOSAI P 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñTheksimi i Çështjesò.

<u>Theksimi i çështjes:</u>
Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i ISHP-së i përfshirë, sa i takon vlerësimit dhe reflektimit të rekomandimeve tona për çështjet si vijon:
- Sipas pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit për vitin 2018, 2019 dhe 2020 në fund të vitit gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlerën 8,862 mijë lekë, për të cilat nga institucioni nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre.
- Nga auditimi i zërave të aktiveve u konstatua se aktivet në vlerën 6,449 mijë lekë, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.
- Nga auditimi i zërave ka rezultuar se mjetet në përdorim janë paraqitur në vlerën bruto prej 5,460 mijë lekë dhe jo në vlerë neto me një devijim në vlerë 1,600 mijë lekë më shumë.
-Nga auditimi i zërave ka rezultuar se Inventari Ekonomik në vlerën 48,772 mijë lekë është pasqyruar më shumë në vlerën 597 mijë lekë (neto) si pasojë e një gabimi në veprimet e llogaritjes.
- Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2019 dhe 2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë.
Vlera e devijimit e konstatuar është 2,197 mijë lekë, dhe është më e vogël se vlera e materialitetit të llogaritur nga analiza e riskut. Konkretisht vlera e materialitetit është 9,770 mijë lekë (ose 1.5% mbi vlerën e shpenzimeve).

II. Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i kualifikuar)[2]
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ISHP me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e

[2] *Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020, kapitulli 7.3.3 , fq 107: " Një opinion i kualifikuar jepet kur audituesi konstaton disa raste te mosrespektimit dhe mospërputhjeve ligjore, të cilat janë materiale, por jo të përhapura".*

fondeve/burimeve të ISHP-së, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.
Nga auditimi u rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i ISHP - së, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, ku u konstatuan shmangie nga kuadri rregullator ose mungesë e tij.

Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe INTOSAI P 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat përmenden në ISSAI-n 4000 ñStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.
Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit.
Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

Sa i takon Regjistrit të Parashikimit të Prokurimeve Publike (më tej RPPP):
- Për vitin 2018, 21 ndryshimet në RPPP për ISHP nuk janë dërguar në Degën e Thesarit.
- Për vitin 2019, nga 12 ndyshimet e RPPP vetëm 3 prej tyre janë dërguar në MSHMS si institucion që vendos në dispozicion fondet, por jo në degën e thesarit; 9 ndryshimet e tjera janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK, si dhe këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit.
- Për vitin 2020, janë kryer gjithsej 25 ndryshime në RPPP, për të cilat konstatohet se: për 10 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK; vetëm 3 prej 25 ndryshimeve të regjistrit, i janë dërguar MSHMS, si institucion qendror që vë në dispozicion fondet; asnjë prej këtyre ndryshimeve nuk i është dërguar Degës së Thesarit; nga verifikimi i regjistrave të parashikimeve dhe ndryshimeve të tyre për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ISHP ka kryer 6 ndryshime në RPPP pas datës 15 tetor, me vlerë totale 28,694,815 lekë.

Sa i takon zhvillimit të procedurave të prokurimeve:
- në 1 rast është konstatuar se kanë ofertuar 10 OE, 6 prej të cilëve kanë qenë pjesë e OE të përzgjedhur në procesin e studimit të tregut, gjatë hartimit të fondit limit. Kontrata është lidhur me 25.12% të vlerës së fondit limit të përllogaritur. Kjo sjellje e OE të mësipërm, konsiderohet si një sjellje e dyshimtë dhe mund të përbëjë ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar në oferta, sipas interpretimit zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Marrëveshjet e ndaluara në oferta çojnë në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 ñPër mbrojtjen e konkurrencësò, të ndryshuar. Paraqitja nga operatorët ekonomikë të ofertave me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender për të njëjtin objekt prokurimi, mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t`i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës, në rast të konstatimit të këtyre diferencave.

- në 6 raste, lidhur me hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga auditimi konstatohet se në hartimin e tyre, AK nuk i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar;
- në 3 raste, lidhur me argumentimin dhe dokumentimin përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet është konstatuar se nuk është argumentuar nga AK përzgjedhja e OE për të dhënë ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në kundërshtim me nenin 12, pika 2, germa a të LPP:
- në 3 raste, lidhur me nevojat për prokurim të punëve shërbimeve apo mallrave është konstatuar se nuk gjendet në dosjen përkatëse kërkesa për furnizim sipas nevojave të institucionit për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së procedurave përkatëse në kundërshtim me nenin 12, pika 2, germa a të LPP;
- në 2 raste është konstatuar kualifikim i OE nga KVO në kundërshtim me nenin 46, pika 1, nenin 53, pika 3 e LPP, si edhe me nenin 66, pika 3 e VKM nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
- në 1 rast është konstatuar nisja e një procedure të re prokurimi në kundërshtim me nenin 73, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

<u>Sa i takon zbatimit të kontratave:</u>

- në 2 raste është konstatuar mos dokumentim nga ana e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallrave të datave të skadencës në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 1.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Menaxhimi i ISHP është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.
Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:
Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.
Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (*<u>kriteret</u>*), dhe që gabimet apo parregullsitë e vërejtura, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura.
Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MIE, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në vijim të njoftimit për fillim auditimi nr. 527, prot., datë 07.05.2021 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 527/1 prot, datë 14.05.2021, i ndryshuar me shkresën nr. 527/2, prot., datë 21.06.2021 dhe me shkresën nr. 527/3, prot., datë 12.07.2021, në Institutin e Shëndetit Publik (më

tej ISHP), nga data 10.05.2021 deri në 30.07.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri në 30.03.2021, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Xh.C. Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. A.G.
3. J.T.
4. A.N.
5. M.K.

Titulli:
Projektraporti i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP).

Marrësi
Ky Projektraport i adresohet Drejtorit të Përgjithshëm të Institutin e Shëndetit Publik (ISHP).

II. 1 OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI I AUDITIMIT

Objektivat specifike të auditimit janë dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.
Qëllimi i auditimit është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë - në çdo aspekt material - në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Instituti i Shëndetit Publik, me qëllim ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, duke synuar kështu mirëpërdorimin e fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

II. 2 IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES

Instituti i Shëndetit Publik është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë. ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni.
Organet drejtuese të ISHP-së janë drejtori dhe këshilli shkencor. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të ISHP-së bëhet nga Ministri i Shëndetësisë. Kushtet dhe kriteret për emërimin e lirimin e drejtorit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Këshilli shkencor është organ këshillimor i ISHP-së ngritur me VKM nr. 380, datë 18.05.2011, ñPër ngritjen, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të këshillit shkencor të institutit të shëndetit publikò. Veprimtaria e institucionit kryet në përputhje me ligjin nr. 10138, datë 11.05.2009 ñPër shëndetin publikò, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetit publik.

II. 3 PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE DREJTUESE TË SUBJEKTIT TË AUDITUAR LIDHUR ME ÇËSHTJEN NËN AUDITIM

Misioni i ISHP, si qendra kombëtare në fushën e shëndetit publik, konsiston në zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjensi/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.
Në mënyrë më të detajuar, misioni i ISHP është:
- monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës në mënyrë që të identifikohen në kohë dhe të zgjidhen shkencërisht problemet shëndetësore të hasura.
- identifikimi dhe monitorimi i determinatëve risk të shëndetit.
- ndërmarrja dhe rritja e shkallës së informimit të popullatës, edukimit dhe ndërgjegjësimit të saj mbi problemet shëndetësore.
- stimulimi, koordinimi dhe mbështetja e iniciativave të institucioneve dhe komuniteteve përsa i

përket aktiviteteve të ndërmarra prej tyre për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore.
- stimulimi dhe mbështetja e projekt-ligjeve dhe rregulloreve drejtuar mbrojtjes së shëndetit të popullatës dhe sigurimit shëndetësor të saj.
- trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm i punonjësve të shëndetit publik dhe mbështetja profesionale ndaj tyre.
- vlerësimi i efektivitetit, aksesibilitetit dhe cilësisë si të shërbimeve shëndetësore të bazuara-në-popullatë ashtu dhe shërbimeve shëndetësore të bazuara-në-pacient.
- kërkimi shkencor për të ofruar zgjidhje inovatore të problemeve shëndetësore si dhe për të vendosur strategji efektive mbi kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve.

Funksionet e institucionit shpalosen në fushat si vijon: epidemiologjia dhe kontrolli i sëmundjeve infektive; epidemiologjia dhe kontrolli i sëmundjeve kronike jo-infektive; informacioni shëndetësor/indikatorët e shëndetit; shëndeti riprodhues; mjedisi dhe shëndeti (shëndeti mjedisor) *(uji, menaxhimi i mbetjeve, siguria ushqimore, cilësia së ajrit, shëndeti në punë, laboratorët, ekspertiza sanitare);* edukimi dhe promocioni shëndetësor. Fushat përparësore të identifikuara nga institucioni janë: duhani, aksidentet, medikamentet psikoaktive, alkooli, rinia, mosha e tretë, shëndeti mendor, sëmundjet kronike specifike, sëmundjet infektive.

II. 4 PËRGJEGJËSIA E AUDITUESVE TË KLSH

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;
- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

II. 5 KRITERET E VLERËSIMIT

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar
- Ligji nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punësò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 për ñKodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò;
- Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 ñPër shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisëò;
- Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 ñPër Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisëò;
- Ligji nr. 8615, datë 01.06.2000 ñPër urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisëò, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj për periudhën objekt auditimi;
- Ligji 75/2020 ñPër miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 21, datë 27.05.2020 ñPër disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020 të Këshillit të Ministrave, ñPër marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes se epidemisë së shkaktuar nga Covid-19ò miratuar me ligjin nr.30/2020.ò
- Çdo bazë ligjore me të cilën është operuar për vitin 2019 si dhe aktet juridike që janë në funksion për funksionimin e QSUNT.
- Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e pregatitjes, paraqitjes, dhe raportimi të pasqurave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik.ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë eletronikeò
- VKM-së nr. 160, datë 02.03.2016 ñPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publikeò.

II. 6 STANDARDET E AUDITIMIT

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ï 165);
- Ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- INTOSAI ï P - 1 ñDeklarata e Limësò;
- INTOSAI ï P ï 10 - 99 ñParimet themelore të INTOSAIò;
- INTOSAI ï P - 10 ñDeklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAIò;
- INTOSAI ï P - 12 ñVlerat dhe përfitimet e SAI ï sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëveò;
- INTOSAI ï P - 20 ñParimet e Transparencës dhe Llogaridhëniesò;
- INTOSAI ï P - 50 ñParimet e juridiksionit të SAIò;
- ISSAI 100 - 129 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò;
- ISSAI 2000 - 2899 ñStandardet e Auditimit Financiarò;
- ISSAI 400 ñParimet e Auditimit të Përputhshmërisëò;
- ISSAI 4000 ñStandardet e Auditimit të Përputhshmërisëò;
- ISSAI 2705 ñModifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarurò;
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

II. 7 MEDODAT E AUDITIMIT

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.
Nisur nga veçoria e subjektit të audituar, Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaòi cili është institucioni shëndetësor terciar më i madh në rand vendi, si për rëndësi ashtu edhe për buxhet të alokuar, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:
a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
g. *Modelimet e thjeshta statistikore* ï në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.
Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të QSUNT, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm.

II. 8 DOKUMENTIMI I AUDITIMIT

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me punonjësit e QSUNT, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë - veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me Akt Konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III. 1 INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Instituti i Shëndetit Publik organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 ñPër Shëndetin Publikò, si një institucion publik, buxhetor në varësi administrative nga të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, përcaktuar në nenin 12 të ligjit të sipërcituar. Neni 16 i ligjit i ligjit të sipër cituar si dhe pika 5 ñFinancimi i ISHPò e Rregullores së Brendshme të ISHP, miratuar me urdhër nr. 512, datë 31.12.2019, përcakton se ISHP financohet nga:

1. Buxheti i Shtetit
2. Të ardhura nga veprimtari shkencore dhe edukative
3. Grante, fonde për veprimtari shkencore, programe zhvillimi
4. Donacione
5. Burime të tjera të ligjshme

III. 2. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

Në zbatim të rregullores, miratuar me urdhër nr. 512, datë 31.12.2019, Drejtori i ISHP miraton treguesit financiar të projekt buxhetit të përgatitur e hartuar nga sektori i financës, ndarjen dhe destinacionin e fondeve buxhetore të financuara, mënyrat, format e evidentimit dhe kontrollit të administrimit të këtyre fondeve sipas legjislacionit në fuqi për buxhetin e shtetit dhe udhëzime të ndryshme në zbatim të tyre. Gjithashtu, Nën Drejtori Ekonomik i ISHP asiston dhe administron fondet buxhetore së bashku me Drejtorin, bazuar në analizën e nevojave të departamentit. Ai drejton procesin e hartimit të buxhetit vjetor të ISHP dhe mbështet Drejtorin e ISHP në argumentimin e saj pranë MSHMS. Është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e buxhetimit të aktiviteteve të projekteve/programeve të ndryshme financuar nga donatorët. Shefi i Sektorit të Financës është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve financiare për Nën Drejtorin Ekonomik në lidhje me aktivitetin ekonomik të ISHP-së, si dhe të marë pjesë në hartimin e projekt-buxhetit duke plotësuar informacionet tekniko-financiare. Aktiviteti financiar i institucionit planifikohet dhe realizohet vetëm në një program ekonomik, përkatësisht programin 07450 ñShërbimet e Shëndetit Publikò. Rezultatet e auditimit lidhur me procedurat e ndjekura nga ISHP për planifikimin, rishikimin dhe zbatimin e buxhetit të ISHP paraqiten si më poshtë:

a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Viti 2018

Në zbatim te Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, dhe Udhëzimin e përhershëm të MFE nr. 8 , datë 29.03.2012 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetitò, është ngritur pranë ISHP Grupi i Punës për hartimin e projekt buxhetit të vitit 2018, me urdhër të Drejtorit të ISHP, nr. prot. 784/1 datë 16.06.2017. Përbërja e grupit të punës paraqitet si më poshtë:

A.A.- Nëndrejtor Ekonomik
G.B.ï Nëndrejtor Teknik
S.F. - Drejtor Shërbimesh
A.M.- Shefe Finance
A.K.- Shefe Burimeve Njerëzore

Në këtë Urdhër, është përcaktuar edhe grup ndihmës për argumentimin e kërkesave të buxhetit të cilët janë Shefat e Departamenteve si më poshtë:

S.B.- Shefe DEKSI
A.L.- Shef i Departamentit të Mjedisit
E.T.- Shef i Departamentit të Informacionit
G.Q. - Shefe e Promocionit

Në dosjen e hartimit të projekt buxhetit, të përgatitur në vitin 2017, në kuadër të PBA-së 2018-2020, gjenden kërkesat për investime e Departamentit D.. Këto kërkesa janë përcjellë me shkresën

215/6, datë 26.05.2015. Sikurse identifikohet në dokumentacion këto janë kërkesat e përcjella nga ky departamenti edhe për përgatitjen e PBA-së 2016-2018. Më hollësisht, kërkesat paraqiten si mposhtë:
Investime në lidhje me pajisjet kompjuterike bazuar në çmimet e referencës dhe specifikimeve teknike të AKSHI-it, për nevoja të stafit për pajisje me PC.
Investime në lidhje me mobilimin dhe kondicionimin, i cili është i nevojshëm për zyrat e këtij departamenti. Sipas kërkesës, shumica e pajisjeve të kërkuara janë të vitit 1990.
Investime në lidhje me pajisjet laboratorike të cilat janë të nevojshme për punën në laborator, sigurinë e punonjësve dhe për të rritur gamën e ekzaminimeve , kryesisht pajisje në laboratorin e mikrobiologjisë, bakteriologjisë, preparotorisë, dhe laboratorit të biologjisë molekulare.
Krahas kërkesës së mësipërme, të cilat janë ato të vitit 2015, ky departament me shkresën nr. 784/2, datë 03.07.2017, ka përcjellë edhe kërkesën për buxhet për vaksinat dhe materialet përkatëse sipas çmimeve referencë të U, sasitë e nevojshme për vitet 2018-2020. Në dosje gjendet gjithashtu, kërkesa nr. 215/3, datë 26.05.2015 për investime për vitin 2016, e Departamentit të Informacionit Teknologjisë dhe Komunikimit. Në këtë dosje gjendet edhe kërkesa për investime për vitin 2016, me nr. 215/2, datë 26.05.2015, e Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit.
Shefi i administratës, ka përcjellë si kërkesë për investim, kërkesën e drejtuar në datë 777/1, datë 07.06.2017, mbi sistemin e tarracës së magazinave ISHP. Referuar kësaj shkresë është kërkuar një investim me qëllim rikonstruksioni e tarracës së magazinës dhe laboratorit. Bashkëlidhur është përcjellë preventivi dhe përllogaritjet përkatëse për investimin e nevojshëm për këtë rikonstruksion. Me anë të shkresës nr. 784/3, datë 17.07.2017 Departamenti i Epiodologjisë dhe Sëmundjeve Shëndetësore ka përcjellë kërkesën për buxhet për fillimin e pilotimit të depistimit për kancerin e qafës së mitrës dhe përllogaritjet përkatëse për periudhën 2018-2020. Me shkresën nr. 784/4, datë 17.07.2017 parashikimin për kontraceptiv për vitin 2018-2020. Me anë të shkresës nr. 784/5, datë 17.07.2017 Zyra e mbrojtjes nga rrezatimi ka përcjellë kërkesën për buxhet për blerje të pajisjeve të cilat do të përdoren për realizimin e matjeve të rrezatimit jo jonizues. Në vijim të kërkesës së vazhduar të bërë nga zyra gjatë viteve 2015-2017. Me anë të shkresës 784/6, datë 21.07.2017 ISHP i ka përcjellë MSHMS-së, propozimin e ISHP për hartimin e Projekt Buxhetit të periudhës 2018-2020 dhe relacioni përmbledhës, bashkëlidhur.

PBA 2018-2020

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
I	600&601	Shpenzime personeli	211,613	211,613	211,613
1	600	Paga	179,796	179,796	179,796
2	601	Sigurime Shoqërore	30,026	30,026	30,026
II	602	Mallra dhe shërbime të tjera	162,826	175,234	187,191
III	605	Transferta me jashtë	446,000	631,550	826,154
IV	230&231	Shpenzime për investime	165,410	17,486	0
TOTAL (I)+(II)+(III)			820,439	1,018,397	1,224,958
TOTAL (I)+(II)+(III)+(IV)			**985,849**	**1,035,883**	**1,224,958**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime (llog 602) me disa nga zërat kryesore sipas së cilave kryhet plani nga shefat e shërbimit paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
1	602	Materiale Zyre	2,450	2,573	2,701
2	602	Materiale dhe shërbime speciale	108,900	129,676	140,396
3	602	Shërbime nga të tretët	21,105	22,106	23,268
4	602	Shpenzim transporti	5,621	5,793	5,793
5	602	Shpenzime udhëtimi	8,200	6,200	6,200

6	602	Shpenzime për mirëmbajtën e zakonshme	12,930	5,240	5,240
7	602	Shpenzime për qiramarrje objektesh	300	250	250
8	602	Shpenzime për detyrime kompensime legale	100	0	0
9	602	Shpenzim të tjera operative	1,760	1,760	1,760
TOTAL			162,826	175,234	187,191

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për investime (llog 230&231) përfshin vetëm projekte të reja, pasi ISHP në nuk ka patur projekte në vazhdim nga periudhat e mëparshme. Planifikimi sipas projekteve respektive në planin buxhetor për periudhën 2020-2022 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
1	231	Investime të ndryshme, zëvendësim dritare, hekurash mbrojtës, dyer të brendshme të jashtme, etj.	400	-	-
2	231	Blerje Kompjutera Printera, Skaner , etj.	4,988.64	-	-
3	231	Blerje pajisje për rrjetin e brendshëm kompjutera	684		
4	231	Blerje pajisje aparatura, instrumente dhe të tjera ndihmëse për laboratorët e departamentit të Ekspertizës së Shëndetit dhe Mjedisit.	7,657.4	4,359	
5	231	Blerje pajisje dhe aparatura për Laboratorin Biologjik Molekular	7,600	15,000	
6	231	Blerje pajisje aparatura diagnostike dhe të tjera ndihmëse për Laboratorët e Departamentit të Sëmundjeve infektive.	6,500	12,000	
7	231	Blerje pajisje për matjen e rrezatimeve për zyrën e mbrojtjes nga rrezatimit	9,670.8		
8	231	Rikonstruksion i tarracës, tavanit të magazinës dhe të laboratorit mikrobiologjisë	960	480	
9	231	Blerje makinash për ISHP	2,500	2,000	
10	230	Rishikim i projektit të rikonstruksionit të hollit ISHP	2,600		
11	231	Blerje kondicioner	936		
12	231	Blerje stabilizatori, invertitor rryme dhe pajisje te tjera për sigurinë e qëndrueshmërisë së rrymës.	788		
13	231	Blerje pajisje mobilimi zyre	733.8		
	231	Blerje APC/Inverter UPS	960		
14	231	Projekt preventivi i laboratorit të Biologjisë Molekulare	100		
15	231	Ristrukturim i fasadës së ISHP, pjesa ballore, veriore dhe e pasme	15,117.93	15,486.8	
16	231	Ndërtim i qendrës së re të trajnimit	105,114		
TOTAL			**165,410.985**	**17,486.85**	**0**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nga krahasimi i kërkesës për investime, përcjellë nga ISHP në MSHMS, në PBA-në e konsoliduar nga kjo e fundit nuk është marrë në konsideratë asnjë prej kërkesave për investime.
Planifikimi i të ardhurave dytësore sipas planit buxhetor të hartuar në ISHP për periudhën 2019-2021 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Baza ligjore	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
1	Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	Udhëzimi Përb. Nr. 403 dt. 30.10.2006	26,000	28,000	29,000
2	Aktivitet mjekësor	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	4,500	5,000	5,000

TOTAL	**30,500**	**33,000**	**34,000**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Viti 2019

Në zbatim te Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, Ligjit nr. 10138, datë 15.05.2009 ñPër Shëndetin Publikò dhe Udhëzimin e përhershëm të MFE nr. 7, datë 28.02.2018 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetit të programit buxhetor afatmesëmò, është ngritur pranë ISHP Grupi i Punës për hartimin e projekt buxhetit të vitit 2019, me urdhër të Drejtorit të ISHP, datë 08.06.2018. Përbërja e grupit të punës paraqitet si mposhtë:

A.A.- Nëndrejtor Ekonomik
G.B.- Nëndrejtor Teknik
D.H. - Drejtor Shërbimesh
A.M.- Shefe Finance
A.K.- Shefe Burimeve Njerëzore

Në këtë Urdhër, është përcaktuar edhe grup ndihmës për argumentimin e kërkesave të buxhetit të cilët janë Shefat e Departamenteve. Sipas tij, hartimi i pasqyrave përkatëse do të bëhet në fushën e investimeve, shpenzimet, pagat, etj.

Me anë të shkresës nr. 700/2 prot., datë 26.06.2018, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi ka përcjellë kërkesën për investimeve në ZMR për vitin 2019. Konstatohet se, kërkesa për investime nga kjo drejtori është përcjellë vetëm për vitin 2019, pa parashikuar nevojat për investime në këtë drejtori, për vitet 2020 dhe 2021.

Me anë të shkresës nr. 700/3, datë 26/06/2018, Drejtoria e Promocionit Shëndetësor ka përcjellë kërkesën për investimeve. Parashikimi i buxhetit për vaksina është përcjellë për Drejtorin e ISHP dhe Zyrën e Financës me shkresën nr. 700/4 prot., datë 26.06.2018 duke përfshirë përllogaritjet bazuar në çmimet paraprake rekomanduar nga U, çmimet e vaksinave për 2 vitet e fundit dhe sasitë që nevojiten për periudhën 2019,2020,2021. Me anë të shkresës nr. 700/5, prot., datë 26.06.2018 Departamenti i Epidemiologjisë ka përcjellë parashikimin për kontraceptiv, në kuadër të programit për planifikimin familjar, për vitin 2019. Konstatohet se, edhe në këtë rast parashikimi i nevojave për kontraceptiv është përcjellë nga drejtoria përgjegjëse vetëm për vitin 2019, pa parashikuar nevojat për investime në këtë drejtori, për vitet 2020 dhe 2021. Me anë të shkresës nr. 700/6 prot., datë 26.06.2018, Drejtoria e Epidemiologjisë ka përcjellë kërkesë për kompjuter dhe pajisje të tjera të nevojshme. Me anë të shkresës nr. 700/7 prot., datë 26.06.2018, Departamenti ñShëndeti dhe Mjedisiò ka përcjellë kërkesat për vitin 2019. Konstatohet se, kërkesa për investime nga kjo drejtori është përcjellë vetëm për vitin 2019, pa parashikuar nevojat për investime në këtë drejtori, për vitet 2020 dhe 2021. Nëpërmjet shkresës nr. 700/8 prot., datë 26.06.2018, Drejtoria D. ka përcjellë kërkesat për këtë drejtori. Me anë të shkresës nr. 700/9, prot., datë 26.06.2018 është bërë kërkesa për mamografi të lëvizshme. Me anë të shkresës nr. 700/10 prot., datë 26.06.2018 Drejtoria e Shërbimeve ka përcjellë kërkesën e kësaj drejtori për periudhën 2019-2021. Me anë të shkresës nr. 700/11, prot., datë 26.06.2018, Drejtoria e Informacionit, Teknologjisë dhe Komunikimit ka përcjellë nevojat e këtij departamenti, për planifikimin e buxhetit. Me anë të shkresës nr. 700/12 prot., datë 03.07.2018 është përcjellë lista e nevojave të përmbledhura për pajisjet IT. Me anë të shkresës nr. 970 prot., datë 10.07.2018 ISHP ka përcjellë pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Financimit në MSHMS, planifikimin e buxhetit për zërat 600-601, 602,605,230,231, planifikimin e të ardhurave dytësore dhe relacionin përmbledhës.

Planifikimi i fondeve sipas projektbuxhetit 2019-2021 të hartuar nga ISHP, paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

PBA 2019 - 2021

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2019	Plani 2020	Plani 2021
I	600&601	Shpenzime personeli	211,613	211,613	211,613
1	600	Paga	177,100	177,100	177,100
2	600	Fond i veçantë	4,231	4,231	4,231
3	601	Sigurime Shoqërore	30,282	30,282	30,282
II	602	Mallra dhe shërbime të tjera	136,327	147,195	158,763
III	605	Transferta me jashtë	537,000	796,000	825,200
IV	230&231	Shpenzime për investime	181,630	20,220	0
TOTAL (I)+(II)+(III)			884,940	1,154,808	1,195,576
TOTAL (I)+(II)+(III)+(IV)			**1,066,570**	**1,175,028**	**1,195,576**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime (llog 602) me disa nga zërat kryesore sipas së cilave kryhet plani nga shefat e shërbimit:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2019	Plani 2020	Plani 2021
1	602	Materiale Zyre	2,450	2,695	2,965
2	602	Materiale dhe shërbime speciale	71,970	79,167	87,084
3	602	Shërbime nga të tretët	26,710	28,046	29,448
4	602	Shpenzim transporti	5,957	6,207	6,207
5	602	Shpenzime udhëtimi	8,200	9,020	9,922
6	602	Shpenzime për mirëmbajtën e zakonshme	18,880	19,900	20,978
7	602	Shpenzime për qiramarrje objektesh	300	300	300
8	602	Shpenzime për detyrime kompensime legale	100	100	100
9	602	Shpenzim të tjera operative	1,760	1,760	1,760
TOTAL			**136,327**	**147,195**	**158,763**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për investime (llog 230&231) përfshin vetëm projekte të reja, pasi ISHP në nuk ka patur projekte në vazhdim nga periudhat e mëparshme. Planifikimi sipas projekteve respektive në planin buxhetor për periudhën 2019-2021 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2019	Plani 2020	Plani 2021
1	231	Investime të ndryshme, zëvendësim dritare, hekurash mbrojtës, dyer të brendshme të jashtme, etj.	400	-	-
2	231	Blerje Kompjutera Printera, Skaner , etj.	5,800	-	-
3	231	Blerje pajisje aparatura, instrumente dhe të tjera ndihmëse për laboratorët e departamentit të Ekspertizës së Shëndetit dhe Mjedisit.	19,031		
4	231	Blerje pajisje aparatura diagnostike dhe të tjera ndihmëse për Laboratorët e Departamentit të Sëmundjeve infektive.	12,257		
5	231	Blerje pajisje për matjen e rrezatimeve për zyrën e mbrotjes nga rrezatimit	9,000		
6	230	Projekt dhe projekt preventiv zbatimi për rikonstruksionin e tarracës godinës qendrore	200		
7	231	Rikonstruksion i tarracës godinës qendrore	960		
8	231	Supervizion rikonstruksion i tarracës godinës qendrore	350		
9	230	Kolaudim supervizion rikonstruksion i tarracës godinës qendrore	200		
10	231	Blerje makinash për ISHP	2,800	2,800	
11	231	Rikonstruksioni i hollit të ISHP	2600		

12	230	Rishikim i projektit të rikonstruksionit të hollit ISHP	200		
13	230	Kolaudim i rikonstruksioni i hollit të ISHP	350		
14	230	Supervizim i rikonstruksionit të hollit të ISHP	350		
15	231	Blerje kondicioner	1,590		
16	231	Blerje stabilizatori, invertitor rryme dhe pajisje te tjera për sigurinë e qëndrueshmërisë së rrymës.	2,380		
17	231	Blerje pajisje mobilimi zyre	1,210		
18	231	Rikonstruksioni i fasadës së ISHP, pjesë ballore, veriore dhe te pasme	15,118	15,500	
19	230	Supervizim i rikonstruksionit të fasadës së ISHP, pjesë ballore, veriore dhe te pasme	960	960	
20	230	Kolaudim i rikonstruksionit të fasadës së ISHP, pjesë ballore, veriore dhe te pasme	960	960	
21	230	Rishikim i projektit të preventiv të rikonstruksionit fasadës së ISHP	200		
22	231	Ndërtim i qendrës së re të trajnimit	105,114		
TOTAL			**181,630**	**20,220**	**0**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Planifikimi i investimeve për ISHP, në PBA-në 2019-2021 të konsoliduar nga MSHMS, projektet për blerje pajisje kompjuterike apo laboratorike të planifikuara janë hartuar për të gjithë programin e shëndetit publik, i cili përfshin ndër të tjera edhe njësitë vendore të shëndetit publik, duke e bërë të pamundur krahasimin për këto zëra mes propozimit të ISHP dhe dokumentit të konsoliduar të PBA-së. Për sa i përket projekteve të rikonstruksionit, supervizim apo investime të tjera, në PBA-në e MSHMS nuk është përfshirë asnjë nga projektet e propozuara nga ISHP.

Planifikimi i të ardhurave dytësore sipas planit buxhetor të hartuar në ISHP për periudhën 2019-2021 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Baza ligjore	Fakt 2018	Plani 2019	Plani 2020	Plani 2021
1	Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	Udhëzimi Përb. Nr. 403 dt. 30.10.2006	13,222	25,500	26,800	27,500
2	Aktivitet mjekësor	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	5,537	4,000	4,500	5,000
TOTAL			**18,759**	**29,500**	**31,300**	**32,500**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Viti 2020

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, Ligjit nr. 10138, datë 15.05.2009 ñPër Shëndetin Publikò dhe Udhëzimin e përhershëm të MFE nr. 7, datë 28.02.2018 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetit të programit buxhetor afatmesëmò, është ngritur pranë ISHP grupi i punës për hartimin e projekt buxhetit të vitit 2020, me urdhër nr. 336, datë 19.06.2019 të Drejtorit të ISHP, me përbërje:

Znj. A.A., Nëndrejtor Ekonomik
Z. G.B., Nëndrejtor Teknik
Znj. A.C., Përgjegjës i Sektorit të Administratës
Znj. A.M., Përgjegjës i Sektorit të Financës
Znj. E.L., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore

Gjithashtu, grup ndihmës për argumentimin e kërkesave të buxhetit janë përcaktuar të jenë edhe shefat e departamenteve. Sipas urdhrit, kërkesat do të jenë të detajuara në kërkesa për:

Investime
Shpenzime të programit të vaksinimit

Shpenzime të programit për Depistimin e HPV
Shpenzime të programit të shëndetit riprodhues (kontraceptivët)
Të tjera.

Parashikimi i buxhetit për vaksina është përcjellë për Drejtorin e ISHP dhe Zyrën e Financës me shkresën nr. 854/2, prot datë 01.07.2019 duke përfshirë përllogaritjet bazuar në çmimet paraprake rekomanduar nga U. mbi çmimet e vaksinave për 2 vitet e fundit dhe sasitë që nevojiten. Parashikimi i shpenzimeve në kuadër të programit për Depistimin e HPV dhe programit të shëndetit riprodhues (kontraceptivët) është përcjellë me shkresën ne. 854/3, prot datë 01.07.2019 nga Departamenti i Performancës së Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike. Parashikimi i shpenzimeve për testimin e grave shtatzëna është përcjellë me shkresën nr. 854/8, prot datë 05.07.2019 të Përgjegjësit të Sektorit të Laboratorit të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive. Parashikimi i investimeve sipas nevojave të institucionit është përcjellë me shkresën nr. 854/1, prot datë 05.07.2019 të Përgjegjësit të Sektorit të Administratës; me shkresën nr. 236, prot datë 11.07.2019 të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi; me shkresën nr. 854/6, prot datë 05.07.2019 të Përgjegjësit të Sektorit të Laboratorit të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive; me shkresën nr. 854/4, prot datë 01.07.2019 të Përgjegjësit të Sektorit të Njësisë Bazë (Departamenti) i Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve të Shëndetit Publik. Në vijim, me shkresën nr. 854/12, prot datë 12.07.2019 të Drejtorit të ISHP është përcjellë pranë MSHMS planifikimi i buxhetit për vitin 2020-2022 dhe pasqyrat respektive.

Planifikimi i fondeve sipas planit buxhetor për periudhën 2020-2022 të hartuar nga ISHP, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2019), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Projekt buxheti 2020-2022

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Fakt 2019	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	600	Paga	153,263	181,070	181,070	181,070
2	600	Fond i veçantë		9,053	9,053	9,053
3	601	Sigurime Shoqërore	25,313	30,239	30,239	30,239
4	602	Mallra dhe shërbime të tjera	151,622	241,700	242,486	270,687
5	605	Transferta me jashtë	364,957	349,854	363,308	639,092
6	230&231	Shpenzime për investime	6,563	157,896	113,906	0
TOTAL (I)+(II)+(III)			**701,718**	**969,812**	**940,062**	**1,130,141**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në projekt buxhetin e vitit 2020 nga ISHP është përcjellë kërkesa për një buxhet prej rreth 969 milion lekë, krahasuar me rreth 701 milion lekë që paraqitet realizimi faktik për vitin 2019 (pra buxheti i propozuar i vitit 2020 është rreth 268 milion lekë më shumë se viti 2019). Për sa i përket shpenzimeve për investime, janë propozuar nga ISHP rreth 157 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 6 milion lekë. Buxheti për mallra dhe shërbime është propozuar në vlerën rreth 241 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 151 milion lekë. Buxheti për paga dhe sigurime shoqërore është propozuar në vlerën rreth 220 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 153 milion lekë.

Detajimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime (llog 602) me disa nga zërat kryesore sipas së cilave kryhet plani nga shefat e shërbimit:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Fakt 2019	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	602	Ilace dhe materiale mjekësore	23,610	44,000	48,400	53,240
2	602	Blerje kite dhe materiale konsumi për programin e Depistimit të HPV0-së	33,401	40,500	48,500	56,250
3	602	Kontraceptive	4,044	5,000	5,000	5,500

4	602	Shërbim i dezinsektimit në zonat bregdetare dhe urbane	41,109	80,000	80,000	80,000
5	602	Mallra dhe shërbime të tjera	49,458	72,200	60,586	75,697
TOTAL			**151,622**	**241,700**	**242,486**	**270,687**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për investime (llog 230&231) përfshin vetëm projekte të reja, pasi ISHP në nuk ka patur projekte në vazhdim nga periudhat e mëparshme. Planifikimi sipas projekteve respektive në projektbuxhetin për periudhën 2020-2022 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	230&231	Supervizim+kolaudim i rikonstruksionit të godinës qendrore të ISHP	1,106	1,106	
2	231	Rikonstruksion i godinës qendrore të ISHP	100,000	110,000	
3	231	Investime të ndryshme, zëvendësim dritare, dyer etj	400		
4	231	Blerje pajisje për Sektorin e Laboratorit të Referencës Kombëtare për Shëndetin dhe Mjedisin	21,710		
5	231	Blerje pajisje për laboratoret e diagnozës të Sëmundjeve Infektive dhe Sektorëve të DEKSI	18,670		
6	231	Blerje pajisje për matjen e rrezatimeve për zyrën e mbrojtjes nga rrezatimi	9,140		
7	231	Blerje makinash për ISHP	2,800	2,800	
8	231	Blerje kondicionera	480		
9	231	Blerje stabiliatori, invertitor rryme dhe pajisje të tjera për sigurinë e qendrueshme	2,380		
10	231	Blerje mobilim zyre	1,210		
TOTAL			**157,896**	**113,906**	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nëse i referohemi projekteve të planifikuara në PBA 2020-2022 përfundimtare të MSHMS me përfitues ISHP, situata rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Kodi i projektit	Emërtimi	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	18BB701	Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës së mbrojtjes nga Rrezatimi	13,000	0	13,680
TOTAL			**13,000**	**0**	**13,680**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Pra, në PBA 2020-2022 të hartuar nga MSHMS, nuk është përfshirë asnjë nga projektet e propozuar nga ISHP në fazën e hartimit të projekt buxhetit, dhe gjithashtu projekti i vetëm i planifikuar nga MSHMS me përfitues ISHP përkatësisht 18BB701, nuk rezulton i përfshirë në listën e investimeve të propozuar nga ISHP në projekt buxhetin për vitin 2020.

Planifikimi i të ardhurave dytësore sipas projektbuxhetit të hartuar në ISHP për periudhën 2020-2022 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Baza ligjore	Fakt 2019	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	Të ardhura nga analiza dhe tarifa shërbimi	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	838	1,430	1,500	1,550
2	Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	Udhëzimi i MSHMS nr. 713, datë 11.10.2018	8,733	15,500	15,900	16,500
3	Të ardhura nga pagesa shërbimesh	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	320	580	600	610

4	Të tjera	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	2,109[3]	55	58	65
TOTAL			**12,001**	**17,565**	**18,058**	**18,725**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, në projekt buxhetin e vitit 2020 janë planifikuar rreth 17 milion lekë të ardhura dytësore në total nga analiza dhe tarifa shërbimi; licenca/dhënie lejesh; pagesa shërbimesh; të tjera; krahasuar më rreth 12 milion lekë që paraqitet realizimi vitit 2019.

Viti 2021

Në zbatim te Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, Ligjit nr. 10138, datë 15.05.2009 ñPër Shëndetin Publikò dhe Udhëzimin e përhershëm të MFE nr. 7, datë 28.02.2018 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetit të programit buxhetor afatmesëmò, është ngritur pranë ISHP Grupi i Punës për hartimin e projek buxhetit të vitit 2021, me urdhër nr. 93, datë 23.06.2020 të Drejtorit të ISHP, me përbërje:
Znj. A.A., Nëndrejtor Ekonomik
Znj. A.C., Përgjegjës i Sektorit të Administratës
Znj. A.M., Përgjegjës i Sektorit të Financës
Znj. E.L., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore
Gjithashtu, grup ndihmës për argumentimin e kërkesave të buxhetit janë përcaktuar të jenë edhe Shefat e Departamenteve.
Parashikimi i buxhetit për vaksina është përcjellë për Drejtorin e ISHP dhe Zyrën e Financës me shkresën nr. 719/3, prot datë 03.07.2020 të Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive duke përfshirë përllogaritjet bazuar në çmimet paraprake rekomanduar nga U me çmimet e vaksinave për 2 vitet e fundit dhe sasitë që nevojiten. Parashikimi i shpenzimeve në kuadër të programit për Depistimin e HPV dhe programit të shëndetit riprodhues (kontraceptivët) është përcjellë me shkresën nr. 719/8, prot datë 07.07.2020 nga Departamenti i performancës së Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike. Parashikimi i investimeve sipas nevojave të institucionit është përcjellë me shkresën nr. 144, prot datë 03.07.2020 të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi; me shkresën nr. 719/5, prot datë 06.07.2020 të Përgjegjësit të Sektorit të Laboratorit të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive; me shkresën nr. 719/4, prot datë 03.04.2020 dhe 719/6 prot datë 07.07.2020 të Përgjegjësit të Sektorit Njësisë bazë (departamenti) i vlerësimit dhe trajtimit të risqeve të shëndetit publik, shkresën nr. 719/10 prot datë 08.07.2020 të Shefit të Departamentit Shëndeti dhe Mjedisi, shkresën nr. 719/9 prot datë 07.07.2020 të Përgjegjësit të Sektorit të Buxhetit dhe Financës. Në përfundim, me shkresën nr. 719/13, prot datë 08.07.2020 të Drejtorit të ISHP është përcjellë pranë MSHMS planifikimi i buxhetit për vitin 2021-2023 dhe pasqyrat respektive.
Planifikimi i fondeve sipas planit buxhetor për periudhën 2021-2023 të hartuar nga ISHP, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2020), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Planifikimi i buxhetit 2021-2023

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Fakt 2020	Plani 2021	Plani 2022	Plani 2023
1	600	Paga	174,080	179,485	179,485	179,485
2	600	Fond i veçantë		8,975	8,975	8,975
3	601	Sigurime Shoqërore	24,568	29,976	29,976	29,976
4	602	Mallra dhe shërbime të tjera	177,794	706,028	745,762	755,207
5	605	Transferta me jashtë	270,760	423,697	696,614	852,624

[3] *Duke perfshire të ardhurat dytësore: Të tjera nga shitja e mallrave dhe shërbimeve dhe Grante nga i njëjti nivel qeverisjeje (Projekte të Ministrisë së Mjedisit).*

6	230&231	Shpenzime për investime	1,411	99,236	2,800	0
TOTAL (I)+(II)+(III)			**648,670**	**1,447,397**	**1,663,612**	**1,826,267**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në projekt buxhetin e vitit 2021 nga ISHP është përcjellë kërkesa për një buxhet prej rreth 1,447 milion lekë, krahasuar me rreth 648 milion lekë që paraqitet realizimi faktik për vitin 2020 (pra buxheti i propozuar i vitit 2021 është rreth 799 milion lekë më shumë se viti 2020). Për sa i përket shpenzimeve për investime, janë propozuar nga ISHP rreth 99 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 1 milion lekë. Buxheti për mallra dhe shërbime është propozuar në vlerën rreth 706 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 177 milion lekë. Buxheti për paga dhe sigurime shoqërore është propozuar në vlerën rreth 216 milion lekë, ku realizimi faktik i vitit korrent paraqitet në vlerën rreth 198 milion lekë.

Detajimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime (llog 602) me disa nga zërat kryesore sipas së cilave kryhet plani nga shefat e shërbimit:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2021	Plani 2022	Plani 2023
1	602	Ilace dhe materiale mjekësore	32,000	48,400	53,240
2	602	Blerje kite dhe materiale konsumi për programin e Depistimit të HPV0-së	31,520	48,500	56,250
3	602	Kontraceptive	5,000	5,000	5,500
4	602	Blerje kite, reagente, materiale konsumi për testimet e COVID	489,000	489,000	489,000
5	602	Shërbim i dezinsektimit në zonat bregdetare dhe urbane	80,000	80,000	80,000
6	602	Mallra dhe shërbime të tjera	68,508	74,862	71,217
TOTAL			**706,028**	**745,762**	**755,207**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Detajimi i shpenzimeve për investime (llog 230&231) përfshin vetëm projekte të reja, pasi ISHP në nuk ka patur projekte në vazhdim nga periudhat e mëparshme. Planifikimi sipas projekteve respektive në projektbuxhetin për periudhën 2021-2023 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llog	Emërtimi	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	230	Projekt preventiv i rikonstruksionit të godinës qendrore të ISHP	4,350		
2	231	Blerje pajisje për Sektorët e Departamentit të Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve në Shëndetin Publik	4,906		
3	231	Blerje pajisje për matjen e rrezatimeve për zyrën e mbrojtjes nga rrezatimi	9,140		
4	231	Blerje stabiliatori, invertitor rryme dhe pajisje të tjera për sigurinë e qëndrueshme	2,380		
5	231	Investime të ndryshme, zëvendësim dritare, dyer etj	400		
6	231	Blerje pajisje për Sektorin e Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive	38,340		
7	231	Blerje pajisje diagnostikuese për Sektorin e Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale	35,000		
8	231	Blerje makinash për ISHP	2,800	2,800	
9	231	Blerje kondicionera	960		
10	231	Blerje pajisje kompjuterike	960		
TOTAL			**99,236**	**2,800**	**0**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nëse i referohemi projekteve të planifikuara në PBA 2021-2023 përfundimtare të MSHMS me përfitues ISHP, situata rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Kodi i projektit	Emërtimi	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
1	18BB701	Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi	0	13,680	13,680
TOTAL			**0**	**13,680**	**13,680**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Pra, në PBA 2021-2023 të hartuar nga MSHMS, nuk është përfshirë asnjë nga projektet e propozuar nga ISHP në fazën e hartimit të projekt buxhetit, dhe gjithashtu projekti i vetëm i planifikuar nga MSHMS me përfitues ISHP përkatësisht 18BB701, nuk rezulton i përfshirë në listën e investimeve të propozuar nga ISHP në projekt buxhet për vitin 2021. Ky projekt ka qenë pjesë edhe e projekt buxhetit të vitit paraardhës dhe për të cilin janë çelur fillimisht fondet në vitin 2020, por në vijim ato janë shpërndarë nga MSHMS në projekte të tjerë.

Planifikimi i të ardhurave dytësore sipas projektbuxhetit të hartuar në ISHP për periudhën 2021-2023 rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Baza ligjore	Fakt 2020	Plani 2021	Plani 2022	Plani 2023
1	Të ardhura nga analiza dhe tarifa shërbimi	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	830	1,300	1,350	1,350
2	Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	Udhëzimi i MSHMS nr. 713, datë 11.10.2018	7,718	14,100	15,000	15,000
3	Të ardhura nga pagesa shërbimesh	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	30	500	550	550
4	Të tjera	Udhëzimi i MSHMS nr. 63, datë 24.04.2007	2,978[4]	52	55	65
TOTAL			**11,558**	**15,952**	**16,965**	**16,965**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, në projekt buxhetin e vitit 2021 janë planifikuar rreth 15 milion lekë të ardhura dytësore në total nga analiza dhe tarifa shërbimi; licenca/dhënie lejesh; pagesa shërbimesh; të tjera; krahasuar më rreth 11.5 milion lekë që paraqitet realizimi vitit 2020.

Konkluzion mbi me zbatimin e kritereve ne planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për sa i përket kërkesave të propozuara nga ISHP për MSHMS lidhur me hartimin e projekt buxhetit

Njësitë e institucionit që kanë përcjellë kërkesat për buxhet për përgatitjen e PBA-ve, në disa raste kanë përcjellë shkresat e kërkesave për buxhet të cilat i përkisnin kërkesave për buxhet për përgatitjen e PBA-ve të periudhave të mëparshme, të parargumentuara, dhe në disa raste me diferenca në përllogaritjen e totalit, duke mos siguruar përcjelljen e kërkesave reale për hartimin e projektbuxhetit.

Në shumicën e rasteve kërkesat e drejtorive/departamenteve respektive janë përcjellë vetëm për vitin e parë të projekt buxhetit dhe jo për periudhën tre vjecare sikundër ky dokument duhet të hartuar, dhe gjithashtu në hartimin e projekt buxhetit në vitin pasardhës nuk merren parasysh kërkesat e argumentuara në vitin e dytë të PBA-ve të mëparshme, duke mos siguruar një planifikim afatmesëm efektiv.

[4] *Duke perfshire të ardhurat dytësore Të tjera nga shitja e mallrave dhe shërbimeve dhe Grante nga i njëjti nivel qeverisjeje (Projekte të Ministrisë së Mjedisit).*

Në PBA-në e konsoliduar përgatitur nga MSHMS konstatohet se kryesisht nuk është marrë në konsideratë asnjë prej kërkesave për investime të bëra nga ISHP gjatë fazës së përcjelljes së kërkesave nga kjo e fundit për hartimin e projekt buxhetit. Gjithashtu në PBA 2020-2022 të hartuar nga MSHMS projekti i vetëm i planifikuar nga MSHMS me përfitues ISHP, përkatësisht 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimiò, nuk rezulton i përfshirë në listën e investimeve të propozuar nga ISHP në projekt buxhetin e vitit 2020 dhe atë të vitit 2021, duke reflektuar mangësi në procesin e planifikimit dhe koordinimit mes institucioneve të varësisë dhe MSHMS.

b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2018

Çelja e buxhetit

Shpenzimet korrente

-Me shkresën e MSHMS nr. 5602/4, prot datë 22.01.2018, prot në ISHP nr. 104, datë 24.01.2018 është bërë celja e buxhetit fillestar për shpenzime korrente të ISHP, në vlerë totale 773,480 mijë lekë, nga të cilat: shpenzime për paga (llog 600) në vlerë 258,880 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) në vlerë 62,990 mijë lekë, shpenzime operative llog (602) në vlerë 101,610 mijë lekë, transferta me jashtë (llog 605) në vlerë 350,000 mijë lekë.

Shpenzimet kapitale

-Për sa i përket shpenzimeve për investime (llog 230 & 231) për vitin 2018, buxheti i çelur është në vlerën 0.

Ndryshime në buxhet përgjatë vitit

Shpenzimet korrente

1. Me shkresën nr. 4773/4, datë 10.09.2018 të MSHMS, në zbatim të ndryshimeve në aktin normativ nr. 1, datë 26.07.2019 janë kryer ndryshime në buxhetin e ISHP duke shtuar fondet në llog 602, në vlerë 32,000 mijë lekë për blerjen e HPV test Depistim, dhe duke pakësuar fondet e ISHP në llog 600 dhe 601, përkatësisht me 4,488 mijë lekë dhe 565 mijë lekë.
2. Me shkresën nr. 5316/1, prot datë 28.09.2018 të MSHMS, janë kryer ndryshime në buxhetin e ISHP duke pakësuar fondet në llog 602 me 3,200 mijë lekë.
3. Me shkresën nr. 6537, prot datë 14.11.2018 të MSHMS, janë kryer ndryshime në buxhetin e ISHP duke pakësuar fondet në llog 602 me 10,000 mijë lekë.
4. Me shkresën nr. 6536/2, prot datë 26.11.2018 të MSHMS, janë kryer ndryshime në buxhetin e ISHP duke pakësuar fondet në llog 605 në vlerë 28,868 mijë lekë në zbatim të shkresës së MFE nr. 20508/1, prot datë 22.11.2018.
5. Me shkresën e MFE në datë 31.12.2018 janë pakësuar fondet në llog 602 në vlerë 10,000 lekë, reflektuar në thesar në 19.01.2019. Në këtë kohë ISHP kishte kryer veprimet mbyllëse të pagesave në vijim te email-it të Drejtorisë së Financës në MSHMS në datë 26.12.2018, e cila kishte paracaktuar si afat datën 27.12.2018.

Ndryshimet në buxhetin për investime

Përgjatë vitit 2018 nuk ka patur ndryshime në buxhetin e investimeve të ISHP, i cili në fund të vitit paraqitet në vlerën 0.

Rishikimet e buxhetit të vitit 2018

Në mijë lekë

Emërtimi	Plani fillestar	Ndryshimet në planin e buxhetit		Plani i rishikuar
		Shtesa	Pakesime	
Paga	258,880		-88,488	170,392
Sigurime	62,990		-23,565	39,425

Shërbime	101,610	32,000	-17,200	116,410
Transferta me jashtë	350,000		-46,868	303,131
Transferta buxhetore	0	291		291
Total shpenzime korrente (A)	773,480	32,291	-176,121	629,649
Investime	0	0	0	0
Totak shpenzime kapitale(B)	0	0	0	0
TOTAL	**773,480**	**32,291**	**-176,121**	**629,649**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Sikundër paraqitet nga tabela e mësipërme, buxheti i ISHP për vitin 2018 është çelur fillimisht në vlerën rreth 773 milion lekë dhe përgjatë vitit si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, ai paraqitet në vlerën rreth 629 milion lekë, pra rreth 144 milion lekë më pak.

Viti 2019

Buxheti i vitit 2019 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2019-2021
Në mijë lekë

Llog	Kërkesa për buxhet 2019-2021	Çelja	Plani final	Diferenca(Plani i rishikuar-Kërkesa)
Paga	181,331	180,000	164,037	-17,294
Sigurime	30,282	32,500	28,772	-1,510
Shërbime	136,327	170,000	152,043	15,716
Transferta	537,000	500,150	365,857	-171,143
Total shpenzime korrente (A)	884,940	882,650	710,709	-174,231
Investime (B)	181,630	49,752	10,950	-170,680
TOTAL (A)+(B)	**1,066,570**	**932,402**	**721,659**	**-344,911**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Për vitin 2019, nga ISHP janë kërkuar në total rreth 1066 milion lekë, dhe deri në fund të vitit 2019 pas rishikimit të buxhetit janë alokuar rreth 721 milion lekë sipas shkresave të MSHMS, pra rreth 345 milion lekë më pak se plani në projekt buxhetin e hartuar nga ISHP ose rreth 32% me pak se buxheti i kërkuar.
Për shpenzimet korrente, sipas buxhetit të hartuar është kërkuar nga ISHP një buxhet rreth 885 milion lekë, nga të cilat 181 milion lekë shpenzime për paga, 30 milion lekë shpenzime për sigurime, 136 milion lekë për shërbime dhe 537 milion lekë shpenzime për transferta. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 711 milion lekë, 174 milion lekë më pak se kërkesat e institucionit në projektbuxhet, pra rreth 20% me pak se plani në projekt buxhetin e hartuar nga ISHP. Diferenca vjen kryesisht në zërin e transfertave (171 milion lekë më pak se plani), në zërin e pagave janë alokuar 17 milion lekë më pak se projekt buxheti, dhe në zërin e shërbimeve janë alokuar rreth 16 milion lekë më shumë se projekt buxheti.
Për shpenzimet kapitale për investime, në buxhetin e hartuar nga ISHP është parashikuar një buxhet rreth 182 milion lekë, dhe fondet e alokuara nga MSHMS deri në fund të vitit 2019 sipas buxhetit të rishikuar paraqiten rreth 11 milion lekë, pra 171 milion lekë më pak ose rreth 94% më pak se kërkesat e institucionit në projektbuxhet.

Celja e buxhetit
-Shpenzimet korrente
Me anë të shkresës nr. 294, datë 16.01.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, i ka përcjellë ISHP-së, pasqyrën e planit të buxhetit të vitit 2019 për shpenzimet korrente, të miratuar nga MFE, si më poshtë:

Kodi institucionit	*Llogaria Ekonomike*	*Kodi i projektit*	*Debiti (lekë)*
1013048	6000000	91305AB	180,000,000
1013048	6010000	91305AB	32,500,000
1013048	6020000	91305AB	163,573,000
1013048	6020000	91305AD	6,427,000
1013048	6060000	91305AB	150,000
1013048	6050000	91305AA	500,000,000
Totali			***882,650,000***

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

-Shpenzimet kapitale

Me anë të shkresës nr. 417/2, datë 04.02.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, i ka përcjellë I.SH.P, çeljen e buxhetit për vitet 2019-2021 për shpenzimet kapitale në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Kjo shkresë është përcjellë në zbatim të shkresës së MFE-së, nr. 22760/207 datë 30.01.2019. Në këtë shkresë është përcaktuar se në rastet e ndërhyrjeve infrastrukturore duhen pasur parasysh zbatimi i:

VKM nr. 629, datë 15/07/2015 ñPër miratimin e manualeve teknike dhe të çmimeve të punimeve të ndërtimit, si dhe analizat teknike të tyreò

VKM nr. 354, datë 11/05/2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektimi, mbikëqyrje dhe kolaudimò, që do të shërbejë për të përcaktuar vlerat e plota të supervizioneve dhe kolaudimeve por dhe të projekteve që do të mund të realizoni gjatë vitit 2019.

Kodi institucionit	*Prog*	*Llog*	*Kodi projektit*	*Emërtimi i projektit*	*Debit 2019*	*Debit 2020*	*Debit 2021*
1013048	07450	2310000	18BB601	Blerje pajisje kompiuterike për ISHP	6,600,000		
1013048	07450	231	18BB701	Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj) si dhe pajisje analizuese dhe të tjera për Laboratorët e mjedisit, si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi	-	63,500,000	
1013048	07450	231	18BB702	Blerje pajisje për laboratorët e shëndetit publik	20,700,000		
1013048	07450	23	18BB501	Projekt preventiv për rikonstruksionin e godinës qendrore te ISHP	2,200,000	-	
1013048	07450	231	18BB502	Rikonstruksion I godinës qendrore te ISHP	20,000,000	85,111,000	12,700,000
1013048	07450	231	18BB503	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godinës qendrore te ISHP	252,000	980,000	980,000
Total					***49,752,000***	***149,591,000***	***13,680,000***

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Ndryshime në buxhet përgjatë vitit

Me anë të shkresës nr. 776 prot., datë 06.02.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, i ka përcjellë I.Sh.P Tiranë, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 15.10.2018 ñMbi miratimin e strukturës dhe të organikës së Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësorò, transferimin e fondeve për shpenzime korrente. Sipas kësaj shkrese, është pakësuar buxheti i I.SH.P, produkti 91305AB, në llogaritë 600, 601, 602 për vlerat 10,000,000 lekë, 1,700,000 lekë dhe 7,000,000 lekë. Në total buxheti i ISHP është pakësuar në vlerën 18,700,000 lekë.

Me anë të shkresës nr. 854/7, datë 13.03.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së, është dërguar miratimi i transferimit të fondeve të investimeve për vitit 2019-2021, miratuar me shkresën e MFE-së nr. 3100/1, datë 07.03.2019. Sipas kësaj shkrese, është pakësuar buxheti i ISHP, në projektin 18BB702 ñBlerje pajisje për laboratorët e shëndetit publikò, në vlerën 1,000,000 lekë.

Me anë të shkresës nr. 4529/1, prot., datë 02.04.2019, me lëndë ñTransferimi fondit për vitin 2019ò, MFE i ka përcjellë MSHMS-së, miratimin e transferimit të fondeve të kërkuara, sipas tabelës në vijim. Sipas kësaj shkrese, ky transferim fondesh është kryer në mbështetje të shkresës së MSHMS-së, nr. prot., datë 15.03.2019, sipas të cilës kërkohet transferimi fondit për pagesën e detyrimit ndaj Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, bazuar në ligjin nr. 87/2018 ñ*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit nëpërmjet KM të R.SH, të përfaqësuar nga Ministri i MSHMS-së, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë*ò.

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Emërtimi i produktit	Debit (lekë)
Shtesat				
1013048	602	91305AB	Numër kontrollesh për situate epidemiologjike	22,500,000
Pakësime				
1013048	605	91305AA	Fëmijë të vaksinuar 0-18	22,500,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me anë të shkresës nr. 2880/2, datë 07.06.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, ka përcjellë transferimin e fondeve të investimeve për vitet 2019-2021, miratuar me shkresën e MFE-së nr. 9813/1, datë 03.06.2019. Sipas kësaj shkrese pakësohet projekti 18BB502 në vlerën 2,150,000 lekë dhe shtohet projekti 18BB501 në të njëjtën vlerë.

Me anë të shkresës nr. 10569/3 prot., datë 21.06.2019, MFE i ka përcjellë MSHMS, efektet financiare dhe detajimin e fondeve shtesë sipas njësive shpenzuese për shpenzimet korrente, për periudhën prill-nëntor 2019, në zbatim të VKM nr. 243, datë 19.04.2019[5]. Sipas kësaj shkresë, midis të tjerave, është shtuar buxheti i ISHP-së, në produktin me kod 91305AB, në llogarinë ekonomike 600, në vlerën 678,300 lekë dhe në llogarinë ekonomike 601, në vlerën 113,200 lekë, dhe llogarinë 606 me vlerë 500,000 lekë duke u pakësuar *Kontigjenca për rritjen e pagave (*Kodi i institucionit nr. 1081001, produkti 98102AA llogaria 609*)*.

Me anë të shkresës nr. 4613, datë 25.09.2019, Sekretariati i Përgjithshëm i MSHMS-së i ka përcjellë ISHP-së, transferimin e fondeve si në vijim. Referuar kësaj shkrese, këto transferime janë kryer në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, Ligjit 99/2018, Udhëzimit nr. 1, datë 17.01.2019, si dhe bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë për shtesat dhe pakësimet e fondeve buxhetore në shpenzimet operative. Sipas shkresës, buxheti i ISHP-së është pakësuar në

[5] ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura*".

produktin 91305AB, në llogaritë 600 dhe 601, për vlerat respektive 6,641,000 lekë dhe 2,141,000 lekë. Pra në total, buxheti i ISHP-së është pakësuar në vlerën 8,782,000 lekë.
Me anë të shkresës nr. 5162, datë 31.10.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së i ka përcjellë I.SH.P-së, transferimin e fondeve sipas të cilës buxheti i I.SH.P-së, është pakësuar në produktin 91305AB, në llogarinë 602, në vlerë 16,000,000 lekë Sipas shkresës, lëvizja e buxhetit është kryer në zbatim të kuadrit ligjore të përshkruar më lartë dhe kërkesave të institucioneve të varësisë për shtesa ose pakësim fondesh.
Me anë të shkresë nr. 4876/3, datë 28.10.2019, në zbatim të Aktit Normative nr. 2, datë 02.10.2019 ñ*Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019"* Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së i ka përcjellë ISHP-së, transferimin e fondeve për shpenzimet operative. Buxheti i I.SH.P-së është pakësuar në llogarinë 602 të produktit 91305AB, në vlerën 17,457,062 lekë, si dhe në llogarinë 605 të produktit 91305AA në vlerën 112,542,938 lekë.
Me anë të shkresës nr. 4876/5, datë 31.10.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, i ka përcjellë ISHP-së, miratimin e detajimit të fondeve të investimeve në zbatim të Aktit Normativ Nr. 2, datë 02.10.2019, miratuar me shkresën e MFE-së nr. 17343/90, datë 28.102.2019. Sipas kësaj shkresë kanë ndodhur pakësimet e mëposhtme:

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Emërtimi i produktit	Debit (lekë)
Paksimet				
1013048	231	18BB502	Rikonstruksion i godinës qendrore te ISHP	17,850,000
1013048	231	18BB503	Superv+kolaudim për rikonstruksionin e godinës qendrore te ISHP	252,000
1013048	231	18BB702	Blerje pajisje për laboratorët e shëndetit publik	19,700,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me anë të shkresës nr. 5162/1, datë 14.11.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, në zbatim të kuadrit ligjor dhe kërkesave të institucioneve të varësisë, ka kryer transferim të fondeve për shpenzime operative. Sipas kësaj shkrese, buxheti i ISHP-së është shtuar në llogarinë 606 të projektit 91305AB në vlerën 250,000 lekë.

Rishikimet e buxhetit të vitit 2019 *në lekë*

Llog	**Çelja**	**Lëvizjet e buxhetit**		**Plani final**	**Diferenca (plani final-celje)**	**Diferenca sipas zerave % ndaj totalit të diferencës**
		Shtesa	**Pakësime**			
Paga	180,000,000	678,300	-16,640,999	164,037,301	-15,962,699	-8%
Sigurime	32,500,000	113,200	-3,841,000	28,772,200	-3,727,800	-2%
Sherbime	170,000,000	22,500,000	-40,457,062	152,042,938	-17,957,062	-9%
Transferta me jashtë	500,000,000		-135,042,938	364,957,062	-135,042,938	-64%
Transferta buxhetore	150,000	750,000		900,000	750,000	0%
Total shpenzime korrente (A)	882,650,000	24,041,500	-195,981,999	710,709,501	-171,940,499	-82%
Investime (B)	49,752,000	2,150,000	-40,952,000	10,950,000	-38,802,000	-18%
TOTAL (A)+(B)	**932,402,000**	**26,191,500**	**-236,933,999**	**721,659,501**	**-210,742,499**	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në fillim të vitit 2019, për ISHP janë çelur në total 932,402,000 lekë fonde, me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, ku më hollësisht janë shtuar 26,191,500 lekë dhe janë pakësuar 236,933,999 lekë, buxheti i korrektuar ne fund rezulton 721,659,501 lekë ose 210,742,499 lekë më pak se celja në fillim të vitit.

Peshën më të madhe në totalin e pakësimeve e zënë ato në shpenzime korrente, ku gjatë vitit 2019 janë shtuar 24,041,500 lekë dhe janë pakësuar 195,951,998 lekë, çka ka shkaktuar një pakësim neto në vlerën 171,940,498 lekë, ose 82 % të totalit të pakësimeve. Përqindjen më të madhe të pakësimeve në shpenzimet korrente e zënë transfertat me jashtë të cilat janë pakësuar me 135,042,938 lekë ose 64% ndaj totalit të pakësimeve.

Pakësimet në shpenzimet kapitale, rezultojnë në vlerën 38,802,000 lekë, ose 18 % ndaj totalit të pakësimeve. Ndërsa, në raport me çeljen fillestare, pakësimin më të madh e kanë pësuar investimet të cilat fillimisht janë çelur me vlerën 49,752,000 lekë dhe janë pakësuar në total me 38,802,000 lekë, ose 78%.

Rishikimet e buxhetit të vitit 2019 në nivel produkti dhe projekti

Llog	Produkti	Celja	Lëvizjet e buxhetit								Plani final
			6.02	13.03	2.04	7.06	21.06	25.09	28.10	31.10	14.11	
600	91305 AB	180,000,000	-10,000,000				678,300	-6,641,000				164,037,300
	91305 AG											-
601	91305 AB	32,500,000	-1,700,000				113,200	-2,141,000				28,772,200
602	91305 AB	163,573,000	-7,000,000		22,500,000				-17,457,062	-16,000,000		145,615,938
	91305 AD	6,427,000										6,427,000
	91305 AF											-
605	91305 AA	500,000,000			-22,500,000				-112,542,938			364,957,062
606	91305 AB	150,000					500,000				250,000	900,000
	Total shpenzime korrente (A)	882,650,000	-18,700,000	-	-	-	1,291,500	-8,782,000	-130,000,000	-16,000,000	250,000	710,709,501
231	18BB702	20,700,000		-1,000,000						-19,700,000		-
231	18BB502	20,000,000			-2,150,000					-17,850,000		-
230	18BB501	2,200,000			2,150,000							4,350,000
23	18BB6	6,600,0										

1	01	00										6,600,000
231	18BB503	252,000								-252,000		-
Total shpenzime kaptale (B)		49,752,000	-	-1,000,000	-	-	-	-	-	-37,802,000	-	10,950,000
TOTAL (A)+(B)		**932,402,000**	**-18,700,000**	**-1,000,000**	**-**	**-**	**1,291,500**	**-8,782,000**	**-130,000,000**	**-53,802,000**	**250,000**	**721,659,501**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Viti 2020

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022

Në mijë lekë

Emërtimi		**Kërkesa projektbuxhet 2020-2022**	**Plani fillestar i miratuar (2020)**	**Plani i rishikuar (2020)**	**Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)**
Shpenzime korrente (A)	Paga	190,123	162,600	228,184	-38,061
	Sigurime	30,239	30,500	24,630	5,609
	Shërbime	241,700	182,162	181,910	59,790
	Transferta me jashtë	349,854	400,000	271,000	78,854
Total (A)		811,916	775,262	705,724	106,192
Shpenzime kapitale (B)	Investime	157,896	13,000	1,806	156,090
Total (B)		157,896	13,000	1,806	156,090
TOTAL (A)+(B)		969,812	788,262	707,530	262,282

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Për vitin 2020, janë planifikuar në projektbuxhetin 2020-2022 në total 969 milion lekë, dhe deri në fund të vitit 2020 pas rishikimit të buxhetit janë alokuar 707 milion lekë sipas shkresave të MSHMS, pra rreth 262 milion lekë më pak se plani në projekt buxhetin e hartuar nga ISHP.
Sipas projektbuxhetit 2020-2022 për shpenzimet korrente janë nga ISHP një buxhet prej 811 milion lekë, nga të cilat 190 milion lekë shpenzime për paga, 30 milion lekë shpenzime për sigurime, 241 milion lekë për shërbime dhe 349 milion lekë shpenzime për transferta me jashtë. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 705 milion lekë, pra 106 milion lekë më pak se kërkesat e institucionit në projektbuxhet. Diferenca vjen kryesisht në zërin e shërbimeve (59 milion lekë se plani), në zërin e transfertave me jashtë ku janë alokuar 78 milion lekë më shumë se projekt buxheti, dhe në zërin e pagave ka patur një rritje duke u alokuar rreth 38 milion lekë më shumë se projekt buxheti, për shkak të shpërblimeve të dhëna për shkak të pandemisë.
Për shpenzimet kapitale për investime, në projektbuxhetin e 2020-2022 është parashikuar një buxhet prej 157 milion lekë, dhe janë alokuar nga MSHMS deri në fund të vitit 2020 buxheti i rishikuar paraqitet në vlerën 1.8 milion lekë, pra rreth 156 milion lekë më pak se kërkesat e institucionit në projektbuxhet.

Celja e buxhetit

Shpenzimet korrente

-Me shkresën e MSHMS nr. 247/2, prot datë 28.01.2020, prot në ISHP nr. 157, datë 29.01.2020 është bërë çelja e buxhetit fillestar për shpenzime korrente të ISHP, në vlerë totale 775,262 mijë lekë (nga mijë lekë të planifikuara fillimisht 1 vit më parë), nga të cilat: shpenzime për paga (llog 600) në vlerë 162,600 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601) në vlerë 30,500 mijë lekë, shpenzime operative llog (602) në vlerë 182,162 mijë lekë, transferta me jashtë (llog

605) në vlerë 400,000 mijë lekë. Transferta buxhetore familjare (llog 606) janë planifikuar në vlerë 450 mijë lekë.
Shpenzimet kapitale
-Për sa i përket shpenzimeve për investime (llog 230 & 231) për vitin 2020, buxheti i çelur është përcjellë për ISHP me shkresën nr. 307/3, prot datë 28.02.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vlerën 13,000 mijë lekë për vetëm 1 projekt investimi.

Ndryshime në buxhet përgjatë vitit
Shpenzimet korrente
1. Me shkresën nr. 6124/1, datë 03.04.2020 të MFE, në zbatim të VKM nr.249, prot datë 27.03.2020 ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fonit Anti Covid për MSHMS për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19ò janë kryer ri alokime të fondeve buxhetore për shpenzime korente duke shtuar fondet në llog 600, sipas produktit 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò në vlerë 150,000 mijë lekë.
2. Me shkresën nr. 1429/9, datë 17.09.2020 të MSHMS, në zbatim të VKM nr. 249 dhe VKM nr. 207 pika 4òPër dhënien e shpërblimit për personelin, mjekët, infermierë dhe punonjës të tjerëò, si dhe kërkesave nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor për shpërblimet e mjekëve epidemiolog që kanë shërbyer në periudhën e pandemisë, janë pakësuar fondet e ISHP në llog 600, sipas produktit 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19ò në vlerë 50,000 mijë lekë, për transferimin e këtyre fondeve pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
3. Me shkresën nr. 4361, datë 29.09.2020 të MSHMS, për nevoja të institucioneve që janë në vijën e parë të luftës kundër COVID, janë pakësuar fondet e ISHP në llog 602, sipas produktit 91305AF ñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò në vlerë 30,000 mijë lekë, për tõju shtuar Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
4. Me shkresën nr. 4784, datë 26.10.2020 të MSHMS, në vijim të kërkesave për artikujt 600-601 të institucionee të programit 07450, janë shtuar fondet e ISHP në llog 600, sipas produktit 91305AB ñNumer kontrollesh per situatat epidemiologjikeò në vlerë 9,400 mijë lekë, dhe janë pakësuar fondet në llog 600, sipas produktit 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19ò në vlerë 12,500 mijë lekë dhe 4,340 mijë lekë; dhe në llog 601 sipas produktit 91305AB ñNumer kontrollesh per situatat epidemiologjikeò në vlerë 1,240 mijë lekë.
5. Me shkresën nr. 4784/1, datë 13.11.2020 të MSHMS, për nevoja të institucioneve në llog 600, janë pakësuar fondet sipas produktit 91305AG në llog 600 ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19ò në vlerë 2,966 mijë lekë për tõju shtuar Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor; dhe janë pakësuar gjithashtu fondet sipas produktit 91305AB ñNumer kontrollesh për situatat epidemiologjikeò në llog 601 në vlerë 330 mijë lekë.
6. Me shkresën nr. 5082, datë 13.11.2020 të MSHMS, në vijim të kërkesës së ISHP nr. 157/7, datë 12.11.2020 ku është kërkuar transferim i fondit nga disa produkte që rezultojnë me teprica me qëllim përdorimin e këtyre fondeve për blerje tamponesh, janë kryer ndryshime nëpërmjet produkteve, pa efekt në totalin e vlerave, ku më hollësisht janë pakësuar fondet e ISHP në llog 602, sipas produktit 91305AD ñGra te depistuara për kancerin e gjiritò në vlerë 4,529 mijë lekë, dhe produktit 91305AFñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò me vlerë 10,497; ku si rezultat janë shtuar fondet në produktin 91305AB ñNumer kontrollesh per situatat epidemiologjikeò me vlerë 15,026 mijë lekë.
7. Me shkresën nr. 1429/10, datë 13.11.2020 të MSHMS, në vijim të kërkesave për artikujt 600-601 të institucionee të programit 07450, janë pakësuar fondet e ISHP në llog 600, sipas produktit 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19ò në vlerë 10,350 mijë lekë për tõju shtuar Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

8. Me shkresën nr. 1429/11, datë 13.11.2020 të MSHMS, në vijim të kërkesave për artikujt 600-601 të institucionee të programit 07450, janë pakësuar fondet e ISHP në llog 600, sipas produktit 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19ò në vlerë 1,000 mijë lekë për tõju shtuar Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
9. Me shkresën e MFE nr. 5022/2 prot në ISHP datë 27.11.2021 janë kryer ndryshimet në buxhet duke pakësuar fondet nga llogaria 605 në produktin 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò me vlerë 60,000 mijë lekë, si tepricë nga kursi i këmbimit për blerjen e vaksinavë, dhe janë shtuar këto fonde në vlerë 60,000 mijë lekë në llogarinë 602 për blerjen e tamponëve dhe reagentëve në produktin 91305AB ñNumer kontrollesh per situatat epidemiologjikeò.
10. Me shkresën nr. 17533/9, datë 03.12.2020 të MFE, janë pakësuar fondet e ISHP në llog 600, sipas produktit 91305AB ñNumër kontrollesh pëe situatat epidemiologjikeò në vlerë 17,000 mijë lekë, fondet në llog 601, sipas produktit 91305AB ñNumër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò në vlerë 4,300 mijë lekë, fondet në llog 602 sipas produktit 91305AB ñNumër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò në vlerë 30,250 mijë lekë, fondet në llog 605, sipas produktit 91305AA ñNumër kontrollesh pëe situatat epidemiologjikeò në 69,000 mijë lekë; për tõju shtuat Administratës Qendrore SHSSH.

Ndryshimet në buxhetin për investime
1. Me shkresën nr 2219/3, prot datë 11.06.2020 të MSHMS, në vijim të shkresës së MFE nr. 8161/1 prot datë 04.06.2020, janë pakësuar fondet për projektin 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëònë vlerë 120 mijë lekë.
2. Me shkresën nr. 3235/4, prot datë 16.07.2020 të MSHMS, në zbatim të Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020, dhe shkresës së MFE nr. 12507/47, datë 14.07.2020 janë pakësuar fondet për projektin 18BB701 në vlerë 12,880 mijë lekë dhe janë shtuar fondet për projektin e celur rishtaz 18BB704 ñTVSH për pajisje dhe materiale konsumi për ISHP në kuadër të Covid 19ònë vlerë 1,900 mijë lekë.
3. Me shkresën nr. 1370 prot datë 25.11.2020 të MSHMS dhe shkresës nr. 21439/1, datë 23.11.2020 të MFE janë pakësuar fondet për projektin 18BB704 në vlerë 1,564 mijë lekë, dhe janë çelur fondet për financimin e 3 projekteve të reja, përkatësisht 18BB603 ñBlerje (F+V) rotor për centrifug ependorfò në shumë 420 mijë lekë; 18BB601 ñBlerje pajisje kompjuterike (Blerje UPS për sigurinë e qëndrueshme të rrymës së energjisë elektrike në pajisje për ISHP)ò në shumën 520 mijë lekë dhe 18BB604 në shumën 530 mijë lekë.

Rishikimet e buxhetit të vitit 2020

Në mijë lekë

Emërtimi	Plani fillestar	Ndryshimet në planin e buxhetit		Plani i rishikuar
		Shtesa	Pakesime	
Paga	162,600	159,400	-93,816	228,184
Sigurime	30,500		-5,870	24,630
Shërbime	182,162	75,026	-75,276	181,910
Transferta me jashtë	400,000		-129,000	271,000
Transferta buxhetore	450			450
Total shpenzime korrente (A)	775,712	234,426	-303,962	706,176
Investime	13,000	3,370	-14,564	1,806
Totak shpenzime kapitale(B)	13,000	3,370	-14,564	1,806
TOTAL	**788,712**	**237,796**	**-318,526**	**707,982**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Sikundër paraqitet nga tabela e mësipërme, buxheti i ISHP për vitin 2020 është çelur fillimisht në vlerën rreth 788 milion lekë dhe përgjatë vitit si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, ai paraqitet në vlerën rreth 707 milion lekë, pra rreth 81 milion lekë më pak.

Në nivel projektesh situata lidhur me shtesat dhe pakesimet paraqitet si më poshtë:

Llog	Produkti	Celja	Shtesa dhe pakesime													Gjendja ne fund
			03.04	11.06	16.07	17.09	29.09	26.10	13.11	13.11	13.11	13.11	26.11	27.11	03.12	
600	91305AB	162,600						9,400							-17,000	155,000
	91305AG		150,000			-50,000		-12,500	-2,966		-10,350	-1,000				73,184
601	91305AB	30,500						-1,240	-330						-4,300	24,630
602	91305AB	127,300								15,026				60,000	-30,250	172,076
	91305AD	14,302								(4,529)						9,773
	91305AF	40,560					-30,000			-10,497						63
605	91305AA	400,000												(60,000)	-69,000	271,000
606	91305AB	450														450
	Total shpenzime korrente (A)	775,712	150,000			(50,000)	(30,000)	(4,340)	(3,296)	-	(10,350)	(1,000)		-	(120,550)	706,176
230	18BB701	13,000		(120)	(12,880)											-
231	18BB704				1,900								-1,564			336
231	18BB603												420			420
231	18BB601												520			520
231	18BB604												530			530
Total shpenzime kaptale (B)		13,000	-	(120)	(10,980)	-	-	-	-	-	-	-	(94)	-	-	1,806
TOTAL (A)+(B)		**788,712**	**150,000**	**(120)**	**(10,980)**	**(50,000)**	**(30,000)**	**(4,340)**	**(3,296)**	**-**	**(10,350)**	**(1,000)**	**(94)**	**-**	**(120,550)**	**707,982**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave te ISHP

Viti 2021

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022

Në mijë lekë

Emërtimi		Kërkesa projektbuxhet 2021-2023	Plani fillestar i miratuar (2021)
Shpenzime korrente (A)	Paga	188,460	171,900
	Sigurime	29,976	30,500
	Shërbime	706,028	198,330
	Transferta me jashtë	423,697	423,699
Total (A)		1,348,161	826,429
Shpenzime kapitale (B)	Investime	99,236	0
Total (B)		99,236	0
TOTAL (A)+(B)		**1,447,397**	**826,429**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Për vitin 2020, janë planifikuar në propozimin e projektbuxhetit të ISHP për periudhën 2021-2022 në total 1,447 milion lekë, dhe deri në fund të vitit 2021 i janë alokuar fillimisht 826 milion lekë sipas shkresave të MSHMS, pra rreth 621 milion lekë më pak se plani në projekt buxhetin e hartuar nga ISHP.

Sipas projektbuxhetit 2021-2023 për shpenzimet korrente janë nga ISHP një buxhet prej 1,348 milion lekë, nga të cilat 188 milion lekë shpenzime për paga, 29 milion lekë shpenzime për sigurime, 706 milion lekë për shërbime dhe 423 milion lekë shpenzime për transferta me jashtë.

Krahasuar me buxhetin e alokuar fillimisht për institucionin, buxheti për shpenzime korrente paraqitet në shumën prej 826 milion lekë, pra 522 milion lekë më pak se kërkesat e institucionit në projektbuxhet. Diferenca vjen kryesisht në zërin e shërbimeve ku rezulton të jenë alokuar 508 milion lekë më pak se kërkesa në projekt buxhet.
Për shpenzimet kapitale për investime, në projektbuxhetin e 2021-2023 është parashikuar një buxhet prej 99 milion lekë, të cilat nuk janë marrë në konsideratë në buxhetin e celur nga MSHMS.

Çelja e buxhetit
Shpenzimet korrente
Me anë të shkresës nr. 320/1, datë 20.01.2021 Sekretari i përgjithshëm i MSHMS, i ka përcjellë ISHP-së, pasqyrën e planit të buxhetit të vitit 2019 për shpenzimet korrente, të miratuar nga MFE, si mposhtë:

Kodi institucionit	***Llogaria Ekonomike***	***Kodi i projektit***	***Debiti (lekë)***
1013048	6000000	91305AB	171,900,000
1013048	6010000	91305AB	30,500,000
1013048	6020000	91305AB	155,009,000
1013048	6020000	91305AD	13,321,000
1013048	6020000	91305AF	32,000,000
1013048	6050000	91305AA	423,699,000
Totali			***826,429,000***

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Shpenzimet kapitale
Me anë të shkresës nr. 142/3, datë 02.02.2021 MSHMS i ka përcjellë I.SH.P, çeljen e buxhetit për vitet 2021-2023 për shpenzimet kapitale në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Kjo shkresë është përcjellë në zbatim të shkresës së MFE-së, nr. 628/1 datë 22.01.2021. Në këtë shkresë është përcaktuar se në rastet e ndërhyrjeve infrastrukturore duhen pasur parasysh zbatimi i:
VKM nr. 629, datë 15/07/2015 ñPër miratimin e manualeve teknike dhe të çmimeve të punimeve të ndërtimit, si dhe analizat teknike të tyreò
VKM nr. 354, datë 11/05/2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektimi, mbikëqyrje dhe kolaudimò, që do të shërbejë për të përcaktuar vlerat e plota të supervizioneve dhe kolaudimeve por dhe të projekteve që do të mund të realizoni gjatë vitit 2019.

(lekë)

Kodi institucionit	***Programi***	***Llogaria***	***Kodi projektit***	***Emërtimi i projektit***	***Debit 2021***	***Debit 2022***	***Debit 2023***
1013048	07450	2310000	18BB701	Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së.	-	13,680,000	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Ndryshime në buxhet përgjatë vitit
Me anë të shkresës nr. 461/2 prot., datë 25.01.2021 të MSHM, është përcjellë alokimi i fondeve bazuar në VKM 32, datë 20.01.2021. Referuar shkresës ky alokim është bërë bazuar në Aktin normativ nr. 1, datë 10.01.2021 ñPër miratimin e tekstit të marrëveshjes së prodhimit dhe furnizimit nëpërmjet *P.*_E. b.v MSHMS, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ISHP, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave AntiCovid-19 në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimin e tyre nga popullataò, Aktit normativ nr.3, datë 18.01.20201, VKM 32, datë 20.01.2021 ñPër përdorimin e fondit rezervë me qëllim kryerjen e parapagimeve të dozave të

vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar, si dhe shkresës së MFE nr. 1443/1 dt. 25.01.2021, dhe paraqitet si më poshtë:

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Emërtimi i produktit	Debit (lekë)
Shtesat				
1013048- ISHP	6050000	-	Persona të vaksinuar me vaksinën anticovid-19	430,000,000
Paksimet				
1049001-Fondi rezervë	6090000	94901AA		430,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me anë të shkresës numër 500/3, datë 15.02.2021, MSHMS i ka përcjellë ISHP-së akordimin e fondeve për rritjen e pagave për vitin 2020. Referuar kësaj shkrese, ky akordim është bërë në zbatuar në VKM 1076, datë 24.12.2020, dhe shkresës së MFE nr. 1862/1, datë 02.02.2021 dhe paraqitet si mposhtë:

Kodi institucion	***Llogaria***	***Kodi***	***Debit (lekë)***
Shtesat			
1013048	6000000	91305AB	43,000,000
1013048	6010000	91305AB	8,500,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me anë të shkresës nr. 658/3, datë 06.02.2021 MSHMS i ka përcjellë ISHP-së akordimin e fondit të veçantë për vitin 2021, miratuar me shkresën nr. 658/1, datë 16.02.2021 të MFE-së, si mposhtë:

Kodi institucion	***Llogaria***	***Kodi***	***Debit (lekë)***
Shtesa			
1013048	6060000	91305AB	700,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me anë të shkresës nr.5667/1, datë 26.03.2021 është miratuar alokimi i fondeve për ISHP, në zbatim të VKM 174, datë 24.03.2021. Referuar shkresës ky alokim është bërë në zbatim të Aktit normativ nr. 10, datë 24.03.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet MSHMS, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ISHP, dhe distributorit të autorizuar ñK...ò A.S për furnizimin e R.SH me vaksinën e inaktivizuar kundër covid-19. *C.*, të krijuar nga S.L.... dhe të prodhura në Repubikën Popullore të Kinësò, në zbatim të VKM nr. 174 datë 24.03.2021, si dhe shkresës nr. 1590 prot., datë 26.03.2021 të MSHMS për akordimin e fondeve për zbatimin e VKM-së së sipër cituar.

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Emërtimi i produktit	Debit (lekë)
Shtesat				
1013048- ISHP	6050000	91305AH	Persona të vaksinuar me vaksinën anticovid-19	1,046,000,000
Paksimet				
1049001-Fondi rezervë	6090000	94901AA		1,046,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Rialokime 2021

Me anë të shkresës nr. 691/4, datë 02.03.2021 MSHMS i ka përcjellë ISHP-së, rialokimin e fondeve në kategorinë shpenzime korrente. Referuar kësaj shkrese ky rialokim është bazuar në shkresën nr. 2682/3, datë 01.03.2021 të MFE dhe paraqitet si mposhtë.

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Emërtimi i produktit	Debit (lekë)
Paksimet				

1013048- ISHP	6050000	91305AA	Fëmijë të vaksinuar 0-18	120,000,000
Shtesa				
1013048- ISHP	6000000	91305AB	Numër kontrollesh për situatën epidemiologjike	110,000,000
1013048- ISHP	6010000	91305AB	Numër kontrollesh për situatën epidemiologjike	10,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Me shkresën nr. 1242 prot., datë 04.03.2021, MSHMS i ka përcjellë ISHP akordimin e fondeve për shpërblimet Covid-19. Referuar kësaj shkrese, ky akordim është bërë mbështetur në bazën ligjore dhe në kërkesat e dërguara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor për shpërblimet e mjekëve epidemiolog që shërbejnë në periudhën e pandemisë, dhe paraqitet si mposhtë:

Tabela 1:

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Debit (lekë)
Shtesat			
1013048- ISHP	600000	91305AG	8,000,000
Paksimet			
1013048- ISHP	6000000	91305AB	114,000,000
1013048- ISHP	6010000	91305AB	10,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Tabela 2:

Kodi institucion	Llogaria	Kodi	Debit (lekë)
Shtesat			
Paksimet			
1013048- ISHP	6009999	91305AB	116,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Rishikimet e buxhetit të vitit 2021

Në mijë lekë

Emërtimi	**Plani fillestar**	**Ndryshimet në planin e buxhetit (deri në fund të marsit)**		**Plani i rishikuar**
		Shtesa	**Pakesime**	
Paga	171,900	161,000	-114,000	218.900
Sigurime	30,500	18,500	-10,000	39.000
Shërbime	198,330	0	0	198,330
Transferta me jashtë	423,699	1,476,000	-120,000	1,779,000
Fond i vecantë	0	700		700
Total shpenzime korrente (A)	*826,429*			2,238,629
Investime	0		-	0
Totak shpenzime kapitale (B)	0	-	-	0
TOTAL	**788,712**			**2,238,629**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në nivel produktesh:

Në mijë lekë

Llog	**Produkti**	**Celja**	**Shtesa dhe pakesime**						**Buxheti i rishikuar**
			25.01	**6.02**	**15.02**	**2.03**	**26.03**	**4.03**	
600	91305AB	171,900			43,000	110,000		-114,000	210,900
	90305AG							8,000	8,000
601	91305AB	30,500			8,500	10,000		-10,000	39,000
602	91305AB	155,009							155,009

	91305AD	13,321							13,321
	91305AF	32,000							32,000
605	91305AA	423,699				-120,000			303,699
	90305AH	0	430,000				1,046,000		1,476,000
606	91305AB			700					700
Total shpenzime korrente (A)		826,429							2,238,629
231		0							0
Total shpenzime kaptale (B)									0
TOTAL (A)+(B)		**826,429**	**430,000**	**700**	**51,500**	**0**	**1,046,000**	**-116,000**	**2,252,309**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nëse i referohemi rakordimit me degën e thesarit për muajin Mars, rezulton se plani i buxhetit për vitin 2021 në llog 600 kod produkti 91305AB paraqitet në vlerën 214,900 mijë lekë, në një kohë ku sipas shtesave dhe pakësimeve faktikisht duhet të ishte 210,900 mijë lekë. Situata është përmirësuar në muajin Prill, ku është paraqitur vlera e duhur në këtë kod produkti dhe llogari, pas ndryshimeve të ndodhura në këtë periudhë.
Gjithashtu, edhe projekti i investimit, i celur faktikisht si projekt për vitin 2022, dhe për të cilin është përcjellë shkresa në vitin 2021 nga MSHMS për këtë projekt që planifikohet të kryhet, ai rezulton të shfaqet në rakordimin mujor me thesarin si plan buxheti për vitin 2021. Sipas përfaqësuesve të ISHP ky është një lapsus, pasi edhe sipas komunikimeve verbale që kanë patur janë orientuar të mos vijojnë me përdorimin e këtij fondi.

Konkluzion me zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimit të planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjate viteve ushtrimore, si dhe planit përfundimtar
-Përgjithësisht vihet re se për periudhën e audituar janë kryer një numër i konsiderushëm rishikimesh në buxhetin e ISHP, që kanë ardhur si rezultat i akteve normative, apo edhe vendimmarrjes së MSHMS për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin e ISHP, duke ia alokuar ato njësive vendore të shëndetit publik, apo institucioneve të tjera nën varësine e ISHP.
-Për vitin 2020 rishikimet kanë konsistuar kryesisht në buxhetin e alokuar fillimisht për financimin e shpërblimeve të personelit të ISHP, nga i cili përgjatë vitit janë kryer rishëpërndarje në degët rajonale të shëndetit publik. Për sa i përket fondeve për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID, në buxhetin e ISHP nuk janë alokuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit përkryerjen e likuidimit të kontratës së lidhur për blerjen e tamponeve dhe kiteve me 2 operatorët ekonomikë (trajtuar më hollësisht në pikën e prokurimeve), por institucioni ka përdorur tepricat e disponueshme në dispozicionin e alokuar për aktivitetin rutinë të institucionit, duke kryer ri alokime brenda programit të institucionit, në produkte të ndryshme, pa efekt në totalin e vlerës së buxhetit në dispozicion për vitin 2020.
Më hollësisht, kanë qenë në dispozicion rreth 60 milion lekë nga produkti i celur për kryerjen e pagesave për vaksina sipas Programit Kombëtar të Vaksinimit, dhe rreth 15 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò, me kod 91305AF. Nga këto fonde janë likuduar vetëm dy fatura me vlerë rreth 50 milion lekë për likuidimin e pagesave për blerje , kitesh dhe reagente në zbatim të kontratës.
-Në vitin 2021 janë konstatuar se ekzistojnë diferenca në planin e buxhetit në dispozicion në disa produkte mes planit që rezulton në rakordimin mujor me degën e thesarit, dhe planit të rishikuar që rezulton shtesave dhe pakësimeve që janë kryer gjatë vitit. Më hollësisht, diferencat në

llogarinë e pagave 600 janë sistemuar në rakordimin e muajit Prill, ndërsa diferenca vijon në projektin e investimit të çelur gabimisht si plan buxheti për vitin 2021, ku si pas shkresës së MSHMS është një plan për vitin 2022 edhe në këtë rakordim.

c. Realizimi i planit të buxhetit.
Realizimi i buxhetit krahasuar me planin e rishikuar për vitet 2018,2019,2020 dhe Janar-Mars 2021 paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Janar-Mars 2021	
Emërtimi	**Plan i rishikuar**	**Fakt**	**Plan i rishikuar**	**Fakt**	**Plan i rishikuar**	**Fakt**	**Plan i rishikuar[6]**	**Fakt**
Paga	170,392	158,157	164,037	153,263	228,184	174,080	257.900	50,748
Sigurime	39,425	26,075	28,772	25,314	24,630	24,568	39.000	6,700
Shërbime	116,410	113,397	152,043	151,623	181,912	177,794	198,330	23,053
Transferta me jashtë	303,131	302,741	365,857	365,753	271,000	270,760	1,779,000	1,185,526
Transferta buxhetore	291	261					700	700
Shpenzime korrente (A)	629,649	600,631	710,709	695,953	705,726	647,259	2,238,629	1,208,651
Shpenzime kapitale (B)	0	-	10,950	6,563	1,806	1,411	0	0
TOTAL (A)+(B)	629,649	600,631	721,659	702,516	707,532	648,670	2,238,629	1,208,651

Për vitin 2018, sipas kërkesave në fazën e hartimit të projektbuxhetit të ISHP, është propozuar alokimi i një buxheti prej rreth 985 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta me jashtë, nga të cilat, sipas buxhetit të rishikuar, janë alokuar rreth 630 milion lekë. Nga institucioni rezultojnë të kryera shpenzime në vlerën rreth 600 milion lekë, pra më një përqindje realizimi kundrejt planit të rishikuar prej 95%.
Për vitin 2019 është propozuar në projektbuxhet një buxhet prej rreth 1,066 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta, nga të cilat fillimisht janë alokuar 932 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar plani paraqitet në rreth 722 milion lekë. Shpenzimet e kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën rreth 702 milion lekë, pra më një përqindje realizimi kundrejt planit të rishikuar rreth 97%.
Për vitin 2020, është propozuar në projektbuxhet alokimi i një buxheti prej rreth 969 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 788 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar në 707 milion lekë, ku rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni në vlerën rreth 648 milion lekë, pra më një përqindje realizimi kundejt planit të rishikuar prej 92%.

Krahasimi i realizimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi në disa nga zërat kryesore paraqitet si më poshtë:

[6] Kundrejt planit vjetor te vitit 2021



Më hollësisht, realizimi për çdo vit trajtohet më poshtë.

Viti 2018

Raporti mbi Analizën e burimeve financiare dhe përdorimin e tyre nga ISHP-ja për periudhën Janar-Dhjetor 2018 është përcjellë nga Nën Drejtori Ekonomik i ISHP për Drejtorin me shkresën nr. 581/24, prot datë 22.01.2019. Gjithashtu, përgjatë vitit është përcjellë edhe raporti i monitorimit 8 mujor me shkresën nr. 1319, prot datë 27.09.2018. Realizimi i buxhetit të ISHP për vitin 2018 sipas llogarive ekonomike, duke krahasuar me kërkesat në projekt buxhet, çeljen dhe planin e rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Llog	Kërkesa për buxhet 2018-2019	Çelja	Plani final	Realizimi	% realizimit
Paga	179,796	258,880	170,392	158,157	93%
Sigurime	30,026	62,990	39,425	26,075	66%
Shërbime	162,826	101,610	116,410	113,397	97%
Transferta me jashtë	446,000	350,000	303,131	302,741	100%
Transferta buxhetore		0	291	261	90%
Total shpenzime korrente (A)	820,439	773,480	629,649	600,631	95%
Investime (B)	165,410	0	0	-	-
TOTAL (A)+(B)	**985,849**	**773,480**	**629,649**	**600,631**	**95%**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në total për vitin 2018, sipas kërkesave për buxhet të ISHP për vitet 2018-2019, janë kërkuar rreth 985.850 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta me jashtë, nga të cilat, sipas buxhetit të rishikuar, janë alokuar rreth 630 milion lekë. Nga institucioni rezultojnë të kryera shpenzime në vlerën 600.6 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 95%.

Për shpenzimet operative, sipas kërkesave për buxhet të institucionit për vitet 2018-2019, në vitin 2018 janë kërkuar nga ISHP rreth 820.4 milion lekë, nga të cilat të alokuara sipas buxhetit të rishikuar rezultojnë rreth 630 milion lekë dhe shpenzimet e kryera nga institucioni janë në vlerën 600 milion lekë, pra më një përqindje realizimi rreth 95%.

Për shpenzimet kapitale, sipas kërkesave për buxhet të ISHP për 2018-2019, në vitin 2018 janë kërkuar rreth 165 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar nuk janë alokuar fonde.

Viti 2019

Raporti mbi Analizën e burimeve financiare dhe përdorimin e tyre nga ISHP-ja për periudhën Janar-Dhjetor 2019 është përcjellë nga Nën Drejtori Ekonomik i ISHP për Drejtorin me shkresën nr. 73, prot datë 15.01.2020. Gjithashtu, përgjatë vitit është përcjellë edhe raporti i monitorimit 4

mujor për periudhën Janar-Prill 2019 me shkresën nr. 679, prot datë 24.05.2019; raporti për periudhën Janar-20 Nëntor 2019 me shkresën nr. 679/1, prot datë 21.11.2019. Realizimi i buxhetit të ISHP për vitin 2019 sipas llogarive ekonomike, duke krahasuar me kërkesat në projekt buxhet, çeljen dhe planin e rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Llog	Kërkesa për buxhet 2019-2021	Çelja	Plani final	Realizimi	% realizimit
Paga	181,331	180,000	164,037	153,263	93%
Sigurime	30,282	32,500	28,772	25,314	88%
Sherbime	136,327	170,000	152,043	151,623	100%
Transferta	537,000	500,150	365,857	365,753	100%
Total shpenzime korrente (A)	884,940	882,650	710,709	695,953	98%
Investime (B)	181,630	49,752	10,950	6,563	60%
TOTAL (A)+(B)	**1,066,570**	**932,402**	**721,659**	**702,516**	**97%**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në total për vitin 2019, ku sipas kërkesave për buxhet për vitet 2019-2021, në vitin 2019 janë kërkuar nga ISHP rreth 1066 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta, nga të cilat fillimisht janë alokuar 932 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar rreth 722 milion lekë. Shpenzimet e kryera nga institucioni rezultojnë në vlerën 702 milion lekë, pra më një përqindje realizimi rreth 97%.
Për shpenzimet operative, sipas kërkesave për buxhet nga ISHP për vitet 2019-2021, në vitin 2019 janë kërkuar rreth 885 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 883 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 711 milion lekë. Rezultojnë shpenzime të kryera nga institucioni rreth 696 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 98%.
Për shpenzimet kapitale, ku sipas kërkesave për buxhet për vitet 2019-2021, në vitin 2019 janë kërkuar nga ISHP rreth 182 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 50 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 11 milion lekë, Nga institucioni rezultojnë shpenzime të kryera në vlerën 7 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej rreth 60%.

Nëse i referohemi detajimit në kode produkti të shpenzimeve sipas kodeve të llogarive ekonomike, planifikimi dhe realizimi rezulton si më poshtë:

Llog	Produkti	Celja	Plani final	Realizimi
600	91305AB	180,000,000	164,037,300	153,263,477
	91305AG		-	
601	91305AB	32,500,000	28,772,200	25,313,645
602	91305AB	163,573,000	145,615,938	145,195,983
	91305AD	6,427,000	6,427,000	6,426,901
	91305AF		-	
605	91305AA	500,000,000	364,957,062	364,957,062
606	91305AB	150,000	900,000	796,232
	Total shpenzime korrente (A)	882,650,000	710,709,501	695,953,300
231	18BB702	20,700,000	-	
231	18BB502	20,000,000	-	
230	18BB501	2,200,000	4,350,000	
231	18BB601	6,600,000	6,600,000	6,563,074
231	18BB503	252,000	-	
Total shpenzime kaptale (B)		49,752,000	10,950,000	6,563,074
TOTAL (A)+(B)		**932,402,000**	**721,659,501**	**702,516,374**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Viti 2020

-Me shkresën nr. 611, prot datë 22.05.2020 të Nën Drejtorit Ekonomik të ISHP është hartuar dhe përcjellë për Drejtorin e ISHP Raporti mbi analizën e burimeve financiare dhe përdorimit të tyre për periudhën Janar-Prill 2020 i cili përbëhet nga disa anekse: tabelën me fondet e çelura, shtesa dhe pakësime, realizimi për kapitullin e shpenzimeve 600 - 606 dhe te investimeve; rakordimin e të ardhurave dytësore; realizimin e regjistrit të prokurimeve.
-Me shkresën nr. 611, prot datë 22.05.2020 të Nën Drejtorit Ekonomik të ISHP është hartuar dhe përcjellë për Drejtorin e ISHP Raporti mbi analizën e burimeve financiare dhe përdorimit të tyre për periudhën Janar-Gusht 2020, i hartuar në të njëjtën format sikundër ai i periudhës së mëparshme.
- Me shkresën nr. 125, prot datë 28.01.2021 të Nën Drejtorit Ekonomik të ISHP është hartuar dhe përcjellë për Drejtorin e ISHP Raporti mbi analizën e burimeve financiare dhe përdorimit të tyre për periudhën Janar-Dhjetor 2020, i cili përmban të dhëna mbi realizimin e fondeve buxhetore vjetore.
Realizimi i shpenzimeve sipas buxhetit në dispozicion të ISHP për vitin 2020, krahasuar me kërkesat e projekt buxhetit të vitit 2020 përcjellë nga ISHP; alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2020
Në mijë lekë

Emërtimi		Kërkesa Projekt buxhet 2020-2022	Plani fillestar i miratuar 2020	Plani i rishikuar 2020	Realizimi 2020	**Realizimi %[7]**
Shpenzime operative (A)	Paga	181,070	162,600	228,184	174,080	**76%**
	Fond i veçantë	9,053				
	Sigurime	30,239	30,500	24,630	24,568	**100%**
	Shërbime	241,700	182,162	181,912	177,794	**98%**
	Transferta me jashtë	349,854	400,000	271,000	270,760	**100%**
Total (A)		811,916	775,262	705,726	647,259	**92%**
Shpenzime kapitale (B)	Investime	157,896	13,000	1,806	1,411	**78%**
Total (B)		157,896	13,000	1,806	1,411	**78%**
TOTAL (A)+(B)		**969,812**	**788,262**	**707,532**	**648,670**	**92%**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nëse i referohemi detajimit në kode produkti të shpenzimeve sipas kodeve të llogarive ekonomike, planifikimi dhe realizimi rezulton si më poshtë:
Në mijë lekë

Llog	**Kodi**	**Emërtimi i treguesit të performancës/produktit**	**Plani fillestar**	**Plani i rishikuar**	**Realizimi**
600	91305AB	Numër kontrollesh për situatat epidemiologjike	162,600	155,000	147,455
	91305AG	Personel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus per Covid-19	0	73,184	26,625
601	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	30,500	24,630	24,568
602	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	127,300	172,076	168,446
	91305AD	Gra te depistuara për kancerin e gjirit	14,302	9,772	9,284
	91305AF	Gra te depistuara për kancerin e qafës së mitrës	40,560	62	62
605	91305AA	Fëmijë të vaksinuar 0-18	400,000	271,000	270,760
606	91305AB	Numer kontrollesh per situatat	450	450	434

[7] *Realizimi në përqindje është përllogaritur kundrejt planit të rishikuar*

		epidemiologjike			
230/231	18BB701	Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi	13,000	0	0
	18BB704	TVSH për pajisje dhe materiale konsumi për ISHP në kuadër të Covid 19	1,900	336	0
	18BB601	Blerje pajisje kompjuterike (Blerje UPS për sigurinë e qëndrueshme të rrymës së energjisë elektrike në pajisje për ISHP)	520	520	478
	18BB603	Blerje (F+V) rotor për centrifug ependorf	420	420	405
	1855604	Blerje centrifugë për manipulim në biologji molekulare për mikrotuba 1.5-2 ml	530	530	526

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në total për vitin 2020, ku sipas PBA 2020-2022, në vitin 2020 janë kërkuar nga ISHP 969 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta me jashtë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 788 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 707 milion lekë, rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni në vlerën 648 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 92%.
Për shpenzimet operative, ku sipas PBA 2020-2022, në vitin 2020 janë kërkuar nga ISHP 811 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 775 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 705 milion lekë, rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni në vlerën 647 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 92%.
Për shpenzimet kapitale ku sipas PBA 2020-2022, në vitin 2020 janë kërkuar nga ISHP 157 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 13 milion lekë (për financimin e projekteve që faktikisht nuk janë përfshirë në projekt buxhetin e hartuar nga ISHP të vitit 2020) dhe sipas buxhetit të rishikuar 1.8 milion lekë, rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni në vlerën 1.4 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 78%.

Detajimi i investimeve të kryera nga ISHP në vitin 2020, krahasuar me alokimin e buxhetit fillestar dhe atë të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Projektet e investimeve të financuara nga buxheti i shtetit për ISHP viti 2020
Në mijë lekë

Kodi i projektit	Përshkrimi	Projektbuxhet 2020-2022 ISHP	PBA 2020-2022 MSHMS	Buxheti fillestar	Buxheti i ndryshuar	Realizimi
	Supervizim+kolaudim i rikonstruksionit të godinës qendrore të ISHP	1,106	0	0	0	0
	Rikonstruksion i godinës qendrore të ISHP	100,000	0	0	0	0
	Investime të ndryshme, zëvendësim dritare, dyer etj	400	0	0	0	0
	Blerje pajisje për Sektorin e Laboratorit të Referencës Kombëtare për Shëndetin dhe Mjedisin	21,710	0	0	0	0
	Blerje pajisje për laboratoret e diagnozës të Sëmundjeve Infektive dhe Sektorëve të DEKSI	18,670	0	0	0	0
	Blerje pajisje për matjen e rrezatimeve për zyrën e mbrojtjes	9,140	0	0	0	0

	nga rrezatimi					
	Blerje makinash për ISHP	2,800	0	0	0	0
	Blerje kondicionera	480	0	0	0	0
	Blerje stabiliatori, invertitor rryme dhe pajisje të tjera për sigurinë e qendrueshme	2,380	0	0	0	0
	Blerje mobilim zyre	1,210	0	0	0	0
18BB701	Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi	0	13,000	13,000	0	0
18BB704	TVSH për pajisje dhe materiale konsumi për ISHP në kuadër të Covid 19	0	0	1,900	336	0
18BB601	Blerje pajisje kompjuterike (Blerje UPS për sigurinë e qëndrueshme të rrymës së energjisë elektrike në pajisje për ISHP)	0	0	520	520	478
18BB603	Blerje (F+V) rotor për centrifug ependorf	0	0	420	420	405
18BB604	Blerje centrifugë për manipulim në biologji molekulare për mikrotuba 1.5-2 ml	0	0	530	530	526
Total		157,896	23,500	16,370	1,806	1,409

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

-Nga auditimi konstatohet se projekti 18BB701 ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi"* është planifikuar në PBA 2020-2022 të MSHMS në vlere 13,000 mijë lekë dhe është çelur po në atë vlerë. Përgjatë vitit janë kryer ndryshime dhe ky projekt deri në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0, shkak për të cilin sipas ISHP është bërë situata e pandemisë, megjithatë nga ana e institucionit nuk është përcjellë asnjë kërkesë zyrtare për të bërë këtë pakësim fondi, por ndryshimi është përcjellë për ISHP nga MSHMS.
-Nga auditimi konstatohet se projekti 18BB704 ñ*TVSH për pajisje dhe materiale konsumi për ISHP në kuadër të Covid 19*ò i cili nuk është i planifikuar në PBA 2020-2022, janë celur për institucionin përgjatë viti vlera prej 1,900 mijë lekë, e cila pas rishikimit përgjatë vitit rezulton në vlerën 336 mijë lekë; dhe në vijim nuk është kryer asnjë pagesë nga ISHP. Sipas komunikimit verbal shkak është bërë fakti se nga ana e donatorit i cili ka përcjellë këo pajisje dhe materiale konsumi në kuadër të COVID nuk është përcjellë një kërkesë për likuiidimin e TVSH pasi donatori e ka likudiuar vetë detyrimin, dhe si rezultat nuk është kryer kjo pagesë. Në raportin e monitorimit të veprimtarisë ekonomike të ISHP për vitin 2020 është përcaktuar se shuma prej 336 mijë lekë është celur gabimisht në llogarinë 230, në vend që të çelej në llog 231 si kosto lokale dhe I. në pjesën e tyre të dhurimeve është paguar TVSH nga I..
-Projektet e tjera, përkatësisht 18BB601,18BB603, 18BB604 si më sipër me vlerë totale pagesash 1,409 mijë lekë, janë projekte të kryera në vijim të punës së departamentit për sëmundjet infektive në kuadër të pandemisë, dhe për këtë arsye nuk kanë qenë të përfshira në PBA 2020-2022.

Janar-Mars 2021
Realizimi i shpenzimeve sipas buxhetit në dispozicion të ISHP për periudhën Janar-Mars 2021, krahasuar me kërkesat e projekt buxhetit të vitit 2021; alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar; paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:
Realizimi i buxhetit Mars 2021
Në mijë lekë

Emërtimi		Kërkesa Projekt buxhet 2021-2023	Plani fillestar 2021	Plani i rishikuar 2021 [8]	Realizimi 2021[9]
Shpenzime operative (A)	Paga	179,485	171,900	218.900	50,748
	Fond i vecantë	8,975			
	Sigurime	29,976	30,500	39.000	6,700
	Shërbime	706,028	200,330	198,330	23,053
	Transferta me jashtë	423,697	423,699	1,779,000	1,185,526
	Fond i vecantë	0	0	700	700
Total (A)		1,348,161	826,429	2,238,629	1,208,651
Shpenzime kapitale (B)	Investime	99,236	0	0	0
Total (B)			0	0	
TOTAL (A)+(B)		**1,447,397**	**826,429**	**2,238,629**	**1,208,651**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Nëse i referohemi detajimit në kode produkti të shpenzimeve sipas kodeve të llogarive ekonomike, planifikimi dhe realizimi rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Llog	Kodi	Emërtimi i treguesit të performancës/produktit	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Realizimi
600	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	171,900	210,900	50,353
	91305AG	Personel mjekesor dhe jo-mjekesor i trajtuar me bonus per Covid-19	0	8,000	395
601	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	30,500	39,000	6,700
602	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	155,009	155,009	22,787
	91305AD	Gra te depistuara për kancerin e gjirit	13,321	13,321	266
	91305AF	Gra te depistuara për kancerin e qafës së mitrës	32,000	32,000	0
605	91305AA	Fëmijë të vaksinuar 0-18	423,699	303,699	101,988
605	91305AH	Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19	0	1,476,000	1,083,538
606	91305AB	Numer kontrollesh per situatat epidemiologjike	0	700	71
230/231	18BB701	Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi	0	0	0
			826,429	2,252,309	1,208,651

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të ISHP

Në total për vitin 2021, ku sipas planifikimit të buxhetit për periudhën 2021-2023, për vitin 2021 janë kërkuar nga ISHP 969 milion lekë për likudimin e shpenzimeve për paga, sigurime, shërbime, investime dhe transferta me jashtë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 826 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 707 milion lekë, rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni për periudhën deri në mars 2021 në vlerën 1,208 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 92%.

[8] *Deri në Mars 2021*
[9] *Deri në Mars 2021*

Për shpenzimet operative, ku sipas PBA 2021-2023, në vitin 2021 janë kërkuar nga ISHP 811 milion lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 806 milion lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 705 milion lekë, rezultojnë të kryer shpenzime nga institucioni në vlerën 1,208 milion lekë, pra më një përqindje realizimi prej 92%.

Niveli më i lartë i shpenzimeve konsiston në kryerjen e likuidimeve për kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave, më hollësisht kryer si më poshtë:

1-Me shkresën nr. 461/2, prot datë 25.01.2021 të MSHMS është përcjellë pranë ISHP shkresa për alokimin e fondeve bazuar në Aktin Normativ nr. 10.01.2021 ñPër miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin, furnizimin nëpërmjet P. E., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, autorizimin e procedurës për lejimin e hryjes dhe administrimit të vaksinave Anti ï Covid - 19 në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimin e tyre në popullatëò, Aktin Normativ nr. 3 datë 18.01.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ñPër prodhimin dhe furnizimin nëpërmjet P. E. b.v dhe MSHMS, MSHR dhe ISHPò si dhe VKM nr. 32, datë 20.01.2021 ñPër përdorimin e fondit rezervë me qëllim kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për ñPër prodhimin dhe furniziin nëpërmjet P. E. b.v dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP miratuar me ligjin nr.3, datë 18.01.2021 dhe shkresës së MFE nr. 1443/1, datë 25.01.2021. Si rezultat i sa më sipër, në zbatim të VKM nr. 32, datë 20.01.2021 nga fondi rezervë janë alokuar për ISHP fonde në vlerën 430,000 mijë lekë në produktin ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò. Në vijim ISHP ka kryer likuidimin:

-Sipas urdhër shpenzimit nr. 6, datë 25.01.2021, është kryer transferta me jashtë në vlerën 303,922 mijë lekë ñTransfertë për vaksinën Anti-Covid-19ò (2,458,723 Euro*123.61=303,922,754.97 lekë), sipas platforma invoice no 31556343 datë 22.01.2021 në kodin e produktit 91305 AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò.

Konstatohet se ky shpenzim është kryer nga ISHP në kodin e produktit 91305AA Fëmijë të vaksinuar 0-18, dhe jo atë të alokuar për pagesat e covid për të cilat është kryer transferimi i fondeve përkatësisht 91305AH Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19. Për këtë arsye, me shkresën nr. 108/1, prot datë 29.01.2021 është përcjellë pranë Degës së Thesarit kërkesa për sistemim kodi produkti në atë të duhur, pra 91305AH.

2-Në zbatim të marrëveshjes mes Qeverisë Shqiptare dhe U. datë 15.04.2005 dhe shkresës së MSHMS nr.1898 datë 05.04.2016 ñPër prokurimin e Vaksinave të Programit Kombëtar të Imunizimitò nga U. Danimarkë është përcjellë pranë ISHP një cost estimate nr. 10023921 datë 25.02.2021 për vaksinën Covid -19 C. nga A./S. nëpëmjet C. F.në shumën 531.900 USD. Në vijim të saj me shkresën nr. 1150 datë 01.03.2021 të MSHMS është përcjellë prane ISHP dhe U shkresa ku autorizohet ISHP për të përdurur Marrëveshjen mes MSHMS dhe U për prokurimin e vaksinave nëpërmjet programit kombëtar të imunizimit. Në këtë kontekst ISHP është autorizuar të kryejë parapagesën e vaksinës së COVID-19 tek U për llogari të C.. Për likuidimin e kësaj pagese janë përdorur fondet që kanë mbetur nga alokimi i kryer nga fondi rezervë në zbatim të VKM nr. 32, datë 20.01.2021 ñPër përdorimin e fondit rezervë me qëllim kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për ñPër prodhimin dhe furnizimin nëpërmjet P. E. b.v dhe MSHMS, MSHR dhe ISHPòò , (u alokuan 430,000 mijë lekë dhe u krye pagesa 303,922 mijë lekë; pra disponoheshin edhe 126,078 mijë lekë në produktin ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò). Në vijim ISHP ka kryer likuidimin:

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 56, datë 02.03.2021, është kryer transferta me jashtë në vlerën 54,998 mijë lekë ñTransfertë për vaksinën Anti-Covid-19ò (531,900 USD *103.4=54,998,460

lekë), sipas cost estimate nr 10023924 datë 25.02.2021 në kodin e produktit 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò dhe 350 lekë komision në produktin 91305AB ñNumer kontrollesh per situatat epidemiologjikeò.
3-Në zbatim të Aktit Normativ nr. 9 datë 22.03.2021 ñPër miratimin e tekstit të marrëveshjes të nënshkruar mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK. I. S.ve T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. S. C. LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinësò dhe Aktit Normativ nr. 10, datë 24.03.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes të nënshkruar mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK.I.S.T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. S. Co LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinësò në zbatim të VKM nr. 174, datë 24.03.2021 ñPër kryejsn e pagesës së dozave të vaksinave që rrjedh nga marëveshja mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK.I.S.T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. S. Co LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, dhe shkresës së MSHMS për akordim akordim të fondeve nr, 1590, datë 26.03.2021, me shkresën nr. 5667/1, prtot datë 26.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE në zbatim të VKM nr. 174, datë 24.03.2021 është miratuar transferimi i fondeve në vlerë 1,046,000 mijë lekë nga fondi rezervë në në projektin 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò. Në vijim ISHP ka kryer likuidimin:

- Sipas urdhër shpenzimit nr.84, datë 29.03.2021, është kryer transferta me jashtë në vlerën 715,942 mijë lekë ñTransfertë për vaksinën Anti-Covid-19ò (6,840,000 USD *104.67=715,942,800 lekë), sipas commerical invoice nr 2021000000166 datë 25.03.2021 në kodin e produktit 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò.
Në mënyrë të përmbledhur pagesat e kryera paraqiten si më poshtë:
Në mijë lekë

Miratimi i tekstit të marrëveshjes	**Miratimi i Marrëveshjes së nënshkruar**	**Miratimi i fondeve**	**Alokimi i fondeve**		**Vlera e akorduar**	**Fatura e OE**	**Likuidimi i pagesës së paradhënies**	**Vlera e paguar**
A.N nr.1, datë 10.01.2021	A.N nr.3, datë 18.01.2021	VKM nr.32, datë 20.01.2021	Shkresa nr.1443/1 datë 25.01.2021 e MFE	Shkresa nr. 461/2 datë 25.01.2021 e MSHMS	430,000	Nr. 31556343 datë 22.01.2021	U.SH nr. 6, datë 25.01.2021	303,922
				Shkresa nr. 1150 datë 01.03.2021 e MSHMS		Nr 10023924 datë 25.02.2021	U.SH nr. 56, datë 02.03.2021	54,998
A.N. nr. 9 datë 22.03.2021	A.N nr. 10, datë 24.03.2021	VKM nr. 174, datë 24.03.2021	Shkresa nr. 5667/1 datë 26.03.2021	Shkresa nr. 1590 datë 26.03.2021	1,046,000	Nr. 2021000000166 datë 25.03.2021	U.SH nr. 84 datë 29.03.2021	715,942
TOTAL					**1,476,000**			**1,074,862**

Pra, në total deri në fund të muajit Mars 2021, nga ISHP është kryer likuidimi i pagesave në vlerë 1,074,862 mijë lekë, sipas 3 urdhër shpenzimeve por nëse i referohemi rakordimit me degën e thesarit, vlera e shpenzimeve të kryera deri në këtë periudhë në projektin 91305 AH ñPersona të

vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò është 1,083,538 mijë lekë. Diferenca vjen si pasojë e përfshirjes në këtë produkt të urdhër shpenzimit të kryer në vlerë 8,673,987 lekë të pagesës së shiringave në kuadër të programit kombëtar të vaksinimit.

Konkluzion mbi realizimin e buxhetit të ISHP

- Nga auditimi u konstatua se Projekti 18BB701 ñ*Blerje paisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe paisje per rrezatimit jo jonizues te zyres se mbrojtjes nga Rrezatimi"* është planfikuar në PBA 2020-2022 të MSHMS në vlerën 13,000 mijë lekë dhe është celur po në atë vlerë. Përgjatë vitit nga MSHMS janë kryer ndryshime në buxhetin në dispozicion të ISHP dhe ky projekt deri në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0, shkak për të cilin sipas ISHP është bërë situata e pandemisë, megjithatë nga ana e institucionit nuk është përcjellë asnjë kërkesë zyrtare për të iniciuar këtë pakësim fondi.
-Projekti 18BB704 ñ*TVSH për pajisje dhe materiale konsumi për ISHP në kuadër të Covid 19*ò i cili nuk është i planifikuar në PBA 2020-2022, janë celur për institucionin përgjatë viti vlera prej 1,900 mijë lekë, e cila pas rishikimit përgjatë vitit rezulton në vlerën 336 mijë lekë; dhe në vijim nuk është kryer asnjë pagesë nga ISHP. Sipas komunikimit verbal shkak është bërë fakti se nga ana e donatorit i cili ka përcjellë këto pajisje dhe mateiale konsumi në kuadër të COVID nuk është përcjellë një kërkesë për likuidimin e TVSH pasi donatori e ka likuiduar vetë detyrimin, dhe si rezultat nuk është kryer kjo pagesë.
-Projektet e tjera, përkatësisht 18BB601,18BB603, 18BB604 si më sipër me vlerë totale pagesash 1,409 mijë lekë, janë projekte të kryera në vijim të punës së departamentit për sëmundjet infektive në kuadër të pandemisë, dhe për këtë arsye nuk kanë qenë të përfshira në PBA 2020-2022.
- Në vitin 2021 për shpenzimet kapitale ku sipas PBA 2021-2023, në vitin 2021 janë kërkuar nga ISHP 99 milion lekë, ku u konstatua se edhe pse faktikisht në rakordimin me degën e thesarit rezulton si plan buxheti vlera prej 13 milion lekë, faktikisht në shkresën e përcjellë nga MSHMS nr.142/3, prot datë 02.02.2021 celja e fondeve është kryer për vitin 2022 dhe 2023 respektivisht me nga 13,680 mijë lekë, dhe jo në vitin 2020 sikundër është kryer celja nga thesari, duke reflektuar kështu një risk të shtuar mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga MSHSM që e kanë mundësuar këtë situatë.

ç. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore

Situata lidhur me planifikimin e të ardhurave dytësore në projektbuxhetin e hartuar nga ISHP sipas periudhave respektive, dhe realizimi deri në fund të vitit rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Planifikimi projektbuxhet	Realizimi	Planifikimi projektbuxhet	Realizimi	Planifikimi projektbuxhet	Realizimi
1	Të ardhura nga analizat dhe tarifa shërbimi	4,500	1,221	4,000	838	1,430	830
2	Të ardhura nga licencat dhe shoqëritë tregtare	26,000	13,222	25,500	8,733	15,500	7,718
3	Të ardhura të tjera nga pagesa shërbimesh		520		320	580	30
4	Të tjera nga shitja e mallrave dhe shërbimeve		39,912		38	55	14
5	Grante nga i njëjti nivel qeverisjeje (Projekte të Ministrisë së Mjedisit)		2,607		2,071		2,964

6	Grante AGR.KEP.Italy, ESPAD		1,148				
TOTAL		**30,500**	**18,759**	**29,500**	**12,001**	**17,565**	**11,558**

Të ardhurat nga licenca dhe dhënie aprovimi janë gjeneruar nga ISHP në vijim të udhëzimit të MSHMS nr. 713, datë 11.10.2018 ñ*Për tarifat e licencimit të veprimtarive që përdorin burime të rrezatimit jonizues*ò në të cilin përcaktohen tarifat përkatëse të licencimit dhe lëshimit të aprovimeve përkatëse për import eksport dhe transport të burimeve të rrezatimit jonizues. Aktivitetet e kontrollit që janë implementuar nga ISHP për garantimin e likuidimit nga ana e përfituesve të shërbimeve që institucioni kryen kundrejt pagesës (analiza, licenca, etj), konsistojnë në bashkëlidhjen e mandatit të pagesës përpara dhënies së cdo vërtetimi të firmosur nga titullari. Likuidimi i pagesës rezulton të kryhet pasi janë kryer analizat përkatëse nga ISHP, moment ky që kryhet dhe përllogaritja e detyrimit përkatës. Pas kryerjes së pagesës nga përfituesit e shërbimeve, ISHP vijon me dhënien e miratimeve zyrtare të këtyre dokumentacioneve. Megjithatë nga ana e institucionit nuk është kryer asnjë monitorim për periudhën nën auditim në regjistrat e vërtetimeve/licencave/analizave sipas departamenteve respektive të ISHP për të garantuar se për të gjitha këto shërbime është kryer likudimi sipas tarifave përkatëse. Gjithashtu, për shkak të mos kryerjes së pagesave përpara se të vijohet me analizat, ekziston risku për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe mos likuidimin e tyre nga ana e përfituesve.

-Grantet nga i njëjti nivel qeverisjeje janë Projekte të Ministrisë së Mjedisit, në të cilat përfaqësuesit e ISHP janë angazhuar dhe pagesat për rimbursimin e këtyre shërbimeve, dietave, udhëtimeve etj janë rimbursuar nga ministria e Mjedisit.
- Në zërin Grante A..K..I., E. janë raportuar shpenzime në kuadër të një projekti që ISHP është informuar se do të zhvillohet pranë institucionit dhe fondet do të rimbursohen nga donatori sipas ecurisë të projektit. Ky projekt ka zhvilluar aktivitet vetëm për vitin 2018, dhe nuk ka vijuar më progresin e mëtejshëm të tij.

Për sa i përket pjesës së të ardhurave dytësore të derdhura në buxhetin e shtetit, dhe atyre qe u përkasin institucionit, situata rezulton si më poshtë:
Në mijë lekë

Viti	Total i arkëtuar	Pjesa e institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbeten per t'u trasheguar
2018	18,759	0	2,789	15,003	966
2019	12,001	0	2,071	9,930	0
2020	11,558	0	2,284	8,593	679

d. Planifikimi, alokimet, rialokimet dhe realizimet e fondeve buxhetore për përballimin e shpenzimeve në kuadër të fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019 dhe nga pandemia COVID-19.
-ISHP nuk ka qenë përfitues i fondeve të alokuara në kuadër të fatkeqesisë natyrore shkaktuar nga tërmetit, pasi dëmet e konstatuara nga grupi i ngritur për këtë qëllim janë vlerësuar në një nivel që nuk kërkonte investime specifike rikonstruksioni.
-Për sa i përket shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë COVID-19, me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është përcaktuar krijimi i fondit anti-Covid-19 prej 2,500 milion i cili është detajuar me VKM nr. 249/2020, ku është përcaktuar se 150 milionë lekë i kalojnë ISHP në programin ñShërbimet e shëndetit publikò. Në zbatim të saj, ISHP i janë alokuar në llogarinë 600, kodi 91305AG ñPersonel mjekesor dhe jo-mjekesor i trajtuar me bonus per Covid-19ò fondet në vlerë 150 milion lekë, një pjesë e të cilave përgjatë vitit është shpërndarë në njësitë vendore të shëndetit publik, dhe një pjesë është përdorur nga ISHP për shpërblimin financiar të stafit të angazhuar gjatë pandemisë. Nëse i referohemi planit fillestar atij të rishikuar dhe realizimit nga

ISHP për këtë fond, konstatohet se janë përdorur 46,558 mijë lekë më pak se fondet disponibël deri në fund të vitit, ose 36%.
Sikundër është trajtuar më sipër, janë kryer përgjatë vitit 2020 shpenzime për blerje tampone, kite dhe reagente për laboratorin e Covid-19 sipas buxhetit që ISHP ka patur në dispozicion në planin e buxhetit të vitit (pra pa ju alokuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit), dhe për periudhën Janar-Mars 2021 janë kryer shpenzime për blerje vaksinash në zbatim të akteve normative respektive sipas marrëveshjeve, fondet për të cilat janë alokuar nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit. Më hollësisht gjenden të trajtuara në pikat e mësipërme ku është trajtuar buxheti në të gjitha fazat e tij, nga hartimi i buxhetit, shtesave e pakësimeve e deri në realizim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
***Pretendimi i subjektit**: Për sa i përket konstatimeve lidhur me kërkesat për buxhet, kërkesat e drejtorive/ departamenteve përkatëse sidomos në fushën e investimeve kanë qenë një vjeçare, sepse në fakt për një periudhë prej më shumë se 7 vjetësh nuk është çelur asnjë investim, për rrjedhojë prioriteti mbetet përsëri i njëjtë në hartimin e buxhetit pasardhës. Në lidhje me kërkesat e shpenzimeve korente ato janë pasqyruar në buxhet vjetor (3 vjeçar), paraqitur në tabelat përkatëse me një rritje mesatare 5% për çdo vit, kurse shpenzimet e vaksinave të kalendarit (kanë qenë mirë të përcaktuara për periudha 3 vjeçare). Në lidhje me çeljen e planit për investime të projektit 18BB701 "Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së" ai është sistemuar dhe nuk paraqitet në Situacionet e rakordimit të muajit Qershor e në vazhdim dhe nuk rezulton sa në SFIQ e Degës Thesarit. Rekomandimi 6.4 lidhur me kryerjen e shpenzimeve të lidhura më situatën e Covid nuk merret në konsideratë nga Instituti i Shëndetit Publik. Në lidhje me rekomandimin 6.4 sqarojmë se Instituti i Shëndetit Publik i ka të sistemuara të gjitha shpenzimet sipas kodeve të produkteve përkatëse.…Përs a i përket gjetjes Nr. 7 i qëndrojmë observacionit të Akt-konstatimit nr. 2, me nr. 1026/20 prot., datë 06.08.2021 dhe theksojmë se pagesa prej 8,673,987 lekë është pagesë që është kryer për materiale konsumi (shiringa) nën C.. Bashkëlidhur gjeni kopje të Cost estimate me nr. 10024063, datë 12.03.2021, ku në fund të CE shkruhet C. si dhe shkresa e MSHMS me nr. 1150 prot., datë 01.03.2021, për pagesat që do të kryhen tek U për llogari të C., si dhe shkresën me nr. 295 prot., datë 03.03.2021 "Kërkesë për llogaritje kostoje për shiringat dhe kutitë e sigurisë të lidhura me vaksinën e C. – (CE).*
***Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në vijim të pretendimeve të subjektit sqarojmë se planifikimi i buxhetit kryhet për një periudhë 3 vjeçare afatmesme dhe për këtë qëllim fondet e propozuara nga ISHP pranë MSHMS duhet të jenë produkt i një plani të tillë. Për sa i përket mos marrjes në konsideratë të kërkesave si shkak i përsëritjes së tyre nga viti në vit, kjo është trajtuar si në akte ashtu edhe në projektraport nga grupi i auditimit, megjithatë nevojat e institucionit ndryshojnë nga viti në vit, dhe duhet të reflektohen në këto plane. Për sa i përket projektit të çelur në kodin 18BB701, problematikat e trajtuara në raport i referohen periudhës objekt auditimi. Lidhur me raportimin e shpenzimeve të kryera në kuadër të Covid, grupi i auditimit i referohet rasteve kur janë kryer shpenzime të tilla (si psh ajo e tamponëve dhe kiteve të prokuruara nga ISHP në fund të vitit 2020), të cilat edhe pse janë kryer për të përballuar situatën, faktikisht janë raportuar si shpenzime të aktivitetit normal të institucionit. Kjo situatë përbën një risk për mos raportimin e saktë të shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë.*
Lidhur me sqarimin nëse janë blerë nga ISHP jo vetëm tampone por edhe kite sqarojmë se sipas urdhër shpenzimit, ISHP ka kryer likuidimin me C. nën U për vaksinat në kuadër të situatës së pandemisë, për të cilat ka marrë edhe konfirmimin nga MSHMS.

1. Titulli:	**Problematika të konstatuara në hartimin e kërkesave nga ISHP gjatë fazës së hartimit të kërkesave për fonde në projektbuxhet, krahasuar me fondet e akorduara nga MSHMS**

Situata	Nga auditimi u konstatua se në kërkesat e hartuara nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Shëndetit Publik në zbatim të urdhrit të titullarit për përgatitjen e projektbuxhetit dhe përcjelljen e tij pranë MSHMS, u konstatuan disa mangësi ku përmendim: - Njësitë e institucionit që kanë përcjellë kërkesat për buxhet për përgatitjen e PBA-ve, në disa raste kanë përcjellë shkresat e kërkesave për buxhet të cilat i përkisnin kërkesave për buxhet për përgatitjen e PBA-ve të periudhave të mëparshme, të pa argumentuara, dhe në disa raste me diferenca në përllogaritjen e totalit, duke mos siguruar përcjelljen e kërkesave reale për hartimin e projektbuxhetit. - Në shumicën e rasteve kërkesat e drejtorive/departamenteve respektive janë përcjellë vetëm për vitin e parë të projekt buxhetit dhe jo për periudhën tre vjeçare sikundër ky dokument duhet të hartuar, dhe gjithashtu në hartimin e projekt buxhetit në vitin pasardhës nuk merren parasysh kërkesat e argumentuara në vitin e dytë të PBA-ve të mëparshme, duke mos siguruar një planifikim afatmesëm efektiv. - Në PBA-në e konsoliduar përgatitur nga MSHMS ku përfshihen edhe njësitë e varësisë së saj, për programin e shëndetit publik konstatohet se kryesisht **nuk** është marrë në konsideratë **asnjë** prej kërkesave për investime të bëra nga ISHP gjatë fazës së përcjelljes së projekt buxhetit të hartuar nga kjo e fundit. Gjithashtu në PBA-në e 2020-2022 dhe 2021-2023 të hartuar nga MSHMS, projekti i vetëm i planifikuar nga MSHMS me përfitues ISHP, përkatësisht 18BB701 ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi*ò, **nuk** rezulton i përfshirë në listën e investimeve të propozuar nga ISHP në projekt buxhetin e vitit 2020 dhe atë të vitit 2021, duke reflektuar kështu mangësi në procesin e planifikimit dhe koordinimit mes institucioneve të varësisë dhe MSHMS.
Kriteri:	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 ñPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmò
Ndikimi/Efekti:	Diferencat e konsiderueshme mes kërkesave për investime nga ISHP krahasuar me fondet e alokuara për disa vite ne rradhë, nuk mundësojnë një analizim nëse kemi të bëjmë me një planifikim shumë herë më të lartë se nevojat reale të institucionit, apo me mos përmbushje të nevojave të institucionit në përmbushje të misionit dhe objektivave të tij. Problematikat e identifikuara në hartimin e projektbuxhetit mund të ndikojnë në hartimin e një plani afatmesëm efektiv dhe përcjelljen e kërkesave reale pranë institucionit epror.
Shkaku:	Planifikimi final i fondeve për programin e shëndetit publik, pjesë e të cilit është edhe ISHP, duke mos përfshirë asnjë prej kërkesave për investime të propozuar, bëhet shkak për kryerjen e një planifikimi formal dhe pa u azhornuar nga viti në vit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	**-**Ekipi i ngritur pranë ISHP për hartimin e kërkesave gjatë fazës së projekt buxhetit, të marrë masat për kryerjen e një planifikimi më efektiv, duke marrë në konsideratë nevojat prioritare dhe buxhetin historik të

	institucionit, në mënyrë që ky proces të mos kryhet formalisht në përmbushje të një detyrimi ligjor, por të reflektojë konkluzionet e analizave të hollësishme në drejtim të një plani afatmesëm efektiv. **-**Strukturat përgjegjëse për hartimin e PBA-së pranë MSHMS të marrin masat për të përfshirë në programin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar të konsoliduar, edhe kërkesat e njësive të varësisë dhe rritjen e bashkëpunimit me to, në mënyrë që të shmangen situatat e konstatuara në këtë projektraport, ku projektet e propozuara dhe çelur për ISHP faktikisht nuk janë propozuar nga kjo e fundit.

2. Titulli:	**Rishikimet e shpeshta të fondeve përgjatë vitit (shtesa, pakësime, ri alokime)**
Situata 1	Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh në buxhetin e ISHP, që kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së MSHMS për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin e ISHP, duke ia alokuar këto fonde njësive vendore të shëndetit publik, apo institucioneve të tjera nën varësinë e ISHP, situata këto që reflektojnë një rol pasiv të institucionit në planifikimin buxhetor të saj. - Nga auditimi i shpenzimeve të kryera në kuadër të **pandemisë COVID-19,** me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është përcaktuar krijimi i fondit anti-Covid-19 prej 2,500 milion lekë, i cili është detajuar me VKM nr. 249/2020, ku është përcaktuar se 150 milionë lekë i kalojnë ISHP në programin ñShërbimet e shëndetit publikò për shpenzime korente. Në zbatim të VKM-së nr. 249/2020, ISHP-së i janë alokuar në llogarinë 600, konkretisht projektit me kod 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò fondet në vlerë 150 milion lekë, një pjesë e të cilave përgjatë vitit është shpërndarë në njësitë vendore të shëndetit publik për shpërblimin e personelit të angazhuar për përballimin e situatës së pandemisë në këto njësi (76.9 milion lekë); një pjesë është përdorur nga ISHP për shpërblimin financiar të stafit të angazhuar gjatë pandemisë (26.6 milion lekë); dhe një pjesë ka mbetur e pa realizuar (46.5 milion lekë). Konkretisht, nëse i referohemi planit fillestar buxhetor, atij të rishikuar dhe realizimit nga ISHP për këtë fond, konstatohet se nga ky fond janë përdorur gjithsej 26,625 mijë lekë, ose **46,558 mijë lekë më pak** se fondet disponibël deri në fund të vitit (ose 36%). Nga ISHP nuk është inciuar asnjë kërkesë për kryerjen e rialokimeve të këtyre fondeve, në institucione të tjera të programit të shëndetit publik, apo produkte të tjera ku nevoja për fonde ka qenë më e lartë. Për sa i përket fondeve për shpenzime operative përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID, në buxhetin e ISHP, për blerjen e tamponeve, kiteve dhe reagenteve me 2 operatorët ekonomikë **nuk** janë alokuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit për kryerjen e likuidimit të kontratës së lidhur (trajtuar më hollësisht në pikën e prokurimeve) dhe nuk është përdorur buxheti i pa realizuar i alokuar nga fondi Anti Covid për shpenzime shpërblimi personeli, por **institucioni ka përdorur tepricat e disponueshme në dispozicion, alokuar për aktivitetin rutinë, duke kryer ri-alokime brenda programit të institucionit, në produkte të ndryshme, pa efekt në totalin e vlerës së buxhetit në dispozicion për vitin 2020**. Më hollësisht, kanë qenë në dispozicion rreth 60 milion lekë nga produkti i çelur për

kryerjen e pagesave për vaksina sipas Programit Kombëtar të Vaksinimit me kod 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò (rialokimi në SIFQ i datës 23.11.2020), 4.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e gjiritò, me kod 91305AD (rialokimi i datës 18.11.2020), dhe rreth 10.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò, me kod 91305AF (rialokimi i datës 18.11.2020). Nga këto fonde janë likuiduar më pas dy fatura me vlerë rreth 50 milion lekë për blerje tamponësh, reagent dhe kite në zbatim të kontratës së lidhur. Këto shpenzime janë kryer nën projektin ñNumër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò, duke mbartur kështu riskun e mos përllogaritjes së tyre në totalin e shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë, për të cilin duhet të ishte çelur kodi jo vetëm në llogarinë 600 për dhënie shpërblimesh të personelit, por edhe për blerje mallrash apo shërbimesh në funksion të situatës shkaktuar nga Covid (602), sikundër është realizuar edhe shpenzimi i trajtuar më sipër për blerje tampon kite, reagent.

Pra, nga auditimi rezultoi se buxheti fillestar total (shpenzime korente dhe kapitale) për vitin 2020, për ISHP ka qene 788,262 mije leke ose 85,746 mijë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019 (702,516 mijë lekë), konkretisht: me shkresën e MSHMS nr. 247/2, prot datë 28.01.2020, është bërë çelja e buxhetit fillestar për shpenzime korrente të ISHP, në vlerë totale 775,262 mijë lekë (nga 695,953 mijë lekë **të realizuara** fillimisht 1 vit më parë); ndërsa me shkresën nr. 307/3, prot datë 28.02.2020 të MSHMS janë çelur shpenzime për investime në vlerën 13,000 mijë lekë për vetëm 1 projekt investimi (nga 49,752 mijë lekë të planifikuara fillimisht 1 vit më parë).
Pavarësisht se planifikuar me rritje (rreth 86 milionë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019), ky buxhet, si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, në fund të vitit 2020 rezultoi në rënie, në vlerën 707,532 mijë lekë (ose rreth 81 milion lekë më pak **më pak** nga sa u parashikua me ligjin nr.88, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò).
Në fund të vitit 2020, buxheti i ISHP u realizua në vlerën 648,670 mijë lekë, ose 58,862 mijë lekë më pak nga sa planifikuar, dhe 53,846 mijë lekë më pak nga sa realizuar një vit më parë, pavarësisht shtesës në fonde për llogari të Covid19.

Në kushtet kur buxheti i ISHP jo vetëm që nuk ka pësuar rritje nga viti i mëparshëm, po dhe shtesat që iu alokuan në buxhet si pasojë e Covid (150 milionë leke vetëm me **VKM nr. 249, date 27.03.2020**) nuk reflektuan rritje ne buxhet, përkundrazi buxheti i ISHP u tkurr me 81 milionë leke nga plani fillestar dhe me rreth 5 milion leke më pak nga fakti i vitit 2019), për shkak të mos realizimit të projekteve të planifikuara që lidhen me aktivitetin normal të ISHP si :

1. 91305AD ñ*Gra te depistuara për kancerin e gjirit*ò, planifikuar fillimisht 14,302 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 9,772 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 9,284 mijë lekë (488 mijë lekë më pak).
2. 91305AF ñ*Gra te depistuara për kancerin e qafës së mitrës*ò planifikuar fillimisht 40,560 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 62 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 62 mijë lekë.
3. 91305AA ñ*Fëmijë të vaksinuar 0-18*ò planifikuar fillimisht 400,000

	mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 271,000 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 270,760 mijë lekë (240 mijë lekë më pak). 4. 91305AB ñ*Numër kontrollesh për situatat epidemiologjike*ò për paga dhe sigurime të personelit të institucionit (llog 600,601) planifikuar fillimisht 193,100 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 179,630 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 172,023 mijë lekë (7,607 mijë lekë më pak); dhe për këtë produkt për shpenzime për shërbime (llog 602) planifikuar fillimisht 127,300 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 172,076 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 168,446 mijë lekë (3,630 mijë lekë më pak)
Situata 2	Nga auditimi u konstatua se Projekti **18BB701** ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi"* është planifikuar në PBA 2020-2022 të MSHMS në vlerën 13,000 mijë lekë dhe është çelur në buxhetin e vitit 2020 po në atë vlerë. Përgjatë vitit nga MSHMS janë kryer ndryshime në buxhetin në dispozicion të ISHP dhe ky projekt deri në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0, shkak për të cilin sipas ISHP është bërë situata e pandemisë dhe ky projekt është gjykuar të përfshihet në planin buxhetor të viteve pasardhëse. Nga auditimi konstatojmë se kërkesa për rishpërndarje fondesh nuk është bërë nga ISHP, por është kryer nga organi epror ï MSHMS; e si pasojë ISHP si njësi shpenzuese që menaxhon këtë projekt nuk ka nja analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, sikundër dikton Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, paragrafi 74.
Situata 3	Në vitin 2021 janë konstatuar se ekzistojnë diferenca në disa produkte mes planit që rezulton në rakordimin mujor me degën e thesarit, dhe planit të rishikuar që rezulton pas shtesave dhe pakësimeve që janë kryer gjatë vitit. Më hollësisht, diferencat në llogarinë e pagave 600 janë sistemuar në rakordimin e muajit Prill, ndërsa diferenca e konstatuar në projektin e investimit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, ka vijuar të mbartet. Më hollësisht u konstatua se referuar shkresës së përcjellë nga MSHMS me nr.142/3, prot datë 02.02.2021 ñ***çelja e fondeve për këtë projekt është kryer për vitin 2022 dhe 2023 respektivisht me nga 13,680 mijë lekë"*****, dhe jo për vitin 2021, ndërsa vëmë re se, referuar** rakordimit mujor me degën e thesarit, për periudhën Janar-Mars 2021, faktikisht këtë projekt rezulton si plan buxheti për vitin 2021, vlera prej 13 milion lekë, duke mbartur riskun e fillimit të procedurave të prokurimit pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion.
Kriteri:	Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò
Ndikimi/Efekti:	Rishikimet e shpeshta të fondeve shkaktojnë impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit; problematika në ekzekutimin e kontratave në kohë për shkak të mos disponibilitetit të fondeve; Disa produkte konsistojnë në realizim të ulët, në kushtet kur shpenzimet nuk realizohen sipas planit, dhe ato nuk rishpërndahen.
Shkaku:	Rishikimet e shpeshta të fondeve që konsistojnë në shtime/pakësime për financimin e investimeve sipas vendimmarrjes së MSHMS, pa u inciuar me

	kërkesa nga ISHP; Mos përcjellja e shkresave nga ISHP për inicimin e procedurave të rialokimit të fondeve për produktet me realizim të ulët; Mos përfshirja e planit buxhetor të ISHP për blerjen e tamponeve, kiteve dhe reagenteve në fondin Anti Covid të krijuar nga buxheti i shtetit për financimin e shpenzimeve në kuadër të pandemisë, është bërë shkak për kryerjen e ri alokimeve nga produkti për blerjen e vaksinave të planit kombëtar (teprica buxhetore) në produktin e epidiomologjisë të programit të shëndetit publik.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	**-** ISHP të marrë masat për një monitorim më efektiv të fondeve buxhetore, duke identifikuar produktet që janë me realizim më të ulët në mënyrë që të përcillen kërkesat pranë MSHMS për rishpërndarjen e këtyre fondeve në produkte apo institucione të tjera brenda programit sipas nevojës, në funksion të përmbushjes së misionit të institucionit. **-**Për sa i përket buxhetit për financimin e investimeve kapitale, strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit pranë ISHP dhe MSHMS, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit me tyre veçanërisht në kuadër të buxhetit për investimet kapitale në mënyrë që të shmangen fenomenet e rishikimeve të shpeshta të fondeve situata këto me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit. **-** Strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS të marrë masa të menjëhershme për të sistemuar planin buxhetor të vitit 2021, të projektit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, duke rakorduar me degën e thesarit, me qëllim shmangien e risqeve të marrjes së angazhimeve, pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion. **-** ISHP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS dhe MFE, të marrin masat në vijim për të sistemuar fondet e shpenzuara në funksion të situatës së shkaktuar nga Covid-19, në dallim me ato që i përkasin veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese, me qëllim që ato të evidentohen me kod produkti të identifikueshëm më vete me qëllim monitorimi dhe raportimi.

3. Titulli:	**Problematika të konstatuara në realizimin dhe raportimin e shpenzimeve sipas kodeve të produkteve buxhetore**
Situata	Nga auditimi u konstatua se për periudhën Janar-Mars 2021, nga ISHP është kryer likuidimi i pagesave për vaksinat kundër Covid-19 në vlerë **1,074,862 mijë lekë**, sipas 3 urdhër shpenzimeve, por nëse i referohemi rakordimit me degën e thesarit, vlera e shpenzimeve të kryera deri në këtë periudhë në projektin 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò është 1,083,538 mijë lekë. Diferenca prej rreth 8.7 milionë lekë leke, e raportuar më shumë sipas thesarit vjen si pasojë e përfshirjes së gabuar në këtë produkt të urdhër shpenzimit të kryer në vlerë 8,673,987 lekë të pagesës së shiringave në kuadër të programit kombëtar të vaksinimit, i cili faktikisht duhet të raportohej si shpenzim në kodin 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò. **Si rezultat, raportimi për shpenzimet buxhetore për personat e vaksinuar nga Covid 19, është i gabuar duke u raportuar rreth 8.7 milion lekë më shumë se niveli faktik i shpenzimeve,** me impakt kjo në analizën e indikatorëve të buxhetit bazuar në të dhënat e konsoliduara nga MSHMS në rang spitalor për programin e shëndetit publik.

Kriteri:	Ligjit Nr. 9936 datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Ligjet respektive për buxhetin e vitit 2018, 2019,2020,2021 Udhëzimi i Përhershëm ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.
Ndikimi/Efekti:	Nuk mundësohet pasqyrimi i saktë i shpenzimeve të destinuara sipas objektivave të projektit/produktit.
Shkaku:	Raportim jo i saktë pranë thesarit, për shkak edhe të periudhës relativisht të shkurtër kur ka filluar implementimin një raportim i tillë në rang produktesh.
Rëndësia:	E mesëm
Rekomandime:	- ISHP të marrë masat për raportimin e saktë të shpenzimeve sipas produkteve ku është çelur plani buxhetor, në mënyrë që edhe analiza e performancës së produktit të reflektojë nivelin real të realizimit të planit.

III. 3 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të rregullores së brendshme të ISHP, u shqyrtua zbatimi i detyrave dhë përgjegjësive të Sektorit të Financës në drejtim të përllogaritjes dhe menaxhimit të pagave, sigurimeve shoqërore, në zbatim të legjislacionit përkatës dhe të Zyrës së Burimeve Njerëzore lidhur me përgjegjësitë për sistemimin dhe drejtimin e personelit, rekrutimin, sistemimin e personelit në përputhje me legjislacionin, trajnimin, ecurinë profesionale, motivimin, pagat, organizimin e strukturave, etj. Më hollësisht:

a. Respektimi i strukturave organike te miratuara dhe krahasimi me faktin.



Burimi: ISHP

Struktura e ISHP fillimisht është miratuar në vitin 2014 me një personel prej **206** punonjësish, sipas shkresës nr. 6/3, prot datë 22.01.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS. Në vijim të saj, është përcjellë nga Ministri i Shëndetësisë struktura analitike e institucionit sipas shkresës nr. 220/1, prot datë 17.02.2014, ku faktikisht struktura rezulton me një personel prej **200** punonjësish. Kjo situatë është saktësuar në shkresën nr. 220/3, prot datë 21.04.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS ku përcaktohet se pavarësisht se fillimisht është përcaktuar një strukturë me 2016 punonjësish, ISHP duhet të qëndrojë brenda limitit prej 200 punonjësish, sipas strukturës analitike përcjellë nga Ministri. Më pas, me shkresën nr. 6232/1, prot datë 10.11.2014 të Ministrit të MSHSM është miratuar ndryshimi në strukturë për shtimin e 2 laborantëve dhe 2 shoferëve, duke e çuar strukturën me një total prej **204** punonjësish. Në vijim, me shkresën nr. 1280, prot datë 04.11.2020 të Drejtorit të ISHP është përcjellë pranë MSHMS kërkesa për kryerjen e një ndryshimi në strukturën e ISHP për një shtesë në strukturë për shkak të volumit të madh të punës

si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, përkatësisht të një specialisti në Sektorin e Laboratorit të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive, Laboratori i Biologjisë Molekulare. Në vijim të saj, me urdhrin nr. 635, datë 19.11.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar ndryshimi, duke e çuar numrin total të punonjësve të ISHP-së nga 204, në **205 vetë.**
Me urdhër nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, është përcjellë struktura organizative e institucionit dhe organika. Një tjetër ndryshim, po pa një efekt në numrin total të punonjësve është kryer me urdhrin nr. 753, datë 22.11.2019 të Ministrit të MSHMS për shtesën e një specialisti në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Rrezatimi, dhe reduktimin e një specialisti në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- Nga auditimi konstatohet se për emërimin e nëpunësit zbatues të ISHP nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ñ*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", ku* cilësohet se, ñ*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, <u>në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë</u>.* Më hollësisht, referuar strukturës organike dhe organigramës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me urdhrin nr . 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, nëpunësi zbatues (Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Financës, znj. A.M.) <u>nuk është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues</u> (Titullari i Institucionit, znj. A.F.) pasi në strukturën e miratuar Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Financës është nën varësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, i cili më pas përgjigjet dhe raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm të ISHP.

-Sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, janë përcaktuar pozicionet dhe klasat sipas së cilave do të kryhet edhe trajtimi financiar i tyre, duke përfshirë edhe rastet në të cilat pozicioni do të jetë përfitues i trajtimit financiar për shkak të disponimit të doktoraturave apo specializimit. Nga auditimi konstatohet se brenda të njëjtit sektor/drejtori në strukturë parashikohet punësimi i specialistëve me të njëjtin titull në pozicionin e emëruar (pra specialist apo përgjegjës sektori) por për disa pozicione është parashikuar shtesa për shkak të pajisjes me një specializim/doktoraturë, dhe për disa të tjera jo. Ky përcaktim në strukturën e miratuar **nuk** është shoqëruar me hartimin dhe miratimin e përshkrimit të pozicionit të punës dhe detyrave në mënyrë që të identifikon edhe se ku do të konsistojë detyra që lidhet me punën kërkimore për të cilën është parashikuar edhe përfitimi financiar. Shtuar këtu edhe faktin se në rregulloren e hartuar nga ISHP nuk është përfshirë përshkrimi i detyrave për pozicionin e specialistëve. Më hollësisht, në Sektorin e Programit Kombëtar te Vaksinimit janë të punësuar 5 specialist ku vetëm njëri mund të përfitojë nga shtesa e pagës nëse disponon një specializim shtesë (kërkues apo doktor), në varësi të emërimit të tij; në Sektorin e Programit Kombëtar të Kontrollit të Turbekulozit, mund të përfitojnë shtesën e specializimit vetëm 2 nga 3 specialistë; në Sektorin e Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive vetëm 1 nga specialistët nuk mund të përfitojë shtesën edhe nëse e disponon një specializim shtesë, në Sektorin e Laboratorëve të Referencës Kombëtare të Shëndetit dhe Mjedisit gjithashtu vetëm një prej specialistëve nuk parashikohet të përfitojë shtesë për specializimin shtesë, etj.

-Në strukturën e miratuar të ISHP evidentohet mungesa e Sektorit të Prokurimeve dhe e pozicionit të juristit. Për këtë, Drejtori i ISHP ka përcjellë pranë MSHMS shkresën nr. 178, prot datë 05.02.2021 ñKërkesë për krijimin e Sektorit të Prokurimeve në ISHPò, duke cituar se menaxhimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik nga Sektori i Financës është bërë tejet i vështirë e gati e pamundur, dhe kërkohen punonjës të angazhuar totalisht në këtë fushë për zhvillimin, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të nënshkruara, duke kërkuar që në 3 nga pozicionet vakante që ISHP disponon aktualisht të krijohet sektori i prokurimeve me 2 specialist. Kjo shkresë është ri

kërkuar me shkresën nr. 178/1 prot datë 16.06.2021.

- Struktura plan/ fakt e ndarë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Viti	Plan	Fakt	Pedagogë të UMT-së
2018	204	199	8
2019	204	185	7
2020	205	183	6
2021	205	186	6

Nga auditimi konstatohet se për 3 vitet e fundit ISHP ka patur vakanca në masën **rreth 10% të totalit (20 punonjës).** Këto pozicione përfshijnë si specialistë, ashtu edhe përgjegjës sektori të cilat rezultojnë vakante për periudha relativisht të konsiderueshme kohore, dhe për të cilat ISHP nuk ka kryer shpalljen e pozicioneve vakante. Konstatohet se shpalljet janë kryer nga institucioni **vetëm** për punonjësit për të cilët procedura e rekrutimit ka konkluduar me një emërim, dhe jo për të gjitha vakancat që disponohen në institucion. Për vitin 2020, në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, rezulton se janë emëruar rishtas vetëm 2 punonjës arkivist, 1punonjës për specialist në sektorin e monitorimit dhe vlerësimit, 1 specialist në Sektorin e DPSHP, 1 shofer dhe vetëm 2 pozicione laborantësh, përkatësisht një specialist laborant dhe një përgjegjës departamenti laboratori.

b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.
Dosjet e personelit

Në zbatim të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 ñPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò, e cila përcakton se ñ*1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuari në institucionin e tyre. Dhe 2. Në kuptim të këtij vendimi, me "institucione të administratës shtetërore" kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale."*, u përzgjodhën nga grupi i auditimit disa dosje punonjësish për tô u verifikuar dokumentacionet që ato përmbajnë. Sipas kuadrit rregullator të sipërcituar, në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen: ñ*Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar; Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes; Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë);certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse "nota mesatare" është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; libreza e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri."* Nga auditimi konstatohet se dosjet e punonjësve të përzgjedhura nga grupi i auditimit nuk ishin te inventarizuara sipas dokumentacioneve respektive në to. Konstatohet se në disa prej tyre

mungonin raportet mjeko ligjore, përshkrimet e pozicioneve të punës apo vlerësimet. Vlerësimet e punonjësve kanë qenë vjetore. Nga auditimi konstatohet se në Rregulloren e Brendshme të ISHP nuk janë miratuar përshkrimet e pozicioneve të punës për poizicionet e specialistëve. Në dokumentacionet e përshkrimit të pozicioneve sipas dosjeve rezulton se këto dokumente nuk janë të miratuara nga titullari i institucionit. Përshkrimet e punës së punonjësve janë firmosur në disa raste vetëm nga eprori direkt, dhe në disa të tjera nga vetë punonjësi për të cilën është bërë përshkrimi. Përshkrimi i pozicionit të punës është kryer në varësi të eksperiencës, aftësive dhe shkollimit që punonjësi i punësuar disponon, dhe jo sipas objektivave dhe detyrave të pozicionit në varësi të sektorit/njësisë ku bën pjesë.

Nga auditimi konstatohet se ISHP nuk aplikon Sistemin Informatikë të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky sistem mundëson që dosjet personale të të punësuarve të pasqyrojnë të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, trajnimet, pagat dhe sigurimet, strukturën dhe organikën e institucioneve duke ndërvepruar me bazat e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave etj; duke shërbyer si burim planifikimi dhe informacioni për pagat dhe pagesat e punonjësve.
Përllogaritja e pagave të punonjësve është kryer në zbatim të VKM-së nr 555, datë 11.08.2011 ñ*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë Së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit te Traumës, si dhe Trajtimin e Personelit Mjekësor në Strukturat e Forcave të Armatosura"* ndryshuar me VKM-në nr 1076, datë 24.12.2020 ñ*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 555.."* dhe VKM-së nr. 717, datë 23.06.20009 ñ*Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore".* Për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05,1993 ñPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëò, ligji nr. 8438, datë 28.12,1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò.

Kontratat e punonjësve

Punonjësit e ISHP trajtohen sipas përcaktimeve ligjore të Kodit të Punës. Në vitin 2019, pas miratimit të strukturës së re të institucionit, sipas urdhrit nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, institucioni është ristrukturuar. Si rezultat të gjitha kontratat provizore të punës kanë përfunduar, dhe me stafin e punësuar në pozicionet sipas strukturës së re janë lidhur kontrata individuale pa afat. Nga auditimi u konstatua se në zbatim të pikës 3 të nenit 21 të Kodit të punës i cili përcakton se *" Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos:a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive",* në kontratat individuale të lidhura nga ISHP nuk parashikohet data e dhënies së pagës. Në kontratën kolektive te lidhur mes MSHMS dhe KSSH për periudhën 2018-2021 nr. 1308/1, datë 26.02.2018, parashikohen procedurat e masave disiplinore dhe llojet e tyre për punonjësit në shërbimin spitalor.

Emërimet e punonjësve

Numri i punonjësve të emëruar	Viti
8	2018

13	2019
5	2020
5	2021

Shpalljet e kryera sipas viteve:

Viti 2018
- Njoftimi për vend te lire pune (jurist, Përgjegjës në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse)
- Njoftimi për vend të lirë pune (Asistent i Drejtorit)
- Njoftimi për vend të lirë pune (Magazinier pranë sektorit të financës)
- Njoftimi për vend të lirë pune (Specialist për marrëdhënie me publikun në sektorin e BNJ)

Viti 2019
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës Përgjegjës BNJ-2019
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës Sanitare/ Teknik Imazheri-Radiologji
- Njoftimi për shpallje të vendit të punës në APP (Specialist DEKSI ï ZMR - Administratë 2019)
- Njoftimi për shpallje të vendit të punës në APP (Specialist DVTRSHP - ZMR dhe Laborator Kimi Analitike - 2019)
- Njoftimi për shpallje të vendit të punës (Specialist në BNJ)
- Njoftimi për shpallje të vendit të punës (Specialist në BNJ)
- Njoftimi për shpallje të vendit të punës specialist DEKSI ï ZMR --2019)

Viti 2020
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës-specialist në DMRR/Arkivist në DSHM
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës shofer/Laborant me arsim të mesëm
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës specialist në sek. e monitorimit dhe vlerësimit
- Njoftimi për shpalljen e pozicioneve të punës Specialist në DPSHP/Përgjegjës në LRK

Viti 2021
- Njoftimi për shpallje të vendeve të punës APP-së SSBNJ+SSFS+LDLRK+SSUS

Largimet e punonjësve
Situata lidhur me emërimet dhe largimet e punonjësve të ISHP për periudhën objekt auditimi, sipas motiveve të largimit paraqiten si më poshtë:

Arsyeja e largimit	2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Dorëheqje	4	5	2	
Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	2	1		
Pension	8	8	1	1
Transferim		2		
Shkurtim		8	1	

Grupi i auditimit mori nën shqyrtim procedurat e ndjekura për secilin rast, ku rezultoi se janë ndjekur procedurat e parashikuara në kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi për secilin rast për ngritjen e grupit të punës, njoftimin e punonjësve, kryerjen e takimeve, dhe vendimmarrjen finale. Më hollësisht, sipër ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, shkurtimit dhe transferimit janë ndjekur procedurat si më poshtë:

Ndërprerje të marrëdhënieve të punës
Viti 2018

1. Me urdhër nr. 170, datë 24.09.2018 të Drejtorit të ISHP është përcaktuar se bazuar në kontratën kolektive të punës me nr. 1715, prot datë 31.12.2015, dhe kërkesës nr. 274, prot., datë 01.03.2018 është urdhëruar zgjidhja e marrëdhënieve të punës për punonjësen me detyrë specialiste pranë Sektorit të Substancave Abuzive në Departamentin e Promocionit Shëndetësor pasi për këtë pozicion do të kryhet procedura e rekrutimit sipas urdhrit nr. 511, prot datë 13.12.2011.
2. Me urdhër nr. 3, datë 18.02.2018, bazuar në Kontratën Kolektive të Punës me nr. 1715 prot., datë 31.12.2015 është urdhëruar zgjidhja e marrëdhënieve të punës me Përgjegjësin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse pasi nuk është paraqitur në punë dhe ka njoftuar me email se nuk do të rikthehet me një kohë të papërcaktuar. Bashkëlidhur në dosje dokumentacionet që vërtetojnë mungesat e punonjësit dhe relacionet përkatëse të Burimeve Njerëzore.
Viti 2019
1. Me urdhër nr. 17, datë 01.02.2019, bazuar në Kontratën Kolektive të punës me nr. 1715 prot datë 31.12.2015 është urdhëruar zgjidhja e marrëdhënieve të punës me teknikun imazheri-radiologji pranë Departamentit të Epidiomologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore pasi nuk është paraqitur në punë pa arsye apo miratim të titullarit për mungesën. Bashkëlidhur në dosje dokumentacionet që vërtetojnë mungesat e punonjësit dhe relacionet përkatëse të Burimeve Njerëzore.

Shkurtime
Viti 2019
Në vijim të ristrukturimit të ISHP, Drejtori i Përgjithshëm ka ngritur një grup punë për të verifikuar përputhshmërinë e punonjësve të institucionit me pozicionet e strukturës së re, konkluzionet e të cilit janë finalizuar me relacionin e grupit të punës nr. 232/2, prot date 09.04.2019. Në vijim janë zhvilluar takime për njoftimin e punonjësve si më poshtë:
1-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/626, prot datë 07.06.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Infeksioneve Spitalore. Në këtë takim punonjëses i është bërë me dije se në vijim të urdhrit nr. 159, datë 15.02.2019 të MSHMS me lëndë ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò ISHP është ristrukturuar, dhe si rezultat kontratat provizore të punës do të përfundojnë. Si rezultat kontrata provizore e lidhur më 07.09.2017, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për atë vend pune, për shkak të rikonstruksionit është ndërprerë.
2-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/625, prot datë 07.06.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Ushqyerjes dhe Sigurisë Ushqimore. Në këtë takim punonjëses i është bërë me dije se ISHP është ristrukturuar, dhe si rezultat kontratat provizore të punës do të përfundojnë. Si rezultat kontrata provizore e lidhur më 17.04.2015, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për atë vend pune, për shkak të rikonstruksionit është ndërprerë. Në fund të procesverbalit të takimit, punonjësja ka shprehur mos dakortësinë e saj për këtë vendim.
3-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/624, prot datë 07.06.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Shëndetit në Punë dhe Teknologjisë. Në ktëë takim punonjëses i është bërë me dije se në vijim të ristrukturimit të ISHP kontratat provizore të punës do të përfundojnë. Si rezultat kontrata provizore e lidhur më 07.09.2017, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për atë vend pune, për shkak të rikonstruksionit është ndërprerë.
4-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/623, prot datë 07.06.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Ujit dhe Sanitetit ku është njoftuar se në vijim të ristrukturimit të ISHP, kontrata provizore e lidhur më 22.06.2018, deri në përfundim të

procedurave të konkurrimit për atë vend pune, për shkak të rikonstruksionit është ndërprerë.
5-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/174, prot datë 13.05.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me një shofer të ISHP, pozicioni i së cilit është shkurtuar në vijim të ristrukturimit të institucionit, dhe është vendosur largimi i tij, duke qenë se punonjësi ka patur më pak vite pune në ISHP krahasuar me punonjësit e tjerë. Në fund të procesverbalit të takimit, punonjësi ka shprehur mos dakortësinë e tij për këtë vendim.
6-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/175, prot datë 13.05.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me një shofer të ISHP, pozicioni i së cilit është shkurtuar në vijim të ristrukturimit të institucionit, dhe është vendosur largimi i tij, duke qenë se punonjësi ka patur më pak vite pune në ISHP krahasuar me punonjësit e tjerë. Në fund të procesverbalit të takimit, punonjësi ka shprehur mos dakortësinë e tij për këtë vendim.
7- Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/173, prot datë 13.05.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me një furnitor të ISHP ku është informuar se pozicioni i tij i punës është shkurtuar, kjo për shkak të konkluzioneve të grupit të punës mbi formimin arsimor dhe eksperiencën e punës së punonjësit. Në fund të procesverbalit të takimit, punonjësi ka shprehur mos dakortësinë e tij për këtë vendim.
8-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 232/622, prot datë 07.06.2019 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Shëndetit në Punë dhe Toksikogjisë. Në këtë takim punonjëses i është bërë me dije se në vijim të urdhrit nr.159, datë 15.02.2019 të MSHMS me lëndë ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò ISHP është ristrukturuar dhe se vendimi për ndërprerjen është mbështetur në relacionin e grupit të punës, në të cilin është analizuar fakti se pozicioni i punës kërkon arsim mjekësi e përgjithshme ose shëndet publik, ndërkohë punonjësja ka arsim të lartë kryesor degën gjeografi dhe për shkak të ñMospërputhjes së vendit të punës me arsimin e punonjësitò është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
Viti 2020
-Në vijim të njoftimit për zhvillimin e takimit për diskutim mbi Kontratën e Punës në kuadër të rikonstruksionit të strukturës, me shkresën nr. 203/1, prot datë 10.02.2020 është mbajtur procesverbali i takimit me specialisten pranë Sektorit të Fizikës Sanitare. Në këtë takim punonjëses i është bërë me dije se në vijim të urdhrit nr. 159, datë 15.02.2019 të MSHMS me lëndë ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò ISHP është ristrukturuar, dhe si rezultat kontratat provizore të punës do të përfundojnë. Si rezultat kontrata provizore e lidhur më 03.10.2016, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për atë vend pune, për shkak të rikonstruksionit është ndërprerë. Shkak për këtë vendimmarrje në vitin 2020 dhe jo në 2019, ka qenë fakti se punonjësja ka qenë me lejen e lindjes dhe ISHP nuk mund të bënte ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjës gjatë kësaj kohe, për sa kohë ajo paguhej nga ISSH.

Transferime
Dy transferimet e punonjësve janë kryer në vijim të shkresës së MSHMS ñPër kalimin e punonjësve të IT pranë AKSHI-tò, dhe urdhrat respektiv në vijim të së cilës, përkatësisht nr. 39 datë 07.03.2019 dhe nr. 53 datë 22.03.2019 për të transferuar punonjësit nën varësinë e AKSHI-t.

Për sa i përket **vendimeve gjyqësore**, sipas informacionit të përcjellë nga ISHP nuk ka asnjë vendim të gjykatës për kthim në punë të ndonjë ish punonjësi apo për të njoftuar mbi detyrime ndaj ish punonjësve të larguar. Për sa i përket çështjeve nën proces gjykim verbalisht u bëmë me dije nga Burimet Njerëzore se nuk ka asnjë rast të tillë, por duke qenë se institucioni nuk ka jurist në strukturë, ky informacion nuk mund të përcillej zyrtarisht.

c. Auditimi mbi shpërblimet e përfituar nga punonjësit në kuadër të shërbimeve të kryera gjatë pandemisë COVID-19.

Në zbatim të VKM-së nr.207, datë 10.3.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò, është vendosur dhënia e shpërblimit mujor për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe për personelin mbështetës, të angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, ku në bazë të ditëve të angazhimit në punë, ku personeli mjekësor do të shpërblehet në masën 125,000 lekë, dhe personeli mbështetës në masën 65,000 lekë.

Me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është përcaktuar krijimi i fondit anti-Covid-19 prej 2,500 milion i cili është detajuar me VKM nr. 249/2020, ku është përcaktuar se 150 milionë lekë i kalojnë ISHP në programin ñShërbimet e shëndetit publikò. Në zbatim të saj, ISHP i janë alokuar në llogarinë 600, kodi 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò fondet në vlerë **150 milion lekë**, një pjesë e të cilave përgjatë vitit është shpërndarë në njësitë vendore të shëndetit publik, dhe një pjesë është përdorur nga ISHP për shpërblimin financiar të stafit të angazhuar gjatë pandemisë. Me shkresën nr. 1429/1, prot datë 12.03.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, është përcjellë për ISHP VKM e sipërcituar, duke udhëzuar se lista emërore e përfituesve do të dërgohet në MSHMS brenda muajit 3 të muajit pasardhës. Në vijim të saj për çdo muaj Drejtori i Përgjithshëm i ISHP ka përcjellë listën e punonjësve të angazhuar dhe ditët e punës respektive sipas listë prezencës, ku në mënyrë të përmbledhur numri total i stafit dhe shuma e pagesave paraqiten si më poshtë:

Nr	Muaji	Shpërblimi në total	Shperblimi sipas pagesave të kryera	Numri i punonjësve
1	MARS	2,755,323	2,755,323	34
2	PRILL	2,920,000	2,920,000	36
3	MAJ	2,854,677	2,854,677	32
4	QERSHOR	2,890,833	2,890,833	32
5	KORRIK	2,772,097	2,772,097	34
6	GUSHT	2,945,167	2,945,167	46
7	SHTATOR	2,605,167	2,605,167	48
8	TETOR	3,498,227	3,498,227	52
9	NENTOR	3,981,001	3,383,851[10]	62
Totali i pagesave nga buxheti i vitit 2020		**27,222,492**	**26,625,342**	
10	DHJETOR	4,012,581		72
11	JANAR-21	2,214,677		36
12	SHKURT-21	3,359,824		50
13	MARS-21	2,338,065		51

Për sa i përket angazhimit të stafit në recepsionin e ISHP, Drejtoi i Përgjithshëm ka hartuar urdhrat si më poshtë:

- Urdhri nr. 142, datë 1.09.2020 ñPër organizimin e stafit në recepsionin e ISHP për muajin Shtator-Tetorò
- Urdhri nr. 173, datë 20.10.2020 ñPër organizimin e stafit në recepsionin e ISHP për muajin Nëntor-Dhjetorò
- Urdhri nr. 209, datë 4.12.2020 ñPër organizimin e stafit në recepsionin e ISHP për muajin Dhjetor-Janarò
- Urdhri nr. 26, datë 29.01.2021 ñPër organizimin e stafit në recepsionin e ISHP për muajin Shkurt-Marsò

[10] *Pagesa e shperblimeve te muajit Nëntor është kryer në muajin Dhjetor, por deklarimi i tatimi prej 597,150 lekë është bërë në muajin Janar 2021.*

- Urdhri nr. 74 datë 26.03.2021 ñPër organizimin e stafit në recepsionin e ISHP për muajin Prill-Korrikò

Sikundër vërehet edhe nga tabela e mësipërme shpërblimi financiar i punonjësve është bazuar në angazhimin e tyre për situatën e pandemisë dhe varion nga 31 punonjës në muajin Qershor në 72 punonjës në muajin Dhjetor .

Produkti	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Realizimi	Realizimi %	Dif. realizim-plani rishikuar
91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò	150,000,000	73,184,000	26,625,342	36%	46,558,658

Nëse i referohemi planit fillestar atij të rishikuar dhe realizimit nga ISHP për këtë fond konstatohet se janë përdorur 46,558 mijë lekë më pak se fondet disponibël, ose 36%.

4.Titulli:	**Problematika të konstatuara në strukturën organizative të ISHP**
Situata:	Nga auditimi konstatohet se sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, janë përcaktuar pozicionet dhe klasat sipas së cilave do të kryhet edhe trajtimi financiar i tyre, duke përfshirë edhe rastet në të cilat pozicioni do të jetë përfitues i trajtimit financiar për shkak të disponimit të doktoraturave apo specializimit. Pra, brenda të njëjtit sektor/drejtori në strukturë parashikohet punësimi i specialistëve me të njëjtin titull në pozicionin e emëruar (pra specialist apo përgjegjës sektori) por për disa pozicione është parashikuar shtesa për shkak të pajisjes me një specializim/doktoraturë, dhe për disa të tjera jo. Ky përcaktim në strukturën e miratuar **nuk** është shoqëruar me hartimin dhe miratimin e përshkrimit të pozicionit të punës dhe detyrave në mënyrë që të identifikohet edhe se ku do të konsistojë detyra që lidhet me punën kërkimore për të cilën është parashikuar edhe përfitimi financiar. - Nga auditimi konstatohet se për emërimin e nëpunësit zbatues të ISHP nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ñ*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", ku* cilësohet se, ñ*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë.* Më hollësisht, referuar strukturës organike dhe organigramës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me urdhrin nr . 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, nëpunësi zbatues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës) **nuk** është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues (Drejtori i Përgjithshëm i ISHP) pasi në strukturën e miratuar përgjegjësi i sektorit të financës ndodhet nën varësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, i cili nga ana e tij përgjigjet dhe raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm të ISHP. -Në strukturën e miratuar të ISHP evidentohet mungesa e Sektorit të Prokurimeve dhe e pozicionit të juristit, situatë kjo me impakt cënimin e menaxhimit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik dhe zhvillimin, ndjekjen apo zbatimin e kontratave të nënshkruara.

	-Nga auditimi konstatohet se për 3 vitet e fundit ISHP ka patur vakanca në masën **rreth 10% të totalit (20 punonjës).** Këto pozicione përfshijnë si specialistë, ashtu edhe përgjegjës sektori të cilat rezultojnë vakante për periudha relativisht të konsiderueshme kohore, dhe për të cilat ISHP **nuk** ka kryer shpalljen e pozicioneve vakante. Konstatohet se shpalljet janë kryer nga institucioni vetëm për punonjësit për të cilët procedura e rekrutimit ka konkluduar me një emërim, dhe jo për të gjitha vakancat që disponohen në institucion. Për vitin 2020, në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, rezulton se janë emëruar rishtas vetëm 2 punonjës arkivist, 1 punonjës për specialist në sektorin e monitorimit dhe vlerësimit, 1 specialist në Sektorin e DPSHP, 1 shofer dhe vetëm 2 pozicione laborantësh, përkatësisht një specialist laborant dhe një përgjegjës departamenti laboratori.
Kriteri:	- Struktura e miratuar me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò; -Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, -Rregullorja e brendshme e ISHP.
Ndikimi/Efekti:	Mosplotësimi i strukturës;mungesa e juristit; mos shpallja e vakancave nga ISHP për inicimin e procedurve të rekrutimit të stafit.
Shkaku:	Problematikat e konstatuara në plotësimin e strukturës mund të kenë një impakt në zbatimin e objektivave dhe misionit të institucionit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-ISHP të marrë masat për saktësimin dhe evidentimin e detyrave me karakter kërkimor të personelit qe përfiton nga shpërblimi financiar për shkak të specializimeve shtesë, ndryshe nga pjesa tjetër e stafit që nuk përfiton nga ky shpërblim pavarësisht nëse stafi i punësuar i disponon ose jo këto kualifikime, në mënyrë që të diferencohet pozicioni i tyre sipas strukturës së miratuar të institucionit. -ISHP të rishikojë pozicionin e nëpunësit zbatues, në mënyrë që varësia nga nëpunësi autorizues të plotësohet sipas kuadrit ligjor në fuqi. -ISHP të marrë masat për shpalljen e procedurave të rekrutimit për të gjitha pozicionet që ekzistojnë vakante në mënyrë që të bëhet plotësimi i tyre dhe të mos cënohet aktiviteti dhe objektivat e institucionit. -MSHMS të rishikojë strukturën e miratuar të ISHP në mënyrë që të parashikohet pozicioni i një juristi që do të monitorojë kontratat ekzistuese dhe asistojë gjatë procedurave të prokurimit; detyra këto që aktualisht mbulohen nga sektori i financës.

5.Titulli:	**Mangësi në të konstatuara në administrimin e burimeve njerëzore të ISHP**
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në Rregulloren e Brendshme të ISHP nuk janë miratuar përshkrimet e pozicioneve të punës për pozicionet e specialistëve. Në dokumentacionet e përshkrimit të pozicioneve sipas dosjeve rezulton se këto dokumente nuk janë të miratuara nga titullari i institucionit. Përshkrimet e punës së punonjësve janë firmosur në disa raste vetëm nga eprori direkt, dhe në disa të tjera nga vetë punonjësi për të cilën është bërë përshkrimi. Përshkrimi i pozicionit të punës është kryer në varësi të eksperiencës, aftësive dhe shkollimit që punonjësi i punësuar disponon, dhe jo sipas objektivave dhe detyrave të pozicionit në varësi të sektorit/njësisë ku bën pjesë.

	- Administrimi i dosjeve të personelit nuk është bërë plotësisht sipas kuadrit ligjor në fuqi pasi janë konstatuar disa mangësi të dokumentacionit si raportet mjeko ligjore, përshkrimet e pozicioneve të punës apo vlerësimet; dhe dosjet nuk ishin të inventarizuara. Vlerësimet e punonjësve kanë qenë vjetore. - Nga auditimi i elementëve të kontratës së punës, u konstatua se në të nuk është përfshirë data e dhënies së pagës sipas nenit 21 të Kodit të Punës, dhe në kontratat e stafit nuk është si referencë kontrata kolektive në fuqi. -ISHP nuk aplikon Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore për automatizimin dhe konsolidimin e këtij procesi.
Kriteri:	- VKM nr. 117 datë 5.03.2014 ñPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit; - VKM nr. 833, datë 28.10.2020 ñPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò; - Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 21; -Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 21 -Rregullorja e brendshme e ISHP.
Ndikimi/Efekti:	Mos evidentim i saktë i detyrave të personelit sipas pozicionit në mënyrë që të kryhet dhe monitorimi i tyre; mangësitë në dosje nuk japin siguri se punonjësit i zotërojnë kualifikimet dhe përmbushin detyrimet e kërkuara në varësi të pozicionit.
Shkaku:	Mos plotësimi i dosjeve me të gjitha dokumentacionet dhe mos inventarizimi i tyre; mos hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të pozicioneve të punës sipas kuadrit ligjor.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-ISHP të hartojë dhe miratojë përshkrimet e pozicioneve të punës së personelit në përputhje me kriteret ligjore, dhe të inventarizojë dosjet me të gjithë dokumentacionet e nevojshme. **-**ISHP të marrë masat për hedhjen e të dhënave në sistemin HRMIS në bashkëpunim me DAP, si dhe të automatizojë mënyrën e përllogaritjes të pagave, duke përfshirë te gjithë elementët e pagës bazë, me qëllim të lehtësohet procesi i hartimit të pagës, kontrollet e brendshme dhe të jashtme, si dhe të minimizohet risku operacional. Gjithashtu në kontratat e punës të reflektohet data e pagës dhe kontrata kolektive si referencë.

III. 4 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit të sipër cituar:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë nga auditimi është konstatuar sa më poshtë:

Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 375, datë 16.10.2018 është likuiduar fatura e muajit shtator të telefonit fiks ndaj operatorit A. në vlerën 53,766 lekë. Ky shërbim dhe faturim nga operatori A., nuk është i bazuar në një kontratë apo marrëveshje. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me pikën 61 të Udhëzimit nr 30 në të cilën përcaktohet se ó*Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të*

*vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës*ò.

Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 70, datë 28.03.2018, është kryer pagesa ndaj operatorit A.P. shpk për largimin e mbeturinave të muajit shkurt, në vlerën 18,180 lekë. Ky shërbim është kryer në bazë të kontratës nr. 82 datë 18.01.2018, në të cilën përcaktohen ditët e javës së kur duhet të kryhet pastrimi si dhe mënyra se si duhet të kryhet Bashkëngjitur urdhër shpenzimit mungojnë dokumentet e marrjes në dorëzim të shërbimit si procesverbalet ose një dokument ku një komision ose përfaqësues i ISHP të jetë shprehur për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet e kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 35 të Udhëzimit nr. 30 në të cilin përcaktohet se ó*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe ne menyre kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet*, mandat pagesat, proçesverbalet, dhe të tjera akte me natyre verifikues shpenzimiôô.

2. Mbi pagesat për vaksinat anti covid -19

Nga auditimi u konstatua se për periudhën janarï mars 2021, ISHP ka kryer likuidimin e pagesave për vaksina Covid-19 sipas urdhër shpenzimeve si më poshtë:

Vaksina	**Urdhër Shpenzim nr.**	**Vlera në ALL**
A.	56, datë 02.03.2021	54,998,810
P.	6, datë 25.01.2021	303,922,754.97
S.	84, datë 29.03.2021	391,641,000
	84, datë 29.03.2021	324,301,800
TOTALI		**1,074,864,364.97**

- Sa i takon urdhër shpenzimit nr. 6, datë 25.01.2021 në vlerë totale prej 303,922,754.97 lekë konstatohet se me shkresën nr. 461/2, prot., datë 25.01.2021, MSHMS i ka përcjellë ISHP ï së alokimin e fondeve bazuar në Aktin Normativ nr. 1, datë 10.01.2021 ñPër miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin, furnizimin nëpërmjet P. E., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtejes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, audotirimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti-Covid-19 në Republikën e Shqiprisë dhe përdorimin e tyre në popullatèò, Aktin Normativ nr. 3 datë 18.01.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ñPër prodhimin dhe furniziin nëpërmjet P. E. b.v dhe MSHMS, MSHR dhe ISHPò si dhe VKM nr. 32, datë 20.01.2021 ñPër përdorimin e fondit rezervë me qëllim kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marëveshja e nënshkruar për ñPër prodhimin dhe furniziin nëpërmjet P. E. b.v dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP miratuar me ligjin nr. 3, datë 18.01.2021 dhe shkresës së MFE nr. 1443/1, datë 25.01.2021. Në zbatim të VKM nr. 32, datë 20.01.2021 ISHPS i janë alokuar nga fondi rezervë fonde në vlerën **430,000 mijë lekë**. Vlera e likuiduar 303,922,754.97 lekë, është parapagim për sasinë parë të vaksinës P. në zbatim të VKM cituat më sipër.
- Sa i takon urdhër shpenzimit nr. 56, datë 02.03.2021, është kryer transferta me jashtë në vlerën 54,998,000 lekë ñTransfertë për vaksinën Anti-Covid-19ò sipas cost estimate nr 10023924 datë 25.02.2021. Kjo pagesë është bërë në kuadër të Marrëveshjes mes Qeverisë Shqiptare dhe U datë 15.04.2005 dhe shkresës së MSHMS nr. 1898 datë 05.04.2016 ñPër prokurimin e Vaksinave të Programit Kombëtar të Imunizimitò nga U Danimarkë është përcjellë pranë ISHP një cost estimate nr. 10023921, datë 25.02.2021 për vaksinën Covid -19 C. nga A./S. nëpërmjet C. F.në shumën 531.900 USD.

Në vijim të saj, me shkresën nr. 1150 datë 01.03.2021, MSHMS i ka përcjellë pranë ISHP dhe U autorizimin për të përdorur Marrëveshjen mes MSHMS dhe U për prokurimin e vaksinave

nëpërmjet programit kombëtar të imunizimit. Në këtë kontekst ISHP është autorizuar të kryej parapagesën e vaksinës së COVID-19.

- Sa i takon urdhër shpenzimit nr. 84, datë 29.03.2021, është kryer transferta me jashtë (parapagim) në vlerën **715,942,000 lekë** ñTransfertë për vaksinën Anti-Covid-19ò sipas commercial invoice nr. 2021000000166, datë 25.03.2021. Me Aktin Normativ nr. 9 datë 22.03.2021 ñPër miratimin e tekstit të marrëveshjes të nënshkruar mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK.I.S.T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. S. Co LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinësò dhe Aktit Normativ nr. 10, datë 24.03.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes të nënshkruar mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK.I.S.T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. Science Co LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinësò në zbtim të VKM nr. 174, datë 24.03.2021 ñPër kryejsn e pagesës së dozave të vaksinave që rrjedh nga marëveshja mes MSHMS, MSH, ISHP dhe distributorit të autorizuar ñK.I.S.T.ò A.S për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (vero cell). C., të krijuar nga S.L. Science Co LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, dhe shkresës së MSHMS për akordim akordim të fondeve nr, 1590, datë 26.03.2021, me shkresën nr. 5667/1, prot., datë 26.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE në zbatim të VKM nr. 174, datë 24.03.2021 është miratuar transferimi i fondeve në vlerë 1,046,000 mijë lekë nga fondi rezervë në projektin 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò.

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit për të audituar ligjshmërinë e kryerjes së likuidimeve të mësipërme sipas marrëveshjeve përkatëse të nënshkruara nga MSHMS, Ministri i Shtetit të Rindërtimit dhe Instituti i Shëndetit Publik i ka kërkuar institucionit me emailin e datës 15.06.2021 vendosjen në dispozicion të dokumentacionit si më poshtë:

I. Për vaksinën A.: plan dorëzimi/grafik lëvrimi; plan shpëmdarje; amendim marrëveshje U;

2. Për vaksinat e dhuruara: vaksinat e dhuruara/marrëveshjet përkatëse dhe/ose mënyrën se si është bërë dhurimi i tyre; marrjen në dorëzim nga ISHP; planin e shpërndarjes;

3. Për vaksinën P.: plan dorëzimi/grafik lëvrimi; plan shpërndarje; marrëveshjen.

4. Për vaksinën S.: plan dorëzimi/grafik lëvrimi; plan shpërndarje*;* marrëveshjen; të gjitha urdhër shpenzimet e likuiduara për sasitë e marra në dorëzim deri tani (të parapaguara dhe jo të parapaguara).

Pas kësaj kërkese të grupit të KLSH - së (kërkesë kjo e protokolluar në ISHP me nr. 581/17, prot., datë 17.06.2021) nga ISHP është vendosur në dispozicion sa më poshtë:

- shkresa nr. 581/20, datë 18.06.2021, e drejtorit të ISHP-së, drejtuar znj. A.N. në MSHMS "Kërkesë për mendim";
- përgjigja me email e znj. N., ndaj shkresës zyrtare të ISHP, datë 18.06.2021, ora 10:59 (për dijeni cc: zj. G.P. dhe zj. E.H.);
- emaili i datës 21.06.2021 ku ftohemi të shkojmë në zyrën e znj. F., Drejtore e ISHP, për të parë dokumentacionin e përgatitur nga ISHP lidhur me këtë çështje.

Bazuar në sugjerimet e MSHMS, grupit të KLSH iu garantua një akses i kufizuar në dokumentacionin e përgatitur nga subjekti sikundër citohet edhe në emailin nga MSHMS si më poshtë: *"KLSH ti krijohet mundësia të lexojë kontratën në prezencën e një përfaqësuesi të ISHP, pa smartfone dhe pa laptop, pa shënime dhe pa mundësi fotokopjimi, pra vetëm të njihen me kontratën."* Pra KLSH i është garantuar akses i kufizuar në dokumentacion, duke e bërë të pa auditueshme këtë problematikë.

Pretendimi kryesor i subjektit, i cili ka çuar edhe në garantimin e një aksesi të kufizuar në dokumentet zyrtare të kërkuara nga grupi i auditimit, ka të bëjë me faktin se marrëveshjet e nënshkruara për furnizimin me vaksina anti covid, sikundër citohet në emailin e MSHMS (që i referohet vetëm marrëveshjes me P. E. BV) <u>për shkak të sekretit tregtar dhe konfidencialitetit</u> nuk lejohet të publikohen në asnjë website apo në Fletoren Zyrtare.

Megjithatë, nga auditimi konstatohet se informacioni i kërkuar nga grupi i auditimit nuk rezulton

të jetë informacion i klasifikuar në kuptimin e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër informacionin e klasifikuar "sekret shtetërorò, i ndryshuar, në nenin 3 të të cilit parashikohen 4 nivele klasifikimi: ñTepër sekretò, ñSekretò, ñKonfidencialò, dhe ñI kufizuarò. Edhe në prezencë të një klasifikimi të tillë, bazuar në nenin 26 të ligjit nr. ligjit nr. 154/2014 ""Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KLSH ka të drejtë të ketë akses në të gjitha dokumentet zyrtare shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave etj edhe kur këto dokumente përbëjnë sekret shtetëror apo konfidencial. Në këtë rast subjekti nuk duhet të kishte krijuar pengesa në dorëzimin e dokumentacionit pa kufizime me qëllim lejimin e zhvillimit normal të procesit të auditimit nga grupi. Për më tepër kur, pretendimet për sekretin tregtar dhe konfidencialitetin nga ana e subjektit, kanë të bëjnë me mos publikimin e marrëveshjeve të nënshkruara nga shteti Shqiptar në fletoren zyrtare apo në asnjë website. Grupi i auditimit thekson gjithashtu se institucioni në asnjë rast nuk ka dhënë argumenta ligjore për të mbështetur mos vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Po kështu, në përgjigjet zyrtare të dhëna nuk është shprehur që informacioni i kërkuar të jetë informacion i klasifikuar sipas specifikimeve të nenit 3, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër informacionin e klasifikuar "sekret shtetërorò, i ndryshuar, gjë kjo e cila gjithsesi nuk do të përbënte pengesë për auditimit e dokumentacionit të kërkuar për aq kohë sa ligji nr. 154/2014 ""Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" i garanton KLSH ï së akses të pakufizuar në informacion.

Për sa më sipër, grupi i auditimit mbajti Aktkonstatimin nr. 1, datë 29.06.2021.

Në vijim të këtij aktkonstatimi subjekti paraqiti observacionet e dërguara me shkresën nr. 581/35, datë 07.07.2021, në të cilat institucioni sqaron se: *"nuk ka qenë palë negociatore dhe hartuese e marrëveshjeve të nënshkruara nga MSHMS, Ministri i Shtetit të Rindërtimit dhe vet ISHP. Institucioni është përfshirë si nënshkrues i këtyre marrëveshjeve në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe jo infektive në vendin tonë me qëllim zbatimin e marrëveshjeve, nisur edhe nga fakti se ISHP është institucioni përgjegjës për vaksinimin në vendin tonë në përgjithësi dhe jo vetë atë covid. Lidhur me pretendimin e grupit për garantimin e një aksesi të kufizuar në dokumentacion, institucioni shprehet se në bazën ligjore të KLSH në asnjë vend nuk flitet për akses të pakufizuar. Megjithatë grupit të auditimit bashkëlidhur observacionit subjekti ka bashkëlidhur shkresat nr. 581/31, datë 01.07.2021 dhe 581/32, datë 01.07.2021 me të cilat është përcjellë Aktkonstatimi nr. 1 i KLSH në MSHMS dhe tek Ministri i Shtetit për Rindërtimin. Nga ana e MSHMS, në cilësinë e institucionit epror (palë në marrëveshje), deri në momentin e mbajtjes së këtij aktkonstatimi nuk ka pasur asnjë përgjigje zyrtare mbi këtë çështje pavarësisht faktit se aktkonstatimi nr. 1, datë 29.06.2021 i është përcjellë zyrtarisht nga ISHP me shkresën nr. 581/31, datë 01.07.2021. Gjithashtu janë vendosur në dispozicion edhe Dokumenti i Planit kombëtar i vaksinimit ndaj Covid 19 (i cili është i aksesueshëm on line). Është bashkëlidhur shpërndarja e vaksinave të ardhura në ISHP (me pagesë dhe ato të dhuruara) deri më 31 mars 2021 si më poshtë:*

- P. – B.

NJVKSH	Sasi doza/flakon
Stadiumi A Albania	329
Tiranë	2095
Vlorë	1117
Shkodër	1083
Korçë	477
Elbasan	412
Fier	342
Berat	305

Durrës	204
Kukës	171
Gjirokastër	146
Lezhë	101
TOTAL	**6782**

- A.

Nr.	**NJVKSH**	**Flakon**
1	Berat	120
2	Bulqizë	45
3	Delvinë	10
4	Devoll	45
5	Dibër	100
6	Durrës	120
7	Elbasan	350
8	Fier	200
9	Gjirokastër	50
10	Gramsh	50
11	Has	35
12	Kavajë	90
13	Kolonjë	40
14	Korçë	250
15	Krujë	100
16	Kuçovë	40
17	Kukës	100
18	Kurbin	30
19	Lezhë	50
20	Librazhd	50
21	Lushnje	135
22	Malësi e Madhe	350
23	Mallakastër	30
24	Mat	60
25	Mirëditë	30
26	Peqin	50
27	Përmet	25
28	Pogradec	120
29	Pukë	35
30	Sarandë	40
31	Shkodër	100
32	Skrapar	40
33	Tepelenë	25
34	Tiranë	1050
35	Tropojë	40
36	Vlorë	150
	TOTAL	**3840**

- C.

NVKSH	Sasi doza/flakon
Berat	5100
Kuçovë	1570
Skrapar	800

Elbasan	8000
Gramsh	1430
Peqin	1550
Librazhd	3379
Korçë	3600
Devoll	1610
Kolonjë	520
Pogradec	3800
Kukës	2800
Has	940
Tropojë	1160
Lezhë	2600
Kurbin	2820
Mirditë	1000
Shkodër	6000
Malësi e Madhe	1700
Pukë	800
Fier	10450
Lushnjë	8460
Mallakastër	2150
Gjirokastër	3811
Përmet	1410
Tepelenë	1580
Vlorë	9800
Sarandë	3560
Delvinë	470
Dibër	3480
Bulqizë	1730
Mat	2480
Durrës	15380
Krujë	3000
Tiranë	50000
Kavajë	4180
Total	173,120

- Vaksina e dhuruar **G. C. Vaccine (S.):** janë shpërndarë 72 doza/flakon në Tiranë.

Observacionit i është bashkëlidhur urdhri nr. 9, datë 11.01.2021 ñPër ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim për vaksinën Covid dhe materiale ndihmëseò, i përbërë nga E.N., I.P., G.R., E.M., dhe X.M., por subjekti nuk ka bashkëlidhur procesverbalet përkatëse të marrjes në dorëzim të sasive të furnizuara e për rrjedhojë grupi i auditimit nuk ka mundur të auditojë ligjshmërinë dhe rregullaritetin e kryerjes së marrjes në dorëzim të tyre.

Është dorëzuar raporti i detajuar i verifikimit fizik të vaksinës covid 19 dhe materialet ndihmëse i datës 11.01.2021 mbajtur për ISHP nga E.N., E.M.dhe G.R., dhe për AKBPM (Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore) nga B.X., A.N.dhe A.L., konfirmuar nga S.B.(përgjegjëse e DEKSI ï ISHP) dhe A.A.(Nën drejtore ekonomike në ISHP), miratuar për ISHP nga A.F. dhe për AKBPM nga J.B.. Raporti i detajuar i referohet vaksinës P. B. si më poshtë:

Nr.	Produkti	Njësia	Seria	Dt.prodhimi	Dt. Skade.	Sasia	Prodhuesi

1	P. ï B. Covid 19 vaccine	Kuti x 195 vials	EL1484	-	04/2021	Kuti x 195 vials x 5 doze	X
2	Sodio Cloruro Galenica Senese 0.9% Solvente per uso parenterale	Kuti x (10 fiale	20A23	-	01/2021	80 kuti	X
3	Sodio CLoruro 0.9% Fresensius Kabi Solvente per uso parentenale	Kuti x (20 fiale x 10 ml)	20PHH007	-	07/2021	10 kuti	X
4	Age 21G x 11/2ò (0.9 x 40 mm) 11/2ò (0.9 x 40 mm)	Kuti x (100 cope)	20170725	-	07/2022	20 kuti	X
5	Age 20G x 11/2ò (0.8 x 38 mm)	Kuti x (100 cope)	20190320	-	03/2023	3 kuti	X
6	Age 25G x 5/8ò (0.5 x 16 mm) (luer lock)	Kuti x (100 cope)	180826	08/2018	07/2023	60 kuti	X
7	Shiringa 1 ml me Age (27G x ½ò)	Kuti x (100 cope)	19L031	08/2018	07/2024	70 kuti	X

Në raport citohet se bashkëlidhur janë fotot për çdo artikull, fletë përdorimin dhe fletëudhëzuesin. Këto dokumentacione nuk i janë bashkëlidhur këtij raporti për tëu dorëzuar grupit të auditimit.
Gjithashtu janë bashkëlidhur edhe kopje të urdhër shpenzimeve (vetëm formatin e urdhër shpenzimit që dorëzohet në thesar me firmat e NA, NZ dhe nëpunësit të thesarit) bashkëlidhur me urdhrin për kryerjen e parapagimit të vaksinave, Aktet normative dhe VKM përkatëse (cituar më sipër) që autorizojnë këtë veprim; kërkesat për transferim fondesh, alokimin e fondeve etj.

Lidhur me sa më sipër subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 26, të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku parashikohet se:
1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, ***që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore;*** *dhe se*
2. Të gjithë subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjëse strukturat drejtuese përkatëse, përgjegjëse për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi saktësinë dhe rregullaritetin e veprimeve të kryera në magazinë është konstatuar sa më poshtë:
Grupi i auditimit përzgjodhi për të audituar në mënyrë rastësore dokumentacionin e magazinave të ISHP sipas muajve si më poshtë:

Nr.	Viti	Muaji
1	2018	Prill, Tetor

2	2019	Korrik, Nëntor
3	2021	Shtator
4	2021	Mars

Nga auditimi i fletë hyrjeve në magazinë është konstatuar se subjekti harton fletë hyrjet e magazinës pa bashkëlidhur kopje të dokumentacioneve shoqëruesi të cilat të përshkruajnë saktësisht arsyen e hyrjes së aktivit në magazinë sikundër kërkohet edhe nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 37 e cila parashikon se: *"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)."* Në të gjitha rastet fletë hyrja nuk është e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE dhe me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit.

Nga auditimi është konstatuar se subjekti ka një kuptim të gabuar të mënyrës se si duhen hartuar dokumentacionet shoqëruese dhe vërtetuese të lëvizjeve të magazinës. Për këtë arsye konstatohet se në të gjitha fletë daljet e audituara për periudhën objekt auditimi dalja e aktivit nga magazina shoqërohet me një format urdhër dorëzimi në të cilin lëshuesi i urdhrit të dorëzimit është shefi i departamentit ose laboratorit, ndërkohë që ky duhet të nënshkruhet nga nëpunësi i cili autorizon magazinën për të bërë daljen e aktivit. Shefi i departamentit dhe/ose laboratorit duhet të jetë personi i cili bën kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar e jo ai që nënshkruan urdhrin e dorëzimit. Asnjë nga fletë daljet nga magazina nuk është e shoqëruar me kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar. Në shumë raste është konstatuar gjithashtu se personi i autorizuar për të tërhequr aktivin nga magazina nuk është i njëjtë me atë që ka tërhequr në fakt aktivin.

Konstatohet se nëpërmjet kësaj praktike të krijuar në institucion, janë ndërthurur në një dokument (pra në urdhër dorëzimin cituar më sipër) edhe vendimmarrja për dorëzimin e aktivit edhe kërkesa duke krijuar konfuzion dhe duke mos lënë gjurmë të qarta auditimi mbi arsyet dhe mënyrën e lëvizjes së aktiveve nga magazina. Lidhur me sa më sipër udhëzimi 30, në pikën 38 kërkon sa më poshtë: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve."* Pra fletë dalja duhet të shoqërohet gjithmonë me urdhër dorëzim nënshkruar nga punonjësi i institucionit i cili autorizon magazinën për nxjerrjen e aktivit, nga fletëkërkesa për furnizimin me atë aktiv, si edhe me planin e shpërndarjes në raste kur ka një të tillë. Në asnjë rast fletë daljet nga magazina shoqërohen me kërkesën përkatëse.

Për vitin 2018, nga auditimi i fletë daljeve të karburantit dhe dokumentacionit shoqërues nga magazina për muajt prill, shtator dhe tetor është konstatuar se përgjegjësi i sektorit të financës nuk ka nënshkruar urdhër dorëzimet përkatëse. Për muajt e audituar është konstatuar se praktika e daljes nga magazina të karburantit nuk shoqërohet nga kërkesa apo autorizimi për kryerjen e shërbimit. Këto dokumente menaxhohen në një set tjetër dokumentacioni i cili përpilohet nga secili shofer për makinën që ka në përdorim. Pavarësisht kësaj, ky dokumentacion ka mangësi pasi, shumica e kopjeve të autorizimeve për kryerjen e shërbimit janë pa numër protokolli, një pjesë e tyre janë edhe pa datë. Gjithashtu në rastin e automjetit me targë TR 7460A fleta përmbledhëse e e konsumit të karburantit për muajin prill 2018 është mbajtur me korrigjime të shumta, disa rreshta janë fshirë me korrektor, gjë kjo e cila le shkas për gabime në raportimin e lëvizjeve të automjetit. Veprimet e mësipërme bien ndesh me udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pikat 36 dhe 38 të cilat parashikojnë përkatësisht se: *"36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*[12]*. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eleminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve. 38. Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe*

dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve." Fletë daljet pa nënshkrimin e sektorit të financës të evidentuara me këtë problematikë janë **146 në numër** për një total prej **5483 litrash në vlerën 922,443 lekë e cila përbën menaxhim jo efektiv për buxhetin e shtetit,** si më poshtë:

Nr.	Nr. Fletë dalje/Datë	Sasia Naftë në Litra	Çmimi/Litër	Vlera	Nr.	Nr. Fletë dalje/Datë	Sasia Naftë në Litra	Çmimi/Litër	Vlera
1	273, datë 03.04.2018	16	157.89	2,526.24	**74**	959, datë 16.10.2018	15	176.72	2,650.80
2	274, datë 03.04.2018	20	157.89	3,157.80	**75**	960, datë 17.10.2018	55	176.72	9,719.60
3	277, datë 03.04.2018	42	157.89	6,631.38	**76**	961, datë 17.10.2018	38	176.72	6,715.36
4	279, datë 03.04.2018	72	157.89	11,368.08	**77**	963, datë 17.10.2018	10	176.72	1,767.20
5	280, datë 03.04.2018	50	157.89	7,894.50	**78**	971, datë 19.10.2018	20	176.72	3,534.40
6	282, datë 03.04.2018	45	157.89	7,105.05	**79**	972, datë 22.10.2018	83	176.72	14,667.76
7	283, datë 04.03.2018	54	157.89	8,526.06	**80**	973, datë 22.10.2018	20	176.72	3,534.40
8	284, datë 04.04.2018	65	157.89	10,262.85	**81**	976, datë 22.10.2018	44	176.72	7,775.68
9	291, datë 05.04.2018	37	157.89	5,841.93	**82**	977, datë 22.10.2018	12	176.72	2,120.64
10	292, datë 05.04.2018	80	157.89	12,631.20	**83**	978, datë 23.10.2018	85	176.72	15,021.20
11	298, datë 10.04.2018	50	157.89	7,894.50	**84**	983, datë 23.10.2018	10	176.72	1,767.20
12	299, datë 10.04.2018	40	157.89	6,315.60	**85**	985, datë 23.10.2018	20	176.72	3,534.40
13	302, datë 10.04.2018	20	157.89	3,157.80	**86**	988, datë 25.10.2018	61	176.72	10,779.92
14	306, datë 11.04.2018	54	157.89	8,526.06	**87**	991, datë 26.10.2018	30	176.72	5,301.60
15	313, datë 12.04.2018	50	157.89	7,894.50	**88**	993, datë 29.10.2018	12	176.72	2,120.64
16	314, datë 12.04.2018	12	157.89	1,894.68	**89**	994, datë 29.10.2018	10	176.72	1,767.20
17	315, datë 13.04.2018	10	157.89	1,578.90	**90**	996, datë 29.10.2018	50	176.72	8,836.00
18	316, datë 13.04.2018	30	157.89	4,736.70	**91**	997, datë 30.10.2018	80	176.72	14,137.60
19	319, datë 16.04.2018	74	157.89	11,683.86	**92**	1000, datë 31.10.2018	35	176.72	6,185.20
20	320, datë 16.04.2018	10	157.89	1,578.90	**93**	1002, datë 31.10.2018	30	176.72	5,301.60
21	323, datë 16.04.2018	50	157.89	7,894.50	**94**	796, date 03.09.2018	48	176.72	8,482.56
22	324, datë 16.04.2018	85	157.89	13,420.65	**95**	797, date 03.09.2018	10	176.72	1,767.20
23	326, datë 17.04.2018	35	157.89	5,526.15	**96**	798, date 03.09.2018	20	176.72	3,534.40
24	327, datë 17.04.2018	65	157.89	10,262.85	**97**	799, date 03.09.2018	20	176.72	3,534.40
25	328, datë 17.04.2018	20	157.89	3,157.80	**98**	809, date 03.09.2018	70	164.11	11,487.70
26	331, datë 18.04.2018	10	157.89	1,578.90	**99**	811, date 04.09.2018	43	164.11	7,056.73
27	332, datë 18.04.2018	70	157.89	11,052.30	**100**	814, date 04.09.2018	50	176.72	8,836.00
28	337, datë 19.04.2018	10	157.89	1,578.90	**101**	820, date 06.09.2018	38	176.72	6,715.36
29	338, datë 20.04.2018	16	157.89	2,526.24	**102**	821, date 06.09.2018	48	164.11	7,877.28
30	340, datë 20.04.2018	15	157.89	2,368.35	**103**	822, date 06.09.2018	61	176.72	10,779.92
31	342, datë 21.04.2018	36	157.89	5,684.04	**104**	823, date 06.09.2018	33	176.72	5,831.76
32	343, datë 21.04.2018	25	157.89	3,947.25	**105**	824, date 06.09.2018	35	176.72	6,185.20
33	344, datë 23.04.2018	55	157.89	8,683.95	**106**	826, date 06.09.2018	50	164.11	8,205.50
34	350, datë 23.04.2018	20	157.89	3,157.80	**107**	830, date 10.09.2018	20	176.72	3,534.40
35	351, datë 23.04.2018	50	157.89	7,894.50	**108**	831, date 10.09.2018	36	176.72	6,361.92
36	355, datë 24.04.2018	40	157.89	6,315.60	**109**	839, date 11.09.2018	58	164.11	9,518.38
37	357, datë 25.04.2018	10	157.89	1,578.90	**110**	840, date 11.09.2018	123	164.11	20,185.53
38	358, datë 25.04.2018	40	157.89	6,315.60	**111**	841, date 11.09.2018	10	176.72	1,767.20
39	359, datë 26.04.2018	55	157.89	8,683.95	**112**	843, date 13.09.2018	36	176.72	6,361.92

40	360, datë 26.04.2018	30	157.89	4,736.70	**113**	844, date 13.09.2018	43	176.72	7,598.96
41	363, datë 26.04.2018	10	157.89	1,578.90	**114**	846, date 14.09.2018	50	176.72	8,836.00
42	364, datë 26.04.2018	70	157.89	11,052.30	**115**	847, date 14.09.2018	20	164.11	3,282.20
43	365, datë 26.04.2018	52	157.89	8,210.28	**116**	848, date 17.09.2018	25	176.72	4,418.00
44	370, datë 26.04.2018	144	164.11	23,631.70	**117**	851, date 17.09.2018	12	176.72	2,120.64
45	371, datë 26.04.2018	22	164.11	3,610.40	**118**	853, date 17.09.2018	34	176.72	6,008.48
46	372, datë 26.04.2018	26	164.11	4,266.83	**119**	854, date 17.09.2018	58	176.72	10,249.76
47	379, datë 30.04.2018	17	176.72	3,004.24	**120**	855, date 18.09.2018	69	164.11	11,323.59
48	902, datë 01.10.2018	5	176.72	883.60	**121**	857, date 18.09.2018	47	164.11	7,713.17
49	903, datë 01.10.2018	11	176.72	1,943.92	**122**	858, date 18.09.2018	25	176.72	4,418.00
50	904, datë 01.10.2018	60	176.72	10,603.20	**123**	860, date 19.09.2018	22	164.11	3,610.42
51	906, datë 01.10.2018	45	176.72	7,952.40	**124**	861, date 19.09.2018	12	176.72	2,120.64
52	907, datë 01.10.2018	29	164.11	4,759.16	**125**	862, date 19.09.2018	30	176.72	5,301.60
53	908, datë 01.10.2018	10	176.72	1,767.20	**126**	864, date 19.09.2018	15	176.72	2,650.80
54	912, datë 01.10.2018	10	176.72	1,767.20	**127**	866, date 20.09.2018	20	176.72	3,534.40
55	913, datë 01.10.2018	50	176.72	8,836.00	**128**	867, date 20.09.2018	30	176.72	5,301.60
56	920, datë 02.10.2018	20	176.72	3,534.40	**129**	867, date 20.09.2018	26	164.11	4,266.86
57	921, datë 03.10.2018	64	176.72	11,310.08	**130**	869, date 20.09.2018	57	164.11	9,354.27
58	925, datë 03.10.2018	20	176.72	3,534.40	**131**	870, date 21.09.2018	15	176.72	2,650.80
59	926, datë 04.10.2018	84	176.72	14,844.48	**132**	872, date 24.09.2018	13	176.72	2,297.36
60	927, datë 04.10.2018	60	176.72	10,603.20	**133**	873, date 24.09.2018	42	176.72	7,422.24
61	930, datë 04.10.2018	10	176.72	1,767.20	**134**	874, date 24.09.2018	26	164.11	4,266.86
62	931, datë 05.10.2018	10	176.72	1,767.20	**135**	875, date 25.09.2018	10	176.72	1,767.20
63	934, datë 05.10.2018	60	176.72	10,603.20	**136**	876, date 25.09.2018	122	164.11	20,021.42
64	940, datë 08.10.2018	38	176.72	6,715.36	**137**	878, date 25.09.2018	20	176.72	3,534.40
65	941, datë 09.10.2018	17	176.72	3,004.24	**138**	880, date 25.09.2018	10	176.72	1,767.20
66	944, datë 09.10.2018	35	176.72	6,185.20	**139**	882, date 26.09.2018	55	164.11	9,026.05
67	947, datë 11.10.2018	20	176.72	3,534.40	**140**	884, date 26.09.2018	49	164.11	8,041.39
68	950, datë 12.10.2018	35	176.72	6,185.20	**141**	885, date 26.09.2018	40	176.72	7,068.80
69	951, datë 12.10.2018	15	176.72	2,650.80	**142**	890, date 27.09.2018	25	176.72	4,418.00
70	953, datë 12.10.2018	30	176.72	5,301.60	**143**	891, date 27.09.2018	58	176.72	10,249.76
71	954, datë 15.10.2018	35	176.72	6,185.20	**144**	894, date 28.09.2018	44	164.11	7,220.84
72	955, datë 15.10.2018	98	176.72	17,318.56	**145**	896, date 28.09.2018	10	176.72	1,767.20
73	956, datë 15.10.2018	20	176.72	3,534.40	**146**	899, date 28.09.2018	20	176.72	3,534.40
TOTAL							**5483**		**922,443**

Nga auditimi është konstatuar gjithashtu se, pa i takon miratimit të normativës së konsumit të karburantit të automjeteve, nga ISHP nuk është kryer rishikim i tyre që prej vitit 2018, kur me urdhrin nr. 155, datë 17.08.2018 është ngritur grupi i punës për miratimin e normativave të karburantit të automjeteve dhe gjeneratorëve. Normativat e konsumit të karburantit të automjeteve aktualisht në fuqi janë ato të vitit 2018 si më poshtë, të cilat nuk mund të përfaqësojnë konsumin real të këtyre automjeteve nisur edhe nga fakti se vetëm 3 prej tyre datojnë pas viteve 2000, ndërsa të tjerat i përkasin viteve 90, e janë pjesërisht të amortizuara.

Nr.	Makina	Lloji	Numri i identifikimit	Targa	Viti i Prodhimit	Vlera	Norma Konsumit te karburantit 2018
1	Hyundai	Autoveture	KMHJN81VP9U989059	TR 4113 R	2008	1,897,600	12 litra /100 km

2	Toyota Land Cruiser	Autoveture	JT1VHZJ7509000235	TR7495 A	1994	1,459,000	18 litra /100 km
3	Toyota HILUX PIC UP	ATP	LN850129575	TR 7460 A	1993	2,028,400	12 litra /100 km
4	Toyota Hilux2,4D	ATP	JT133LNA09045398	TR 6987 A	1996	2,054,600	12 litra /100 km
5	Toyota Land Cruiser	ATP	HZJ750036582	TR 6425 A	1996	1,897,600	18 litra /100 km
6	Mercedes Benz	ATP	WDB6013671P304773	TR 7463 A	1993	2,876,280	12 litra /100 km
7	NISSAN	Autoveture	JN1WRGY60Z0254389	TR 9484 D	1997	1,239,347	18 litra /100 km
8	Toyota Hilux	Autoveture	LN1660040410	TR 5589 G	1997	1,897,600	12 litra /100 km
9	Toyota Land Cruiser	Autobus	JT1VHZJ5090000739	TR 2436 B	1997	884,040	18 litra /100 km
10	Mitsubishi	Autoveture	JMBL043WDY411110	TR 7561 A	1983	2,565,570	12 litra /100 km
11	Toyota HILUX PIC UP	ATP	LN850129574	TR 7853 G	1993	2,353,500	12 litra /100 km
12	IVECO FIAT	APV	ZCFC359300D531551	AA 158 KM	2014	7,560,000	15 litra/100 km
13	IVECO FIAT	APV	ZCFC359300D531550	AA 157 KM	2014	7,560,000	15 litra/100 km

Nga auditimi i fletë hyrjes nr. 17, datë 17.12.2020 e cila ka të bëjë me furnizimin me kite reagonte, materiale konsumi për QIA Symphony sipas faturës tatimore nr. 2765, datë 17.12.2020 me nr. serial 84227763 në vlerën 28,499,088 lekë me TVSH të OE B.A. shpk dhe fletë daljes nr. 113, datë 17.12.2020 është konstatuar se ISHP ka bërë dalje për laboratorin e virologjisë të gjithë sasinë e furnizuar si më sipër. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 38. ku citohet se: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve."* Në kushtet kur konsumi i sasisë së furnizuar nuk mund të jetë i menjëhershëm, por i shpërndarë në kohë nuk justifikohet dalja totale e mallrave të furnizuara nga magazina. Për me tepër, nisur edhe nga fakti se në 31.12.2020 subjekti duhet të bëj mbylljen e magazinës dhe inventarizimin e mallrave të konsumit gjendje dhe të pakonsumuara. Dalja në total e sasisë së furnizuar si më sipër shtrembëron pasqyrimin e saktë të gjendjes së magazinës në fund të vitit duke gjeneruar impakt edhe në pasqyrat financiare.
Lidhur me sa më sipër mban përgjegjësi NZ, i institucionit në cilësinë e personit që urdhëron dorëzimin e mallrave të furnizuara.

Nga auditimi i magazinës së dhurimeve për vitin 2020 është konstatuar se përgjatë këtij viti institucionit i janë dhuruar/transferuar/kalimet kapitale etj një sasi e madhe artikujsh që kanë të bëjnë me përballimin e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19 si më poshtë:

Përshkrimi	**Sasi**	**Vlerë**
Gjendje 31.12.2019	**467**	**5,171,146.67**
Durimet Covid 19 viti 2020		
Hyrje në vlerë		416,053,928.84
Hyrje në sasi (numër artikujsh)	863,018	
Dalje në vlerë		401,539,614.00
Dalje në sasi (numër artikujsh)	747,793	
Gjendje në 31.12.2020 në vlerë		**19,685,461.51**
Gjendje në 31.12.2020 në sasi	115,692	

Pra në numër ISHP i janë dhuruar **863,018** artikuj në vlerën **416,053,928.84 lekë**, vlerë kjo e cila është konsumuar përgjatë vitit 2020 në masën 96.51%, ose rreth **747,793** artikuj të ndryshëm. Nga këto janë tamponë sipas çmimeve dhe paketimeve të ndryshme sipas tabelës në vijim:

Data	Nr. FH	Lloji	Sasia	Vlera	Cmimi	Shkresa	Origjina
19.03.2020	6	Tampone Nazofaringal	1,000	198,950	199	nr. 286, prot., 19.03.2020	x
03.04.2020	11	Tampone nazofaringal;19.2 leke	4,000	76,800	19	nr. 1687/1, prot., date 03.04.2020 nga MSHMS	x
22.04.2020	15	Tampon nazofaringal 12x150mm sterile;	3,200	49,920	16	nr. 505, prot., date 22.04.2020	x
23.04.2020	16	Tampona plastik steril	500	19,200	38	nr. 508, prot., date 23.04.2020	x
08.06.2020	36	Tampone nazofaringale	39,000	2,574,000	66	Kontrata nr. 2272/4, date 02.06.2020 midis MSHMS dhe O.D. shpk	x
01.07.2020	47		129,000	8,514,000	66		
16.06.2020	40	Set marrje mostras (tampon N/F dhe O/F + UTM)	3,480	466,768	8,046.72	Invoice PO 202541484, date 09.05.2020	x
15.07.2020	50	Tampone nazofaringale me material sintetik	22,000	2,376,000	108		
26.08.2020	66	Tampon nazofaringal :(qese me 1000 cope)	2,000	343,760	172	FD MSHMS 118, date 26.08.2020	x
25.09.2020	74	Tampon nazofaringal :(kuti me 1000 copeK	6,000	1,032,480	172	FD MSHMS nr. 135, date 25.09.2020	x
25.09.2020		Tampon nazofaringal :(kuti me 1000 copeK	17,000	2,409,070	142		
24.12.2020	104	Tampone	1,000	504,000	504	nr. 924/3, prot., date 23.12.2020	x
		TOTAL	**228,180**	**18,564,948**			

1. *Lidhur me sa më sipër subjekti ka paraqitur observacion me nr. 1026/71, prot., datë 07.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 527/24, datë 11.10.2021*

Pretendimet e Subjektit: ISHP ka bashkëlidhur me shkresën përkatëse Kthim Përgjigje nga MSHMS në të cilën specifikohet se qëndrimi i MSHMS në cilësinë e institucionit epror (Shkresa nr. 3010/2, prot., datë 06.08.2021) është ai i faktit se KLSH nuk i lejohet aksesi në dokumentacionin i cili është "Sekret tregtar" sipas specifikimete të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008. "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 18. Sipas MSHMS, KLSH nuk i mohohet aksesi në dokumentacionin që përbën sekret shtetëror apo janë konfidenciale në kuptimin e ligjit nr. 8457/1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror". Nëse do bëhej fjalë për informacion i cili është sekret shtetëror apo konfidencial sigurisht që informacioni do të ishtë i aksesueshëm sipas legjislacionit për informacionin e klasifikuar. Çdo gjë tjetër që është pjesë e tekstit të marrëveshjes është sekret tregtar e si rrjedhojë i nënshtrohet legjislacionit përkatës dhe nuk është i aksesueshëm nga KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër grupi i auditimit rithekson pozicionin e tij në cilësinë e institucionit më të lartë të kontrollit ekonomiko – financiar në Shqipëri, i cili ka të drejtë të ketë akses të pakufizuar në dokumentacion, si dhe në ato dokumenta të cilat janë të klasifikuar sekret shtetëror apo tregtar. Skenari i shpjeguar nga observacioni dhe interpretimi që jepet është në kundërshtim me nenet 26 dhe 27 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", pasi KLSH ka të drejtën e aksesit në dokumentacion pa kufizime dhe kushtëzime gjithmonë, duke përfshirë dhe rastet kur informacioni klasifikohet sipas legjislacionit përkatës.
Dokumentacioni i cili mbrohet nga sekreti tregtar, cituar në observacion i përket kategorisë së dokumenteve të cilat duhet të jenë të aksesueshme gjithmonë nga KLSH, në cilësinë e institucionit më të lartë shtetëror të auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i pavarur, i cili i ushtron kompetencat e tij duke iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. (Neni 162, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 4, ligji 154/2014). KLSH është e angazhuar në mbrojten e interesave të shtetit shqiptar e jo në mbrojtje të sekretit tregtar të vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme i cili, nëse do tu përhapej personave të pa autorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë. Për këto arsye qëndrimi nuk ndryshon.

***2.** Subjekti ka paraqitur observacionin nr. 1026/51, prot., datë 05.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 527/24, datë 11.10.2021 ku shpjegon se sa i takon daljes së karburantit nga magazina janë hartuar procedurat përkatëse me qëllim dokumentimin e kësaj procedure.*

***3.** Subjekti ka paraqitur observacionin nr. 1026/65, datë 05.10.2021 mbi fletë hyrjet e magazinës dhe mungesës së dokumentacionit bashkëlidhur ku nuk shprehet dakord me gjetjen pasi dokuemtnacionet përkatës gjenden në likuidimet nëpërmjet bankës.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** pretendimi i subjektit nuk pranohet pasi hyrja dhe dalja e aktiveve nga magazina dokumentohet gjithmonë nga njësia shpenzuese sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30 dhe dokumentet e kërkuara nga udhëzimi nuk ishin bashkëlidhur fletë hyrjeve dhe fletë daljeve përkatëse për të lenë gjurmë të veprimeve të kryera në magazinë.*

***4.** Subjekti ka [paraqitur observacionin nr. 1026/67, prot., datë 05.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 527/24, datë 11.10.2021 ku shprehet se kontratat me A.i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit dhe observacioni është marrë parasysh nga ky i fundit e për këtë arsye duhet hequr gjetja dhe rekomandimi përkatës.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** subjekti u vendos në lëvizje për rregullimin e situatës pasi u vendos në dukje nga auditimi kjo parregullsi, për këtë arsye gjetja dhe rekomandimi përkatës qëndrojnë me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.*

***5.** Subjekti ka paraqitur observacionin nr. 1026/52, datë 05.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 527/24, datë 11.10.2021 ku shkrehet se rekomandimi mbi hartimin sipas formatit të përcaktuar të fletëve përmbledhëse të karburantit është marrë parasysh.*

6. Titulli:	**Mangësi në dokumentacion vërtetues dhe verifikues për likuidimin e urdhër shpencimeve**
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se: - Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 375, datë 16.10.2018 është likuiduar fatura e muajit shtator të telefonit fiks ndaj operatorit A. në vlerën 53,766 lekë. Ky shërbim dhe faturim nga operatori A., nuk është i bazuar në një kontratë apo marrëveshje. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me pikën 61 të Udhëzimit nr 30 në të cilën përcaktohet se ó*Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të*

	Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës. - Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 70, datë 28.03.2018, është kryer pagesa ndaj operatorit A.P. shpk për largimin e mbeturinave të muajit shkurt, në vlerën **18,180 lekë**. Ky shërbim është kryer në bazë të kontratës nr. 82 datë 18.01.2018, në të cilën përcaktohen ditët e javës së kur duhet të kryhet pastrimi si dhe mënyra se si duhet të kryhet Bashkëngjitur urdhër shpenzimit mungojnë dokumentet e marrjes në dorëzim të shërbimit si procesverbalet ose një dokument ku një komision ose përfaqësues i ISHP të jetë shprehur për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet e kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 35 të Udhëzimit nr. 30 në të cilin përcaktohet se ó*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe ne menyre kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet*, mandat pagesat, proçesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimiôõ.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumentacionit vërtetues dhe verifikues sjell risk operacion në likuidimin e shpenzimeve të subjektit për aq kohë sa nuk mund të verifikohen kushtet e kontratave, si edhe nuk mund të verifikohet nëse marrja në dorëzim është kryer sipas kushteve të dakordësuara.
Shkaku:	Kontrata të hershme. Neglizhencë nga ana e institucionit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	- ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të shmangen në të ardhmen situata në të cilat subjekti të likuidojë vlera angazhimesh financiare në mungesë të kontratës/ave të nënshkruara për këtë qëllim. - Instituti i Shëndetit Publik të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim evidentimin e arsyeve për të cilat largimi i mbeturinave kryer nga OE A.P. është likuiduar pa verifikuar dhe/ose dokumentuar nëse subjekti ka kryer punën e kërkuar në përputhje me kushtet e dakordësuara.

7. Titulli:	**Mangësi në dokumentacionin hyrës dhe dalës të magazinës**
Situata:	- Nga auditimi i fletë hyrjeve në magazinë është konstatuar se subjekti harton fletë hyrjet e magazinës pa bashkëlidhur kopje të dokumentacioneve shoqëruese të cilat të përshkruajnë saktësisht arsyen e hyrjes së aktivit në magazinë sikundër kërkohet edhe nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 37 e cila parashikon se: *"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)."* Në të gjitha rastet fletë hyrja nuk është e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE dhe me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit. - Nga auditimi është konstatuar se subjekti ka një kuptim të gabuar të mënyrës se si duhen hartuar dokumentacionet shoqëruese dhe vërtetuese të lëvizjeve të

	magazinës. Për këtë arsye konstatohet se në të gjitha fletë daljet e audituara për periudhën objekt auditimi dalja e aktivit nga magazina shoqërohet me një format urdhër dorëzimi në të cilin lëshuesi i urdhrit të dorëzimit është shefi i departamentit ose laboratorit, ndërkohë që ky duhet të nënshkruhet nga nëpunësi i cili autorizon magazinën për të bërë daljen e aktivit. Shefi i departamentit dhe/ose laboratorit duhet të jetë personi i cili bën kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar e jo ai që nënshkruan urdhrin e dorëzimit. Asnjë nga fletë daljet nga magazina nuk është e shoqëruar me kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar. Në shumë raste është konstatuar gjithashtu se personi i autorizuar për të tërhequr aktivin nga magazina nuk është i njëjtë me atë që ka tërhequr në fakt aktivin. Konstatohet se nëpërmjet kësaj praktike të krijuar në institucion, janë ndërthurur në një dokument (pra në urdhër dorëzimin cituar më sipër) edhe vendimmarrja për dorëzimin e aktivit edhe kërkesa duke krijuar konfuzion dhe duke mos lënë gjurmë të qarta auditimi mbi arsyet dhe mënyrën e lëvizjes së aktiveve nga magazina. Lidhur me sa më sipër udhëzimi 30, në pikën 38 kërkon sa më poshtë: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve".* Pra fletë dalja duhet të shoqërohet gjithmonë me urdhër dorëzim nënshkruar nga punonjësi i institucionit i cili autorizon magazinën për nxjerrjen e aktivit, nga fletëkërkesa për furnizimin me atë aktiv, si edhe me planin e shpërndarjes në raste kur ka një të tillë. Në asnjë rast fletë daljet nga magazina shoqërohen me kërkesën përkatëse.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe vërtetues për hyrjen dhe daljen e aktiveve nga magazina sjell risk operacion në menaxhimin e lëvizjeve të aktiveve në institucion duke krijuar mundësi për shpërdorime të aktiveve.
Shkaku:	Procedura dhe kontrolle të brendshme të dobëta dhe jo në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	- ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen hyrja e aktiveve në magazinë të dokumentohet në çdo rast jo vetëm me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, por të jetë edhe e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE, me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit, për të evidentuar saktësisht arsyen e hyrjes së aktiveve në magazinë. - ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen dalja e aktiveve nga magazina të bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe të dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve, ku të jenë lehtësisht të identifikueshëm kërkuesi, miratuesi, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i aktivit për një menaxhim sa më efektiv të këtij procesi.

8. Titulli:	**Mangësi në dokumentacionin dalës të karburanit në magazinën e ISHP**
Situata:	Për vitin 2018, nga auditimi i fletë daljeve të karburantit dhe dokumentacionit shoqërues nga magazina për muajt prill, shtator dhe tetor është konstatuar se: përgjegjësi i sektorit të financës nuk ka nënshkruar urdhër dorëzimet përkatëse; praktika e daljes nga magazina të karburantit nuk shoqërohet nga kërkesa apo autorizimi për kryerjen e shërbimit. Këto dokumente menaxhohen në një set tjetër dokumentacioni i cili përpilohet nga secili shofer për makinën që ka në përdorim. Pavarësisht kësaj, ky

	dokumentacion ka mangësi pasi, shumica e kopjeve të autorizimeve për kryerjen e shërbimit janë pa numër protokolli, një pjesë e tyre janë edhe pa datë. Në rastin e automjetit me targë x fleta përmbledhëse e konsumit të karburantit për muajin prill 2018 është mbajtur me korrigjime të shumta, disa rreshta janë fshirë me korrektor, gjë kjo e cila le shkas për gabime në raportimin e lëvizjeve të automjetit. Fletë daljet pa nënshkrimin e sektorit të financës të evidentuara me këtë problematikë janë **146 në numër** për një total prej **5483 litrash në vlerën 922,443 lekë, e cila përbën menaxhim jo efektiv për buxhetin e shtetit.**
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumentacionit shoqërues për daljen e aktiveve nga magazina sjell risk operacion në menaxhimin e lëvizjeve të aktiveve në institucion duke krijuar mundësi për shpërdorime të aktiveve.
Shkaku:	Procedura dhe kontrolle të brendshme të dobëta dhe jo në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	- ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse dhe arsyeve të cilat kanë cuar në menaxhimin e gabuar të daljes së karburantit nga magazina në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në vitin 2018. - ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që procesi i daljes së karburantit nga magazina të jetë gjithmonë i dokumentuar me autorizimin përkatës, fletë kërkesën, urdhër dorëzimin dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që të justifikojnë këtë veprim. - ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që plotësimi i fletëve përmbledhëse të karburantit nga përgjegjësit për automjetet në ISHP të kryet duke respektuar kushtet minimale të një dokumenti të lexueshëm, të kuptueshëm dhe të auditueshëm, me qëllim promovimin e përgjegjshmërisë institucionale për daljen e aktiveve nga magazina si edhe konsumin e tyre.

Për sa më sipër janë mbajtur aktkonstatimet nr. 1, datë 29.06.2021 dhe nr. 4, datë 30.07.2021.

III. 5 AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT

Auditimi vlerëson se, për periudhën objekt auditimi në përgjithësi veprimet dhe transaksionet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikues që mbështesin regjistrimet kontabël si në mënyrë kronologjike, ashtu dhe sistematike, konform përcaktimeve të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. nr. 8, datë 09.03.2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.
Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe të ardhurave të rakorduara me degën e Thesarit.
PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.
Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.
Për të tre vitet objekt auditimi Pasqyrat Financiare janë hartuar nga Shefja e Financës zj. A.M.dhe janë miratuar nga titullari i institucionit zj. A.F.

Pasqyrat Financiare Viti 2020:

Me shkresën nr. 203/2 datë 30.03.2021 janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2020 pranë Degës së Thesarit Tiranë. Nga drejtoria e ISHP janë dërguar nëntë formatet e pasqyrave financiare referuar udhëzimit të MFE me nr. nr. 8, datë 09.03.2018. Si dhe është përgatitur relacioni sqarues për pasqyrat financiare me nr.203/1, datë 18.03.2021.

Mijë lekë

Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Paraardhes
A	**A K T I V E T**	**600,335**	**655,021**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**272,677**	**345,240**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**683**	**36**
520	Disponibilitete ne Thesar	683	36
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**246,503**	**321,709**
31	Materiale	233,944	305,439
32	Inventar I imët	12,558	16,269
	3.Llogari te Arketushme	**25,490**	**23,494**
411	Kliente e llogari te ngjashme	1,239	0
468	Debitore te ndryshëm	8,862	8,862
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	15,389	14,632
	II.Aktivet Afat gjata	**327,658**	**309,781**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**210**	**336**
202	Studime dhe kërkime	210	336
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**327,448**	**309,445**
212	Ndertesa e Konstruksione	32,823	34,550
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	235,917	216,227
215	Mjete Transporti	9,880	12,350
217	Kafshe pune e prodhimi(kafshe dhe kavje laboratori)	54	54
218	Inventar ekonomik	48,772	46,262
	4.Investime	**0**	**0**
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**25,490**	**23,494**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**25,490**	**23,494**
	1. Llogari te Pagushme	**25,490**	**23,494**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	782	194

42	Detyrime ndaj personelit	10,241	10,067
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	927	926
435	Sigurime Shoqerore	2,057	2,061
436	Sigurime Shendetsore	1,380	1,382
466	Kreditore per mjete ne ruajtje		
467	Kreditore te ndryshëm	1,239	0
4341	Operacione me shtetin(detyrime	8,862	8,862
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**574,845**	**631,527**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**574,845**	**631,527**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	568,701	626,029
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	683	36
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne përdorim	5,460	5,460
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**600,335**	**655,021**

Tabela: Pasqyra e pozicionit Financiar

AKTIVI:

Llogaria 520 "Disponibiliteti në Thesar" është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 679 mijë lekë dhe është shuma e fondeve të ardhura në formën e sponsorizimeve dhe granteve që trashëgohen.

Mijë lekë

Fonde	**Vlera**
CEI GRANT AGREEMENT KEP ITALY3-	3
Projekt i Agjencisë Kombëtare Mjedisi	679
Total	**683**

Tabela: Disponibiliteti në Thesar

Nga auditimi rezultoi se teprica e llogarisë 520 ñDisponibilitete në Thesarò **nuk vërtetohet me aktrakordim me Drejtorinë e Thesarit sic përcaktohet në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, pika 50:**

Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore.

2. Gjendja e Inventarit qarkullues është e paraqitur në pasqyrat financiare për vitin 2020 në vlerën 246,503 mijë lekë, me një diferencë në ulje në vlerën 75,205 mijë lekë diferencë kjo e pasqyruar në *llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjen së inventarit*ò në pasqyrën e performancës me shenjë + (pozitive).

Vlera prej 246,503 mijë lekë e *Gjendja e Inventarit qarkullues* përbëhet nga *llogaria 31 "Materiale"* në vlerën 233,944 mijë lekë dhe *llogaria 32 "Inventar i Imët"* në vlerën 12,558 mijë lekë referuar inventarizimit të iniciuar me urdhrin nr. 238 datë 31.12.2020 nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Mijë lekë

Nr	**Emërtimi**	**Gjendja në fund**
Nr 1	Magazina e Konsumit	23,199
Nr 2	Magazina Kimikate ï qelqurina	14,466
Nr 3	Magazina Vaksina	183,941
Nr 4	Inventar AQT- E.S.	4,349
Nr 5	Inventar AQT G.R.	861
Nr 6	Magazina e dhurimeve	19,685
Total		**246,503**

Tabela: Inventarit qarkullues

Nga auditimi është konstatuar se vlera 4,349 mijë lekë dhe vlera 861 mijë lekë janë aktive të qëndrueshme të trupëzuara të cilat ndodhen në magazinë. Konkretisht vlera 4,349 mijë lekë përfshinë pajisje kompjuterik, tavolina, varëse rrobash, etj ku një pjesë e tyre janë aktive kalim kapitali me urdhër nr.269 datë 19.06.2015 të projektit ñFurnizimi i Përgjigjes Kombëtare të Shqipërisë ndaj HIV/AIDS dhe TBC për grupet e pambrojturaò, dhe një pjesë janë projektor të rikthyer në magazinë me urdhër nr.196 datë 07.11.2018. Gjithashtu vlera 861 mijë lekë përfshinë dy frigorifer të cilët ndodhen në magazinën e vaksinave. Këto pajisje edhe pse janë aktive afatgjata materiale janë klasifikuar si aktive afatshkurtra: Inventari Qarkullues. **Nisur nga kjo referuar udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 këto aktive duhet të ishin klasifikuar në klasën 2 të aktiveve si Aktive Afatgjata të magazinuara dhe jo në klasën 3 siç janë pasqyruar në këto pasqyra.**

Klasa 2 e llogarive të kontabilitetit në sektorin publik përbëhet nga:

- Aktive afatgjata materiale (Aktive të qëndrueshme të trupëzuara);
- Aktive afatgjata jomateriale (Aktive të qëndrushme të patrupëzuara);
- Aktive afatgjata financiare. AAGJ dokumentohen si: 34;
- Aktive të qëndrueshme të trupëzuara ose (AAGJM) ï të cilat njësia publike i përdor për prodhimin e produkteve, kryerjen e shërbimeve, për tô u dhënë me qira palëve të treta si dhe për qëllime administrative (kjo e fundit është veçori kryesisht në sektorin publik).

é Kohëzgjatja e përdorimit parashikohet e llogaritet për më shumë se një vit ushtrimor kontabël.

- Destinacioni është për tô u përdorur në prodhimin, furnizimin e marrjen e sendeve ose shërbimeve, për t'ua dhënë më qira të tretëve dhe për qëllime administrative (zyra, mobilje orendi, mjete kompjuterike, etj).

Klasa 3: Aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor. Këto aktive, për shkak të destinacionit të tyre dhe për shkak të natyrës së tyre, nuk kanë prirjen që të qëndrojnë gjatë në formën që kanë. Ato shpesh kalojnë nga njëra formë e aktiveve qarkulluese në tjetrën.

Sa më sipër është një klasifikim i gabuar dhe nuk ka devijim në vlerë për aq kohë sa nuk llogaritetet amortizim për këto aktive të magazinuara.

Llogaria 468 "Debitor të ndryshëm" është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 8,862,115 lekë. Nga të cilat:

-vlera prej 6,269 mijë lekë janë detyrime të lindura nga auditimi i KLSH në vitin 2014 për paga të përfituara pa të drejtë për punnjësit si më poshtë:

Mijë Lekë

Emër Mbiemër	Totali
FT	556
PK	399
NG	471
GT	425
IP	502
EK	533
IM	436
BG	452
EM	537
QH	173
KP	292
EF	217
GR	241
DG	148
KS	119
AL	177
A.M.	134

XM	135
VU	136
PT	177
TOTAL	**6,269**

Tabela: Debitor ISHP

- Vlera 1,585 mijë lekë janë detyrime të lëna nga KLSH në auditimin e vitit 2014 për personelin mbi karburantin e përfituar padrejtësisht.

Mijë Lekë

Emër Mbiemët	Vlera
ZS	136
BH	205
AG	192
YN	36
AK	72
AK	210
NL	181
IG	55
IK	91
AL	403
TOTALI	**1,585**

Tabela: Debitor ISHP

- Vlera 2 mijë Euro, janë detyrime të konstatuara nga KLSH në auditimin e vitit 2014 për personelin si pasojë e një rimbursim të padrejtë që kanë përfituar nga një projekt.

Nga grupi i auditimit u kërkua nëpërmjet email-it zyrtar informacion lidhur me procesin e ndjekur nga institucioni për arkëtimin e debitorëve por nga ana e institucionit nuk është kthyer asnjë përgjigje zyrtare. Nga sektori i financës nuk janë marr veprimet e nevojshme për ndjekjen e debitorëve si dhe nuk administrohet informacion i plotë (informacion që administrohet është që prej viti 2016) për ecurinë e çështjeve drejtuar gjykatës dhe vendimin për likujdimin e këtyre vlerave. Edhe pse kanë kaluar 7 vjet nga momenti i njohjes së këtyre debitorëve për institucionit ende nuk është marrë asnjë masë duke u pasqyruar cdo vit në pasqyrat financiare. **Sa më sipër në kundërshtim me gërmën g, pika 3, neni 12, ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin":**

é Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçantaé

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin" është paraqitur në vlerën 15,389 mijë lekë në pasqyrën e pozicionit financiar si kundër parti e llogarive 401-408, 42, 431, 435 dhe 436 të pasivit për llogari të shpenzimeve të realizuara në vitin 2020 që do të likujdohen në vitin 2021, sipas tabelës së më poshtme:

Mijë Lekë

llogari 4342		**Vlera**
401-408	Furnitor	782
42	Paga	10,241
431	Det.taksa	927
435	S.Shoq	2,057
436	S.Shend	1,380
Total		**15,389**

Tabela: Operacione me Shtetin

Llogaria 411 "klientë e llogari të ngjashme" është paraqitur në vlerën 1,239 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga klientë të ISHP, për fatura arkëtimi të lëshuara për burime jo jonizuese në fund të

vitit :

Mijë Lekë

llogaria 411	**Vlera**
S.A	2
I F	18
I.H	6
kA.	1,207
QSUT	1
SPITAL "Shefqet Ndroqi"	5
Total	**1,239**

Tabela: Klientët ISHP 2020

Nga auditimi ka rezultuar se si kundërparti e kësaj llogarie në pasiv është paraqitur llogaria 467 ñKreditor të ndryshëmò. **Nëse i referohemi udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2014.**

Llogaria 411 *I referohet* ***debitorëve t institucionit*** *dhe* ***nuk ka kundër parti llogaritë 467 e cila i referohet kreditorëve:***
Llogaria 411: janë llogari të arkëtueshme për të ardhura të gjeneruara nga shitja
Llogaria 467 janë detyrime (llogari të pagueshme) ndaj kreditorëve të realizuara nga një blerje.

Sa më sipër nga hartuesi i pasqyrave financiare është bërë një klasifikim i gabuar në pasiv i debitorëve të llogarisë 411.

Llogaria 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to" paraqiten në shumën 782 mijë lekë të cilat janë detyre që kanë lindur në muajin dhjetor.

Mijë lekë

llogaria 401-408	**Vlera**
SS	686
D shpk	33
K shpk	36
OT shpk	27
Total	**782**

Tabela: Furnitorët viti 2020

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin detyrime" është pasqyruar në shumën 8,862 mijë lekë si kundërparti e *llogarisë 468 "Debitor të ndryshëm".*
Detyrime punonjësish ndaj ISHP sipas rekomandimeve të KLSH të vitit 2014:

Mijë lekë

Detyrime	**Vlera**
detyrim kërkuesi shkencor	6,269
Karburant	1,585
Revista	313
I.	311
Dieta	381
Total	**8,862**

Tabela: Debitorët (klasifikuar sipas llojit të vlerës që kanë për të dëmshpërblyer nga rekomandimet e KLSH)

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore paraqitet në vlerën 683 mijë lekë, sac janë edhe fondet e mbartura në fund të vitit në llogarinë ñDisponibitet në Thesarò referuar udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018: *"Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme,*

llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t'u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës".

Teprica fondi i akumuluar paraqitet në shumën 567,701 mijë lekë, kjo është llogaritur duke zbritur amortizimin , janë zbritur dhe aktivet e blere dhe janë zbritur mjetete në përdorim.

Llogaria 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim" paraqitet në shumën 5,460 mijë lekë.
Këto *"mjete të caktuara në përdorim"* janë paraqitur në vlerë bruto (kosto historike) në pasiv dhe jo në vlerë neto **në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 23.3.2018:**

Llogaria 107 ñPër vlerën e mjeteve të caktuara në përdorimò merr në kredi vlerën neto të aktiveve afatgjata që institucioni merr në përdorim nga të tretët, me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJ. Teprica e saj tregon se këto aktive nuk janë të vetat.

Konkretisht kjo vlerë përbëhet nga:

- Vlera 1,817 mijë lekë e cila është një automjet i dhënë institucionit në përdorim me akt përdorimin nr.169 datë 12.12.2018 nga ñNjësia e menaxhimit të programit të fondit G-PMU. Për këtë vlerë nuk është llogaritur amortizimi për vitin 2019 dhe për vitin 2020 por është pasqyruar në vlerë bruto. Vlera neto për këtë aktiv në pasqyra duhet të ishte 1,163 mijë lekë. **Vlera e devijimit për këtë aktiv si pasojë e mos llogaritjes së amortizimit është 654 mijë lekë.**
- Vlera 187,200 lekë të cilët janë kompjuter të është dhënë institucionit në përdorim me shkresën nr.1671/2 datë 06.02.2018, për të cilët nuk është llogaritur amortizimi për vitin 2019 dhe 2020 por është pasqyruar në vlerë bruto. Vlera neto për këtë aktiv në pasqyra duhet të ishte 105,300 lekë. **Vlera e devijimit për këtë aktiv si pasojë e mos llogaritjes së amortizimit është 82 mijë lekë.**
- Dhe vlera 3,456,000 lekë e dhënë institucionit në përdorim me shkresën nr.298 datë 24.12.2019 për Sistemin e integruar të informacionit për programin e parandalimit të transmetimit të HIV nga nëna te fëmija në kuadër të sistemit të survejencës së HIV/AIDS për të cilin nuk është llogaritur amortizimi për vitin 2020 **në vlerën 864 mijë lekë**.

Aktivet Afatgjata:

Klasa 2 e llogarive të kontabilitetit përbëhet nga:

- Aktive afatgjata materiale (Aktive të qëndrueshme të trupëzuara);
- Aktive afatgjata jomateriale (Aktive të qëndrushme të patrupëzuara);

Konkretisht në PF, pasqyra 7/a ñGjendja e ndryshimit të aktiveve afatgjataò pasqyrohet gjendja e aktiveve AAGJ të ISHP në kosto historike:

Mijë Lekë

20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	7,708
201	Studime dhe kerkime	7,708
21	**II. TAAGJ/ MATERIALE**	732,981
212	Ndertime e Konstruksione	70,703
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	454,486
215	Mjete transporti	43,522
217	Kafshe pune e prodhimi	54
218	Inventar ekonomik	164,214
	T O T A L I (I + II)	740,689

Tabela: AAGJ (Kosto Historike)

Në pasqyrën e pozicionit financiar Llogaria 20 "Aktivet afatgjata jomateriale" është pasqyruar në vlerën neto 210 mijë lekë pasi i është llogaritur amortizimi linear në normën 15% të vlerës

fillestare. Projekti i përfshirë në *llogarinë 201 Studime dhe kërkime* është projekti për procesin ñInventarizimi i pasurisë Plan rilevimi 2016ò.

Llogaria 21 "Aktivet afatgjata materiale" në vlerën 327,448 mijë lekë është e përbërë nga:

1. *Llogaria 212 "Ndërtesat":*

Mijë Lekë

Nr.	EMERTIMI	VLERA
1	Godina Qendrore	35,006
2	Godina e Laboratorit Mikrobik	31,966
3	Qendra e Trajnimeve	347
4	Godina e magazinës	1,204
5	Godina e garazheve	20
6	Godina Klubit	7
7	Godina e vivariumit	725
8	Muri Rrethues	968
9	Projekt preventiv lab kimise analitike	457
	SHUMA	**70,703**

Tabela: Ndërtesat (Kosto Historike)

Për këto ndërtesa ndër vite është llogaritur amortizimi me normën 5% mbi vlerën e mbetur të aktivit. Në pasqyrat financiare të ISHP për vitet 2016 dhe 2017, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre, nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (*janë evidentuar për vleftën zero lekë*). Sipërfaqja totale e tokës që ka ISHP në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.

ISHP i është drejtuar MSHMS me shkresën nr. 906/5, prot., datë 30.09.2019 me një informacion në lidhje me regjistrimin e pasurive dhe vlerat e pasurive të paluajtshme si toka, troje, terrene dhe godina ku ka bashkëlidhur shkresa të mëparshme mbi zbatimin e VKM nr. 500, datë 14.08.2001, ôPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, si edhe të gjithë dokumentacionin mbi pasuritë që ndodhen brenda territorit të institucionit. Me shkresën nr. 906/6, prot., datë 30.09.2019 ISHP i ka dërguar MSHMS ñRikërkesë për regjistrimin e pronave të Institutit të Shëndetit Publikò së bashku me listën përfundimtare sipas formularit të inventarizimit të pronave të paluajtshme, plan vendosjen, planimetritë për çdo kat etj, duke kërkuar regjistrimin e pronës me qëllim kryerjen e rivlerësimit të tyre. Me shkresën nr. 906/7, prot., datë 16.10.2019 ISHP i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me qëllim kryerjen e regjistrimit për të vijuar me rivlerësimin. Në vijim të kësaj shkrese, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka kthyer përgjigje ISHP me shkresën nr. 16154/1, prot., datë 06.11.2019, për dijeni MSHMS, ku shprehet se nga shqyrtimi i praktikës dhe dokumentacionit bashkëlidhur bëjnë me dije institucionin se kërkesa për inventarizimin e pasurive në administrim të pushtetit qendror duhet të iniciohet nga institucioni qendror nga i cili ISHP ka varësinë, pra nga MSHMS.

2. *Llogaria 215 "Mjete transporti"*

Mjetet e transportit janë paraqitur në pasqyrat financiare me vlerën neto. Konkretisht për vitin 2020 llogaria 215 ñMjete Transportiò është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 9,880,211 lekë. Amortizimi i mjeteve të transportit është llogaritur në masën 20% të vlerës së mbetur të këtyre mjeteve.

Makina C. është mjet në përdorim i dhënë ISHP-s me aktpërdorim nr.169 datë 12.12.2018 nga njësia e menaxhimit të programit të fondit g.-pmu e cila ka si kundërparti në pasiv llogarinë 107 ñVlera e mjeteve të caktuara në përdorimò dhe nuk i llogaritet amortizimi.

Llogaria 217 ñkafshë pune dhe prodhimiò është paraqitur në vlerën 55 mijë lekë.

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	vlera
1	Lepuj	Copë	44	554	24
2	Kavie	Copë	30	200	6
3	Minj të bardhë	Copë	40	50	2
4	Desh	Copë	5	4,500	22
Shuma					**54**

Tabela: kafshët laboratorike

Në këtë llogari janë regjistruar kafshët e laboratorit të cilët përdoren për eksperimente laboratorike. Për këto aktive nuk mund të llogaritet amortizim kështu që janë paraqitur me kosto historike.

Llogaria 218 "Inventari ekonomik" është paraqitur në vlerën 48,772 mijë lekë në vlerë neto. Për Inventarin ekonomik është llogaritur amortizimi me normën 20% për Inventarin e pajisjeve e mobiljeve dhe 25% për pajisjet kompjuterike. Vlera e kostos historike (Vlera kontabël) e kësaj llogarie e paraqitur në në pasqyrën 7/a është 164,214 mijë lekë.
Nga auditimi i procesit të inventarizimit është konstatuar se vlera fizike e Inventari Ekonomik ishte në shumën 163,429 mijë lekë **duke rezultuar një diferencë prej 784 mijë lekë më shumë pajisje në Inventarin ekonomik të pasqyrave financiare.** Nga komunikimi me hartuesin e pasqyrave financiare dhe verfikimi i dokumentacionit grupi i auditimit konstatoi se kjo diferencë vjen si pasojë e një gabimi në llogaritje ku: Gjatë llogaritjes së Inventarit Ekonomik nuk janë llogaritur ndryshimet e vitit 2020 shtesat dhe pakësimet, përfshirë këtu dhe rregullimet e llogarive nga viti 2019 të ñInventarit të Imët Ekonomikò por është marrë vlera e ñInventarit të imëtò pasqyruar në PF e vitit 2019. Konkretisht, për llogaritjen e llogarisë 218 ñInventari Ekonomikò hartuesi i pasqyrave financiare ka kryer veprimet si më poshtë:

Inventar i imët në përdorim + kompjuter + mobilje dhe pajisje

Mijë lekë

Emertimi	IE rezultuar nga Inventari	IE në pasqyra	Diferenca
Inventar I Imet	17,838	**18,623**	(784)
komp	87,047	87,047	-
mobilje	58,543	58,543	-
Total	163,429	164,214	(784)

Tabela: Invetari Ekonomik

Nr. llog	Emri I llogarise	vlera e mjeteve ne 2019	sistemime te brendshme	materiale te ardhura ne 2020	transferim kapital	VLERA E MJETEVE 2020	Vlera e mjeteve pa perfshire te ardhurat ne 2020	Vlera Neto
218	Inventar ekonomik	**18,623**				**18,623**[11]	**18,623**	**5,553**

Tabela e përllogaritjes së amortizimit për vitin 2020 bashkëlidhur PF

Vlera 18,623 mijë lekë është Inventari i Imët i rezultuar nga inventarizimi i vitit 2019 ndërkohë që vlera që ka rezultuar nga inventarizimi në vitin 2020 është 17,838 mijë lekë. Ky gabim ka bërë që vlera e aktiveve (vlera historike) të pasqyrohet 784 mijë lekë më shumë në PF.
Llogaria 214 ñMakineri pajisjeò është paraqitur në vlerën 235,917 mijë lekë. Nga inventarizimi kosto historike e këtyre pajisjeve ka rezultuar në vlerën 454,486 mijë lekë mbi të cilat është llogaritur norma e amortizimit 5%.

[11] Duhet të ishte 17,838 mijë lekë

Pasqyra e Performancës

Mijë lekë

Nr. rreshti	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	B	C	1	2
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**726,602**	**496,469**
53	***72***	***V.GRANTE KORENTE***	**651,397**	**692,346**
54	**720**	**1.Grant korent I Brendshem**	**651,393**	**692,309**
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	635,324	677,677
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	15,389	14,632
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme	679	
64	**721**	**2.Grant korent I Huaj**	**3**	36
65		Nga Qeveri te Huaja	3	36
73	***73***	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***	**75,205**	**-195,877**
74	**B**	**SHPENZIMET**	**725,919**	**496,432**
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**174,253**	**152,626**
76	6001	Paga, personel I perhershem	117,585	122,862
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin	56,668	29,763
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**24,564**	25,230
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	24,564	25,230
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**180,700**	**148,699**
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	920	1,224
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	69,197	60,028
87	6022	Sherbime nga te trete	86,556	70,376
88	6023	Shpenzime transporti	5,047	5,000
89	6024	Shpenzime udhëtimi	4,697	4,307
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	11,063	6,862
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	0	353
94	6029	Shpenzime te tjera operative	3,217	545
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**271,195**	**365,753**
107	**605**	**2.Transferime korente me jashtë**	**270,760**	**364,957**
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	270,760	364,957
112	**606**	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**434**	**796**
130	***63***	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**75,205**	**-195,877**
132	***85***	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES *(Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)***	**683**	**36**

Tabela: Pasqyra e Performancës

Për auditimin e pasqyrës së performancës janë audituar rakordimet e shpenzimeve me Degën e thesarit, shpenzimet e vitit 2019 për vitin 2020 dhe shpenzimet e vitit 2020 për vitin 2021. Nga auditimi rezultoi se në pasqyrat financiare këto shpenzime janë llogaritur drejtë nga hartuesi i pasqyrave financiare duke pasqyruar kështu në PF të performancës shpenzimet e periudhës kontabël. Konkretisht për llogaritë 600, 601 dhe 602 është vepruar si më poshtë:

Mijë Lekë

Llog	*Emërtimi*	Shpenz faktike	Detyrimet 2019 Minus	Detyrimet 2020 plus
B	**Shpenzimet**	**649,956**	**14,632**	**15,389**
600	**I.pagat dhe perfitimet e punonjseve**	**174,080**	**12,376**	**12,549**
6001	Paga, personel i perhershem	117,411	10,067	10,241
6009	Shpenzime te tjera per personelin	56,669	2,308	2,307
601	**II.kontribute te sigurimeve**	**24,568**	**2,061**	**2,057**
6010	Kontributi i sigurimeve shoqerore	24,568	2,061	2,057
602	**III.blerje mallra e sherbime**	**180,111**	**194**	**782**
6022	Sherbime nga te trete	85,967	194	782

Tabela: Shpenzimet ISHP

-Për llogarinë 600 dhe 601 janë zbritur detyrimet e likujduara për muajin dhjetor 2019 dhe janë shtuar detyrimet e muajit dhjetor 2020.
-Për llogarinë 602 janë zbritur detyrimet e likujduara në vitin 2020 për vitin 2019 si llogarinë 4342 ñOperacione me shtetinò dhe 401-408 ñFurnitorò të vitit 2019 dhe jaën shtuar detyrimet që do të likujdohen për 2021 të vitit 2020 për llogarinë 4342 ñOperacione me shtetinò dhe 401-408 ñFurnitorò.
Të ardhurat e realizuara për periudhën janar - dhjetor të vitit 2020:

Mijë lekë

llogaria	**Emërtimi**	**fakti progresiv**
7111005	TR nga analizat dhe tarifat	830
7111021	TR nga licensat për shoq.	7,718
7111099	TR nga pagesa shërbimesh	30
7113099	Shitje mallra&shërbime	14
7200105	Granta nga i njëjti niv. qeverisje	2,964
Total		**11,558**

Tabela: Të ardhurat

Nga auditimi rezultoi se këto të ardhurat në vlerën 10,878 mijë lekë nuk janë pasqyruar në pasqyrën e performancës pasi janë derdhur në Buxhetin e Shtetit, por vetëm të ardhurave që trashëgohen për vitin tjetër.

Gjithashtu llogaria 7200 ñGrante të brendshmeò është paraqitur në vlerën 635,324 mië lekë. Nga auditimi ka rezultuar se vlera e paraqitjes së granteve të brendshme është llogaritur: Shpenzime totale të buxhetitm të vitit 2020 minus shpenzimet për llogarinë 231 të vitit 2020 dhe financimin e pritshëm të vitit 2019 (651,367 mijë lekë ï 1,411mijë lekë -14,632 mijë lekë).

Llogaria 7206 ñFinancimi i pritshëm nga buxhetiò paraqitet në vlerën 15,389 mijë lekë si kundërpadi e llogarisë 4342 ñoperacione me shtetinò.

Llogaria 7209 ñTë tjera grante të brendshmeò paraqiten në shumën 679 mijë lekë dhe janë grante nga projekti i Angjencisë Kombëtare të mjedisit për ñMonitorimin mikrobiologjik të ujrave bregdetare të larjes në plazheté ò

Llogaria 73 ñNdryshimi i gjëndjes së inventarit të produkteveò është në shumën 75,205 mijë lekë.

Pasqyra CASH FLOW, pasqyra e investive, pasqyra e fondeve neto, aktiveve dhe pagave janë plotësuar dhe janë dërguar në kohë.

Mijë lekë

PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese

VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	**67,777**	**23,753**
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	706,176	710,709
Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor	**11,558**	**12,001**
Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	8,593	9,930
Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	2,964	2,071
Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	**-649,956**	**-698,958**
Per detryrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-649,956	-698,958
VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	**394**	**4,386**
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	1,806	10,950
Per detryrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-1,411	-6,563
TRANSFERTA E TE TJERA	**-67,526**	**-42,004**
Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-8,593	-9,930
Transferime ne buxhet te Fondevete pa perdorura(-)	-58,932	-19,143
Levizje e brendshme e transferta te tjera(+-)		-12,930
Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	**646**	**-13,864**
Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	**36**	**13,901**
Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor	**683**	**36**

Tabela: Pasqyra CASH FLOW

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente të vitit 2020, shpenzimet e vitit ushtrimor, fondet buxhetore të akorduara për investime dhe shpenzimet e investimeve. Teprica e likujditetit në fund të vitit ushtrimor është sa vlera e të ardhurave të trashëguara.

Investimet, kontratat e lidhur dhe likujdimi i kontratave:

Mijë lekë

Investime	**Debiti**	**Financimi**	**Diferenca**
blerje rotor centrifuge	420	405	14
blerje p. kompjuterike	520	478	41
blerje centrifuge	530	526	3
Total	**1,470**	**1,411**	**58**

Tabela: Investimet

Pasqyrat Financiare Viti 2019:

Me shkresën nr.48/3 datë 31.03.2020 janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2019 pranë degës së Thesarit Tiranë. Nga drejtoria e ISHP janë dërguar nëntë formatet e pasqyrave financiare referuar udhëzimit të MFE me nr. nr. 8, datë 09.03.2018. Si dhe është përgatitur relacioni sqarues për pasqyrat financiare me nr.48/2 datë 31.03.2020.

Mijë lekë

Llog	**E M E R T I M I**	**Ushtrimi I Mbyllur**	**Ushtrimi Paraardhes**
A	**A K T I V E T**	**655,021**	**491,268**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**345,240**	**169,938**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**36**	**13,901**
520	Disponibilitete ne Thesar	36	13,901
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**321,709**	**125,832**
31	Materiale	305,439	115,975
32	Inventar I imët	16,269	9,856
	3.Llogari te Arketushme	**23,494**	**30,205**

411	Kliente e llogari te ngjashme	0	62
468	Debitore te ndryshëm	8,862	8,862
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	14,632	21,281
	II.Aktivet Afat gjata	**309,781**	**321,329**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**336**	**462**
202	Studime dhe kërkime	336	462
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**309,445**	**320,867**
212	Ndertesa e Konstruksione	34,550	36,369
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	216,227	224,022
215	Mjete Transporti	12,350	15,437
217	Kafshe pune e prodhimi(kafshe dhe kavje laboratori)	54	54
218	Inventar ekonomik	46,262	44,983
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**23,494**	**30,205**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**23,494**	**30,205**
	1. Llogari te Pagushme	**23,494**	**30,205**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	194	6,122
42	Detyrime ndaj personelit	10,067	10,619
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	926	955
435	Sigurime Shoqerore	2,061	2,144
436	Sigurime Shendetsore	1,382	1,439
467	Kreditore te ndryshëm		62
4341	Operacione me shtetin(detyrime	8,862	8,862
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**631,527**	**461,062**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**631,527**	**461,062**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	626,029	445,156
12	Rezultatet e mbartura	0	12,930
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	36	970
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	5,460	2,004
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**655,021**	**491,268**

Tabela: Pasqyra e pozicionit financiar

AKTIVI:

Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" paraqitet me vlerën 36 mijë lekë.

Kjo është shumë e fondeve të ardhura në formën e sponsorizimeve dhe granteve të të njëjtit nivel qeverisje që trashëgohen nga Institucioni në periudhat pasardhëse .

Mijë lekë

Emërtimi	**Vlera**
Instituti Superior Sanitar	3
Projekt i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	33
Total	**36**

Tabela: Disponibiliteti në Thesar

Shuma 3 mijë lekë janë fonde të ardhura nga Instituti Superior Sanitar ñC.ò dhe shuma 33 mijë lekë janë Grante nga i Njëjti nivel Qeverisje, Projekt i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për ñMonitorimin mikrobiologjik të ujrave bregdetarë të larjes në plazhet Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit.Gjiri i Lalëzit, Kavajës, Divjakës, Semanit, Vlorës, Palasës, Dhërmiut, Himarës , Jalës, Borshit, Qeparoit, Lukovë, Ksamilit, Sarandës, Pogradecit Linit për vitin 2019ò.

Nga auditimi rezultoi se teprica e llogarisë 520 ñDisponibilitete në Thesarò **nuk vërtetohet me aktrakordim me Drejtorinë e Thesarit sic përcaktohet në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018,**

pika 50.

"Gjendje Inventari qarkullues" paraqitet me vleren 321,709 mijë lekë . Paraqet shumën e aktiveve qe ndodhen në magazinat si më poshtë:

Mijë Lekë

Nr	Emërtimi	Gjendja në fund
Nr 1	Magazina e Konsumit	29,396
Nr 2	Magazina Kimikate ï qelqurina	42,531
Nr 3	Magazina Vaksina	233,501
Nr 4	Inventar AQT- ES	4,295
Nr 5	Inventar AQT G.R.	6,813
Nr 6	Magazina e dhurimeve	5,171
Total		**321,709**

Tabela: Inventari Qarkullues

Nga auditimi është konstatuar se vlera 4,295 mijë lekë dhe vlera 6,813 mijë lekë janë aktive të qëndrueshme të trupëzuara të cilat ndodhen në magazinë. Këto pajisje edhe pse janë aktive afatgjata materiale janë klasifikuar si aktive afatshkurtra: Inventari Qarkullues. **Nisur nga kjo referuar udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 këto aktive duhet të ishin klasifikuar në klasën 2 të aktiveve si Aktive Afatgjata të magazinuara dhe jo në klasën 3 siç janë pasqyruar në këto pasqyra.** Sa më sipër është një klasifikim i gabuar dhe nuk ka devijim në vlerë për aq kohë sa nuk llogaritetet amortizim për këto aktive të magazinuara.

Llogaria 468 " Debitore të ndryshëm" paraqitet me vleren 8 862 mijë lekë. Në këtë llogari janë regjistruar detyrimet që kanë punonjësit e ISHP-së ndaj shtetit detyrime keto të krijuara në vitin 2014 nga raporti përfundimtar i auditimit të KLSH-së, si në vitin 2020.

Llogaria 4342 (Operacione me shtetin (Të drejta) paraqitet ne vleren 14,632 mijë lekë detyrime që ka shteti ndaj ISHP ï së për pagesën e furnitorëve,pagve te punonjësve,sigurimeshoqerore dhe shendetësore dhe tatimin mbi të ardhurat, detyrime te muajit Dhjetor 2018 dhe qe likujdohen në muajin Janar të vitit pasardhës e ndarë si më poshtë:

Mijë Lekë

Emërtimi	Vlera
Llogaria 401- 408 në shumën	194
Llogaria 42 (421 ñ Paga personeliò)	10,060
427 ñ Ndalesë urdhër mjekuò	7
Llogaria 431 ñDetyrime ndaj shtetit per tatim taksaò	926
Llogaria 435 ñSigurime shoqëroreò	2,061
Llogaria 436 ñSigurime shendetsoreò	1,382
TOTALI	**14,632**

Tabela: Llogaria 4342

Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" paraqitet me vlerën 336 mijë lekë. Llogaritja e amortizimit është bazuar ne metoden lineare, dhe keto aktive paraqiten me vleren neto (kosto historike ï amortizim te akumuluar) e shperhur ne vlerë 336 mijë lekë (7,708 mijë lekë ï 7,372 mijë lekë).
Llogaria 212 "Ndertime e Konstruksione" paraqitet me vlere neto 34,550 mijë lekë mbi të cilën është llogaritur amortizimi me normën 5% mbi vlerën e mbetur në vlerën 36,152 mijë lekë.
Llogaria 215 "Mjete transporti" paraqitet me vlerën neto 12,350 mijë lekë mbi të cilën është llogaritur amortizimi me normën 20% mbi vlerën e mbetur 31,172 mijë lekë.
Llogaria 217 "Kafshë pune prodhimi" paraqitet me shumen 54 mijë lekë.
Llogaria 214 "Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune" paraqitet me vleren neto 216,227 mijë lekë (424,075 mijë lekë ï 207,847 mijë lekë) .
Llogaria.218 "Inventar ekonomik" paraqitet me vleren neto 46,262 mijë lekë
Paisje kompjuterike në fund te vitit paraqitet me shumën 16,744 mijë lekë

Mobilje Zyre në fund të vitit paraqitet në shumen 23,147 mijë lekë
Inventar i imet paraqitet me shumen 6,370 mijë lekë
Nga auditimi i procesit të inventarizimit kanë rezultuar diferenca midis vlerës fizike dhe kontabël të llogarisë 214 dhe llogarisë 218.

Mijë Lekë

Emertimi	Inv Kontab	Inv fizik	Diferenca
Makineri	424,075	423,521	553
IE	151,507	150,884	623

Tabela: Inventari Ekonomik

Këto diferenca kanë rezultuar për shkakë të klasifikimeve të gabuara të llogarive të cilat janë korrigjuar në vitin 2020. Konkretisht:

- Në vlerën 423,521 mijë lekë të rezultuar nga inventari fizik nuk janë përfshirë disa pajisje pjesë përbërëse të makinerive në vlerën 80 mijë lekë si dhe janë përfshirë pajisje si perde dhe mobilje të cilat janë pjesë e inventarit ekonomik në vlerën 633 mijë lekë. Duke bërë që këto aktive të paraqiten me diference 553 mijë lekë (në vlerë bruto) më shumë në pasqyrat financiare.
- Lidhur me diferencën 623 mijë lekë nga hartuesi i pasqyrave financiare janë bërë korrigjimet përkatëse në vitin 2020 pasi disa nga pajisjet kompjuterike ñPower suppliersò kanë qënë të regjistruara dy herë në kontabilitet.

Llogaria 401–408 "Furnitore dhe llogari të lidhura me to" është paraqitur në shumën 194 mijë lekë. Faturat e furnitorëve të mëposhtëm i përkasin përiudhës së muajit Dhjetor të vitit 2019, të cilat paguhen në vitin pasardhës.

Mijë Lekë

Operatori ekonomik	Vlera e detyrimit
B. E.	187
ñL.Aò shpk	6
Total	**194**

Tabela: Furnitor

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" ne shumen 8,862 mijë leke si kundërpadi e *llogarisë 468 "Debitor të ndryshëm".*

Llogaria 101 Teprica "Fondi Akumuluar" është në shumen 626,029 mijë leke. Kjo llogari është pakësuar dhe për vlerën e Amortizimit të vitit 2019 në shumën 25,607 mijë lekë si dhe janë hequr dhe aktivet që janë marrë në përdorim në shumën 3,456 mijë lekë nga ñSistem i Integruar i Informacionit për Programin e Parandalimit të Transmetimit të HIVò. Gjithashtu kjo llogari është shtuar dhe nga ndryshimi i gjëndjes së materialeve në shumën 183,853 mijë lekë (195,877 mijë lekë ï 5,460 mijë lekë aktive ne perdorim -6,563 mijë lekë aktive me pagese).

Llogaria 85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore" paraqitet me vlerë 37 mijë lekë të cilat janë fonde te mbetura pa perdorur në fund të vitit llogaria 520.

Pasqyra e performancës:

Mijë lekë

Nr.		VITI	VITI
Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	USHTRIMOR	I MEPARSHEM
A	**TE ARDHURAT**	**496,469**	**722,693**
72	***V.GRANTE KORENTE***	**692,346**	**592,643**
720	**1.Grant korent I Brendshem**	**692,309**	**591,672**
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	677,677	570,391

7206	Financim I pritshe nga buxheti	14,632	21,281
721	**2.Grant korent I Huaj**	**36**	**970**
	Nga Qeveri te Huaja	36	970
73	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***	**-195,877**	**130,050**
B	**SHPENZIMET**	**496,432**	**721,723**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**152,626**	**157,726**
6001	Paga, personel I perhershem	122,862	127,673
6003	Shperblime	0	231
6009	Shpenzime te tjera per personelin	29,763	29,821
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**25,230**	**25,992**
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	25,230	25,992
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**148,699**	**104,950**
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,224	1,613
6021	Materiale dhe sherbime speciale	60,028	48,330
6022	Sherbime nga te trete	70,376	25,692
6023	Shpenzime transporti	5,000	5,258
6024	Shpenzime udhëtimi	4,307	6,884
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	6,862	13,252
6026	Shpenzime per qeramarrje	353	299
6029	Shpenzime te tjera operative	545	3,618
	V.TRANSFERIME KORENTE	**365,753**	**303,002**
605	**2.Transferime korente me jashtë**	**364,957**	**302,741**
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	364,957	302,741
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**796**	**261**
63	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**-195,877**	**130,050**
	IX.SHPENZIME TE TJERA		
85	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**		
	(Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	**36**	**970**

Llogaria 720 "Grant Korrent i Brendshëm" paraqitet me vlerën 692,309 mijë lekë.
Kjo llogari paraqitet si shume e llogarise 7200 Grand korrent i brendëshme dhe llogarise 7206 Financim i pritshem nga Buxheti.
Llogaria 7200 " Nga Buxheti për NJQP" paraqitet me vlerën 677,677 mijë lekë ku fondeve buxhetore të shpenzuara faktike i janë zbritur Financimi i pritshem nga buxheti detyrim i viti 2018 si dhe duke zbritur shpenzimet e investimeve te vitit 2019.

Llogaria 7206 " Financimi pritshëm nga buxheti" paraqitet me shumën 14,632 mijë lekë për vlerën totale të llogarisë 4342 ñOperacione me Shtetinò.
Në llogarinë 721 "Grante të huaja nga Organizata Ndërkombëtare" paraqitet në total në shumën 36 mijë lekë të cilat janë të ardhura që janë trashëguar në vitin 2020. Pjesa tjetër e të ardhurave janë paraqitur me vlerën 0 lekë në pasqyrën e performancës pasi janë derdhur në buxhetin e shtetit gjatë vitit 2019.

Llogaria 73 "Ndryshimi i gjëndjes së inventarit të produkteve" është në shumën 195,877 mijë lekë sa është diferenca e Inventarit qarkullues midis vitit 2018 dhe 2019.

Llogaria 600,601,602,605,606 "Shpenzimet" janë paraqitur si diferencë midis shpenzimeve faktike, duke i zbritur detyrimet e viti 2018 dhe duke shtuar detyrimet në fund të periudhës ushtrimore.

Mijë lekë

73	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***	**Shpenz faktike**	**Detyrimet 2018 Minus**	**Detyrimet 2019 plus**
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	153,263	13,013	12,376
6001	Paga, personel I perhershem	123,326	10,531	10,067
6009	Shpenzime te tjera per personelin	29,936	2,481	2,308
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	25,313	2,144	2,061
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	25,313	2,144	2,061
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	154,627	6,122	194
6022	Sherbime nga te trete	76,304	6,122	194

Tabela: Shpenzimet

Pasqyrat financiare viti 2018:

Me shkresën nr. 380 datë 28.03.2019 ISHP ka dërguar pasqyrat financiare për vitin 2018 pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga drejtoria e ISHP janë dërguar nëntë formatet e pasqyrave financiare referuar udhëzimit të MFE me nr. nr. 8, datë 09.03.2018. Si dhe është përgatitur relacioni sqarues për pasqyrat financiare me datë 28.03.2020.

Mijë lekë

Referenca e Logarive	**E M E R T I M I**	**Ushtrimi I Mbyllur**	**Ushtrimi Paraardhes**
A	**A K T I V E T**	**491,268**	**648,965**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**169,938**	**293,388**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**13,901**	**12,930**
520	Disponibilitete ne Thesar	13,901	12,930
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**125,832**	**255,882**
31	Materiale	115,975	251,911
32	Inventar I imët	9,856	3,971
	3.Llogari te Arketushme	**30,205**	**24,574**
411	Kliente e llogari te ngjashme	62	
468	Debitore te ndryshëm	8,862	8,862
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	21,281	15,712
	II.Aktivet Afat gjata	**321,329**	**355,577**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**462**	**6,778**
202	Studime dhe kërkime	462	6,778
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**320,867**	**348,798**
212	Ndertesa e Konstruksione	36,369	37,801
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	224,022	234,630
215	Mjete Transporti	15,437	17,025
217	Kafshe pune e prodhimi (kafshe dhe kavje laboratori)	54	54
218	Inventar ekonomik	44,983	59,286
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**30,205**	**24,574**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**30,205**	**24,574**
	1. Llogari te Pagushme	**30,205**	**24,574**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	6,122	40
42	Detyrime ndaj personelit	10,619	10,956
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	955	993
435	Sigurime Shoqerore	2,144	2,226

436	Sigurime Shendetsore	1,439	1,494
467	Kreditore te ndryshëm	62	
4341	Operacione me shtetin(detyrime	8,862	8,862
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**461,062**	**624,391**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**461,062**	**624,391**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	445,156	611,460
12	Rezultatet e mbartura	12,930	9,870
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	970	3,060
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne përdorim	2,004	
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**491,268**	**648,965**

Tabela: Pasqyra e pozicionit financiar

Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" paraqitet me vlerën 13,901mijë lekë të cilat janë fonde të ardhura nga donatorë të huaj në formën e sponsorizimeve në kuadër të projekteve te ndryshme te ardhura ne ISHP të pa përfunduara. Për vitin 2018 këto fonde janë shtuar me 1,148 mijë lekë nga të cilat 182 mijë lekë janë fonde te ardhura nga Instituti Superior Sanitar ñCò dhe 966 mijë lekë janë fonde te ardhura nga E për projektin e ESPAD-it.

Gjendja e inventarit qarkullues është paraqitur në vlerën 125,832 mijë lekë. Vlera kontabël përputhet me vlerën e inventarit fizik të rezultuar nga procesi i inventarizimit si dhe është shumë e magazinave të më poshtme.

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
konsumi			29,078
dhurime			6,033
Kim-qelq			23,120
vaksina	48,354	14,509	62,863
AQT			3,950
AQT			785
Total			**125,832**

Tabela: Inventarit qarkullues

Llogaria 411 "Kliente dhe llogari të ngjashme" paraqet shumën 62 mijë lekë dhe janë detyrime që kanë klientet ndaj ISHP për shërbime të kryera:

Mijë Lekë

Emërtimi	Vlera
Subjekti ñR Hò Tiranë	5
Subjekti ñMshpkò Vlorë	10
Bashkia Pukë ï Gjegjan	31
Instituti i Fizikes Bërthamore të Zbatuar Tiranë	10
I H	4
Qëndra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò	2
TOTALI	**62**

Tabela: Klientët

Nga auditimi ka rezultuar se si kundërparti e kësaj llogarie në pasiv është paraqitur llogaria 467 ñKreditor të ndryshëmò. **Nëse i referohemi udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2014.**

Llogaria 411** I referohet **debitorëve t institucionit** dhe **nuk ka kundër parti llogaritë 467 e cila i referohet kreditorëve:
Llogaria 411: janë llogari të arkëtueshme për të ardhura të gjeneruara nga shitja
Llogaria 467 janë detyrime (llogari të pagueshme) ndaj kreditorëve të realizuara nga një blerje.

Sa më sipër nga hartuesi i pasqyrave financiare është bërë një klasifikim i gabuar në pasiv i debitorëve të llogarisë 411.

Llogaria 468 " Debitore të ndryshëm" paraqitet me vleren 8,862 mijë lekë si në vitin 2020 dhe 2019 të cilat janë detyrime që kanë punonjësit e ISHP-së ndaj shtetit që prej vitit 2014 nga raporti i auditimit të KLSH-së.

Llogaria 4342 (Operacione me shtetin (Të drejta) paraqitet ne vleren 21,281 mijë lekë detyrime që ka shteti ndaj ISHP ï së për pagesën e furnitorëve,pagve te punonjësve,sigurimeshoqerore dhe shendetësore dhe tatimin mbi të ardhurat, detyrime te muajit Dhjetor 2018 dhe qe likujdohen në muajin Janar të vitit pasardhës e ndarë si më poshtë:

Mijë lekë

Emërtimi	**Vlera**
Llogaria 401	6,122
Llogaria 42 (421 ñ Paga personeliò)	10,531
427 ñ Ndalesë urdhër mjekuò	87
Llogaria 431 ñDetyrime ndaj shtetit per tatim taksaò	955
Llogaria 435 ñSigurime shoqëroreò	2,144
Llogaria 436 ñSigurime shendetsoreò	1,439
TOTALI	**21,281**

Tabela: llogaria 4342

Aktivet Afat gjata

Llogaria 202 "Studime dhe kerkime" paraqitet me vlerën 442 mijë lekë.

Llogaria 212 "Ndertime e Konstruksione" paraqitet me vlere neto e shperhur ne vlere 36,369 mijë lekë (70,703 mijë lekë -34,333 mijë lekë). Kjo llogari eshte shtuar me 457 mijë lekë vlerë e ñProjekt ide dhe projekt zbatim per rikonstruksionin e laboratorit te kimise analitike viti 2011ò.

Llogaria 214 "Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune" paraqitet me vleren neto 224,022,564 lekë.

Llogaria 215 "Mjete transporti" paraqitet me vlerën neto 15,437 mijë lekë. Kjo llogari eshte shtuar me nje mjet te ri me vlerën 1,817 mijë lekë , mjet i dhënë në përdorim me Akt Përdorimi Nr.169 prot. datë 12.12.2018 nga njësia e menaxhimit të Programit të Fondit G.-P . Për këtë mjet nuk eshte llogaritur amortizim pasi është marrë nga ISHP në datën 14.12.2018.

Llogaria 217 "Kafshë pune prodhimi" paraqitet me shumen 54 mijë lekë. Për këtë llogari është kryer sistemimi i shumës 35 mijë lekë si amortizim i akumuluar në vite në zbatim urdhrit 147 date 17.08.2018.

Llogaria 218 "Inventar ekonomik" paraqitet me vleren neto 140,854 mijë lekë

Paisje kompjuterike në fund te vitit paraqitet me shumën	62,887 mijë lekë
Mobilje Zyre në fund të vitit paraqitet në shumen	57,467 mijë lekë
Inventar i imet paraqitet me shumen	20,499 mijë lekë

Llogaria 401 – 408 "Furnitore dhe llogari të lidhura me to" paraqitet në shumën 6,122 mijë lekë. Këto janë detyrime të Institucionit për tu paguar në fillim të vitit 2019. Më poshtë pasqyra e detyrimeve për fatura dhe shërbimë të pa paguara në fund të vitit 2018:

Mijë lekë

Nr	**llogaria 401 -408**	**Vlera**
1	C shpk	633
2	K. shpk	516
3	BE	914
4	K. shpk	544
5	K. shpk	28
6	B.A.	1,812
7	F	779
8	A MS	798

9	K	30
10	TI	29
11	A.P.	18
12	T I	17
	Total	**6,122**

Tabela: Furnitor

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" ne shumen 8,862 mijë leke është kundërpadi e llogarisë 468 ñDebitor të ndryshëmò.
Llogaria 101 Teprica "Fondi Akumuluar" paraqitet në shumen 445,137 mijë leke.
Kjo llogari është pakësuar dhe për vlerën e Amortizimit të vitit 2018 në shumën 28,671 mijë lekë, aktivet që janë marrë në përdorim në shumën 2,004 mijë lekë dhe nga ndryshimi i gjëndjes së materialeve në shumën 130,050 mijë lekë.

Në kredi, për vitin 2018, *llogaria 12 "rezultatet e mbartura"* është paraqitur në vlerën 12,930 mijë lekë si fonde të mbetura papërdorur. Komisoni i caktuar sipas urdhërit nr. 149 datë 17/08/2018 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, përgatiti shkresën nr. 581/33, datë 30.04.2019 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për rikonsiderimin e fondeve të mbetura nga grante dhe subvencionet. Bazuar në Shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Nr. 9759/1 prot., datë 30.05.2019 si dhe në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr.2988/1 prot., datë 05.07.2019 në lidhje me ñRikonsiderimin e fondeve të mbetura nga Grantet dhe Subvencionetò, Instituti i Shëndetit Publik shumën 12,930 mijë lekë të mbetur nga grantet dhe subvencionet në kapitullin 6 e kaloi në buxhet në fund të periudhës ushtrimore duke mos e pasqyruar më në vitet në vijim në PF.

Llogaria 85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore" paraqitet me vlerë 970 mijë lekë fonde te ardhura nga Instituti Superior Sanitar ñC.ò ne shumen 3 mijë lekë dhe E për projektin e ESPAD-it ne shumen 966 mijë lekë.

Pasqyra e performancës:

Mijë lekë

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
A	**TE ARDHURAT**	**722,693**	**501,504**
72	***V.GRANTE KORENTE***	**592,643**	**518,817**
720	**1.Grant korent I Brendshem**	**591,672**	**518,817**
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	570,391	500,045
7206	Financim I pritshe nga buxheti	21,281	15,712
7209	Te tjera grante korente te brendshme		3,060
721	**2.Grant korent I Huaj**	**970**	**0**
	Nga Organizata Nderkombetare		
73	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***	**130,050**	**-17,313**
B	**SHPENZIMET**	**721,723**	**498,444**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**157,726**	**161,118**
6001	Paga, personel I perhershem	127,673	114,879
6003	Shperblime	231	
6009	Shpenzime te tjera per personelin	29,821	46,238
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**25,992**	**26,505**

6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	25,992	26,505
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**104,950**	**327,687**
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,613	12,691
6021	Materiale dhe sherbime special	48,330	239,211
6022	Sherbime nga te trete	25,692	48,139
6023	Shpenzime transporti	5,258	5,537
6024	Shpenzime udhëtimi	6,884	8,454
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	13,252	2,162
6026	Shpenzime per qeramarrje	299	
6029	Shpenzime te tjera operative	3,618	11,490
	V.TRANSFERIME KORENTE	**303,002**	**446**
605	**2.Transferime korente me jashtë**	**302,741**	**0**
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	302,741	
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**261**	**446**
63	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**130,050**	**-17,313**
85	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** ***(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)***	**970**	**3,060**

Llogaria 720 "Grant Korrent i Brendshëm" paraqitet me vlerën 692,309 mijë lekë.
Kjo llogari paraqitet si shume e llogarise 7200 Grand korrent i brendëshme dhe llogarise 7206 Financim i pritshem nga Buxheti.

Llogaria 7200 " Nga Buxheti për NJQP" paraqitet me vlerën 677,677 mijë lekë**.** Nga fondet buxhetore të shpenzuara faktike janë zbritur ñFinancimin e pritshem nga buxhetiò viti 2018 dhe duke shpenzimet e investimeve te vitit 2019.

Llogaria 7206 " Financimi pritshëm nga buxheti" paraqitet me shumën 14,632 mijë lekë në kredi të llogarisë 4342 si detyrime për furnitorë të pa paguar ne fund të vitit 2019, Pagat,Tatimet dhe Sigurimet shoqerore dhe Shëndetsore të muajit Dhjetor 2019.

Në *llogarinë 721 "Grante të huaja nga Organizata Ndërkombëtare"* paraqitet në total në shumën 36 mijë lekë të cilat janë fondet e mbetura pa perdorur për vitin 2018.

Llogaria 600,601,602,605,606 "Shpenzimet" janë si diferencë midis shpenzimeve faktike, duke i zbritur detyrimet e viti 2018 dhe duke shtuar detyrimet në fund të periudhës ushtrimore.

Mijë lekë

Llog	***Emertimi***	**shpenz faktike**	**Detyrimet 2017 minus**	**Detyrimet 2018 plus**
600	**Pagat dhe perfitimet e punonjseve**	**157,925**	**13,444**	**13,013**
6001	Paga, personel i perhershem	128,098	10,956	10,531
6009	Shpenzime te tjera per personelin	29,827	2,487	2,481
601	**Kontribute te sigurimeve**	**26,074**	**2,226**	**2,144**
6010	Kontributi i sigurimeve shoqerore	26,074	2,226	2,144
602	**Blerje mallra e sherbime**	**85,255**	**17,354**	**6,122**
6021	Materiale dhe sherbime speciale	65,644	17,313	
6022	Sherbime nga te trete	19,611	40	6,122

Tabela: Shpenzime

Procesi i Inventarizimit të aktiveve në ISHP për të tre vitet objekt auditimi.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit në Institutin e Shëndetit Publik, ka rezultuar se inventarizimi i aktiveve është kryer në të treja vitet objekt auditimi, në fund të çdo viti ushtrimor. Nga titullari i institucionit për çdo vit janë ngritur disa komisione për procesin e inventarizimit, kjo pasi institucioni ka kapacitet përvec ambjenteve të administratës dhe 6 magazina.

Për vitin 2020:

Për vitin 2020, janë ngritur 5 komisione inventarizimi me urdhra të ndryshëm.
Nga inventarizimi për vitin 2020 ka rezultuar kjo gjendje inventari:
Aktive afatgjata:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
AAGJ	**538,641**	**79,274**	**600,077**
Inventar i Imet	17,838		17,838
Makineri	411,078	43,407	454,486
Komp	51,518	35,528	87,047
Mobilje	58,205	337	58,543

Tabela: AAGJ

Aktive afatshkurtra:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
AASH	**231,918**	**14,585**	**246,503**
Konsumi	23,199		23,199
Dhurime	19,685		19,685
Kim-qelq	7,947	6,518	14,466
Vaksina	169,356	14,585	183,941
AQT	861		861
AQT	4,349		4,349

Tabela: AASH

Vaksina të skaduara në vlerën 14,509 mijë lekë:

Mijë lekë

Emërtimi	Sasia	Vlera
Vaksine OPV (199,386)	1456	290
Vaksine OPV (257,419)	1145	294
SERUM Antirabik (53009)	14	742
Vaksine T (1408)	1754	2,470
Vaksine T (1614)	6632	10,704
Termometer frigoriferi	3	6
TOTAL		**14,509**

Tabela: Vaksina të skaduara

Këto vaksina janë vaksina të cilat kanë skaduar prej vitit 2013 dhe 2016 ose janë hequr nga qarkullimi si pasojë e vendimeve të marra nga OBSH.
Gjithashtu, në datën 27.01.2020 është mbajtur procesverbali për evidentimin e temperaturave të ulta në frigoriferin nr. 1. Pas kryerjes së testeve ñShake testò për vaksinat e ndodhura në këtë frigorifer në vlerën 8,100 mijë lekë, nga të cilat rezultuan të dëmtuara vetëm 609 vaksina në vlerën 82 mijë lekë. Me shkresën nr.965, datë 25.03.2020 u kërkua nxjerrja jashtë inventarit e vaksinave të dëmtuara si më poshtë:

Njësi

Vaksina DTP HepB-Hib	302
Vaksina DTP HepB-Hib	43
Vaksina Td	264

Tabela: Vaksina të dëmtuara

Procesi i inventarizimit ka qenë i rregullt dhe është ndjekur sipas hapave të mëposhtëm:
Me urdhrin e titullarit nr. 238, datë 31.12.2020 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të magazinave si më poshtë:

1. Për magazinën e konsumit:

BA
BA
AL

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të magazinës së konsumit rezultoi se Komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të konsumit të rezultuara nga inventarizimi është 513 artikuj në vlerën 23,199 mijë lekë dhe janë të gjitha në funksion.Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.
Nga auditimi i procesit të inventarizimit të magazinës nr. 5 ñAQTò rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/5 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të konsumit të rezultuara nga inventarizimi është 49 artikuj në vlerën 4,349 mijë lekë të cilat janë të gjitha në funksion.Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

2. Për magazinën e kimikateve dhe qelqurinave dhe dhurimeve:

PZ
MX
AB

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të magazinës nr. 2 ñKimikatet dbe qelqurinatò rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/4 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e vaksinave të rezultuara nga inventarizimi është 402 artikuj në vlerën 14,466 mijë lekë nga të cilat 7,947 mijë lekë janë në funksion dhe 6,518 mijë lekë janë jashtë funksioni.Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.
Nga auditimi i procesit të inventarizimit të dhurimeve rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/5 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e vaksinave të rezultuara nga inventarizimi është 99 artikuj në vlerën 19,685 mijë lekë të cilat janë të gjitha në funksion. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.
Për magazinën e vaksinave:

I.P.
A.S
F.T

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të magazinës nr. 3 ñVaksinatò rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/3 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e vaksinave të rezultuara nga inventarizimi është 67 artikuj në vlerën 183,941 mijë lekë nga të cilat 169,356 mijë lekë janë në funksion dhe 14,585 mijë lekë janë jashtë funksioni . Gjithashtu në këtë magazinë kanë rezultuar dhe 2 artikuj AQT në vlerën 861 mijë lekë Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.
Me urdhrin nr. 239 datë 31.12.2020 është krijuar komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme (Inventarin Ekonomik) si më poshtë:

A.K.
V. J.
P.D.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve afatshkurtra rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/2 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve afatshkurtra të rezultuara nga inventarizimi është 17,838 mijë lekë dhe është e njëjtë me vlerën kontabël.

Me urdhrin nr. 240 datë 31.12.2020 është krijuar komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme:

X.M.
A.A
E.Q

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 313/6 datë 5.03.2021 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve afatshkurtra të rezultuara nga inventarizimi është e njëjtë me vlerën kontabël.

Për vitin 2019:

Për vitin 2019, janë ngritur 5 komisione inventarizimi me urdhra të ndryshëm.
Nga inventarizimi për vitin 2019 ka rezultuar kjo gjendje inventari:
Aktive afatgjata:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
Inventar i Imet	17,397	1,225	18,623
Makineri	380,113	43,407	423,521
Komp	38,349	35,528	73,877
mobilje	58,044	337	58,382
AAGJ	**493,905**	**80,500**	**574,405**

Tabela: AAGJ

Aktivet afatshkurtra:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
Konsumi	29,396		29,396
Dhurime	5,171		5,171
Kim-qelq	36,012	6,518	42,531
Vaksina	218,999	14,502	233,501
AQT	4,295		4,295
AQT	6,813		6,813
AASH	**300,687**	21,021	**321,709**

Tabela: AAGJ

Vaksina të skaduara në vlerën 14,509 mijë lekë:

Mijë lekë

Emërtimi	Sasia	Vlera
Vaksine OPV (199,386)	1456	290
Vaksine OPV (257,419)	1145	294
SERUM Antirabik (53009)	14	742
Vaksine T.(1408)	1754	2,470
Vaksine T. (1614)	6632	10,704
Termometer frigoriferi	3	6
TOTAL		**14,509**

Tabela: Vaksina të skaduara

Procesi i inventarizimit ka qenë i rregullt dhe është ndjekur sipas hapave të më poshtëm:
Me urdhrin nr.13 datë 27.01.2020 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të magazinës i përbërë nga:

1. Për magazinën e konsumit:

A.L
H.M.
A.B.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se nga komision është mbajtur procesverbali i inventarizimit në datën 20.02.2020, në të cilën specifikohet vlera e inventarit faktik 29,396 mijë lekë. Gjithashtu, komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 145/5 datë 28.02.2020 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 29,396 mijë lekë aktive në funksion. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

2. Për magazinën e kimikateve dhe qelqurinave:

B.A.
A.D.
E.K.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të magazinës nr. 2 ñKimikate - Qelqurinaò rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 145/3 datë 28.02.2020 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 36,012 mijë lekë aktive në funksion dhe 6,518 mijë lekë jashtë funksionit.Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

3. Për magazinën e vaksinave:

I.P.
E.M.
P.D.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 145/4 datë 28.02.2020 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 218,999 mijë lekë aktive në funksion dhe 14,502 mijë lekë jashtë funksionit. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Me urdhrin nr.14 datë 27.01.2020 është krijuar komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme si më poshtë:

X.M.
K.P
Z.S.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme rezultoi se nga komision është mbajtur procesverbali i inventarizimit në datën 28.02.2020, në të cilën specifikohet vlera e inventarit faktik 555,782 mijë lekë. Gjithashtu, komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 145/9 datë 28.02.2020 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 476,507 mijë lekë aktive në funksion dhe 79,274 mijë lekë jashtë funksionit. **Në raportin e inventarizimit grupi është shprehur se vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve. Kur në fakt sic është trajtuar dhe më sipër në pasqyrat financiare këto dy vlera kanë pasur diferenca si pasojë e klasifikimeve dhe regjistrimeve të gabuara.**

Me urdhrin nr.15, datë 27.01.2020 është krijuar komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme si më poshtë:

N.G.
B.D
PD

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 145/8 datë 28.02.2020 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 17,397 mijë lekë aktive në funksion dhe 1,225 mijë lekë jashtë funksionit. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të mobilje dhe pajisjeve.

- **Vlerësimi i aktiveve:**

Me urdhrat nr.412, 413, 414 datë 12.09.2019 janë ngritur komisionet për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Kryetar i këtyre komisioneve është shefja e financës zj. A.M..

Me shkresën nr, 1328/3 datë 18.09.2019, nga ISHP është kërkuar një punonjëse IT e AKSHIT per vlerësimin e pajisjeve kompjuterike, por nga auditimi ka rezultuar se nuk ka pasur kthim përgjigje nga ky institucion. Megjithatë nga ky komision në vijimësi është bërë vetëm vlerësimi i pajisjeve të zyrës (mobilje) të cilat janë vlerësuar si jashtë funksionit. Mbi vlerësimin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve laboratorike është lënë për një kohë të dytë. Lidhur me pajisjet kompjuterike, është argumentuar me shkresën nr. 1328/4 datë 18.09.2019 se procesi i vlerësimit do të kryhet pas përfundimit të kontratës me objekt ñblerje pajisje kompjuterikeò. Gjithashtu, për pajisjet laboratorike në shkresën nr.1328/5 është specifikuar se vlerësimi i pajisjeve do të kryhet pas lirit të zyrave dhe laboratorëve nga AKBPM. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit. Me procesverbalin nr. 1328/8 datë 27.12.2019 është përshkruar procedura e asgjësimit.

- **Nxjerrjen jashtë përdorimit:**

Me urdhrin nr.497 datë 13.12.2019 të titullarit është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme (pajisje mobilimi) në vlerën 1,748 mijë lekë të vlerësuara si aktive jashtë përdorimit.

Për këtë procedurë janë mbajtur procesverbali i nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve të mobilimit nr. 1328/8, datë 27.12.2019 dhe relacioni me nr.1328/9, datë 27.12.2019 në të cilën është përshkruar procesi i asgjësimit të mobiljeve ku janë bashkëlidhur dhe fotografitë e mobiljeve që janë asgjësuar.

Procesi i vlerësimit dhe nxjerrja jashtë përdorimit të kimikateve dhe reagentëve.

- Vlerësimi i aktiveve:

Me urdhrin nr. 100, datë 4.06.2018 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve në magazinën e kimikateve dhe kiteve reagent. Me shkresën nr.762/1, datë 10.09.2018 është hartuar relacioni në lidhje me vlerësimin e aktiveve të kimikateve referuar shkresës nr.2496, datë 25.05.2015 ñMbi asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme në laboratorët e Shëndetit Publikò. Artikujt u vlerësuan duke përdorur si kritere vlerësimin e indikatorëve si: data e skadencës, gjendja fiziko kimike dhe kushtet teknike si dhe qëllimi i përdorimit në bazë të teknologjive të reja të laboratorëve. Nga vlerësimi ka rezultuar se kimikatet e nxjerra jashtë funksionit nga komisioni i inventarizimit, duhet të nxirën jashtë përdorimit dhe të asgjësohet pasi produktet:

1. I përkasin periudhës 1999-2000 dhe janë të skaduara.
2. Produktet kanë humbur standardet dhe kushtet teknike për shkak të kohës së gjatë të qëndrimit të tyre.
3. Janë produkte të cilat nuk përdoren për shkakë të ndryshimit të metodologjisë së përdorur si dhe janë produkte të rrezikshmërisë së lartë.

Po ashtu nga komisioni është bërë klasifikimi i këtyre mbetjeve sipas katalogut shqiptar të mbetjeve ku janë klasifikuar:

1. Kimikate të rrezikshme inorganike
2. Kimikate të rrezikshme organike
3. Kimikate jo të rrezikshme

Me shkresën nr.762/2, datë 13.09.2018 nga drejtoria e ISHP është kërkuar miratimi për nxjerrje jashtë përdorimit dhe asgjësimin e kimikateve nga magazinat e ISHP të rezultuara nga procesi i vlerësimit të këtyre aktiveve ku bashkëlidhur ka nisur relacionin dhe procesverbalin e mbajtur nga grupi i vlerësimit . Nga ana e MSHMS nuk është kthyer ansjë përgjigje dhe për këtë arsye nga ana e ISHP është ridërguar kërkesa për nxjerrjen jashtëpërdorimit me shkresën nr.672/3, datë 29.10.2018 dhe (sërisht) me shkresën nr.870, datë 20.06.2019. MSHM ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3370/1, datë 17.07.2019 për ndjekjen me përpikmëri të procedurës dhe të merret vendimi përfundimtar edhe pse kjo procedurë është dërguar tre herë nga ISHP. Në përgjigje të

kësaj shkrese ISHP nga nisur me shkresën nr.870/2, datë 05.08.2019 kërkesën për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe dokumentacionin e procesverbaleve bashkëlidhur.
Në vijim të procesit me urdhrin nr. 393, datë 14.08.2019 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen jashtë përdorimi të këtyre kimikateve. Për këtë është kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr.311, datë 21.02.2020 për kompanitë e liçensuara mbi trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme kimikate. Në përgjigje të kësaj shkrese Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr.918/1, datë 09.03.2020 ka nisur listën e subjekteve aktive që janë të licensuara për ñGrumbullim, transport, ruajtje, trajtim dhe asgjësim të mbetjeve të rrezikshmeò.
Me shkresën nr. 778, datë 16.06.2021 grupi i ngritur për nxjerrjen jashtë përdorimit i është drejtuar Drejtorit të ISHP me relacionin e nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre kimikateve ku përshkruhet puna e bërë për kodifikimin e këtyre kimikateve për nxjerre jashtë përdorimi.
Në vijimësi nga Drejtoria e ISHP i është drejtuar disa prej subjekteve të dërguara nga lista e AKM për tu informuar në rast se ndonjë nga këto kompani ofron shërbimin e asgjësimit të këtyre kimikateve. Konkretisht:

- Shkresa nr. 778/1, datë 25.06.2021 MT
- Shkresa nr. 778/2, datë 26.06.2021 ER
- Shkresa nr. 778/3, datë 25.06.2021 C
- Shkresa nr. 778/4, datë 26.06.2021 SS
- Shkresa nr. 778/5, datë 25.06.2021 drejtuar E&C

Deri tani ka kthyer përgjigje vetëm subjekti MT me shkresën e protokolluar në ISHP nr.778/6, datë 07.07.2021, ku bënë me dije se kjo kompani nuk e ofron shërbimin e kërkuar.
Nga auditimi rezultoi se procesi i asgjësimit të kimikateve është ende në proces.

Për vitin 2018

Nga procesi i inventarizimit për vitin 2019 ka rezultuar kjo gjendje inventari:
Aktivet Afatgjata Materiale:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
Inventar i Imet			20,499
Makineri	420,669	41,097	461,766
Komp	71,664	5,553	
Mobilje		1,905	79,124
AAGJ	**492,333**	**48,556**	**540,890**

Tabela: AAGJ

Aktivet Afatshkurtra materiale:

Mijë lekë

Emertimi	Funksion	Jashte Funksionit	Total
Konsumi	29,078		29,078
Dhurime	6,033		6,033
Kim-qelq	23,120		23,120
Vaksina	48,354	14,509	62,863
Aqt	3,950		3,950
Aqt	785		785
Aash	**111,322**	**14,509**	**125,832**

Tabela: AASH

Procesi i inventarizimit ka qenë i rregullt dhe është ndjekur sipas hapave të më poshtëm:
Me urdhrin nr.1729/1, datë 31.12.2018 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të magazinave për vitin 2018 si më poshtë:

Për magazinën e konsumit:

1. B.A.
2. L.E.
3. E.K.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra me nr. 1729/3, datë 28.01.2019 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 29,078 mijë lekë aktive në funksion. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Po ky komision, ka hartuar dhe raportin e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të magazinuara me nr. 172/5, datë 28.01.2019. Vlera totale e inventarizimit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Për magazinën e kimikateve dhe qelqurinave:

1. E.Q.
2. L.H.
3. A.B.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të kimikateve dhe qelqurinave me nr. 1729/4, datë 28.01.2019 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 23,120 mijë lekë aktive në magazinën nr.2 ñKimikate dhe Qelqurinaò nga të cilat 6,518 mijë lekë janë aktive jashtë funksionit si dhe 6,033 mijë lekë aktive të dhuruara të magazinuara në magazinën nr. 7. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Për magazinën e vaksinave:

1. E.N.
2. F.T.
3. X.M.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të vaksinave me nr. 1729/6, datë 28.01.2019 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 62,863 mijë lekë për aktivet e magazinuara në magarinën nr.3 të vaksinava nga të cilat 14,509 mijë lekë janë aktive jashtë funksionit si dhe 785 mijë lekë aktive AQT të magazinuara në magazinën nr.6 AQT. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Me urdhrin nr. 1729, datë 31.12.2018 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme (inventari ekonomik) për vitin 2018 si më poshtë:

1. E.R.
2. I.C.
3. P.D.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se komisioni, ka hartuar raportin e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme me nr. 1729/2 datë 25.01.2019 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 20,499 mijë lekë për aktivet e inventarit të imët në përdorim dhe janë aktive të gjitha në funksion. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Me urdhrin nr. 1299, datë 24.09.2018 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme si më poshtë:

1. X.M.
2. A.S,
3. Z.S.
4. P.Z.
5. V.T.
6. D.R.

Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të konsumit rezultoi se komisioni, ka hartuar informacionin të inventarizimit të aktiveve të qendrueshme me nr. 1299/1, datë 26.10.2018 nga ku ka rezultuar se vlera fizike e aktiveve të rezultuara nga inventarizimi është 492,333 mijë lekë aktive në funksion dhe 48,556 mijë lekë aktive jashtë funksionit. Vlera totale e inventarit fizik për këto aktive është e njëjtë me vlerën kontabël të aktiveve.

Gjendja e Kite- Reagentëve në Laboratorin e Virologjisë: Situata Covid-19:
Nga auditimi rezultoi se sasia e ñKiteve dhe reagentëveò të blera në datën 17.12.2020 në vlerën 28,499 mijë lekë janë nxjerr menjëherë nga magazina me fletëdaljen nr. 113, datë 17.12.2020 për në laboratorin e Sektorit të Virologjisë. Këto dalje në sasi kaq të madhe janë justifikuar me kushtet e situatës së paparashikueshme Covid dhe kushtet e këqija të gjendjes së magazinës megjithatë edhe pse këto sasi janë mbajtur në laborator për tu përdorur duke qenë se nuk parashikohet dot emergjenca covid sic është justifikuar nga ana e subjektit nuk është ndërmarrë asnjë veprim për inventarizimin e këtyre sasive kite reagent në datën 31.12.2020. Gjatë auditimit në terren grupi i auditimit kërkoi nga laboratori i Virologisë gjendjen e kiteve dhe reagentëve në laborator në datë 31.12.2020 nga ku rezultuan sasitë si më poshtë:

Mijë lekë

Nr.	Emertimi	Amballazhi/ose Paketimi	Njesia	Gjendja	Cmimi	Vlera
1	Tampona	Cope	Cope	6,000	20.4	122
2	Kit e ARN-se	192 test/ reaksione per kit	teste ose reaksione	32,736	1,002	32,801
3	Tub	2*500 copë/kuti	Kuti	30	32,400	972
4	Kartrixh per pergatitje mostre (sample cartdrige)	336 kartdrixhe/ kuti	Kuti	51	34,800	1,774
5	Kapake mbulues (Road Cover)	144/kuti	Kuti	33	18,000	594
6	Maja me filter 200 ul	(8*128) ose 1024 maja /kuti	Kuti	17	19,200	326
7	Maja me filter 1500ul	(8*128) ose 1024 maja /kuti	Kuti	109	27,000	2,943
8	Mikrotuba (elution tubes)	(24*96)/kuti	Kuti	12	92,000	1,104
9	Kapake per elution	(50*8)/kuti	Kuti	64	1,200	76
10	Tampon per lizen qelizore	4*50 ml/kuti	Kuti	3	26,172	78
Totali						**40,793**

Tabela: Kite dhe reagent në laborator

Një pjesë e këtyre sasive janë nga blejre të mëparshe dhe një pjesë janë nga blerjet e datës 17.12.2020. Këto sasi, janë në vlerën e konsiderueshme 40,793 mijë lekë dhe kanë një peshë jo me pak impakt për pasqyrat financiare. Për sa kohë këto kite reagent në kushte normale do të ishin të magazinuara dhe do të tërhiqeshin nga magazina në sasi sipas kërkesave periodike të laborantëve ndjekja e tyre dhe inventarizimi në fund të vitit është i nevojshëm për pasqyrimin e një informacioni të plotë financiar.

Observacionet për gjetjet nr. 10, 11, 12 shprehen se rekomandimet do të merret në konsideratë nga Instituti i Shëndetit Publik në vijimësi.
Observacioni mbi Gjetjen nr. 13 protokolluar me tuajën nr. 1026/40 prot., datë 09.10.2021, përgatitur nga zj. A.M..

Pretendimi i subjektit: *I qëndron observimit me nr. 1026/23 prot., datë 06.08.2021 në përgjigje të Akt-konstatimit nr. 3 dhe theksojmë:*

a. Daljet nga magazina janë kryer me Fletë-dorëzimi të nënshkruar nga shefi i departamentit/ ose laboratorit (ne ketë raste kane qene të sektorit të virologjisë ku kryheshin analizat covid, e nënshkruar nga personi përgjegjës për daljen që kanë marrë pranë magazinës magazinës (bashkëlidhur).

Theksojmë se kërkesa në formën e Fletë dorëzimit për tërheqjen e mallit ka ekzistuar dhe është përmirësuar pas diskutimeve me KLSH sipas urdhrit nr.164, me shkresë 1048, datë 03.08.2021 dhe në qoftë se do të ketë nevojë përsëri do të azhurnohet në përmirësim të punës, por nënvizojmë se këto fletë dorëzimi nga magazina kanë qene dhe janë aplikuar edhe në auditime të tjera ku asnjë nuk e ka gjetur shkelje.(bashkëlidhur kopje e urdhrit).

b. Institucioni nuk mund të kryejë inventarizimin e produkteve të sasive materiale të konsumit në laborator dhe ti paraqesi në rubrikat financiare sepse ato janë bërë hyrje nga magazina dhe janë mallra konsumi. Pasqyrat financiare pasqyrojnë lëvizjet e magazinës për këta artikuj në llogarinë 63 "ndryshim i gjendjes". Ritheksojmë se ky fenomen ka ndodhur për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

c. Përsëri ju theksojmë siç edhe juve e konstatuat se kjo situatë ka ndodhur për kitet e Covid të cilat janë kite të ndjeshme , kërkojnë kushte laboratorike temperature (-20°C), dhe nuk mund të qëndrojnë në magazinën dhe kushtet ku janë.

d. Materialet gjendje në fund të vitit nuk mund të bëhen hyrje ne magazinë sepse ripërsërisim se nuk ka asnjë kusht teknik laboratorik që këto kite të qëndrojnë në magazinë.

e. Fletë-dorëzimi i kërkesës nga magazina, siç e kemi paraqitur edhe në konstatimet e gjetjeve të mëparshme është përmirësuar bazuar në urdhrin nr. 164, me shkresë 1048, datë 03.08.2021 bashkëlidhur.

f. Në bazë të ligjit të kontabilitetit mallrat konsum nuk mund të inventarizohen në fund të vitit dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare.

g. Data e zbatimit të këtij rekomandimi është vendosur gabim.

Për sa më sipër ky rekomandim nuk gjen zbatim në kushtet në të cilat jemi dhe për magazinimin.

Theksojmë se ka nisur një projekt për rikonstruksionin e ISHP-së, ku do të shikohet me shumë prioritet magazinimi me kushte temperature (duke përfshirë edhe temperatura shumë të ulta).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Pretendimi a: Fletë dorëzimi dhe fletë kërkesa nuk janë e njëjta gjë dhe nuk kryejnë të njëjtin funksion. Nëpërmjet fletë kërkesës, sasitë e tërhequra nga magazina justifikohen për përdorimin e tyre për nevoja laboratorike dhe respektohen gjithmonë metodat FIFO.
2. Pretendimi b: Mallrat e konsumit të magazinuara pasqyrohen në PF në llogarinë nr. 31. Juve keni bërë dalje të gjithë sasinë si mall konsumi dhe me të drejtë thoni se nuk inventarizohet. Por nga ana tjetër ju vetë pretendoni (dhe dokumentet tregojnë) se sasitë nuk janë nxjerr në mënyrë të menjëhershme nga magazina për konsum urgjent por si pasojë e kushteve të magazinës dhe nevojave të paparashikueshme. Në këto kushte ju rekomandojmë që për raste si këto (të cilat duhet të ishin magazinuar) të menaxhohet në mënyrë më efektive nga ana juaj dhe në rast se ka ende teprica të ri magazinohen sipas procedurave të përcaktuara nga titullari.
3. Pretendimi d: Për këtë pjesë prandaj kemi dhënë rekomandim që nëse magazina nuk i plotëson kushtet titullari i institucionit të miratojë procedura te qarta të lëvizjes së tyre, te shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Kemi marr në konsideratë pretendimin tuaj për kushtet e magazinës prandaj dhe kërkojmë nga ana juaj të menaxhohet kjo situatë sipas një procesi të miratuar dhe jo duke i bërë dalje të gjithë mallit në laborator.

Observimi juaj për sa më sipër nuk merren në konsideratë.

4. Pretendimi g: Kjo qëndron, **observimi juaj merret në konsideratë.**

9. Titulli:	**Gabim në Klasifikimin e llogarive të Pasqyrave financiare**

Situata:	- Nga auditimi i *Gjendjes së Inventarit qarkullues* i paraqitur në pasqyrat financiare në vitin 2020 me vlerën 246,503 mijë lekë është konstatuar se aktivet me vlerë 4,349 mijë lekë dhe vlerë 861 mijë lekë janë aktive të qëndrueshme të trupëzuara të cilat ndodhen në magazinë dhe jo aktive qarkulluese. Konkretisht vlera 4,349 mijë lekë përfshinë pajisje kompjuterik, tavolina, varëse rrobash, etj të rikthyera në magazinë kurse vlera 861,409 lekë përfshinë dy frigorifer të magazinuar të cilët ndodhen në magazinën e vaksinave. Këto pajisje edhe pse janë aktive afatgjata materiale janë klasifikuar si aktive afatshkurtra: Inventari Qarkullues. Ky klasifikim i gabuar është bërë në të tre vitet objekt auditimi.Nisur nga kjo referuar udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 këto aktive duhet të ishin klasifikuar në klasën 2 të aktiveve si Aktive Afatgjata të magazinuara dhe jo në klasën 3 siç janë pasqyruar në këto pasqyra. - Nga auditimi i regjistrimeve kontabël për llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria e debitorëve: *411 "klientë e llogari të ngjashme"* në vlerën 1,239 mijë lekë ka si kundërparti të saj në pasiv llogarinë e kreditorëve: *467 "Kreditor të ndryshëm".* Për aq kohë sa një llogari i përket debitorëve dhe tjetra kreditorëve këto regjistrime kontabël nuk qëndrojnë dhe nuk janë paraqitur drejtë në pasqyrat financiare.
Kriteri:	- ***Klasa 2*** *e llogarive të kontabilitetit në sektorin publik përbëhet nga:*
	tive afatgjata materiale (Aktive të qëndrueshme të trupëzuara); *Kohëzgjatja e përdorimit parashikohet e llogaritet për më shumë se një vit ushtrimor kontabël*
	- ***Klasa 3:*** *Aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor.* - ***Llogaria 411:*** *janë llogari të arkëtueshme për të ardhura të gjeneruara nga shitja ndërkohë* ***Llogaria 467*** *janë detyrime (llogari të pagueshme) ndaj kreditorëve të realizuara nga një blerje.*
Ndikimi/Efekti:	Nuk pasqyrojnë drejtë informacionin financiar
Shkaku:	Gabim në klasifikimin e llogarive
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi	**-** Personi përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të merrë masa për riklasifikimin e drejtë të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra duke iu referuar bazave ligjore në fuqi. **-** Personi përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të merrë masa për korrigjimin e kreditimit të llogarisë 411 dhe pasqyrimin e drejtë të kësaj llogarie në pasqyrat financiare të vitit pasardhës.

10. Titulli:	**Dokumentimi i plotë i vërtetësisë së informacionit**
Situata:	ga auditimi i dokumentacionit justifikues për regjistrimet kontabël rezultoi se: *- Llogaria 520 "Disponibiliteti në Thesar"* është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 679 mijë lekë dhe është shuma e fondeve të ardhura në formën e sponsorizimeve dhe granteve që trashëgohen por në të treja vitet objekt auditimi nuk ka pasur shkresë rakordimi me Drejtorinë e Thesarit për këtë vlerë. *- Llogaria 468 "Debitor të ndryshëm"* është paraqitur në vlerën 8,862 mijë lekë. Kjo llogari përbëhet nga ñdetyrime personeliò të konstatuara nga auditimi i KLSH në vitin 2014. Nga sektori i financës nuk janë marr veprimet e nevojshme për ndjekjen e debitorëve si dhe nuk administrohet

	informacion i plotë për ecurinë e çështjeve drejtuar gjykatës dhe vendimin për likujdimin e këtyre vlerave. - Në pasqyrat financiare të ISHP, sipërfaqet e evidentuara të tokave si dhe vlera e tyre, nuk rezultojnë të regjistruara në AQT. Sipërfaqja totale e tokës që ka ISHP në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Gjithashtu dhe ndërtesat e institucionit nuk rezultojnë në pronësinë e ISHP.
Kriteri:	***gërmën g, pika 3, neni 12, ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin":*** *...Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta…* ***në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 23.3.2018:*** - *Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore.*
Ndikimi/Efekti:	Vlerat e pasqyruara në bilancë nuk shoqërohen me dokumentacion të plotë.
Shkaku:	Nuk janë ndjekur të gjitha hapat e duhura nga institucioni
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	**-** Sektori i financës, në fund të çdo viti ushtrimor të bëjë rakordimin e llogarisë 520 ñDisponibiliteti në thesarò me Drejtorinë e Thesarit referuar udhëzimit të MFE. **-** Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa, duke krijuar një grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet, për ndjekjen e procesit të arkëtimit të detyrimeve të këtyre debitorëve ose në rast se ka procedura gjyqësore të fituara nga këta debitor, në favor të tyre, të merren masa për fshirjen e detyrimeve nga kontabiliteti.

11. Titulli:	**Gabim në llogaritjen e Inventarit Ekonomik**
Situata:	Nga auditimi i procesit të inventarizimit në vitin 2020, është konstatuar se vlera fizike e Inventari Ekonomik ishte në shumën 163,429 mijë lekë *ndërkohë që vlera kontabël e pasqyruar në PF* në vlerë bruto është 164,214 mijë lekë duke rezultuar një diferencë prej 784 mijë lekë më shumë në PF. Nga verifikimi i dokumentacionit grupi i auditimit konstatoi se kjo diferencë vjen si pasojë e llogaritjes së gabuar gjatë mbledhjes së Inventarit Ekonomik pasi për ñInventarit të Imët Ekonomikò (një nga tre komponentët e IE) është mbledhur vlera që ka rezultuar në PF e vitit 2019 pa marrë në konsideratë ndryshimet gjatë vitit 2020. Vlera 18,623 mijë lekë është Inventari i Imët i rezultuar nga inventarizimi i vitit 2019 ndërkohë që vlera që ka rezultuar nga inventarizimi në vitin 2020 është 17,838 mijë lekë. Ky gabim ka bërë që vlera e aktiveve (në vlerë historike) të pasqyrohet 784 mijë lekë më shumë në PF.
Kriteri:	***Udhëzimi Nr. 30 Datë 27.12.2011,Kapitulli IV, Pika 73:*** *Inventarizimi i aktiveve eshte nje element i rendesishem kontrolli ne kuadrin e menaxhimit te aktiveve te njesise, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilesine e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe perdorimin ne menyren e duhur dhe me eficience te tyre. Inventarizimi kryhet nën*

	përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me kete udhezim dhe nga titullari i njësisë publike.
Ndikimi/Efekti:	Vlera e aktiveve të pasqyruara në PF nuk është vlera e vërtetë e tyre.
Shkaku:	Gabime gjatë llogaritjes së Inventarit Ekonomik
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	Personi përgjegjës për kontabilitetin dhe hartimin e Pasqyrave financiare të merrë masa duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2021.

12. Titulli:	**Inventarizimi i sasisë së Kite dhe reagent në laborator**
Situata:	Nga auditimi i fletë hyrjes nr. 17, datë 17.12.2020 për furnizimin me kite reagonte, materiale konsumi për QIA Symphony, janë bërë hyrje në magazinë artikujt sipas faturës tatimore nr. 2765, datë 17.12.2020, me nr. serial 84227763 në vlerën 28,499,088 lekë me TVSH, të OE B.. shpk. Po në të njëjtën ditë, me fletë daljen nr. 113, datë 17.12.2020 është konstatuar se ISHP ka bërë dalje të gjithë sasinë e furnizuar, në laboratorin e virologjisë, në mungesë të fletë kërkesës së laboratorit, apo plan shpërndarjes ose kartelës limit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 38, ku citohet se: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve".* Nga ana e institucionit dalja e kësaj sasie në mënyrë të menjëhershme për në laborator është justifikuar me kushtet e situatës së paparashikueshme Covid-19 dhe kushtet e këqija të gjendjes fizike të magazinës, pra nuk janë tërhequr për përdorim laboratorik, por për tu ñmagazinuar përkohësishtò në laborator deri në përdorim. Nisur nga sa më sipër, nga institucioni **nuk** është marrë asnjë masë për inventarizimin e këtyre sasive dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Gjatë auditimit, grupi i auditimit kërkoi në rrugë zyrtare nga laboratori i virologjisë gjendjen e sasisë së kite reagentëve në datën 31.12.2020, nga ku u konstatua se gjendja e kiteve dhe reagenteve ishte në **vlerën e konsiderueshme 40,793 mijë lekë**, pasi në laborator gjendeshin sasi dhe nga blerje të mëparshme. Dalja në mënyrë të menjëhershme, pa kërkesë dhe pa iu nënshtruar procesit të inventarizimit për sasitë e furnizuara si më sipër, shtrembëron pasqyrimin e saktë të gjendjes së magazinës në fund të vitit me impakt në pasqyrat financiare.
Kriteri:	***Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli IV, Pika 73:*** *Inventarizimi i aktiveve eshte nje element i rendesishem kontrolli ne kuadrin e menaxhimit te aktiveve te njesise, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilesine e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe perdorimin ne menyren e duhur dhe me eficience te tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me kete udhezim dhe nga titullari i njësisë publike.* ***Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, Neni 21, Pika 3, Gërma dh,*** *procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave;* **Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011** ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, **pika 38:** *Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e*

	urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave te aktiveve.
Ndikimi/Efekti:	Këto aktive nuk pasqyrohen në Pasqyrat Financiare
Shkaku:	Nuk është bërë inventarizimi i plotë i aktiveve
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	**1.** Titullari i institucionit të marr masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e gjendjes së kiteve dhe reagenteve që ndodhen aktualisht në Laboratorin e Virologjisë, dhe që janë transferuar në këtë laborator nga magazina pa fletë kërkesë, me qëllim rakordimin e vlerës aktuale me sasinë gjendje në fillim të periudhe, sasinë e bërë hyrje, dhe sasinë e përdorur. Pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse, dhe nxjerrja e përgjegjësive dhe marrja e masave për mosrakodrime (nëse do të konstatohen), e gjithë sasia e këtyre artikujve: - ose të ribëhet hyrje në magazinën qendrore, sipas rregullave që parashikon Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. - ose nëse magazina qendrore nuk plotëson kushtet e magazinimit, si dhe për shkak të situatës Covid 19, këto artikuj të bëhen hyrje në Laboratorin e Virologjisë, vetëm pasi Nëpunësi Autorizues i ISHP të miratojë procedura te qarta të lëvizjes së tyre, te shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Në secilin prej rasteve që do të konkludohet, sasitë gjendje në këtë laborator të inventarizohen me qëllim paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Në asnjë rast të mos bëhet më, dalje e menjëhershme e sasive të furnizuara për laboratorët, por dalja nga magazina të jetë gjithmonë e justifikuar nga kërkesat përkatëse, bazuar në konsumin real të kiteve, materialeve dhe reagenteve. **2.** Në kushtet kur magazina nuk plotëson kushtet për magazinimin e artikujve, MSHMS si institucion epror të marr masa për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së ISHP për fonde për investime, për rregullimin e magazinës në mënyrë që të plotësohen kushtet e nevojshme për magazinimin e kiteve dhe reagentëve dhe/ose artikujve të tjerë laboratorik për qëllime të shëndetit publik.

13. Titulli:	**Nuk është paraqiturnë vlerë neto në PF llogaria 107**
Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se *Llogaria 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim"* paraqitet në shumën 5,460 mijë. Për këto aktive nuk është zbritur vlera e amortizimit vjetor për tu paraqitur me vlerën neto në PF referuar udhëzimit nr. 8, datë 23.3.2018, por janë paraqitur me koston historike **(**vlera me të cilën këto aktive janë marrë në përdorim). Konkretisht nëse për këto aktive do ishte llogartitur amortizimi vlera e tyre në PF duhet të ishte: - Automjetet e marra në përdorim me akt përdorimin nr.169, datë 12.12.2018 nga ñNjësia e menaxhimit të programit të fondit G - PMU me vlerë 1,817 mijë lekë duhet të ishte 1,163 mijë lekë. **Vlera e devijimit për këtë aktiv është 654 mijë lekë.** - Kompjuterat e marra në përdorim me shkresën nr.1671/2, datë 06.02.2018 me vlerë 187,200 duhet të ishin paraqitur në vlerën 105,300 lekë. **Vlera e devijimit për këtë aktiv është 82 mijë lekë.**

	- Dhe Sistemin e integruar të informacionit për programin e parandalimit të transmetimit të HIV marrë në përdorim me shkresën nr.298, datë 24.12.2019 me vlerë 3,456,000 lekë duhet të ishte paraqitur në vlerën 2,592,000 lekë. **Vlera e devijimit për këtë aktiv është 864 mijë lekë.**
Kriteri:	***Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018,*** *...Llogaria 107 "Për vlerën e mjeteve të caktuara në përdorim" merr në kredi vlerën neto të aktiveve afatgjata që institucioni merr në përdorim nga të tretët, me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJ. Teprica e saj tregon se këto aktive nuk janë të vetat.*
Ndikimi/Efekti:	Vlera e aktiveve të pasqyruara në PF nuk është vlera e drejtë.
Shkaku:	Gabime gjatë llogaritjes
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Personi përgjegjës për kontabilitetin dhe hartuesi i pasqyrave financiare të merrë masa për llogaritjen e amortizimit të këtyre aktiveve dhe kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2021.

III. 6 PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:

Parashikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2018-30.03.2021), paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në lekë

Viti	Parashikuar		Realizuar		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Përqindje
Viti 2018	56	96,728,592	51	89,970,168	93.01%
Viti 2019	48	352,994,756	36	138,186,296	39.15%
Viti 2020	59	510,555,881	43	477,615,524	93.55%
Viti 2021	14	49,684,689	4	1,022,667	2.06%
SHUMA	**177**	**1,009,963,917**	**134**	**706,794,655**	**69.98%**

Procedurat e përzgjedhura për auditim, janë si më poshtë vijon:

Nr.	Objekti i procedurës së prokurimit	Vlera në lekë	Lloji i procedurës	Viti i zhvillimit të procedurës
1	ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marjen e mostrave të testimeve Covid-19ò.	166,260,000	E hapur	2020
2	Blerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19	163,020,375	E hapur	2020
3	Blerje kite dhe materiale të tjera për manipulim në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve për Covid-19	50,515,000	E hapur	2020
4	LOTI 4: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Vloreò,	30,509,969	E hapur	2019
5	Blerje e kitve dhe materialeve te konsumit per Depistimin e HPV-së	26,663,857	E hapur	2018
6	Depistimin e HPV-së, blerje e kiteve dhe materialeve të konsumit	26,324,800	E hapur	2019
7	Blerje materiale dhe kite per kerkim dhe diagnostikim per laboratorin e biologjise	13,743,700	E hapur	2018

	molekulare dhe HIV, HEP, HPV, etjò			
8	LOTI 1: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhëò,	9,943,883	E hapur	2019
9	Mirëmbajtje e paisjeve të mamografive lëvizëse	8,643,623	E hapur	2019
10	Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etj	8,149,500	E hapur	2020
11	Blerje kite dhe reagente e materiale per teknikat Taq Man dhe Cobas Amplikor	8,056,500	Kërkesë për Propozim	2018
12	Blerje kite dhe reagente e materiale per teknikat Cobas Taq Man	7,992,500	Kërkesë për Propozim	2019
13	Materiale dhe kite per kerkim dhe diagnostikim per laboratorin e biologjise molekulare, semundjeve infektive emergjente, si dhe HIV, HEP, HPV, etjò, blerje	7,950,500	Kërkesë për Propozim	2019
SHUMA		**527,774,207**		

Mbulimi me fonde paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Realizuar		Audituar		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Përqindje
Viti 2018	51	89,970,168	3	48,167,500	53.54%
Viti 2019	36	138,186,296	6	91,365,275	66.12%
Viti 2020	43	477,615,524	4	387,944,875	81.23%
Viti 2021	4	1,022,667	0	0	0%
SHUMA	**134**	**706,794,655**	**13**	**527,477,207**	**74.63%**

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion për procedurat e mësipërme, u konstatua si më poshtë vijon:

Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP), për periudhën objekt auditimi është si më poshtë vijon:

Për vitin 2018, me shkresën nr. 32, datë 10.01.2018, drejtuar APP, titullari i AK znj. A.A.ka caktuar PPP znj. A.M..

Për vitin 2019, me anë të Urdhrit nr. 2, nr. 4 prot., datë 03.01.2019, titullari i AK znj. A.F., ka emëruar PPP z. D.H.dhe znj. A.M.. Ndërsa me Urdhrin nr. 325, nr. 4/1 prot., datë 12.06.2019, titullari i AK ka vendosur heqjen e z. D.H. si PPP dhe mbylljen e llogarive të tij, për arsye të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Për vitin 2020, me anë të Urdhrit nr. 3, nr. 46 prot., datë 10.01.2020, titullari i AK znj. A.F., ka emëruar PPP znj. A.M..

Për vitin 2021, me anë të Urdhrit nr. 1, nr. 13 prot., datë 06.01.2021, titullari i AK znj. A.F., ka emëruar PPP znj. A.M.dhe znj. A.C..

Nga shkresat e mësipërme, konstatohet se është caktuar si PPP znj. A.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, e cila është **Nëpunës Zbatues** i ISHP, si dhe në cilësinë e PPP është anëtare e Njësisë së Prokurimit për të gjitha procedura e zhvilluara nga ISHP, e për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, të cilat përcaktojnë se:

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:
a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe

efektivitetit;
e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

Si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi titullarët e AK sipas shkresave të sipërcituara dhe A.M.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës.

Parashikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2018-30.03.2021), paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Parashikuar		Realizuar		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Përqindje
Viti 2018	56	96,728,592	51	89,970,168	93.01%
Viti 2019	48	352,994,756	36	138,186,296	39.15%
Viti 2020	59	510,555,881	43	477,615,524	93.55%
Viti 2021	14	49,684,689	4	1,022,667	2.06%
SHUMA	**177**	**1,009,963,917**	**134**	**706,794,655**	**69.98%**

Për vitin 2018, nga 56 procedura prokurimi me vlerë 96,728,592 lekë të parashikuara për tu realizuar, ISHP ka realizuar 51 të tilla me vlerë 89,970,168 lekë.
Për vitin 2019, nga 48 procedura prokurimi me vlerë 352,994,756 lekë të parashikuara për tu realizuar, janë realizuar gjithsej 36 procedura me vlerë 138,186,296 lekë, ose prokuruar afërsisht 39% të fondeve të parashikuara për tu prokuruar. Ndikimin më të lartë në këtë mos realizim ka ardhur si pasojë e mos realizimit të procedurave:
-ñRikonstruksion i godinës qendrore të ISHPò me vlerë 98,175,833 lekë, e cila nuk është realizuar pasi janë pakësuar fondet nga MSHMS për këtë procedurë.
-ñShërbim i diziinsektimit në zonat bregdetare dhe urbane (me Lote)ò me vlerë 133,333,333 lekë, nga të cilat për vitin 2019 janë realizuar 2 lote me vlerë 64,326,864 lekë dhe 2 lotet e tjera të mbetura janë realizuar në vitin 2020 me vlerë 40,453,852 lekë.

Për vitin 2020, nga 59 procedura prokurimi me vlerë 510,555,881 lekë të parashikuara për tu realizuar, janë realizuar 43 të tilla me vlerë 477,615,524 lekë, ose afërsisht 94% e fondeve të parashikuara. Diferenca prej 100 milion lekësh në realizim, konsiston në mos realizimin e procedurës së prokurimit me objekt ñDepistimin e HPV-së, blerje kiteve dhe materialeve të konsumiò me vlerë 26,267,000 lekë, për arsye të pandemisë.

Në lidhje me regjistrat e parashikimit, konstatohet se:
Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për vitin 2018, është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këto e më poshtë: MSHMS) dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 56, datë 15.01.2018.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2018, janë kryer gjithsej 21 ndryshime të regjistrit, për të cilat janë dërguar shkresat respektive në MSHMS, por jo në Degën e Thesarit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se:

Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të

tillë.

Për këtë veprim, në zbatim të paragrafit 1, të pikës 3, të nenit 57, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, mban përgjegjësi A.M.në cilësinë e PPP për vitin 2018.

Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për vitin 2019, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 43/1, datë 17.01.2019.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2019, janë kryer gjithsej 12 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se:
-Vetëm 3 prej këtyre ndryshimeve i janë dërguar MSHMS si institucion qëndror që vë në dispozicion fondet, por jo në Degën e Thesarit.
-Për 9 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK, si dhe këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

Për këto veprim, në zbatim të paragrafit 1, të pikës 3, të nenit 57, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, mbajnë përgjegjësi A.M. dhe D.H. në cilësinë e PPP për vitin 2019.

Me anë të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 121, datë 08.01.2018 ñMbi dërgimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2018 dhe regjistrin e realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2017ò, dërguar autoriteteve kontraktore në varësi të MSHMS, ndër të tjera, në pikën 3 përcakton që ñ*Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektonik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem,* ***ndaj ndryshimet nuk do të dërgohen më në institucionin qëndror që vë në dispozicion fondet buxhetore***ò. Në zbatim të kësaj shkrese, ISHP nuk i ka dërguar ndryshimet e regjistrave të parashikimit pranë MSHMS.
Përcaktimi i kryer nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Një kopje e këtyre ndryshimeve*, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe* ***institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore****, në rastin kur ka një të tillë.*

Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për vitin 2020, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 50, datë 10.01.2020.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2020, janë kryer gjithsej 25 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se:
-Për 10 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK.
-Vetëm 3 prej 25 ndryshimeve të regjistrit, i janë dërguar MSHMS, si institucion qëndror që vë në dispozicion fondet.
-Asnjë prej këtyre ndryshimeve nuk i është dërguar Degës së Thesarit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

Si dhe Rregulloren e Brendshme të ISHP, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ISHP nr. 512, nr. 1906/1 prot., datë 31.12.2019, pika 6.3 ñDrejtoriò, nënpikat (i) dhe (iv), të cilat përcaktojnë se:

Drejtori i ISHP-së:
(i) Është titullari i ISHP-së.
(iv) Organizon, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e përgjithshme të ISHP dhe e përfaqëson atë.

Për këto veprim, në zbatim të paragrafit 1, të pikës 3, të nenit 57, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, mban përgjegjësi A.M.në cilësinë e PPP për vitin 2020.

Nga verifikimi i regjistrave të parashikimeve dhe ndryshimeve të tyre për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ISHP ka kryer ndryshimet e RPP pas datës 15 tetor, si më poshtë vijon:

Nr.	Procedura	Parashikuar		
		Nr. Prot.	Datë	Vlerë
1	Blerje e kitve dhe materialeve te konsumit per Depistimin e HPV-së	1038/6	19/10/2018	26,663,857
2	Blerje bileteTiranë - Romë -Tiranë për projektin e KEP3	1038/7	06/11/2018	37,958
3	Mirembjatje e paisjeve laboratorike diagnostikuese, instrumenta kimike, autoclava dhe te tjera	769/6	24/11/2020	768,000
4	Blerje (F+V) rotor centrifuge ependorf.	769/7	01/12/2020	350,000
5	Blerje paisje kompjuterike(Blerje UPS per sigurine e qendrueshmerise se rrumes se energjise elektrike ne paisjet per ISHP)	769/7	01/12/2020	433,333
6	Blerje Centrifuge, per manipulim ne biologjine molekulare(per mikkrotuba 1.5-2ml)per ISHP.	769/7	01/12/2020	441,667

Ndryshimet e zërave të regjistrit të parashikimeve për shkresat e sipërcituara, janë pas datës 15 tetor, e për pasojë janë në kundërshtim me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò, pika 1, e cila përcakton se:

1. Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.

Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për vitin 2021, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 180, datë 08.02.2021. sipas ëktij regjistri, për vitin 2021, janë parashikuar të zhvillohen 37 procedura prokurimi, me një vlerë totale 422,887,868 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion për procedurat e mësipërme, u konstatua si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje kiteve dhe materialeve te konsumit për Depistimin e HPV-sëò, me fond limit 26,663,857 lekë pa tvsh, Tetor 2018.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje kiteve dhe materialeve te konsumit për*

***Depistimin e HPV-së*"**				
1. Urdhër Prokurimi nr. 1420/8, datë 22.10.2018 **2.** Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	**3. Njësia e prokurimit** D.H. L.S. A.M..		**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 1420/9, datë 22.10.2018. S.B. G.B. A.A.	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 26,663,857 lekë	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** 26,427,000 lekë (99% e fondit limit)		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 236,857 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 19.11.2018; ora: 11:00	**9. Burimi i Financimit** Buxhetit i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. B.A. SHPK me vlerë 26,427,000 lekë.	
11. Ankimime PO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** PO		**13. Përgjigje ankesës nga KPP-** N/A	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës nr. 1420/25, datë 18.12.2018	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 31,712,400 lekë me TVSH		**16. Likuiduar:** 31,712,400 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Fatura nr. 380, datë 20.12.2018 me vlerë 31,712,400 lekë.	**18. Afati i kontratës në ditë** Brenda datës 31.12.2018		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** JO	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Procesverbal i marrjes në dorëzim** Datë 20.12.2018	**23. Grupi i marrjes në dorëzim** Urdhri nr. 1693, datë 20.12.2018: L.S., B.H. H.M.		**24.** Fletë Hyrja nr. 25, datë 20.12.2018	

Me anë të shkresës nr. 4773/4, datë 10.09.2018, protokolluar në ISHP me nr. 1218, datë 13.09.2018, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i ka dërguar detajimin e ndryshimeve të miratuara me anë të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, me anë të së cilit për ISHP janë shtuar 32,000,000 lekë fonde në dispozicion.
Me anë të emailit të datës 15.10.2018, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Saimir Kadiu, i sugjeron përdorimin e fondit të alokuar prej 32 milion lekësh për blerjen e reagentëve të nevojshëm për depisitimin e kancerit të qafës së mitrës.

Në zbatim të komunikimeve të sipërcituara, me anë të Urdhrit nr. 187, nr. 1420 prot., datë 15.10.2018, titullari i AK ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga:

1. A.Y., shef sektori,
2. L.S.,
3. A.M..

Me anë të relacionit nr. 1420/7, datë 19.10.2018, grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përllogaritur fondin limit në vlerën 26,663,857 lekë pa tvsh.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 1420/8, datë 22.10.2018, titullari i AK znj. A.F., ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje kiteve dhe materialeve te konsumit për Depistimin e HPV-së*ò, me procedurë ñE hapur me mjete elektronikeò, me fond limit 26,663,857 lekë pa tvsh, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit.
Me anë të Urdhrit nr. 1420/9, datë 22.10.2018, titullari i AK ka ngritur KVO.

Me anë të Procesverbalit nr. 1, datë 23.10.2018, Njësia e Prokurimit ka kryer hartimin dhe miratimin e DT për këtë procedurë, por nuk ka argumentuar teknikisht vendosjen e kritereve të veçanta për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Në specifikimet teknike të përdorura, NjP ka përdorur emra markash pa shtuar tog-fjalëshin ñ*ose ekuivalent*ò, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e cila përcakton se:

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1420/10, datë 24.10.2018, është publikuar në Buletinin e APP datë 29.10.2018.
Me anë të shkresës nr. 1420/11, datë 02.11.2019, OE S. SHPK ka dërguar ankesën e tij në lidhje me specifikimet teknike.
Në zbatim të kësaj ankese, me anë të shkresës nr. 1420/12, datë 02.11.2018, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës, ndërsa me Urdhrin nr. 1420/13, datë 02.11.2018, ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga:

1. B.V.
2. E.A.
3. A.A.

Me anë të relacionit nr. 1420/14, datë 05.11.2018, KSHA ka vendosur mos-pranimin e ankesës për arsye se ka ardhur jashtë afatit të përcaktuar në ligj.
Me anë të shkresës nr. 1420/15, datë 05.11.2018, drejtuar OE S. SHPK, titullari i AK i dërgon vendimin e KSHA ku citohet mos-pranimini i ankesës së paraqitur.

Në datën e hapjes së ofertave, 19.11.2018, sipas procesverbalit të vlerësimit të datës 20.11.2018 dhe SPE, konstatohet se është paraqitur vetëm një ofertë, ajo e OE B.A. SHPK me vlerë 26,427,000 lekë. Sipas këtij procesverbali, KVO e ka kualifikuar pa rezerva ofertën e këtij OE.
Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 1420/17, datë 11.12.2018, KVO i ka paraqitur për miratim procedurën titullarit të AK, që e miraton me anë të Vendim Miratimit nr. 1420/19, datë 11.12.2018.
Formulari i njoftimit të fituesit nr. 1420/20, datë 11.12.2018, është publikuar në buletinin e APP datë 17.12.2018.

OE B.A. SHPK ka sjellë Formularin e sigurimit të kontratës nr. 0053161, datë 12.12.2018.
Kontrata nr. 1420/23, datë 18.12.2018, me vlerë 31,712,400 lekë me tvsh, me afat deri më datë 31.12.2018, është nënshkruar nga znj. A.F. për Ak dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.
Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 1420/24, datë 20.12.2018, është publikuar në Buletinin e APP datë 31.12.2018.

Me anë të Urdhrit nr. 1693, datë 20.12.2018, titullari i AK ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim të përbërë nga:

1. L.S.
2. B.H.
3. H.M.

OE B.A. SHPK ka sjellë materialet mjekësore me anë të faturës tatimore nr. 380, datë 20.12.2018, me vlerë 31,712,400 lekë me tvsh. Mallrat janë bërë hyrje me anë të fletë hyrjes nr. 25, datë 20.12.2018.
Këto materiale mjekësore janë marrë në dorëzim me anë të procesverbalit të datës 20.12.2018.

Fatura është likuiduar me anë të urdhër-shpenzimeve si më poshtë:
-Urdhër-Shpenzimi nr. 498, datë 26.12.2018, me vlerë 29,900,000 lekë.
-Urdhër-Shpenzimi nr. 26, datë 06.02.2019, me vlerë 1,812,400 lekë.

2. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, Tetor 2020.

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marjen e mostrave të testimeve Covid-19”</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 34, nr. 1139, datë 06.10.2020</td><td rowspan="2">3. Njësia e prokurimit
I.H.
A.A.
A.M..</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 161, nr. 1139/1, datë 06.10.2020.
L.S.
B.V.
A.R.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapur - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)ò</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa tvsh)
166,260,000 lekë</td><td>6. Oferta Fituese (pa tvsh)
41,760,000 lekë
(25.12% e fondit limit)</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
124,500,000 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave
02.11.2020; ora: 11:00</td><td>9. Burimi i Financimit
Buxhetit i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>OE pjesëmarrës</th><th>Oferta (pa tvsh)</th><th>Shënime</th></tr>
<tr><td>1</td><td>E. SHPK</td><td>41,760,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>2</td><td>O.D. SHPK</td><td>50,280,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>3</td><td>B.A. SHPK</td><td>55,500,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>4</td><td>F.N.A SHPK</td><td>56,862,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>5</td><td>M. SHPK</td><td>64,560,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>6</td><td>F. SHPK</td><td>69,000,000</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>7</td><td>S. SHPK</td><td>68,160,000</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>8</td><td>K. SHPK</td><td>93,810,000</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>9</td><td>M. SHPK</td><td>48,300,000</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>10</td><td>G. SHPK</td><td>116,400,000</td><td>Skualifikuar</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
PO</td><td>12. Përgjigje e ankesës nga AK
PO</td><td>13. Përgjigje ankesës nga KPP-
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
</table>

14. Lidhje e kontratës: Marrëveshja Kuadër nr. 1139/32, datë 11.12.2020, me vlerë 50,112,000 lekë me TVSH	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** Kontrata e furnizimit nr. 1139/37, datë 24.12.2020, me vlerë 18,072,000 lekë me TVSH		**16. Likuiduar:** 18,072,000 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Fatura nr. 1731, datë 29.12.2020, me vlerë 448,800 lekë. Fatura nr. 330/2021, datë 15.02.2021, me vlerë 17,623,200 lekë.	**18. Afati i kontratës:** 3 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** JO	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Procesverbal i marrjes në dorëzim** Datë 29.12.2020 dhe 15.02.2021.	**23. Grupi i marrjes në dorëzim** Urdhri nr. 233, nr. 1139/40, datë 28.12.2020: M.K., B.A.dhe H.M.		**24.** Fletë Hyrja nr. 210, datë 29.12.2020 dhe Fletë Hyrja nr. 2, datë 15.02.2021.	

Me anë të shkresës nr. 1044, datë 15.09.2020, drejtuar titullarit të AK, është dërguar kërkesa për materiale për:

1. SET Kit (tamponë + tub me terren), për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19 në sasinë 420,000 copë,
2. Tampon orofaringeal në sasinë 30,000 copë,
3. Tampon nazofaringeale në sasinë 30,000 copë.

Kërkesa është hartuar nga znj. R.D. epidemiologe, znj. I.H. specialiste virologe dhe znj. A.R. shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, si dhe miratuar nga znj. S.B. shefe e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive.
Në zbatim të kësaj kërkese, me anë të Urdhrit nr. 152, nr 1044/1, datë 15.09.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga:

1. A.R., Përgjegjëse e Sektorit të Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale.
2. R.D., Epidemiologe dhe
3. X.M., specialiste në Sektorin e Buxhetit dhe Financës.

Me anë të Relacionit nr. 1044/14, datë 21.09.2020, grupi i punës harton specifikimet teknike, si dhe përllogarit fondin limit në vlerën 166,260,000 lekë pa tvsh, si mesataren e çmimeve të ofertave të nxjerra nga studimi i tregut, të marra nga OE sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Amballazhi / Paketimi	Njësia	Sasia	Çmimi F.N	Çmimi O.D.	Çmimi M.	Çmimi B.A.	Çmimi K.	Çmimi E.

1	SET Kit (tamponë + tub me terren), për marjen e mostrave të testimeve Covid-19	kit (copë)	kit (cope)	420,000	398	410	350	400	320	420
2	Tampon orofaringeal	copë	cope	30,000	75	85	90	80	120	90
3	Tampon nazofaringeale	copë	cope	30,000	75	85	90	80	120	90

Me anë të shkresës nr. 1044/15, datë 21.09.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, titullari i AK i dërgon kërkesën për procedurën e prokurimit me objekt ñ*Blerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marjen e mostrave të testimeve Covid-19*ò, si dhe marrjen e masave nga MSHMS për furnizimin në një kohë sa më të shpejtë.
Me anë të shkresës nr. 4264/1, datë 01.10.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1126, datë 02.10.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i njofton se Ministri vendos t`i lejojë kryerjen e procedurës së prokurimit nga vetë ISHP.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 34, nr. 1139, datë 06.10.2020, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marjen e mostrave të testimeve Covid-19*ò, me fond limit në vlerën 166,260,000 lekë pa tvsh, me procedurë ñE hapur me mjete elektronike-Mallraò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit.
Ndërsa me Urdhrin nr. 161, nr. 1139/1, datë 06.10.2020, ka përcaktuar komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga L.S., B.V. dhe A.R.. Në lidhje me këtë urdhër konstatohet se:
-Anëtarja e KVO A.R. është njëkohësisht anëtare e e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit i ngritur me anë të Urdhrit nr. 152, nr 1044/1, datë 15.09.2020, e për pasojë vendosja e saj si anëatëre e KVO është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se:

Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi Personi Përgjegjës për Prokurimet anëtar i NjP A.M., anëtarja e KVO A.R. dhe titullari i AK.

Me anë të procesverbalit të datës 06.10.2020, Njësia e Prokurimit ka hartuar, argumentuar dhe miratuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Nga verifikimi i DT, u konstatua se:
-Në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiro jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b, e cila përcakton se:

kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose

-Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të*

*dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashmë me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkondëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 1139/2, datë 08.10.2020, është publikuar në Buletinin e APP datë 12.10.2020. Data e zhvillimit të procedurës do jetë data 02.11.2020, ora 11:00.

Me anë të procesverbalit nr. 1, datë 02.11.2020, KVO ka marrë në dorëzim mostrat nga 10 OE pjesëmarrës në këtë procedurë. Procesverbali është i firmosur nga anëtarët e KVO dhe përfaqësuesit e OE pjesëmarrës në këtë procedurë.
Në datën e hapjes së ofertave, kanë marrë pjesë OE e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta (pa tvsh)	Shënime
1	E. SHPK	41,760,000	Kualifikuar
2	O.D. SHPK	50,280,000	Kualifikuar
3	B.A. SHPK	55,500,000	Kualifikuar
4	F.N.A. SHPK	56,862,000	Kualifikuar
5	M. SHPK	64,560,000	Kualifikuar
6	F.SHPK	69,000,000	Kualifikuar
7	S. SHPK	68,160,000	Skualifikuar
8	K. SHPK	93,810,000	Skualifikuar
9	M. SHPK	48,300,000	Skualifikuar
10	G. SHPK	116,400,000	Skualifikuar

Sipas procesverbaleve të vlerësimit të datës 03.11.2020 dhe 06.11.2020, KVO ka skualifikuar OE S. SHPK, K. SHPK, M. SHPK dhe G.SHPK, si dhe ka kualifikuar OE të tjerë pjesëmarrës.
Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, KVO ka konstatuar se oferta e OE E. SHPK është anomalisht e ulët. Për këtë arsye me anë të shkresës nr. 1139/2, datë 06.11.2020 si dhe me mesazh në SPE. I është drejtuar këtij OE për të dhënë shpjegime mbi ofertën e dhënë.
OE E. SHPK ka kthyer përgjigje me anë të shkresës së datës 10.11.2020, e cila është protokolluar në ISHP me nr. 1139/22, datë 10.11.2020.
KVO me anë të procesverbalit të datës 10.11.2020, ka pranuar pretendimet e subjektit dhe e ka kualifikuar këtë OE.

Me anë të shkresës datë 14.11.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1139/23, datë 16.11.2020, OE M. SHPK ka sjellë formularin e ankesës, ku parashtron pretendimet e tij mbi procesin e vlerësimit.
Me anë të Urdhrit nr. 191, nr. 1139/24, datë 16.11.2020, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës, ndërsa me Urdhrin nr. 192, nr. 1139/25, datë 16.11.2020, ka ngarkuar për verifikimin e kësaj ankese komisionin e përbërë nga E.A., A.B.dhë A.C..
Me anë të relacionit nr. 1139/26, datë 18.11.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vendosur mos-pranimin e ankesës.

Me anë të shkresës nr. 1139/27, datë 18.11.2020, drejtuar OE M. SHPK, titullari i AK i ka dërguar përgjigje duke e informuar mbi mos-pranimin e ankesës në zbatim të relacionit të komisionit të shqyrtimit të ankesës.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 1139/28, datë 01.12.2020, titullari i AK ka miratuar procedurën e prokurimit dhe shpalljen fituese të ofertës së OE E. SHPK me vlerë 41,760,000 lekë pa tvsh.
Formulari i njoftimit të OE të suksesshëm në marrëveshjen kuadër nr. 1139/29, datë 01.12.2020.
Me anë të procesverbalit të datës 09.12.2020, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin e OE E. SHPK të shpallur fitues.

Në këtë procedurë prokurimi, kanë ofertuar 10 OE. Nga këta 10 OE, 6 prej tyre kanë qenë pjesë e OE të përzgjedhur në procesin e studimit të tregut, gjatë hartimit të fondit limit. Për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se kontrata është lidhur me 25.12% të vlerës së fondit limit të përllogaritur. Kjo ulje drastike në vlerë, ka ardhur si pasojë që 6 OE e përzgjedhur në studimin e tregut, gjatë fazës së studimit të tregut kanë ofertuar vlera shumë të larta, ndërsa gjatë fazës së tenderimit kanë ofertuar vlera më të ulta, e konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

në lekë

Operatori Ekonomik	**F.N**	**O.D.**	**M.**	**B.A.**	**K.**	**E.**
Oferta studimin e tregut	171,660,000	177,300,000	152,400,000	172,800,000	141,600,000	181,800,000
Oferta në procedurën e prokurimit	56,862,000	50,280,000	64,560,000	55,500,000	93,810,000	41,760,000
Përqindja	**33%**	**28%**	**42%**	**32%**	**66%**	**23%**

Kjo sjellje e OE të mësipërm, konsiderohet si një sjellje e dyshimtë dhe mund të përbëjë egzistencën e një marrëveshje të ndaluar në oferta, sipas interpretimit zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Marrëveshjet e ndaluara në oferta çojnë në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 ñPër mbrojtjen e konkurrencësò, të ndryshuar.
Paraqitja nga operatorët ekonomikë të ofertave me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender për të njëjtin objekt prokurimi, mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t`i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës, në rast të konstatimit të këtyre diferencave.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ñPër mbrojtjen e konkurrencësò, i ndryshuar, neni 4, pika 1, e cila ndër të tjera përcakton se:

1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg...

Nisur nga fakti që të gjithë operatorët e konomikë të mësipërm kanë paraqitur oferta me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që kanë paraqitur në tender, **Autoriteti Kontraktor (ISHP) duhej ti ishte drejtuar Autoritetit të Konkurrencës** *për verifikimin e egzistencës së mundshme të marrëveshjeve të ndaluara nga këta operatorë ekonomikë*, si dhe marrjen e masave respektive ndëshkuese ndaj tyre.

OE E. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 060475, datë 07.12.2020, me vlerë 19,951,200 lekë (10% e fondit limit).
Marrëveshja Kuadër nr. 1139/32, datë 11.12.2020, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.A për OE E. SHPK.

Me anë të Urdhrit nr. 221, nr. 1139/33, datë 21.12.2020, titullari i AK ka ngarkuar znj. A.R. me detyrë shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër.

Në lidhje me personat e ngarkuar për këtë zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, konstatohet se ka një përqendrim të detyrave te znj. A.R., e konkretisht:
-Ka hartuar kërkesën për materiale me anë të shkresës nr. 1044, datë 15.09.2020.
-Ka hartuar fondin limin limit dhe specifikimet teknike, sipas Urdhrit nr. 152, nr 1044/1, datë 15.09.2020.
-Është anëtare e KVO, sipas Urdhrit nr. 161, nr. 1139/1, datë 06.10.2020.
-Është caktuar si personi përgjegjës për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, sipas Urdhrit nr. 221, nr. 1139/33, datë 21.12.2020.
Ky përqëndrim i detyrave është këryer në kundërshtim me:
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar
Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 20, pika 1 dhe pika 2/c, si dhe neni 22, pika 3/b, të cilat përcaktojnë se:

Neni 20
1. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.
2. Mjedisi i kontrollit përmban:
c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
Neni 22
3. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:
b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK si dhe znj A.R..

Me anë të shkresës nr. 1139/34, datë 22.12.2020, drejtuar titullarit të AK, znj. A.R. ka dërguar kërkesësn për artikujt sipas Marrëveshjes Kuadër (150,000 Set Kit, 6,000 Tampon Orofaringeal dhe 24,000 tampon Nazofaringeale), kërkesë e cila është e miratuar nga shefja e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive znj. S.B..
Me anë të shkresës nr. 113/35, datë 22.12.2020, drejtuar OE E. SHPK, titullari i AK i ka dërguar ftesën për të ofruar ofertë dhe për të nënshkruar kontratën për sasinë sipas kërkesës të ardhur me anë të shkresës nr. 1139/34, datë 22.12.2020.
Me anë të shkresës datë 24.12.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1139/36, datë 24.12.2020, OE E. SHPk ka dorëzuar ofertën në vlerën totale 15,060,000 lekë pa tvsh (ose 18,072,000 lekë me tvsh), sipas çmimeve të Marrëveshjes Kuadër nr. 1139/32, datë 11.12.2020.
Kontrata e furnizimit nr. 1139/37, datë 24.12.2020, me vlerë 18,072,000 lekë me tvsh, me afat 3 muaj nga nënshkrimi i minikontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.A për OE E. SHPK.
Me anë të Urdhrit nr. 1139/40, datë 28.12.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim të përbërë nga M.K., B.A.dhe H.M..

OE E. SHPK ka sjellë mallrat e kontraktuara sipas faturave të mëposhtme:
Me anë të faturës tatimore nr. 1731, datë 29.12.2020, me vlerë 448,800 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 1, datë 29.12.2020, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 210, datë 29.12.2020.
Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 587, datë 31.12.2020, me vlerë 448,800 lekë.

Me anë të faturës tatimore nr. 330/2021, datë 15.02.2021, me vlerë 17,623,200 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me znë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 2, datë 15.02.2021, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 2, datë 15.02.2021.
Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 59, datë 12.03.2021, me vlerë 17,623,200 lekë.

Nga verifikimi i gjendjes së magazinë, gjendja e tyre më datë 30.03.2021, është si vijon:

Nr	Emërtimi	Amballazhi / Paketimi	Njësia	Sasia	Çmimi (me tvsh)	Vlera
1	SET Kit (tamponë + tub me terren), për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19	kit (copë)	kit (cope)	126,000	116.40	**14,666,400**
2	Tampon orofaringeal	copë	copë	0	20.40	**0**
3	Tampon nazofaringeale	copë	copë	0	20.40	**0**

Pas komunikimeve me përfaqësuesit e ISHP, konstatohet se për këtë marrëveshje kuadër, nuk janë nënshkruar kontrata furnizimi të tjera përveç Kontratës së furnizimit nr. 1139/37, datë 24.12.2020, me vlerë 18,072,000 lekë me tvsh.
Sipas Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 2, datë 15.02.2021, data e skadencës për artikullin ñSET Kit (tamponë + tub me terren), për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, është mbi 12 muaj nga data e lëvrimit. Nga verifikimi fizik i setit, konstatohet se data e skadencës është Shkurt 2022.

3. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, Tetor 2020.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 35, nr. 1149, datë 07.10.2020 **2.** Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapur - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)ò	**3. Njësia e prokurimit** M.K. A.M. A.C.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 162, nr. 1149/1, datë 08.10.2020. D.U. (zëvëndesohet me A.Y. me Urdhrin nr. 184, nr. 1149/3, datë 05.11.2020) A.R. E.A.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 163,020,375 lekë	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** 155,875,500 lekë (95.62% e fondit limit)	**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 7,144,875 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 06.11.2020, ora 11:00	**9. Burimi i Financimit** Buxhetit i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. B.A. SHPK.
11. Ankimime	**12. Përgjigje e ankesës nga**	**13. Përgjigje ankesës nga KPP**

<table>
<tr><td>JO</td><td colspan="2">AK
N/A</td><td colspan="2">N/A</td></tr>
<tr><td colspan="5">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhje e kontratës:
Marrëveshja Kuadër 1149/8, datë 01.12.2020, me vlerë 187,050,600 lekë me TVSH</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
Kontrata e furnizimit nr. 1149/13, datë 11.12.2020, me vlerë 51,433,488 lekë me TVSH
Kontrata e furnizimit nr. 311/3, datë 09.03.2021, me vlerë 57,540,600 lekë me TVSH</td><td colspan="2">16. Likuiduar:
84,140,264 lekë</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë
-nr. 2763, datë 17.12.2020, me vlerë 28,499,088 lekë.
-nr. 365, datë 22.12.2020, me vlerë 21,813,600 lekë.
-nr. 156/2021, datë 12.02.2021, me vlerë 1,120,800 lekë.
-nr. 279/2021, datë 12.03.2021, me vlerë 36,706,776 lekë.</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës:
Kontrata 1: 60 Ditë
Kontarata 2: 4 muaj</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë
Kontrata 1: 15 ditë</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>22. Procesverbal i marrjes në dorëzim
Datë 17.12.2020, 22.12.2020, 12.02.2021 dhe 12.03.2021.</td><td colspan="2">23. Grupi i marrjes në dorëzim
Urdhri nr. 215, nr. 1149/14, datë 11.12.2020:
E.B., S.M. dhe H.M..</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja:
nr. 17, datë 17.12.2020
nr. 21, datë 29.12.2020
nr. 1, datë 12.02.2021
nr. 3, datë 12.03.2021</td></tr>
</table>

Me anë të shkresës nr. 1073, datë 22.09.2020, drejtuar titullarit të AK, është dërguar kërkesa për ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19ò. Në këtë kërkesë parashikohet të blihen 138,240 kite për amplifikimin e ARN-së, si dhe materiale të tjera. Sasia është përllogaritur në mënyrë të përafërt për mbulimin e nevojave për një periudhë 12 mujore.

Kërkesa është hartuar nga znj. M.D. specialiste virologe dhe znj. A.R. shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, si dhe miratuar nga znj. S.B. shefe e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive.

Në zbatim të kësaj kërkese, me anë të Urdhrit nr. 158, nr 1073/1, datë 22.09.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga:

4. A.R., Përgjegjëse e Sektorit të Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale,
5. M.K., specialiste e Sektorit të Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale,
6. A.M., Person Përgjegjës për Prokurimet.

Me anë të Relacionit nr. 1073/12, datë 28.09.2020, grupi i punës harton specifikimet teknike, si dhe përllogarit fondin limit në vlerën 163,020,375 lekë pa tvsh, si mesataren e çmimeve të ofertave të nxjerra nga studimi i tregut, të marra nga OE sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Amballazhi/ose Paketimi	Njësia	Sasia	A.M.	B.A.	Mesatarja	Vlera pa tvsh

1	Kit për amplifikimin e ARN-së	192 test/ reaksione per kit	teste ose reaksione	138,240	885	875	880	121,651,200
2	Tub	2*500 copë/kuti	kuti	160	40,000	45,000	42,500	6,800,000
3	Kartrixh per pergatitje mostre	336 kartdrixhe/ kuti	kuti	400	21,550	20,000	20,775	8,310,000
4	Kapake mbulues	144/kuti	kuti	150	15,000	14,500	14,750	2,212,500
5	Maja me filter	(8*128) ose 1024 maja /kuti	kuti	200	16,000	15,000	15,500	3,100,000
6	Maja me filter	(8*128) ose 1024 maja /kuti	kuti	540	24,500	24,000	24,250	13,095,000
7	Mikrotuba	(24*96)/kuti	kuti	65	100,000	99,590	99,795	6,486,675
8	Kapake	(50*8)/kuti	kuti	350	2,550	2,450	2,500	875,000
9	Majtese tubash mostre	cope	cope	5	42,000	40,000	41,000	205,000
10	Adaptor per tuba 2 ml	24 cope/ kuti	kuti	5	10,000	10,000	10,000	50,000
11	Tampon per lizen qelizore	4*50 ml/kuti	kuti	10	25,000	22,000	23,500	235,000
SHUMA								**163,020,375**

AK i është drejtuar për ofertë OE si vijon:

1. M. SHPK me shkresën nr. 1073/2, datë 23.09.2020,
2. A.M. SHPK me shkresën nr. 1073/3, datë 23.09.2020,
3. B.A. SHPK me shkresën nr. 1073/4, datë 23.09.2020,
4. B.A.D. me shkresën nr. 1073/5, datë 23.09.2020,
5. K. SHPK me shkresën nr. 1073/6, datë 23.09.2020

OE M. SHPK, K. SHPK dhe B.A.SHPK, nuk kanë paraqitur ofertë pasi nuk mund të ofrojnë çmime për të gjithë artikujt.

Me anë të shkresës nr. 1073/13, datë 28.09.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, titullari i AK i dërgon kërkesën për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19ò.
Me anë të shkresat nr. 4264/3, datë 05.10.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1126/2, datë 08.10.2020 dhe nr. 4369/1, datë 05.10.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1126/1, datë 05.10.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i njofton se Ministri vendos t`i lejojë kryerjen e procedurës së prokurimit nga vetë ISHP, si dhe fondet do përballohen nga buxheti i ISHP.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 35, nr. 1149, datë 07.10.2020, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIAsyphony për testimet e Covid-19ò, me fond limit në vlerën 163,020,375 lekë pa tvsh, me procedurë ñMarrëveshje Kuadër, E hapur me mjete elektronike-Mallraò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga M.K., A.M.dhe A.C..
Ndërsa me Urdhrin nr. 162, nr. 1149/1, datë 08.10.2020, ka përcaktuar komisionin e vlerësimit të

ofertave, të përbërë nga D.U., E.A. dhe A.R.. Në lidhje me këtë urdhër konstatohet se:
-Anëtarja e KVO A.R. është njëkohësisht anëtare e e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit i ngritur me anë të Urdhrit nr. 158, nr 1073/1, datë 22.09.2020, e për pasojë vendosja e saj si anëatëre e KVO është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se:

Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi Personi Përgjegjës për Prokurimet anëtar i NjP A.M.dhe A.C., anëtarja e KVO A.R. dhe titullari i AK.
Me anë të Urdhrit nr. 184, nr. 1149/3, datë 05.11.2020, është kryer zëvendësimi i kryetarit të KVO z. D.U. për arsye se ka rezultuar pozitiv me Covid-19, me z. A.Y..

Me anë të procesverbalit të datës 07.10.2020, Njësia e Prokurimit ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Me anë të procesverbalit të datës 13.10.2020, pas rishikimeve të APP, njësia e prokurimit ka hartuar, argumentuar dhe miratuar DT për këtë procedurë prokurimi.
Nga verifikimi i DT, u konstatua se:
-Në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiro jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b, e cila përcakton se:

kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose

-Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet...*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashmë me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkondëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 1149/2, datë 13.10.2020, është publikuar në Buletinin e APP datë 19.10.2020. Data e zhvillimit të procedurës do jetë data 06.11.2020, ora 11:00.

Në datën e hapjes së ofertave, ka marrë pjesë vetëm OE B.A. SHPK me ofertë 155,875,500 lekë pa tvsh. Sipas procesverbaleve të vlerësimit të datës 13.11.2020, KVO e ka kualifikuar këtë OE.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 1149/4, datë 23.11.2020, titullari i AK ka miratuar procedurën e prokurimit dhe shpalljen fituese të ofertës së OE B.A. SHPK me vlerë 155,875,500 lekë pa tvsh. Formulari i njoftimit të OE të suksesshëm në marrëveshjen kuadër nr. 1149/5, datë 23.11.2020.

Me anë të procesverbalit të datës 27.11.2020, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin e OE B.A. SHPK të shpallur fitues.

OE B.A. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 060465, datë 26.11.2020, me vlerë 19,562,445 lekë (10% e fondit limit).
Marrëveshja Kuadër nr. 1149/8, datë 01.12.2020, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.

Me anë të Urdhrit nr. 211, nr. 1149/9, datë 07.12.2020, titullari i AK ka ngarkuar znj. A.R. me detyrë shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër.

Në lidhje me personat e ngarkuar për këtë zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, konstatohet se ka një përqendrim të detyrave te znj. A.R., e konkretisht:
-Ka hartuar kërkesën për materiale me anë të shkresës nr. 1073, datë 22.09.2020.
-Ka hartuar fondin limin limit dhe specifikimet teknike, sipas Urdhrit nr. 158, nr 1073/1, datë 22.09.2020.
-Është anëtare e KVO, sipas Urdhrit nr. 162, nr. 1149/1, datë 08.10.2020.
-Është caktuar si personi përgjegjës për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, sipas Urdhrit nr. 211, nr. 1149/9, datë 07.12.2020.
Ky përqëndrim i detyrave është këryer në kundërshtim me:
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar
Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 20, pika 1 dhe pika 2/c, si dhe neni 22, pika 3/b, të cilat përcaktojnë se:

Neni 20
1. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.
2. Mjedisi i kontrollit përmban:
c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
Neni 22
3. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:
b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK si dhe znj A.R..

Me anë të shkresës nr. 1149/10, datë 07.12.2020, drejtuar titullarit të AK, znj. A.R. ka dërguar kërkesësn për artikujt sipas Marrëveshjes Kuadër (39,936 Set Kit, si dhemateriale të tjera), kërkesë e cila është e miratuar nga shefja e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive znj. S.B..
Me anë të shkresës nr. 1149/11, datë 07.12.2020, drejtuar OE B.A. SHPK, titullari i AK i ka dërguar ftesën për të ofruar ofertë dhe për të nënshkruar kontratën për sasinë sipas kërkesës të ardhur me anë të shkresës nr. 1149/10, datë 07.12.2020.
Me anë të shkresës datë 10.12.2020, protokolluar në ISHP me nr. 1149/12, datë 10.12.2020, OE

B.A. SHPk ka dorëzuar ofertën në vlerën totale 42,861,240 lekë pa tvsh (ose 51,433,488 lekë me tvsh), sipas çmimeve të Marrëveshjes Kuadër nr. 1149/8, datë 01.12.2020.
Kontrata e furnizimit nr. 1149/13, datë 11.12.2020, me vlerë 51,433,488 lekë me tvsh, me 60 ditë nga nënshkrimi i minikontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.
Me anë të Urdhrit nr. 215, nr. 1149/14, datë 11.12.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim të përbërë nga E.B., S.M. dhe H.M..

OE B.A. SHPK ka sjellë mallrat e kontraktuara sipas faturave të mëposhtme:
Me anë të faturës tatimore nr. 2763, datë 17.12.2020, me vlerë 28,499,088 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 1, datë 17.12.2020, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 17, datë 17.12.2020. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 561, datë 24.12.2020, me vlerë 24,499,088 lekë.
Me anë të faturës tatimore nr. 365, datë 22.12.2020, me vlerë 21,813,600 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 2, datë 29.12.2020, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 21, datë 29.12.2020. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 589, datë 31.12.2020, me vlerë 21,813,600 lekë.
Me anë të faturës tatimore nr. 156/2021, datë 12.02.2021, me vlerë 1,120,800 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 3, datë 12.02.2021, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 1, datë 12.02.2021. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 135, datë 27.04.2021, me vlerë 1,120,800 lekë.

Me anë të shkresës të datës 10.02.2021, protokolluar në ISHP me nr. 201, datë 10.02.2021, OE B.A. SHPK njofton ISHP se është në pamundësi të lëshimit të faturës elektronike, për arsye se të dhënat e ISHP nuk janë në data-bazën e të dhënave për Entet Publike në Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore.
Në zbatim të kësaj shkrese, me anë të shkresës nr. 201/1, datë 10.02.2021, drejtuar OE B.A. SHPK, titullari i AK e njofton se afati i fundit i lëvrimit shtyhet me 15 ditë, me qëllim hapjen e sistemit të fiskalizimit për ISHP.
Aneks-Kontrata nr. 201/2, datë 10.02.2021, nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK, parashikon shtyrjen me 15 ditë të afatit të lëvrimit.

Kontrata e furnizimit nr. 311/3, datë 09.03.2021, me vlerë 57,540,600 lekë me tvsh, me 4 muaj nga nënshkrimi i minikontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.
Me anë të faturës tatimore nr. 279/2021, datë 12.03.2021, me vlerë 36,706,776 lekë lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 1, datë 12.03.2021, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 3, datë 12.03.2021. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 136, datë 27.04.2021, me vlerë 36,706,776 lekë.

4. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh, Shkurt 2018.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPV, etj."		
1. Urdhër Prokurimi nr. 224/4, datë 26.02.2018	**3. Njësia e prokurimit** H.I.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 224/5, datë 26.02.2018.

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapur me mjete elektronikeò	L.S. A.M.	B.V. E.A. I.H.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 13,743,700 lekë	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** 13,684,000 lekë (99.57% e fondit limit)	**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 59,700 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 02.04.2018, ora 11:00	**9. Burimi i Financimit** Buxhetit i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. B.A. SHPK.
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A	**13. Përgjigje ankesës nga KPP** N/A

b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës: Kontrata e furnizimit nr. 224/13, datë 11.05.2018.	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 16,420,800 lekë me TVSH		**16. Likuiduar:** 16,420,800 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë -nr. 0448, datë 07.06.2018, me vlerë 838,800 lekë; -nr. 0500, datë 27.06.2018, me vlerë 3,291,000 lekë; -nr. 0532, datë 10.07.2018, me vlerë 7,654,800 lekë; -nr. 0582, datë 02.08.2018, me vlerë 240,000 lekë; -nr. 0649, datë 04.09.2018, me vlerë 2,803,200 lekë; -nr. 0760, datë 08.10.2018, me vlerë 1,020,000 lekë; -nr. 0772, datë 10.10.2018, me vlerë 573,000 lekë.	**18. Afati i kontratës:** 5 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** JO	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Procesverbal i marrjes në dorëzim** -nr. 1, datë 07.06.2018; -nr. 2, datë 27.06.2018; -nr. 3, datë 10.07.2018; -nr. 4, datë 02.08.2018; -nr. 5, datë 04.09.2018; -nr. 6, datë 08.10.2018; -nr. 7, datë 10.10.2018;	**23. Grupi i marrjes në dorëzim** Urdhri nr. 224/15, datë 16.05.2018: E.A, X.M. dhe H.M..		**24. Fletë Hyrja**: -nr. 4, datë 07.06.2018; -nr. 5, datë 27.06.2018; -nr. 6, datë 10.07.2018; -nr. 11, datë 02.08.2018; -nr. 13, datë 04.09.2018; -nr. 16, datë 08.10.2018; -nr. 17, datë 10.10.2018.	

Me anë të shkresës nr. 1673/9, datë 27.12.2019, Shefi i Sektorit të Laboratorëve z. S.Q, ka dërguar kërkesën për materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPV, etj, për vitin 2018.

Me anë të Urdhrit nr. 26, nr. 224, datë 19.02.2018, titullari i AK ka ngritur grupin për hartimin e specifikimeve teknike, kërkesave të veçanta për kualifikim dhe përllogaritjen e fondit, të përbërë nga S.Q, M.D. dhe X.M..

Me anë të relacionit nr. 224/3, datë 23.02.2018, komisioni ka përllogaritur vlerën e fondit limit 13,743,700 lekë pa tvsh, duke u bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme si dhe studimin e tregut për 2 artikuj që nuk ishin prokuruar gjatë vitit 2017.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 224/4, datë 26.02.2018, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPV, etj.*ò, me fond limit në vlerën 13,743,700 lekë pa tvsh, me procedurë ñE hapur me mjete elektronike-Mallraò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga H.I., L.S. dhe A.M..
Ndërsa me Urdhrin nr. 224/5, datë 26.02.2018, ka përcaktuar komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga B.V., E.A. dhe I.H..

Me anë të Procesverbalit nr. 1, datë 27.02.2018, Njësia e Prokurimit ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Nga verifikimi i këtyre kritereve, u konstatua se:
-Në argumentimin e kritereve të veçanta për kualifikim, NJP ka përdorur si argument nenit 27 ñKontratat e mallraveò, po pa argumentuar teknikisht vendosjen e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

-Në Shtojcën 9, pika 2.2.1.b, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet te zoteroje vleren monetare prej 10% te fondit limit te lotit/loteve per te cilat ofrojne e cila do te mbuloje shpenzimet paraprake per fillimin e zbatimit te kontrates. Kjo vertetohet me anen e nje Deklarate te Gjendjes Financiare te tij te leshuar nga nje ose me shume banka jo me shume se 20 dite perpara dates se hapjes se procedures se tenderit*ò. Vendosja e kësaj kërkese, duke qenë se nuk parashikohet më në RRPP, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27.
-Në specifikimet teknike të përdorura, NjP ka përdorur emra markash pa shtuar tog-fjalëshin ñ*ose ekuivalent*ò, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e cila përcakton se:

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 224/6, datë 28.02.2018, është publikuar në Buletinin e APP datë 05.03.2021. Data e zhvillimit të procedurës do jetë data 26.03.2018, ora 11:00.
Me anë të shtojcës nr. 224/7, datë 13.03.2021, NJP kryen modifikimin e DST sipas rekomandimeve të APP. Data e re e zhvillimit të procedurës do jetë data 02.04.2018, ora 11:00.

Në datën e hapjes së ofertave, ka marrë pjesë vetëm OE B.A. SHPK me ofertë 13,684,000 lekë pa tvsh. Sipas procesverbalit të vlerësimit të datës 13.04.2018, KVO e ka kualifikuar këtë OE.

Me anë të Vendimit të Miratimit nr. 224/9, datë 23.04.2018, titullari i AK ka miratuar Raportin Përmbledhës nr. 224/8, datë 23.04.2018, ku propozohet miratimi i procedurës së prokurimit dhe shpallja fituese e ofertës së OE B.A. SHPK me vlerë 13,684,000 lekë pa tvsh.
Formulari i njoftimit të fituesit nr. 224/10, datë 25.04.2018, u publikua në Buletinin e APP datë 30.04.2018.
Me anë të procesverbalit të datës 11.05.2018, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin e OE B.A. SHPK të shpallur fitues dhe me shkresën nr. 224/12, datë 11.05.2018, ka informuar titullarin e AK për ndjekjen e hapave ligjore për lidhjen e kontratës.

OE B.A. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 0051624, datë 02.05.2020, me vlerë 1,642,080 lekë (10% e kontratës).
Kontrata e furnizimit nr. 224/13, datë 11.05.2018, me vlerë 16,420,800 lekë me tvsh, me afat 5 muaj nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.
Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 224/14, datë 16.05.2018, është publikuar në Buletinin e APP datë 21.05.2018.

Me anë të Urdhrit nr. 224/15, datë 16.05.2018, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga E.A, X.M. dhe H.M..

OE B.A. SHPK ka sjellë mallrat e kontraktuara sipas faturave të mëposhtme:
-Me anë të faturës tatimore nr. 0448, datë 07.06.2018, me vlerë 838,800 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 1, datë 07.06.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 4, datë 07.06.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 245, datë 13.07.2018, me vlerë 838,800 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0500, datë 27.06.2018, me vlerë 3,291,000 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 2, datë 27.06.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 5, datë 27.06.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 246, datë 13.07.2018, me vlerë 3,291,000 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0532, datë 10.07.2018, me vlerë 7,654,800 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 3, datë 10.07.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 6, datë 10.07.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 247, datë 13.07.2018, me vlerë 7,654,800 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0582, datë 02.08.2018, me vlerë 240,000 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 4, datë 02.08.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 11, datë 02.08.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 296, datë 20.08.2018, me vlerë 20.08.2018 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0649, datë 04.09.2018, me vlerë 2,803,200 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 5, datë 04.09.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 13, datë 04.09.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 322, datë 12.09.2018, me vlerë 2,803,200 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0760, datë 08.10.2018, me vlerë 1,020,000 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 6, datë 08.10.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 16, datë 08.10.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 389, datë 22.10.2018, me vlerë 1,020,000 lekë.
-Me anë të faturës tatimore nr. 0772, datë 10.10.2018, me vlerë 573,000 lekë me tvsh. Mallrat e dorëzuara janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 7, datë 10.10.2018, nga grupi i marrjes në dorëzim, si dhe janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 17, datë 10.10.2018. Fatura është likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 396, datë 22.10.2018, me vlerë 573,000 lekë.

5. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñMateriale dhe kite per kerkim dhe diagnostikim per laboratorin e biologjise molekulare, semundjeve infektive emergjente, si dhe

HIV, HEP, HPV, etj. blerjeò, me fond limit 7,995,000 lekë pa tvsh, Gusht 2019.

<table>
<tr><td colspan="6">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale dhe kite per kerkim dhe diagnostikim per laboratorin e biologjise molekulare, semundjeve infektive emergjente, si dhe HIV, HEP, HPV, etj. blerje”</td></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 1180, datë 08.08.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñKërkesë për propozimò</td><td colspan="2">3. Njësia e prokurimit
S.Q
A.M.
B.V.</td><td colspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 381, nr. 1180/1, datë 08.08.2019.
A.A.
E.A.
I.H.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa tvsh)
7,995,000 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)
7,950,500 lekë
(99.44% e fondit limit)</td><td colspan="2">7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
44,500 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
19.08.2019, ora 09:00</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxhetit i Shtetit</td><td colspan="2">10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. B.A. SHPK.</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
JO</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
N/A</td><td colspan="2">13. Përgjigje ankesës nga KPP
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="6">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. Lidhje e kontratës:
Kontrata e furnizimit nr. 1180/8, datë 12.09.2019.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
9,540,600 lekë me TVSH</td><td colspan="2">16. Likuiduar:
9,540,600 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë
Sipas tabelës</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës:
Deri më 31.12.2019</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë
JO</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Procesverbal i marrjes në dorëzim
Sipas tabelës</td><td colspan="2">23. Grupi i marrjes në dorëzim
Urdhri nr. 415, nr. 1180/10, datë 16.09.2019:
E.A, X.M. dhe H.M..</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja:
Sipas tabelës</td></tr>
</table>

Me anë të Urdhrit nr. 247, nr. 704, datë 27.05.2019, titullari i AK ka ngritur grupin për hartimin e specifikimeve teknike, kërkesave të veçanta për kualifikim dhe përllogaritjen e fondit, të përbërë nga S.Q, B.V. dhe X.M..
Me anë të relacionit nr. 704/1, datë 24.06.2019, komisioni ka përllogaritur vlerën e fondit limit 7,995,000 lekë pa tvsh, duke u bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 30, nr. 1180, datë 08.08.2019, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Materiale dhe kite per kerkim dhe diagnostikim per laboratorin e biologjise molekulare, semundjeve infektive emergjente, si dhe HIV, HEP, HPV, etj. blerje, etj.*ò, me fond limit në vlerën 7,995,000 lekë pa tvsh, me procedurë ñKërkesë për propozimò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga S.Q, B.V. dhe A.M..
Ndërsa me Urdhrin nr. 1180/1, datë 08.08.2019, ka përcaktuar komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga A.A., E.A. dhe I.H..

Me anë të Procesverbalit nr. 1, datë 08.08.2019, Njësia e Prokurimit ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Në argumentimin e kritereve të veçanta për kualifikim, NJP ka përdorur si argument nenit 27 ñKontratat e mallraveò, po pa argumentuar teknikisht vendosjen e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i

vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndërsa me anë të procesverbalit nr. 2, datë 08.08.2019, ka përzgjedhur për ti dërguar ftesën për ofertë, OE M. SHPK, A. SHPK, E., B.A.D. SHPK dhe B.A. SHPK, por nuk ka argumentuar arsyen e përzgjedhjes së këtyre OE, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 39, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 1180/2, datë 08.08.2019, është publikuar në Buletinin e APP datë 13.08.2021. Data e zhvillimit të procedurës do jetë data 19.08.2019, ora 11:00.

Në datën e hapjes së ofertave, ka marrë pjesë vetëm OE B.A. SHPK me ofertë 7,950,500 lekë pa tvsh. Sipas procesverbalit të vlerësimit të datës 19.08.2019, KVO e ka kualifikuar këtë OE.

Me anë të Vendimit të Miratimit nr. 1180/4, datë 02.09.2019, titullari i AK ka miratuar Raportin Përmbledhës nr. 1180/3, datë 29.08.2019, ku propozohet miratimi i procedurës së prokurimit dhe shpallja fituese e ofertës së OE B.A. SHPK me vlerë 7,950,500 lekë pa tvsh.
Formulari i njoftimit të fituesit nr. 1180/5, datë 02.09.2019.
Me anë të procesverbalit të nr. 1180/7, datë 06.09.2019, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin e OE B.A. SHPK të shpallur fitues dhe informon titullarin e AK për ndjekjen e hapave ligjore për lidhjen e kontratës.

OE B.A. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës, me vlerë 954,060 lekë (10% e kontratës).
Kontrata e furnizimit nr. 1180/8, datë 12.09.2019, me vlerë 9,540,600 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2019, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK.
Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 1180/9, datë 16.09.2019.

Me anë të Urdhrit nr. 415, nr. 1180/10, datë 16.09.2019, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga E.A, X.M. dhe H.M..
Zbatimi i kësaj kontrate, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Urdhër-Shpenzimi			**Fatura**			**Fletë-Hyrja**		**Procesverbali i marrjes në dorëzim**	
Nr.	**Datë**	**Vlerë**	**Nr.**	**Datë**	**Vlerë**	**Nr.**	**Datë**	**Nr.**	**Datë**
380	07/10/2019	694,800	1667	17/09/2019	694,800	4	17/09/2019	1	17/09/2019
381	07/10/2019	240,000	1670	18/09/2019	240,000	5	18/09/2019	2	18/09/2019
382	07/10/2019	145,200	1675	19/09/2019	145,200	6	19/09/2019	3	19/09/2019
394	08/10/2019	650,400	1697	25/09/2019	650,400	7	25/09/2019	4	25/09/2019
414	16/10/2019	618,000	1720	03/10/2019	618,000	9	03/10/2019	5	03/10/2019
423	18/10/2019	3,348,000	1722	04/10/2019	3,348,000	10	04/10/2019	6	04/10/2019
454	24/10/2019	680,400	1758	15/10/2019	680,400	12	15/10/2019	7	15/10/2019
494	14/11/2019	2,755,800	1815	05/11/2019	2,755,800	15	05/11/2019		
587	24/12/2019	408,000	1942	24/12/2019	408,000	19	24/12/2019		

6. Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etjò, me fond limit 8,159,500 lekë lekë pa tvsh, Mars 2020.

<table>
<tr><td colspan="6">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etj”</td></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 10, nr. 373/2, datë 10.03.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñE hapurò</td><td colspan="2">3. Njësia e prokurimit
S.Q
A.M.
A.R.</td><td colspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 39, nr. 373/3, datë 10.03.2020.
A.A.
E.A.
B.V.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa tvsh)
8,159,500 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)
8,149,500 lekë
(99.88% e fondit limit)</td><td colspan="2">7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
10,000 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
06.04.2020, ora 11:00</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxhetit i Shtetit</td><td colspan="2">10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. B.A. SHPK,
2. K. SHPK.</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
JO</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
N/A</td><td colspan="2">13. Përgjigje ankesës nga KPP
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="6">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. Lidhje e kontratës:
Kontrata e furnizimit nr. 373/9, datë 14.05.2020.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
9,779,400 lekë me TVSH</td><td colspan="2">16. Likuiduar:
9,779,400 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë
Sipas tabelës</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës:
Deri më 31.12.2020</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë
JO</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td colspan="2">Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td colspan="2">Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Procesverbal i marrjes në dorëzim
Sipas tabelës</td><td colspan="2">23. Grupi i marrjes në dorëzim
Urdhri nr. 822, nr. 373/12 prot., datë 28.05.2020:
S.Q, L.S. dhe H.M..</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja:
Sipas tabelës</td></tr>
</table>

Me anë të Urdhrit nr. 37, nr. 373, datë 05.03.2020, titullari i AK ka ngritur grupin për hartimin e specifikimeve teknike, kërkesave të veçanta për kualifikim dhe përllogaritjen e fondit, të përbërë nga A.R., M.D. dhe B.A..
Me anë të relacionit nr. 373/1, datë 09.03.2020, komisioni ka përllogaritur vlerën e fondit limit 8,159,500 lekë pa tvsh, duke u bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 10, nr. 373/2, datë 10.03.2020, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etj, etj.*ò, me fond limit në vlerën 8,159,500 lekë pa tvsh, me procedurë ñE hapurò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga S.Q, A.R. dhe A.M..
Ndërsa me Urdhrin nr. 39, nr. 373/3, datë 10.03.2020, ka përcaktuar komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga A.A., E.A. dhe B.V..

Me anë të Procesverbalit nr. 1, datë 10.03.2020, Njësia e Prokurimit ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Në argumentimin e kritereve të veçanta për kualifikim, NJP ka përdorur si argument nenit 27 ñKontratat e mallraveò, po pa argumentuar teknikisht vendosjen e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e

rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 373/4, datë 11.03.2020, është publikuar në Buletinin e APP datë 17.03.2021. Data e zhvillimit të procedurës do jetë data 06.04.2020, ora 11:00.

Në datën e hapjes së ofertave, ka marrë pjesë OE B.A. SHPK me ofertë 8,149,500 lekë pa tvsh dhe OE K. SHPK pa ofertë. Sipas procesverbalit të vlerësimit të datës 14.04.2020, KVO e ka kualifikuar OE B.A. SHPK dhe skualifikuar OE K. SHPK.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 373/5, datë 23.04.2020, të miratuar nga titullari i AK, miratohet procedura e prokurimit dhe shpallja fituese e ofertës së OE B.A. SHPK me vlerë 8,149,500 lekë pa tvsh. Formulari i njoftimit të fituesit nr. 373/6, datë 23.04.2020.
Me anë të procesverbalit të nr. 373/8, datë 30.04.2020, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin e OE B.A. SHPK të shpallur fitues dhe informon titullarin e AK për ndjekjen e hapave ligjore për lidhjen e kontratës.

OE B.A. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 055679, datë 28.04.2020, me vlerë 977,950 lekë (10% e kontratës).
Kontrata e furnizimit nr. 373/9, datë 14.05.2020, me vlerë 9,779,400 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2020, është nënshkruar nga znj. A.F. për ISHP dhe z. A.K. për OE B.A. SHPK. Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 373/10, datë 18.05.2020.

Me anë të Urdhrit nr. 82, nr. 373/12 prot., datë 28.05.2020, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga S.Q, L.S. dhe H.M..
Zbatimi i kësaj kontrate, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Urdhër-Shpenzimi			Fatura			Fletë-Hyrja		Procesverbali i marrjes në dorëzim		Shënime
Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Nr.	Datë	
420	13/10/2020	1,386,000	239	23/09/2020	1,386,000	10	23/09/2020	1	23/09/2020	Nuk provohet skadenca
464	29/10/2020	1,269,600	2552	02/10/2020	1,269,600	11	02/10/2020	2	02/10/2020	Nuk provohet skadenca
494	17/11/2020	2,268,000	2659	09/11/2020	2,268,000	14	09/11/2020	3	09/11/2020	Provohet Skadenca
495	17/11/2020	886,800	308	11/11/2020	886,800	15	11/11/2020	4	11/11/2020	Provohet Skadenca
570	28/12/2020	3,969,000	2782	23/12/2020	3,969,000	18	23/12/2020	5	23/12/2020	Nuk provohet skadenca

Nga verifikimi i Urdhër-Shpenzimeve të mësipërme, si dhe dokumentacionit përkatës, konstatohet se për Urdhër-Shpenzimet nr. 420, datë 13.10.2020, me vlerë 1,386,000 lekë, nr. 464, datë 29.10.2020, me vlerë 1,269,600 lekë dhe nr. 570, datë 28.12.2020, me vlerë 3,969,00 lekë, nga

verifikimi i dokumentacionit shoqërues të praktikave, nuk konstatohet data e skadencës së këtyre. Në procesverbalet e marrjes në dorëzim, grupi i marrjes në dorëzim është shprehur vetëm se malli është në përputhje me skadencën, por që një fakt i tillë nuk provohet, nisur nga fakti që data e skadencës duhet të jetë 6-8 muaj nga data e marrjes së mallit në dorëzim.
Për sa më sipër, gjatë fazës së auditimit në terren, grupi i auditimit nuk mundi të shprehej mbi ligjshmërinë e materialeve të furnizuara nga OE B.A. SHPK **në vlerën 6,624,600 lekë**, për arsye të mos identifikimit të datës së skadencës së këtyre mallrave.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 1, e cila përcakton se:

1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 47, e cila përcakton se:

47. Në cdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhenat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dhe njofton shitësin për ti tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njesia publike në marrëdhënie me furnitorin).

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të ngritur me anë të Urdhrit të titullarit të AK nr. 82, nr. 373/12 prot., datë 28.05.2020: S.Q, L.S. dhe H.M..

Për sa më sipër janë mbajtur Akt-Konstatimet nr. 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, datë 30.07.2021.

9. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH.
-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19ò”</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 32 prot., datë 20.08.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur ï me mjete elektronike ñMarrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të parashikuara ï 12 muajò.</td><td>3. Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi nr. 32 prot., datë 20.08.2020: A.R., M.K., A.M.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 133, datë 20.08.2020 Përbërja; S.B., A.A., L.S..</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa tvsh)
Total 50,515,000 Mesatarja e çmimeve për njësi 705,250 lëkë pa TVSH</td><td>6. Oferta Fituese (pa tvsh)
47,770,000 lekë pa TVSH TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
2,745,000 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave
18.09.2020 ora 10:00</td><td>9. Burimi i Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. B.A. shpk;
2. G. shpk;
3. E. shpk.</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
JO</td><td>12. Përgjigje e ankesës nga AK
N/A</td><td>13. Përgjigje ankesës nga AKKP-
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhje e kontratës
1. Marrëveshje kuadër 947/11, datë 09.10.2020</td><td>15. Vlera e kontratës (me tvsh)
67,985,000 lekë</td><td>16. Likuiduar
Fatura të likuiduara nga MSHMS</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni përfundimtar /faturë</td><td>18. Afati i kontratës në ditë</td><td>19. Zgjatja e kontratës me</td></tr>
</table>

malli/shërbimi datë	12 muaj		**ditë** 365	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Akt Kolaudimi** Po	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr:	

Procedura ka nisur me urdhrin nr. 125, datë 12.08.2020 ñPër argumentimin e fondit limit të prokurimit me objekt ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò ku ngarkohen I.H., M.K. dhe A.M. me këtë detyrë. Me shkresën nr. 917/9, datë 18.08.2020 drejturar titullarit të AK grupi i punës ka hartuar përgjigjen për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò. Kërkesa për miratim fondi i është drejtuar MSHMS më shkresën nr. 733/1, datë 28.07.2020 dhe miratimi nga MSHMS ka ardhur me shkresën nr. 2598/8, datë 03.08.2020, nëpërmjet të cilës MSHMS vendos ti lejojë ISHP kryerjen e kësaj procedure. Kërkesa ka ardhur nga Sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Sëmundjeve Infektive me shkresën nr. 831/1, datë 27.07.2020.
Ky prokurim ka nisur në vijim të kërkesës së Sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Sëmundjeve Infektive. Në përllogaritjen e fondit limit grupi i punës është bazuar në metodën e testimin të çmimeve të tregut për të identifikuar çmimin për njësi për përllogaritjen e fondit limit të nevojshëm për një artikull për të cilin nuk ka çmim reference përkatës.

Nr.	Artikulli	Amballazhi	Njësia	Sasia
1	Kit tuba me kapak për Real Time PCR	Kit me 960 tuba dhe kapakë	kit	20

Për këtë arsye AK i është drejtuar OE të mëposhtëm për të marrë ofertat përkatëse:
- A. shpk me shkresë nr. 917/1, datë 12.08.2020. OE përgjigjur me shkresën 917/5, datë 14.08.2020;
- B.A.D. me shkresë nr. 917/2, datë 12.08.2020. OE përgjigjur me shkresën 917/6, datë 14.08.2020;
- B.A. shpk me shkresë nr. 917/3, datë 12.08.2020. OE përgjigjur me shkresën 917/7, datë 14.08.2020;
- M. shpk me shkresë nr. 917/4, datë 12.08.2020. OE përgjigjur me shkresën 917/7, datë 14.08.2020,

Pas përgjigjes së marrë nga OE të mësipërm për çmimin për njësi të artikullit për të cilin nuk ka çmim referimi grupi i punës bazuar në kërkesën e shërbimit përkatës ka hartuar fondin limit bazuar në kontratat e mëparshme dhe në studimin e tregut për artikullin e ri, në total 6 artikuj si më poshtë:

Nr	PERSHKRIMI MALLIT			Njesia	Sasia për 12 muaj	Cmimi për njësi	Fondi Limit
	Artikulli	Specifkimet teknike	Lloji i amballazhit				
1	Maja mikropipete 1000 ε l per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 1000 ε l (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja) /rack per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex	96 maja/rack	rack	800	1,925	1,540,000
2	Maja mikropipete 200 ε l per manipulim ne biologjine	Maja mikropipete 200 ε l (DNAs/RNAs free) sterile, me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosolet, paketim unik 96 tips (maja)/rack per Micropipeta Eppendorf dhe Socorex	96 maja/rack	rack	400	1,925	770,000

	molekulare						
3	Maja mikropipete 20 ε l per manipulim ne biologjine molekulare	Maja mikropipete 20 ε l (DNAs/RNAs free) sterile,me filter me densitet te larte per mbrojtjen nga aerosole paketim unik 96 tips (maja)/rack Micropipeta Eppendorf dhe Socorex	96 maja/ rack	rack	200	1,925	385,000
4	Kit tuba me kapake per Real-Time PCR	Tubat duhet te jene te pershtatshem per manipulime me instrumentin MIC Real-Time PCR. Kiti duhet te permbaje: 1.Tuba polipropileni te vendosur ne stripe katershe ne 5 stative me12 stripe secili. Nje kit duhet te permbaje 960 tuba dhe kapake: 4 grupe te paketuar vec e vec me nga 5 stative x 12 sripe sejcili. Tubat duhet te mundesojne perdorimin e te pakten nje vellimi prej 5 ε l reaksioni PCR. 2. Kapake per tuba, te paketuar vec. Kapaket te kene zgjatime te sheshta per te mundesuar manipulimin dhe etiketimin e tyre. 3. Kapse per kapaket	kit me 960 tuba dhe kapake	kit	20	31,000	620,000
5	Kit me reagente per kryerjen e teknikes molekulare sasiore one-step real time RT-PCR.	Kiti duhet te jete i pershtatshem per teknologjine e bazuar ne sonda fluorogjenike(TaqMan). Reagente perberes te kitit duhet te jene : 1)Enzimen transkriptase te kundert(RT) si nje version i MMLV-RT ose ekuivalente me perqendrim 25x ose 50X e cila redukton aktivitetin e e RNAse H per te prodhuar qendrueshmeri termale. Kjo enzime duhet te sintetizoje ADN-citoplazmike ne intervalin e temperatures 40°C - 60°C. 2)Enzimen ADN polimeraze me efekt antitrupash qe bllokojne aktivitetin e polimerizimit ne temperature ambjenti dhe e aktivizon mbas hapit te denatyrimit te PCR-se duke dhene nje rritje te ndjeshmerise, specificitetit dhe produktit. 3) Perzierje 2X e pasuruar me (dNTPs; sulfat magnezi ose klorur magnezi, perfshire ROX, stabilizues etj). Kiti duhet te jete i pershtatshem per aparatet ABI7500; ABI7500Fast. Paketime (nga 50-1250 reaksione/kit)	50-1250 reaksione/kit	reaksione	30,000	490	14,700
6	Viral RNA Kit	Kit per izolimin dhe purifikimin e acideve nukleike virale (kryesisht ARN) nga lengjet e trupit te njeriut pa qeliza(plazma dhe serum, urine, lengu cerebrospinal ose te tjera ekuivalente) si edhe supernatant te kulturave qelizore e mostra virale si lavazhet bronkoalveolare apo ekuivalente me ane te kolonave te pajisura me membrana filtruese prej dioksid silikoni ose silika. Kiti duhet te permbaje ARN carrier, buferin lizues, shpelaresin e membranave si dhe tubat mbledhes. Te kete rendiment ekuivalent te 90% te produktit te matreialit gjenetik edhe nga mostra me sasi te kufizuar (yield).Te kete kryer kontroll cilesie me kampione humane. Paketimi te jete 50 deri ne 500 reaksione /kit.	50-500 reaksione/kit	reaksione	50,000	650	32,500
					Çmimi për njësi	**37,915**	**50,515,000**
						TVSH	**17,470,000**
						TOTAL	**67,985,000**

Nga të dhënat e mësipërme fondi limit është përllogaritur duke përllogaritur çmimin për njësi për secilin artikull shumëzuar për sasinë e kërkuar nga ku rezulton të jetë në vlerën 50,515,000 lekë pa TVSH, ose 67,985,000 lekë me TVSH.

Lidhur me sa më sipër është konstatuar se nuk është argumentuar nga AK përzgjedhja e OE për të dhënë ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në këtë fazë të procedurës së prokurimit në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku specifikohet se:

ñ*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*.

Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i punë për përllogartijen e fondit limit, I.H., M.K., A.M..

Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga auditimi konstatohet se në hartimin e tyre, AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por nuk i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar si më poshtë:

"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

*Në çdo rast, hartimi i tyre **duhet të argumentohet teknikisht** dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.".*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 32, datë 20.08.2010 urdhërohet kryerja e procedurës së sipërpërmendur duke përzgjedhur procedurën e hapur ï prokurim me mjete elektronike (shërbime), pasi është procedurë mbi kufirin e ulët monetar. Njësia e prokurimit e ngarkuar për këtë është përbërë si më poshtë: A.R., M.K. dhe A.M..

Me procesverbalin nr. 1 të datës 24.08.2020 janë hartuar dhe miratuar DST të kësaj procedure.
Me urdhrin nr. 133, datë 20.08.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje: S.B., Kryetar, dhe anëtarë A.A.dhe L.S..

Me procesverbalin e datës 11.09.2020 është kryer një modifikim në DST të kriterit 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë:

ISHTE
2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT
3. Kapaciteti teknik:
c) Në pikën 2.3 gërma ñcò të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose **CE** sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose 98/79EC (IVDD), të vlefshme, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyera dhe të noterizuara per artikujt 1, 2 dhe 3"*
BËHET
2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT
3. Kapaciteti teknik:
c) Në pikën 2.3 gërma ñcò të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose **CE** sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose 98/79EC (IVDD), të vlefshme,ose çertifikimi **FDA** për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyera dhe të noterizuara per artikujt 1, 2 dhe 3"*
Në përputhje me nenin 42 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò (të ndryshuar) afati kohor për dorëzimin e ofertave në sistemin elektronik për procedurën e prokurimit me objekt :**"Blerje kite dhe materiale të tjera për manipulim në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve për Covid-19 "**
ISHTE
DATA E ZHVILLIMIT TE PROCEDURES ISHTE 18/09/2020 ORA 10.00
BËHET
DATA E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS BËHET 23/09/2020 ORA 10.00

Më datë 24.09.2020 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO nga ku konstatohet se për këtë procedurë kanë hyrë në konkurrim elektronik 3 OE si më poshtë:
- B.A. shpk
- G. shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion përveç një ekstrakti nga QKB ï ja. Nuk ka ofertë ekonomike.
- E. shpk. (nuk ka dokumenta me numër NIPT- i)

Në këtë procesverbal specifikohet se vetëm OE B.A. shpk kishte sjellë dokumentacion për të cilin mund të kryej verifikim i gjendjes gjyqësore. Gjithashtu ky dokumentacioni i dërguar në SPE nga ky OE është gjykuari rregullt nga KVO, e si rrjedhojë KVO konstaton si ofertë të vetme të vlefshme atë të OE B.A. shpk me ofertë ekonomike në vlerën 47,770,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 947/7, prot., datë 05.10.2020 është hartuar raporti përfundimtar mbi procedurën e prokurimit drejtuar titullarit të institucionit dhe miratuar nga ky i fundit
Me shkresën nr. 947/8, datë 05.10.2020 është hartuar Formulari i njoftimit të OE të suksesshëm në MK.
Me shkresën nr. 947/10, datë 09.10.2020 KVO ka hartuar njoftimin për lidhjen e MK.
AK ï ISHP ka nënshkruar marrëveshjen kuadër me nr. 947/11, datë 09.10.2020. OE ka dorëzuar sigurimin e kontratës në vlerë 6,061,800 lekë.

Me shkresën nr. 947/12, datë 12.10.2020 ISHP ka dërguar njoftim për lidhje kontrate MSHMS .

Zbatimi i kontratës
Kjo procedurë është kryer nga ISHP nga fillimi deri në lidhjen e MK. Mini kontratat përkatëse janë nënshkruar nga MSHMS në vijim të kërkesave të ISHP. Marrja në dorëzim e materialeve të furnizuara është berë nga ISHP, ndërsa likuidimi i korrespondentit të mallrave në vlerë është kryer nga MSHMS.
Nga auditimi është konstatuar se është nënshkruar marrëveshja kuadër me nr. 947/11, datë 09.10.2020.
Me urdhrin nr. 171, datë 19.10.2020 ñPër personat përgjegjës përgatitjen e kërkesave në zbatim të marrëveshjes kuadër me nr. 947/11, datë 09.10.2020 për lidhjen e kontratave nga MSHMSò me anë të së cilit përcaktohet znj. A.R. me detyrën për të hartuar kërkesat për MSHMS ï në, e cila do të lidhë mini kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër.
Afatet e lëvrimit të mallit për secilin artikull janë si më poshtë:
1. Maja mikropipete 1000 ε l, 40% brenda 3 mujorit të parë dhe 60% në varësi të kërkesave të AK brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i mini kontratës;
2. Maja mikropipete 200 ε l, 40% brenda 3 mujorit të parë dhe 60% në varësi të kërkesave të AK brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i mini kontratës;
3. Maja mikropipete 20 ε l, 40% brenda 3 mujorit të parë dhe 60% në varësi të kërkesave të AK brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i mini kontratës;
4. Kit tuba me kapakë për Real-Time PCR, 40% brenda 2 mujorit të parë dhe 60% në varësi të kërkesave të AK brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i mini kontratës;
5. Kit me reagente per kryerjen e teknikes molekulare sasiore one-step real time RT-PCR, 40% brenda 3 mujorit të parë dhe 60% në varësi të kërkesave të AK brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i mini kontratës;
6. Viral RNA Kit, 10% e sasisë së pritshme do të lëvrohet menjëherë, brenda 3 ditëve nga lidhja e minikontratës. 40% brenda 3 mujorit të parë sipas kërkesës së AK dhe 50 % ne varësi të kërkesae të AK brenda 30 nga nënshkrimi i minikontratës.

- Me shkresën nr. 947/15, datë 19.10.2020 është hartuar kërkesa e parë nga ISHP drejtuar MSHMS, për artikullin nr, 6 Viral RNA kit në sasinë 5,000 reaksione menjëherë (brenda 3 ditëve) dhe 30,000 reaksione brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës.
Minikontrata është lidhur nga MSHMS me nr. 2598/15, datë 23.10.2020 me vlerë 24,325,000 lekë pa TVSH ose 29,190,000 lekë me TVSH për sasitë si më sipër. Me urdhrin nr. 176, datë 23.10.2020 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje X.M., S.M.dhe H.M..
Me shkresën nr. 947/18, datë 10.11.2021 i është përcjellë MSHMS dokumentacioni i marrjes në dorëzim të mallit të kërkuar me procesverbalin përkatës nr. 1 datë 23.10.2020 dhe fletë hyrjen nr. 83, datë 23.10.2020 për sasinë reaksione 25,000.
Me shkresën nr. 947/19, datë 10.11.2020 janë përcjellë dokumentacionet në MSHMS për marrjen në dorëzim të sasisë prej 10,000 reaksione të Viral RNA në vlerë 6,950,000 lekë pa TVSH ose 8,340,000 lekë me TVSH, me fletë hyrjen nr. 84, datë 02.11.2020 sipas procesverbalit nr. 2 të datës 02.11.2020.

Nr.	Kerkesa	Sasia e kërkuar	Procesverbali	Sasia e marrë në dorëzim
1	nr. 947/15, datë 19.10.2020		procesverbalin përkatës nr. 1 datë 23.10.2020	25,000
	Viral RNA	5,000 reaksione (brenda 3 ditëve); 30,000 (brenda 30 ditëve)	procesverbali nr. 2 të datës 02.11.2020	10,000
		35,000		35,000

- Me shkresën 947/20, datë 19.11.2020 dërgohet kërkesa për lidhje kontrate nga ISHP në MSHMS, për artikullin nr. 4 me emërtimin kit tuba me kapakë për Real time PCR, kit me 960 tuba dhe kapakë, në sasinë 5 kite; artikulli nr. 6, Viral RNA në sasinë 15,000 reaksione brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës. Për sa më sipër është nënshkruar mini kontrata nr. 2598/24, datë 26.11.2020 për sasitë e kërkuara më sipër në vlerë totale 10,577,500 lekë pa TVSH ose 12,693,000 lekë me TVSH. Me shkresën nr. 947/24, datë 04.12.2020 i janë përcjellë MSHMS dokumentacionet për marrjen në dorëzim të mallrave të kërkuara, me fletë hyrjen nr. 94, datë 01.12.2020 janë bërë hyrje në magazinë në IHSP sasitë e kërkuara; është mbjatur procesverbali nr. 3 më datë 01.12.2020.

Nr.	Kerkesa	Sasia e kërkuar	Procesverbali	Sasia e marrë në dorëzim
1	947/20, datë 19.11.2020 (brenda 30 ditëve)		procesverbali nr. 3 më datë 01.12.2020	
4	kit tuba me kapakë për Real time PCR	5 kite		5
	Viral RNA	15,000 reaksione		15,000 reaksione

- Me shkresën nr. 947/26, datë 10.12.2020 është bërë kërkesa nga ISHP për MSHMS për blerje të artikullit maja mikropipete 1000 ɛl për manipulim në biologjinë molekulare, 96/maja rack në sasinë 300 rack; për artikullin nr. 2 maja mikropipete 200 ɛl për manipulim në biologjinë molekulare, 96/maja rack në sasinë 150 rack; artikulli nr. 6, Viral RNA në sasinë 8000 reaksione.
Për sasitë si më sipër është nënshkruar nga MSHMS kontrata nr. 2598/28, datë 14.12.2020
- me procesverbalin nr. 4, datë 17.12.2020 janë marrë në dorëzim Viral RNA 8,000 reaksione bazuar në kërkesën më sipër dhe janë bërë hyrje në magazinë me fh nr. 99, datë 17.12.2020.
- me procesverbalin nr. 5, datë 24.12.2020 janë marrë në dorëzim 300 rack të artikullit 1 dhe 55 rack të artikullit 2.
- me procesverbalin nr. 6, datë 11.02.2021janë marrë në dorëzim 95 rack të artikullit 2.

Nr.	Kerkesa	Sasia e kërkuar	Procesverbali	Sasia e marrë në dorëzim
1	nr. 947/26, datë 10.12.2020		procesverbali nr. 5, datë 24.12.2020	
	mikropipete 1000 ɛl	300 rack		300 rack
	maja mikropipete 200 ɛl	150 rack	procesverbali nr. 6, datë 11.02.2021	55 rack + 95 rack
	Viral RNA	8000 reaksione	procesverbali nr. 4, datë 17.12.2020	8,000 reaksione

- Me shkresën nr. 310/1, datë 05.03.2021, është derguar kërkesa nga ISHP për artikullin1 në sasinë 250 rack, për artikullin 3 në sasinë 30 rack dhe për artikullin 6 në sasinë 3000 reaksione. Është nënshkruar kontrata 1327/3, datë 17.03.2021. Materialet janë marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 7, datë 19.03.2021 sipas kërkesës së ISHP.

Deri më datë 31.03.2020 sasitë e furnizuara me vlerat përkatëse janë si vijon:

Nr.	**Artikulli**	**Njësia matëse**	**Sasia**	**Çmimi për njësi**	**Vlera**	**Sasia e Furnizuar**	**Vlera**
1	Maja mikropipete 1000 ɛl	rack	800	1,900	1,520,000	550	1,045,000
2	Maja mikropipete 200 ɛl	rack	400	1,500	600,000	150	225,000
3	Maja mikropipete 20 ɛl	rack	200	1,500	300,000	30	45,000
4	Kit tuba me kapake per Real-Time PCR	kit	20	30,500	610,000	5	152,500

5	Kit me reagente per kryerjen e teknikes molekulare sasiore one-step real time RT-PCR.	reaksione	30,000	333	9,990,000		
6	Viral RNA Kit	reaksione	50,000	695	34,750,000	61,000	42,395,000
Çmimi për njësi				**37,915**	**50,515,000**	**61,735**	**43,862,500**
TVSH					**17,470,000**		**8,223,000**
TOTAL					**67,985,000**		**52,085,500**
Vlere e mbetur nga MK pa TVSH deri me 31.03.2021					**6,652,500**		
Vlere e mbetur nga MK me TVSH deri me 31.03.2021					**15,899,500**		

10. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH.
-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò"				
1. Urdhër Prokurimi nr. 22, datë 14.06.2019 **2.** lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim ï Mallra - me mjete elektronike	**3. Njësia e prokurimit** Urdhër Prokurimi nr. 22, datë 14.06.2019: A.M., L.S., E.A.		**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 329, datë 14.06.2019, Përbërja; A.A., S.Q, E.A..	
5. Fondi Limit (pa tvsh) **Total** 7,992,500	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** **7,992,500** lekë pa TVSH		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 0	
8. Data e hapjes së ofertave 19.03.2018 ora 11:00	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. S. shpk;	
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A		**13. Përgjigje ankesës nga AKKP-** N/A	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës 1. Kontrata nr. 766/15, datë 15.08.2019	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** **9,591,000 lekë**		**16. Likuiduar** Urdhër shpenzim nr. 361, datë 18.09.2019 vlerë 9,591,000 lekë me TVSH.	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë	**18. Afati i kontratës në ditë** 14.09.2018		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** 4 muaj	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Akt Kolaudimi** NA	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr: 2, datë 03.09.2019	

Procedura ka nisur me urdhrin nr. 309, datë 05.06.2019 ñPër argumentimin e fondit limit të prokurimit me objekt ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò ku ngarkohen L.S., E.A dhe B.A.me këtë detyrë. Me shkresën nr. 766/1, datë 10.06.2019 drejturar titullarit të AK, grupi i punës ka hartuar përgjigjen për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit. Komisioni është mbledhur më datë 07.06.2019 për të filluar punën për zbatimin e urdhrit të mësipërm nisur edhe nga kërkesa për furnizim me mallrat e kërkuara dërguar me

shkresën nr. 1720/10, datë 31.12.2019 të Laboratorit të Biologjisë Molekulare në Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve Infektive.
Për çmimet e artikujve të kërkuar me shkresën cituar më sipër grupi i punës i është referuar kontratës të realizuar nga AK në vitin 2018. Artikullin nr. 5 Cobas Amplicor HCV Virus Test v 2.0 nuk do të prokurohet pasi ka dalë jashtë prodhimit.
Në zbatim të rekomandimit të APP me nr. 8197, datë 03.09.2018 ñMbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë dhe shërbimeò, grupi rekomandon:
1. artikujt të jenë të pajisur me certifikatën ISO 9001 ose 13484, nëpërmjet së cilës vërtetohet cilësia e prodhimit të prodhuesit;
2. ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë konformiteti CE për të gjitha artikujt të përkthyer dhe të noterizuar;
3. afati i skadencës të jetë 6 ï 8 muaj nga data e dorëzimit;
4. afati i lëvrimit të jetë 4 muaj.
Referuar dokumentacionit bashkëlidhur procesverbalit përllogaritja e fondit limit është si vijon:

Nr.	Artikulli	Sasia e kërkuar	Lloji i paketimit	Çmimi pa TVSH	Vlera Totale
1	HCV Test version 2.0	6	48 teste	480,000	2,880,000
2	HIV 1 Test v.2	4	48 teste	525,000	2,100,000
3	HBV Test Version 2.0	5	48 teste	460,000	2,300,000
4	High Pure Sistem Viral Nuvleic Acid Kit	15	48 teste	47,500	712,500
	Total pa TVSH				**7,992,500**
	TVSH				**1,598,500**
	Total me TVSH				**9,591,00**

Me urdhrin e prokurimit nr. 22, datë 14.06.2019 urdhërohet kryerja e procedurës së sipërpërmendur duke përzgjedhur procedurën kërkesë për propozim ï prokurim me mjete elektronike (mallra). Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure është pasi vlera e fondit limit ka rezultuar nën kufirin e ulët monetar (në zbatim të nenit 34 të LPP dhe nenit 39 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Njësia e prokurimit e ngarkuar për këtë është përbërë si më poshtë: A.M., L.S. dhe E.A..
Më datë 20.06.2019 është mbajtur procesverbali nr. 1 për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur. Me procesverbalin e cituar janë hartuar dhe miratuar DST të kësaj procedure.
Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga auditimi konstatohet se në hartimin e tyre, AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por nuk i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar si më poshtë:
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre ***duhet të argumentohet teknikisht*** *dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.".*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin nr. 329, datë 14.06.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje:, A.A.Kryetar, dhe anëtarë S.Q, E.A..

Me procesverbalin nr. 2 të datës 20.06.2019 ñPër përzgjedhjen e kandidatëve, hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurën e prokurimit ñkërkesë për propozimò me objekt ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan".* Në zbatim të pikës 4 të nenit 39 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, AK ka ftuar 5 operatorë ekonomik për të marrë pjesë

në këtë procedurë prokurimi bazuar në: përputhjen e objekt të veprimtarisë së tyre me objektin e procedurës; eksperiencën e gjatë në ushtrimin e aktivitetit të tyre ekonomik; realizimin e kontratave të mëparshme me të njëjtin objekt prokurimi me AK. Pesë OE të ftuara janë si vijon:
1. S. shpk;
2. B.A.D. shpk;
3. K. shpk;
4. A. shpk;
5. B.A. shpk.

Me shkresën nr. 766/4, datë 21.06.2019 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës me afat kohor për dorëzimi e ofertave datën 08.07.2019, ora 11:00, dhe për hapjen e ofertave datë 08.07.2019, ora 11:00.

Me shkresën nr. 766/5, datë 03.07.2019 ñMbi një ndryshim në afatin kohor të zhvillimit të procedurësò, njësia e prokurimit ka argumentuar se pas njoftimit nga OE S. u konstatua mospërputhje midis afatit kohor të zhvillimit të procedurës në formularin e njoftimit të kontratës (08.07.2019 ora 11:00) dhe në DST (07.07.2019 ora 11:00). Për këtë çështje njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin përkatës më datë 02.07.2019 nga ku rezulton se data e procedurës ndryshon: bëhet 15.07.2019 ora 11:00. Të dhënat e tjera të procedurës mbeten të pandryshuara. Me shkresën nr. 766/6, datë 03.07.2019, titullari i AK miraton ndryshimin përkatës në afatin kohor të procedurës.
KVO me përbërje A.A., S.Q dhe E.A. kanë proceduar me hapjen e fazës së vlerësimit të ofertave sipas afatit të përcaktuar më datë 15.07.2019 ora 11:00.

Më datë 15.07.2019 është mbajtur nga KVO procesverbali nr. 1, nga ku konstatohet se për këtë procedurë ka hyrë në konkurrim elektronik 1 OE si më poshtë:
- S. shpk, me ofertë ekonomike në vlerë **7,992,500** lekë pa TVSH.

Sipas procesverbalit KVO ka rezultuar se OE S. ka dorëzuar vërtetimin e debisë OSHEE me nr. 5880, datë 27.06.2019, me nr. kontrate TR1F020069171986, lëshuar nga OSHEE nga ku thuhet se deklaruesi (përfaqësuesi ligjor) është A.S., ndërkohë që nga ekstrakti historik i QKB rezulton të jetë përfaqësues ligjor J.Q.. Lidhur me sa më sipër KVO i drejtohet titullarit të AK me shkresën nr. 766/7, datë 15.07.2019 me qëllim verifikimin vërtetimit të debisë nr. 5880, datë 27.06.2019. Me shkresën nr. 766/8, datë 15.07.2019, titullari i AK i drejtohet OSHEE për verifikimi e shkresës cituar më sipër.

Më datë 19.07.2019, KVO mban procesverbalin nr. 2 për vlerësimin e ofertës së paraqitur nga OE S. shpk ku citohet se sipas përgjigjes së OSHEE me shkresën nr. 6427/1, datë 18.07.2019 (protokolluar në ISHP me nr, 766/9, datë 19.07.2019 e cila nuk gjendet në dosjen e prokurimit), ky institucion pranon që gabimisht ka vendosur emrin e A.S.t si përfaqësues ligjor në vend të J.Q.s dhe konfirmon se nuk ka detyrime për kontratën nr. TR1F020069171986. Për këtë arsye KVO e quan të rregullt si dokument dhe vijon me përfundimin e vlerësimit të procedurës së mësipërme. KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE rendit në vend të parë OE të vetëm S. shpk me ofertë ekonomike 7,992,500 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 766/10, datë 29.07.2019 është hartuar raporti përfundimtar për këtë procedurë nga njësia e prokurimit.

Me shkresën 766/11, datë 29.07.2019 ka dalë vendimi i miratimit të OE fitues për këtë procedurë: S. shpk me ofertë ekonomike në vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 766/12, datë 30.07.2019 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit.

AK dhe S. shpk kanë lidhur kontratën nr. 766/15, datë 15.08.2019 me vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH, ose 9,591,800 lekë me TVSH.
Me urdhrin nr. 403, datë 30.08.2019 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim për këtë kontratë me përbërje: B.V., L.S., H.M..

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në SPE krahasuar me DST konstatohet se:
- vërtetimi i debisë nr. 5880, datë 27.06.2019 lëshuar nga OSHEE është vetëm për kontratën nr. TR1F020069171986, ndërkohë që nga ekstrakti historik i këtij subjekti vërehet se ky subjekt ka dy adresa të ushtrimit të aktivitetit të tij të deklaruara: zyra qendore Njësia Bashkiake nr. 11, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 92, seksioni 4, Hyrja 28; Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit ï Magazinë shitje me shumicë Njësia Bashkiake nr. 11 Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 92, Seksioni 4, Kati 0. Lidhur me sa më sipër, OE ka paraqitur vërtetim debie vetëm për njërën nga dy adresat në të cilat ushtron aktivitetin pa specifikuar se cilës prej tyre i përket kontrata e cituar në vërtetimin e paraqitur. Ky veprim bie në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në shtojcën 8, pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, 1/d, e për pasojë nuk duhet të ishte kualifikuar për këtë kriter.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, pika 1 e LPP i cilin përcakton se:
"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, ***duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret*** *e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese"*, si edhe me nenin 66, pika 3 e VKM nr. 914 e cila citon se: *"Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara,* ***duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim****, të përcaktuara në dokumentet e tenderit."*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO – së.

Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte OE S. shpk e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se: ñ*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*.ò
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO - së.

Zbatimi i kontratës
Kontrata nr. 766/15, datë 15.08.2019 me vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH, ose 9,591,800 lekë me TVSH ka gjetur zbatim nëpërmjet 1 urdhër shpenzim1 si më poshtë:
Urdhër shpenzim nr. 361, datë 18.09.2019 vlerë 9,591,000 lekë me TVSH. Materialet janë marrë në dorëzim nëpërmjet procesverbalit nr. 1, datë 03.09.2019 dhe mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletëhyrjen nr. 2, datë 03.09.2019.

11. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH.
-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò**"**		
1. Urdhër Prokurimi nr. 33 prot., datë 21.08.2019	**3. Njësia e prokurimit** Urdhër Prokurimi nr. 33 prot., datë 21.08.2019: A.Y., L.S., A.M.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 396, datë 22.08.2019, Përbërja; S.B., A.A., E.A. ndryshuar me urdhrin nr. 409, datë 12.09.2019. Përbërja; S.Q, B.V., E.A.
2. lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur ï		

Mallra - me mjete elektronike				
5. Fondi Limit (pa tvsh) **Total 26,434,400**	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** **26,324,800** lekë pa TVSH		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)**	
8. Data e hapjes së ofertave 18.09.2019 ora 09:00	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. B.A. shpk;.	
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A		**13. Përgjigje ankesës nga AKKP-** N/A	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës 1. Kontrata nr.1190/17, datë 04.102019	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** **31,598,760 lekë**		**16. Likuiduar** Urdhër shpenzim nr. 511, datë 25.11.2019 vlerë 8,216,760 lekë me TVSH. Urdhër Shpenzim nr. 544, datë 23,373,000 lekë me TVSH	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë	**18. Afati i kontratës në ditë** 31.12.2019		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** 31.12.2019	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Akt Kolaudimi** Po	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr: FH nr. 16, datë 15.11.2019	

Procedura ka nisur me urdhrin nr. 387, datë 13.08.2019 ñPër argumentimin e fondit limit të prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò ku ngarkohen A.Y., L.S. dhe A.M. me këtë detyrë. Me shkresën nr. 1190/7, datë 20.08.2019 drejturar titullarit të AK grupi i punës ka hartuar përgjigjen për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò.
Nga auditimi konstatohet se nuk gjendet në dosjen përkatëse kërkesa për furnizim me mallrat sipas nevojave të institucionit për kryerjen e depistimit HPV për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj procedure në kundërshtim me nenin 12, pika 2, gërma a të LPP ku citohet se:
ñ2. *Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.*
Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose ***të nevojës për prokurim****, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës".*
Për sa më sipër mban përgjegjësi Titullari i institucionit, znj. A.F., në cilësinë e personit përgjegjës për nisjen e procedurës së prokurimit.

Grupi i punës është mbledhur më datë 16.09.2019 dhe ka vendosur të përdorë metodën e kontratave të ngashme duke ju referuar kontratës së realizuar nga AK në vitin 2018 dhe çmimeve të tregut për arsye se është shtuar një artikull për të cilin nuk ka çmim referimi. Për këtë të fundit AK i është drejtuar me shkresa OE të mëposhtëm:
- OE B.A. shpk me shkrësë 1190/1, datë 19.08.2019; kthyer përgjigje me shkresë 1190/4, datë 1190/4, datë 20.08.2019.
- OE B.A.D.shpk me shkresë nr. 1190/2, datë 19.08.2019; kthyer përgjigje me shkresën nr. 1190/5, datë 20.08.2019.
- OE M. shpk me shkresë nr. 1190/3, datë 19.08.2019; kthyer përgjigje me shkresë nr. 1190/6, datë 20.08.2019.

Bazuar në sa më sipër grupi i punës përllogariti çmimin e artikullit pa çmim reference bazuar në mesataren e ofertave për këtë artikull. Gjithashtu grupi, bazuar në rekomandimin nr. 1897, datë 03.09.2019 ñMbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbimeò, si edhe në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër rregullat e prokurimit publikò, i ndryshuar, komisioni ka rekomanduar: për artikullin 1 dhe 2 të jenë të pajisur me certifikatat ISO 9001 ose 13485 të vlefshme, certifikatë e konformitetit CE, afati i skadendës të jetë 10 ï 12 muaj, afati i lëvrimit deri në 3 muaj. Fondi limit për këtë procedurë është 26,434,400 lekë pa TVSH ose 32,719,894 lekë me TVSH.
Lidhur me sa më sipër është konstatuar se nuk është argumentuar nga AK përzgjedhja e OE për të dhënë ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në këtë fazë të procedurës së prokurimit në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku specifikohet se:
ñ*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*.
Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i punë për përllogartijen e fondit limit, A.Y., L.S. dhe A.M..

Me urdhrin e prokurimit nr. 33, datë 21.08.2019 urdhërohet kryerja e procedurës së sipërpërmendur duke përzgjedhur procedurën e hapur ï prokurim me mjete elektronike (mallra),. Njësia e prokurimit e ngarkuar për këtë është përbërë si më poshtë: A.Y., L.S. dhe A.M..
Më datë 21.08.2019 është mbajtur procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur. Me procesverbalin e cituar janë hartuar dhe miratuar DST të kësaj procedure.
Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga auditimi konstatohet se në hartimin e tyre, AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por nuk i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar si më poshtë:
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre ***duhet të argumentohet teknikisht*** *dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin nr. 396, datë 22.08.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje: S.B., Kryetar, dhe anëtarë A.A.dhe E.A.. Me urdhrin nr. 409, datë 12.09.2019 janë ndryshuar anëtarët e KVO ï së S.B.dhe A.A.me S.Q dhe B.V.. Anëtari i tretë nuk ka ndryshuar. Lidhur me këtë ndryshim PPP i institucioni ka hartuar për titullarin një memo të datës 12.09.2019 me lëndë ñNë lidhje me ndryshimin e anëtarëve të KVO për procedurën me objekt ñBlerje kite dhe reagonte e materiale për teknika CObas Taq Manò duke shpjeguar që dy anëtarët S.B.dhe A.A. nuk do të jenë prezent ditën e zhvillimit të procedurës. Nisur nga sa më sipër konstatohet se është bashkëlidhur në dosje një shkresë e cila i përket një procedure tjetër prokurimi pasi, këtu bëhet fjalë për procedurën e prokurimit të depistimit HPV, pavarësisht faktit që anëtarët e KVO që ndryshohen janë po të njëjtë.
Për sa më sipë mban përgjegjësi A.M., në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.

Me shkresën nr. 1190/10, datë 23.08.2019 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës me afat kohor për dorëzimi e ofertave datën 18.09.2019 ora 9:00, dhe për hapjen e ofertave datë 18.09.2019 ora 9:00.

Me urdhrin nr. 409, datë 12.09.2019 janë ndryshuar anëtarët e KVO ï së S.B.dhe A.A.me S.Q dhe B.V.. Anëtari i tretë nuk ka ndryshuar

Më datë 19.09.2019 është mbajtur procesverbali nr. 1 i vlerësimit të ofertave nga KVO nga ku konstatohet se për këtë procedurë ka hyrë në konkurrim elektronik vetëm 1 OE si më poshtë:
- B.A. shpk
Sipas procesverbalit KVO vlerësoi dhe verifikoi dokumentacionin e paraqitur online nga OE si dhe u krye verifikimi i ofertës ekonomike në vlerën 26,324,000 lekë pa TVSH. KVO i është drejtuar PPP me qëllim verifikimi e gjendjes gjyqësore të OE.
Verifikimi i gjendjes gjyqësore të OE është kryer nga PPP dhe rezulton i padënuar. Me procesverbalin nr. 2, datë 20.09.2019, KVO ka vijuar me kualifikimin e ofertës së OE pjesëmarrës në vlerën 26,324,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 1190/12, datë 01.10.2019, KVO ka hartuar raportin përfundimtar mbi këtë procedurë nga ku rezulton fitues OE i vetëm ofertues, B.A. shpk.
Me shkresën nr. 1190/13, datë 01.10.2019 është nënshkruar vendimi i miratimit të fituesit nga titullari i institucionit. Me shkresën nr. 1190/14, datë 01.10.2019 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit.
Me shkresën nr. 1190/16, datë 03.10.2019 është hartuar nga KVO njoftimi për ldhje kontrate drejtuar titullarit të ISHP.
Për sa më sipër AK ISHP dhe OE B.A. shpk ka nënshkruar kontratën nr. 1190/17, datë 04.10.2019.

Zbatimi i kontratës
Kontrata nr. 1190/17, datë 04.10.2019 ka gjetur zbatim nëpërmjet 2 urdhër shpenzimeve si më poshtë:
- urdhër shpenzim nr. 511, datë 25.11.2019 në vlerën 8,216,760 lekë me tvsh;
- udhër shpenzim nr. 544, datë 04.12.2019 në vlerën 23,373,000 lekë me tvsh.
Në total 31,589,760 lekë me TVSH.
Mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje L.S., A.M., E.S., sipas urdhrit nr. 434, datë 08.10.2019. Lidhur me sa më sipër konstatohet se znj. A.M., përgjegjëse e sektorit të financës dhe nëpunëse zbatuese e institucionit e cila nënshkruar urdhër shpenzimet, është anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim, ndërkohë që është edhe PPP i institucionit, situatë kjo e cila K. konflikt dhe mbi vendosje në detyrat e përgjegjësit të sektorit të financës.
Për sa më sipër mban përgjegjësi A.F. në cilësinë e titullarit të institucionit përgjegjëse për miratimit të urdhrit nr. 434, datë 08.10.2019.

12. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH.
-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje kite, reagente, materiale të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor***ò"**		
1. Urdhër Prokurimi nr. 92/2, datë 19.02.2018	**3. Njësia e prokurimit** Urdhër Prokurimi nr. 92/2, datë 19.02.2018: H.I., L.S., A.M.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 92/3, datë 19.02.2018, Përbërja; S.Q, E.A., I.H..
2. lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur ï Mallra - me mjete		

elektronike					
5. Fondi Limit (pa tvsh) **Total** 8,056,500	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** **8,056,500** lekë pa TVSH		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 0		
8. Data e hapjes së ofertave 19.03.2018 ora 11:00	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. S. shpk; 2. E shpk		
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A		**13. Përgjigje ankesës nga AKKP-** N/A		
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave					
14. Lidhje e kontratës 1. Kontrata nr.92/11, datë 14.05.2018	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** **9,667,800 lekë**		**16. Likuiduar** Urdhër shpenzim nr. 276, datë 13.08.2018 vlerë 8,644,800 lekë me TVSH. Urdhër shpenzimi nr. 282, datë 13.08.2018 vlerë 1,023,000 lekë me TVSH.		
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë	**18. Afati i kontratës në ditë** 14.09.2018		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** 4 muaj		
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A	
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A	
22. **Akt Kolaudimi** Po	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr: FH nr. 8, datë 16.07.2018		

Procedura ka nisur me urdhrin nr. 9, datë 22.01.2018 ñPër argumentimin e fondit limit të prokurimit me objekt ñ*Blerje kite,reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò ku ngarkohen B.V., E.A dhe X.M. me këtë detyrë. Me shkresën nr. 91/1, datë 29.01.2018 drejturar titullarit të AK, Nën Drejtorit Ekonomik znj. A.A., grupi i punës ka hartuar përgjigjen për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit.
Nga auditimi konstatohet se nuk gjendet në dosjen përkatëse kërkesa për furnizim me mallrat sipas nevojave të institucionit (kjo kërkesë me nr. 1682 prot., datë 29.12.2017) është cituar në urdhrin nr. 9, datë 22.01.2018) për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj procedure në kundërshtim me nenin 12, pika 2, gërma a të LPP ku citohet se:
ñ2. *Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.*
Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose ***të nevojës për prokurim****, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës".*
Për sa më sipër mban përgjegjësi znj. A.A., në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor përgjegjës për nisjen e procedurës së prokurimit.

Grupi i punës është mbledhur më datë 29.01.2018 dhe ka vendosur të përdorë metodën e kontratave të ngjashme duke ju referuar kontratës së realizuar nga AK në vitin 2017. Sa i takon sasive të nevojshme për artikuj grupi i punës i është referuar kërkesës së cituar më sipër e cila nuk administrohet në dosjen e auditimit.
Referuar dokumentacionit bashkëlidhur procesverbalit përllogaritja e fondit limit është si vijon:

Nr.	Artikulli	Sasia e blerë	Gjendja në fund	Sasia e	Lloji i	Çmimi pa	Vlera

		2017	2017	kërkuar	paketimit	TVSH	Totale
1	HCV Test version 2.0	7 kite	1	6	48 teste	480,000	2,880,000
2	HIV 1 Test v.2	5 kite	1	2	48 teste	525,000	1,050,000
3	HBV Test Version 2.0	5 kite	2	7	48 teste	460,000	3,220,000
4	High Pure Sistem Viral Nuvleic Acid Kit	17 kite	4	15	48 teste	47,500	712,500
5	Tube k Box Pack	1 kuti	0	1	12 x 96/kuti	140,000	140,000
6	AmpliLute Liquid Media Extraction Kit	1 Kuti	0	1	20 teste	54,000	54,000
	Totali pa TVSH						**8,054,500**
	TVSH						**1,611,300**
	Totali me TVSH						**9,667,800**

Artikujt duhet të ketë certifikata CE dhe ISO të vlefshme. Të kenë afate kadence 6 deri në 8 muaj nga data e dorëzimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 92/2, prot., datë 19.02.2018 urdhërohet kryerja e procedurës së sipërpërmendur duke përzgjedhur procedurën e hapur ï prokurim me mjete elektronike (mallra),. Njësia e prokurimit e ngarkuar për këtë është përbërë si më poshtë: H.I., L.S. dhe A.M..
Më datë 19.02.2018 është mbajtur procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur. Me procesverbalin e cituar janë hartuar dhe miratuar DST të kësaj procedure.
Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga auditimi konstatohet se në hartimin e tyre, AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por nuk i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar si më poshtë:
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre ***duhet të argumentohet teknikisht*** *dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.".*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin nr. 92/3, datë 19.02.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje: S.Q, Kryetar, dhe anëtarë E.A., I.H..

Me shkresën nr. 92/4, datë 20.02.2018 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës me afat kohor për dorëzimi e ofertave datën 19.03.2018 ora 11:00, dhe për hapjen e ofertave datë 19.03.2018 ora 11:00.

Me procesverbalin e datës 13.03.2018 Njësia e prokurimit i drejtoher Nën Drejtorit Ekonomik në cilësinë e titullarit të AK për një ndryshim në DST, bazuar në emailin e dërguar nga sektori i monitorimit të kontratave të APP-së lidhur me kriteret e pranimit, si dhe mbështetur në nenin 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, dhe në nenin 42 të LPP ka vendosur të kryejë ndryshimet në DST si më poshtë:

1.	Në shtojcën 9 tek **2 - KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT bëhet ndryshimi si më poshtë**
	ISHTE
2.	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**
	a. Vertetim nga Dega e tatim taksave per xhiron mesatare gjatë tre viteve te fundit me nje vlerë sa fondi limit te lotit/loteve per te cilat ofertojne.

b. Operatori ekonomik duhet te zoteroje vleren monetare prej 10% te fondit limit te lotit/loteve per te cilat ofrojne e cila do te mbuloje shpenzimet paraprake per fillimin e zbatimit te kontrates.Kjo vertetohet me anen e nje Deklarate te Gjendjes Financiare te tij te leshuar nga nje ose me shume banka jo me shume se 20 dite perpara dates se hapjes se procedures se tenderit.

2.3 Kapaciteti teknik:

a. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej **40%** te fondit limit te lotit/ loteve për të cilat OE merr pjese, furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik.
Kur kontrata eshte realizuar me entet publike, subjekti ofertues duhet ta shoqeroje ate me vërtetime të lëshuara nga një ent publik, ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b. Operatori duhet te paraqese çertifikatë ISO te vlefshme, per prodhuesin/t e produkteve te ofruar ,te perkthyer dhe noterizuar.

BËHET

Vertetim nga Dega e tatim taksave per xhiron mesatare gjatë tre viteve te fundit me nje vlerë prej 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Operatori ekonomik duhet te zoteroje vleren monetare prej 10% e vlerës limit të kontratës që prokurohet e cila do te mbuloje shpenzimet paraprake per fillimin e zbatimit te kontrates.Kjo vertetohet me anen e nje Deklarate te Gjendjes Financiare te tij te leshuar nga nje ose me shume banka jo me shume se 20 dite perpara dates se hapjes se procedures se tenderit.

Kapaciteti teknik:

a. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej **40%** të vlerës limit të kontratës që prokurohet për të cilat OE merr pjese, furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik.
Kur kontrata eshte realizuar me entet publike, subjekti ofertues duhet ta shoqeroje ate me vërtetime të lëshuara nga një ent publik, ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 ose ISO 13485, të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, të përkthyer dhe të noterizuar

Në përputhje me nenin 42 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò (të ndryshuar) afati kohor për dorëzimin e ofertave në sistemin elektronik

ISHTE

DATA e zhvillimit te procedures ishte 19/03/2018 ORA 11.00

BËHET

DATA e zhvillimit të procedurës bëhet 26/03/2018 ora 11.00

Të gjitha të dhënat e tjera në dokumentat e tenderit të kësaj proçedure mbeten të pandryshuara

Me shkresën nr. 92/5, datë 13.03.2018 miratohen nga titullari i AK ndryshimet e mësipërme.
Nga auditimi konstatohet se njësia e prokurimit nuk ka bashkëlidhur kësaj praktike emailin e cituar në procesverbal sa i takon ndryshimeve të sugjeruara në DST, pasi këto nuk rezultojnë të argumentuara, sikurse nuk rezultonin të argumentuara teknikisht as në fazë fillestare të miratimit të DST.
Për sa më sipër mban përgjegjësi njësia e prokurimit.

Më datë 06.04.2018 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO nga ku konstatohet se për këtë procedurë kanë hyrë në konkurrim elektronik 2 OE si më poshtë:
- S. shpk, me ofertë ekonomike në vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH;
- E. shpk, pa ofertë ekonomike.

Sipas procesverbalit KVO vlerësoi dhe verifikoi dokumentacionin e paraqitur online nga OE nga ku KVO ka konstatuar se dokumentacioni i dërguar nga OE S. shpk rezulton i rregullt dhe i plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.
OE E. ka paraqitur vetëm ekstraktin historik nga QKB dhe asnjë nga dokumentet e tjera të kërkuara për këtë procedurë.
KVO ka kualifikuar S. shpk dhe ka skualifikuar E. shpk
Me shkresën nr. 92/6, datë 18.04.2018 është hartuar nga KVO raporti përfundimtar i kësaj procedure drejtuar titullarit të AK, znj. A.F..

Me shkresën 92/7, datë 19.04.2018 ka dalë vendimi i miratimit të OE fitues për këtë procedurë: S. shpk me ofertë ekonomike në vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 92/8, datë 20.04.2018 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit.
AK dhe S. shpk kanë lidhur kontratën nr. 92/11, datë 14.05.2018 me vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH, ose 9,667,800 lekë me TVSH.
Me urdhrin nr. 92/13, datë 17.05.2018 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim për këtë kontratë me përbërje: B.V., E.A, H.M..

Zbatimi i kontratës
Kontrata nr. 92/11, datë 14.05.2018 me vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH, ose 9,667,800 lekë me TVSH ka gjetur zbatim nëpërmjet 1 urdhër shpenzimet si më poshtë:
- nr. 276, datë 13.08.2018 vlerë 8,644,800 lekë me TVSH;
- nr. 282, datë 13.08.2018 vlerë 1,023,000 lekë me TVSH.
Në total janë likuiduar 9,667,800 lekë me TVSH.
Mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me procesverbalin nr. 1 të datës 18.07.2018 dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 8, datë 18.07.2018, dhe me fletë hyrjen nr. 9, datë 27.07.2018 marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2018 si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Sasia (kite)	Skadenca	Lloji i paketimit	Çmimi pa TVSH	Vlera Totale
	Procesverbal nr.1, datë 18.07.2018					
1	HCV Test version 2.0	6	31.10.2019	48 teste	480,000	2,880,000
2	HIV 1 Test v.2	2	30.11.2019	48 teste	525,000	1,050,000
3	HBV Test Version 2.0	7	30.11.2019	48 teste	460,000	3,220,000
4	AmpliLute Liquid Media Extraction Kit	15	06.06.2019	48 teste	54,000	54,000
	Total pa VSH					7,204,000
	TVSH					1,440,800
	Total me TVSH					8,644,800
	Procesverbal nr. 2, datë 27.07.2018					
5	Tube k Box Pack	1		12 x 96/kuti	140,000	140,000
6	High Pure Sistem Viral Nuvleic Acid Kit	1		15 teste	47,500	712,500
	Total pa VSH	1	0			852,500
	TVSH	1	0			170,500
	Total me TVSH	1	0			1,023,000
	TOTAL me TVSH					**9,667,800**
	TVSH					**1,611,300**

Në procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2019, komisioni i marrjes në dorëzim është shprehur se malli i marrë në dorëzim e plotëson kushtin e skadencës mbi 8 muaj por në dokumentacionin bashkëlidhur nuk ka gjurmë të verifikimit të datës së skadencës sikundër ka ndodhur në rastin e furnizimit të parë nga OE, i cili faturën tatimore e ka shoqëruar me një faturë shitjeje në të cilën janë vendosur edhe datat e skadencave për secilin artikull të furnizuar. Në rastin e procesverbalit nr. 2 dhe të dokumentacionit shoqërues të tij deklarohet vetëm që përmbushet kushti, por nuk ka prova nga OE dhe AK për përmbushjen e tij, për më tepër kur bëhet fjalë për mallra konsumi të cilat nuk mund të verifikohen më në momentin e këtij auditimi nëse e përmbushnin apo jo këtë kriter.
Për sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje B.V., E.A, H.M..

13. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH.
-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 34 prot., datë 28.08.2019	**3. Njësia e prokurimit** Urdhër Prokurimi nr. 34 prot., datë 28.08.2019: K.K, E.Z.,	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 400, datë
2. lloji i Procedurës së Prokurimit ñMarrëveshje		

kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të parashikuara ï 12 muajò	A.M.		28.08.2019 Përbërja; A.Y., A.L, A.I	
5. Fondi Limit (pa tvsh) **Total 8,463,263 Mesatarja e çmimeve për njësi 705,250 lëkë pa TVSH**	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** **Total 10,155,600 lekë meTVSH**		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)**	
8. Data e hapjes së ofertave 23.09.2019 ora 10:00	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. B.E. shpk	
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A		**13. Përgjigje ankesës nga AKKP-** N/A	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës 1. Marrëveshje kuadër 1260/3, datë 11.10.2019 2. Mini Kontratë nr. 1260/12 prot., datë 15.10.2019	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** **1. 10,155,600** lekë me TVSH **2. 2,115,749.28** lekë me TVSH		**16. Likuiduar** Total Likuiduar 99,072,000 lekë 1. U.Sh. nr. 517 datë 22.11.2019, vlera 423,150 lekë; 2. U.Sh. nr. 538, datë 04.12.2019, vlera 423,150 lekë; 3. U.Sh. nr. 604, datë 31.12.2019, vlera 235,500 lekë, 4. U.Sh. nr. 584, datë 31.12.2019, vlera 846,300 lekë. 5. U.Sh. nr. 26, datë 14.02.2020, vlera 846,300 lekë 6. U.Sh. nr. 68, datë 09.04.2020, vlera 846,300 lekë, 7. U.Sh. nr. 235, datë 14.07.2020, vlera 846,300 lekë 8. U.Sh. nr. 236, datë 14.07.2020, vlera 846,300 lekë 9. U.Sh. nr. 292, datë 11.08.2020, vlera 846,300 lekë 10. U.Sh. nr. 374, datë 19.09.2020, vlera 423,150 lekë 11. U.Sh. nr. 423, datë 13.10..2020, vlera 846,300 lekë 12. U.Sh. nr. 482, datë 09.11.2020, vlera 846,300 lekë 13. U.Sh. nr. 534, datë 14.12.2020, vlera 846,300 lekë 14. U.Sh. nr. 584, datë 31.12.2020, vlera 423,150 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë	**18. Afati i kontratës në ditë** 12 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** 365	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Akt Kolaudimi** Po	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr:	

Procedura ka nisur me urdhrin nr. 183, datë 24.05.2019 ñPër argumentimin e fondit limit të prokurimit me objekt ñShërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisëò ku ngarkohen K.F., E.Z. dhe A.M. me këtë detyrë. Me shkresën nr. 680/6, datë 08.07.2019 drejtuar titullarit të AK

grupi i punës ka hartuar përgjigjen për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit ñMirëmbajtje e pajisjeve të mamografive lëvizëseò.
Nga auditimi i shkresës cituar më sipër konstatohet se grupi i punës nuk ka cituar shkresën e kërkesës për këtë shërbim në të cilën të specifikohen nevojat përkatëse për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve mamografike. Gjithashtu në dosjen e prokurimit nuk është prezent kjo kërkese, në kundërshtim me me nenin 12, pika 2, gërma a) të LPP e cila citon se:
ñ2. *Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:*
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës; (…)"
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi K.F., E.Z. dhe A.M..

Shërbimi që kërkohet për mirëmbajtjen e 2 pajisjeve të mamografisë së lëvizshme është mirëmbajtje full risk, që do të thotë mirëmbajtje parandaluese, mirëmbajtje korrigjuese dhe ndërhyrje të ndryshme.
Në përllogaritjen e fondit limit grupi i punës është bazuar në testimin e çmimeve të tregut duke dhe atë të kontratave të mëparshme të realizuara vet dhe/ose nga autoritete kontraktore si më poshtë:
- QSUNT me shkresë 680/1, datë 28.05.2019
- D. shpk me shkresë nr. 680/2, datë 28.05.2019
- B.E. shpk me shkresë nr. 680/3, datë 28.05.2019

Në përgjigje të shkresave të mësipërme u kthyen përgjigje nga QSUNT me shkresën nr. 2138/1, datë 05.06.2019 protokolluar në ISHP me nr 680/4, datë 07.06.2018; OE B.E. me shkresën 680/5, datë 25.06.2019. OE D. nuk iu përgjigj kërkesës së ISHP-së.

Burimet e çmimeve	Njësia	Sasia	Muaj	Vlera për 1 muaj pa TVSH	Totali ne Lek pa TVSH	Afati
B.E.	Cope	2	1	356,000	712,000	12 muaj
QSUNT	Cope	2	1	349,302	698,604	12 muaj

Nga të dhënat e mësipërme fondi limit është përllogaritur duke kryer mesataren mujore për një pajisje mamografie në vlerën 351,651 lekë pa TVSH. Për dy pajisje mamografie rezulton në vlerën 705,302 lekë pa TVSH.
Lidhur me sa më sipër është konstatuar se nuk është argumentuar nga AK përzgjedhja e OE për të dhënë ofertë në këtë fazë të procedurës së prokurimit në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku specifikohet se:
ñ*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*.
Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i punë për përllogartijen e fondit limit, K.F., E.Z., A.M..

Me urdhrin e prokurimit nr. 34, datë 28.08.2019 urdhërohet kryerja e procedurës së sipërpërmendur duke përzgjedhur procedurën e hapur ï prokurim me mjete elektronike (shërbime), pasi është procedurë mbi kufirin e ulët monetar. Njësia e prokurimit e ngarkuar për këtë është përbërë si më poshtë: K.K, E.Z. dhe A.M..
Më datë 28.08.2019 është mbajtur procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur, nga ku është konstatuar se njësia e prokurimit në këtë procedurë

ka vendosur të miratojë kriteret e përcaktuara në dst të procedurës me nr REF - e cila është anuluar për arsye se ofertat e paraqitura nuk përputheshin me kriteret e vendosura. Nga auditimi konstatohet se njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 73, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku parashikohet se: ñ*Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit" .*
Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i punë për përllogartijen e fondit limit, K.F., E.Z., A.M..

Me urdhrin nr. 400, datë 28.08.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje: A.Y., Kryetar, dhe anëtarë A.L dhe A.I..
Me shkresën nr. 1260/2, prot. datë 28.08.2019 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës me të gjithë elementët e tij duke specifikuar fondin limit pa TVSH në vlerën 8,463,623 lekë, shumatorja e çmimeve për njësi 705,302 lekë; datën dhe orën e dorëzimit të ofertave datë 23.09.2019 ora 10:00; afati kohor i hapjes së ofertave 23.09.2019 ora 11:00.

Më datë 23.09.2019 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO nga ku konstatohet se për këtë procedurë ka ofertuar vetëm një operator ekonomik B.E. me ofertë ekonomike 705,250 lekë pa TVSH çmimi për njësi, 846,300 lekë me TVSH çmimi për njësi.

Me shkresën nr. 1260/3, prot., datë 01.10.2019 është hartuar raporti përfundimtar mbi procedurën e prokurimit drejtuar titullarit të institucionit.
Me shkresën nr. 1260/4, datë 01.10.2019 ka dalë vendimi i miratimit për shpalljen e fituesit të kësaj procedure prokurimi i cili është B.E.. Me shkresën 1260/5, datë 01.10.2019 është hartuar formulari i njoftimit të fituesit.

Zbatimi i kontratës
Nga auditimi është konstatuar se është nënshkruar marrëveshja kuadër me nr. 1260/3, datë 11.10.2019 dhe mini kontrata nr. 1260/12 prot., datë 15.10.2019, mini kontrata nr. 1260/18, datë 30.12.2019, në vlerë **10,155,600** lekë me TVSH.
Është konstatuar se vlera totale e realizimit të kontratave është 99,072,000 lekë sipas urdhër shpenzimeve të mëposhtme:
1. U.Sh. nr. 517 datë 22.11.2019, vlera 423,150 lekë
2. U.Sh. nr. 538, datë 04.12.2019, vlera 423,150 lekë
3. U.Sh. nr. 604, datë 31.12.2019, vlera 235,500 lekë
4. U.Sh. nr. 584, datë 31.12.2019, vlera 846,300 lekë
5. U.Sh. nr. 26, datë 14.02.2020, vlera 846,300 lekë
6. U.Sh. nr. 68, datë 09.04.2020, vlera 846,300 lekë
7. U.Sh. nr. 235, datë 14.07.2020, vlera 846,300 lekë
8. U.Sh. nr. 236, datë 14.07.2020, vlera 846,300 lekë
9. U.Sh. nr. 292, datë 11.08.2020, vlera 846,300 lekë
10. U.Sh. nr. 374, datë 19.09.2020, vlera 423,150 lekë
11. U.Sh. nr. 423, datë 13.10..2020, vlera 846,300 lekë
12. U.Sh. nr. 482, datë 09.11.2020, vlera 846,300 lekë
13. U.Sh. nr. 534, datë 14.12.2020, vlera 846,300 lekë
14. U.Sh. nr. 584, datë 31.12.2020, vlera 423,150 lekë

Nga auditimi është konstatuar se për vitin 2020, ISHP nuk ka pasur mirëmbajtje të pajisjeve të mamografisë së lëvizshme. Konstatohet gjithashtu se aktualisht vetëm njëra prej këtyre pajisjeve

është në funksion, ndërkohë që tjetra është me difekt sipas emailit të datës 15.02.2021 nga ku evidentohet një ñDefekt në Njësinë Nr.1 të Mamografive Lëvizëseò si më poshtë:
"Sot më datën 15.02.2021 pasi njësinë e mamografisë vura re që temperatura në dhomën e aparatit ishte ulur nën normat e lejuara. Pas shkëputjes së furnizimit me energji elektrike bateritë e aparaturës nuk kanë mbajtur dhe temperatura është ulur nën 0°. Në monitorin e pc del tabela e kuqe që kërkon asistencen e inxhinierëve të mirëmbajtjes. Kërkoj praninë e inxhinerave që të riparohet defekti."

Për sa më sipër janë mbajtur aktkonstatimet nr. 12, 13, 14, 15, 16, datë 30.07.2021.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1026/77 prot., datë 08.10.2021, protokolluar në KLSH me nr. 527/2, datë 11.10.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga A.F. dhe A.M., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi i subjektit**: Këtë rekomandim (Rekomandimi 1.1) IShP-ja e ka marrë në konsideratë dhe e ka zbatuar. Në datën 17.09.2021 është hartuar urdhri me nr. 187, datë 17.09.2021 "Për heqjen e A.M. si Person Përgjegjës për Prokurimet", e caktuar me urdhrin nr. 1, datë 06.01.2021. Lidhur me këtë heqje, është njoftuar edhe Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën me nr. 13/3 prot., datë 17.09.2021 "Njoftim për heqje nga person Përgjegjës".*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj qëndron pasi rekomandimi është zbatuar.*
***Pretendimi i subjektit**: Këtë rekomandim (Rekomandimi 1.2) Instituti i Shëndetit Publik do ta ketë në konsideratë në vijimësi dhe do të marrë të gjitha masat për ta zbatuar.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj do të verifikohet në auditimet e rradhës që KLSH do kryejë në ISHP.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1026/77 prot., datë 08.10.2021, protokolluar në KLSH me nr. 527/2, datë 11.10.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga A.F., A.M., A.A. dhe A.C., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi i subjektit**: Rekomandimi 2.1 do të merret në konsideratë në vijimësi nga Instituti i Shëndetit Publik. Për vitin 2021, Regjistri i Parashikimit të Prokurimit Publik për IShP-në si dhe çdo ndryshim që është kryer në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2021 është miratuar nga Titullari Autoritetit Kontraktor dhe është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Degën e Thesarit Tiranë.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj do të verifikohet në auditimet e rradhës që KLSH do kryejë në ISHP.*
***Pretendimi i subjektit**: Në lidhje me këtë rekomandim i qëndrojmë Observimit nr. 1026/24 datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 6". Instituti i Shëndetit Publik ka zatuar VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore". Sa më sipër ISHP është mbështetur në pikën 3,germa (a) "fonde të alokuara nëpërmjet rishikimit të ligjit vjetor të buxhetit"dhe germa (ç) "fondet të alokuara për kryerjen e një investimi/shërbimi, në zbatim të detyrimeve të parashikuara me ligj të ri" në ndryshimet e regjistrave të parashikimeve të Prokurimeve Publike pas datës 15 Tetor.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj për ndryshimin e RPPP pas datës 15 tetor nuk qëndron, për arsye se nuk është i provuar nga ana dokumentare e ligjore. Konkretsisht nuk provohet se cili është ligji i ri me anë të të cilit ju janë akorduar fondet juve.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1026/77 prot., datë 08.10.2021, protokolluar në KLSH me nr. 527/2, datë 11.10.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga A.F., A.R., A.M., A.A., L.S., A.Y., I.H., M.K., A.C., K.K, E.Z., S.Q. dhe B.V., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi i subjektit**: Në rastin e mësipërm nuk ka asnjë shkelje nga ana e titullarit të institucionit për sa i përket strukturës organizative, garantimit të ndarjes së detyrave, hierarkisë*

dhe rregullave, të drejtave dhe përgjegjësive si dhe linjave të raportimit në mjedisin e punës. Në interpretim kjo dispozitë përcakton fushat në të cilat titullari i një institucioni duhet të zbatojë në ruajtjen e mjedisit të kontrollit. Këto përcaktime, pavarësisht se janë të një karakteri përgjithësues, nuk gjejnë zbatim në konstatimin e bërë nga ana juaj. Konkretisht sipas përcaktimeve në gërmën c) të pikës 2 të nenit 20 nga ana e titullarit të ISHP-së zbatohen me përpikmëri të gjithë këto elementë të cilët garantojnë mirfunksionimin e punës dhe sigurojnë ruajtjen e mjedisit të kontrollit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se ka hartuar specifikimet teknike (pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit) dhe njëkohësisht është anëtare e KVO, duke mos garantuar ndarjen e detyrave.*

***Pretendimi i subjektit**: A.R. nuk ka qenë pjesë në Njësisë së Prokurimit.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar pika 1 (Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe **informacionin specifik**) dhe pika 3/b (Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:*

- *specifikimet teknike;*
- *grafikun e lëvrimit;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit).*

***Pretendimi i subjektit**: Për këtë gjetje ISHP i qendron observacionit me nr. 1026/26 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 8" dhe observacionit nr. 1026/27 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 9"*

Theksojmë se të dyja këto procedura kanë kaluar nëpërmjet APP-së, bazuar në nenin 13, germa (d) të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, pikën 2 të Udhëzimit Nr.9 datë 29.03.2018, dhe nuk ka patur kontestime për këtë pikë. (bashkëlidhur edhe një herë kopje të asistenës APP-së).

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27, pikat 4-5.*

***Pretendimi i subjektit**: Për gjetjen 3.2, ISHP i qëndron Observimit me nr. 1026/28 prot., datë 06.08.2021, "Në lidhje me Akt Konstatimin nr.10 datë 30.07.2021".*

Për më shumë shtojmë se kjo gjetje e KLSH-së bazohet në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1 germa (c) " gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;"

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27.*

***Pretendimi i subjektit**: Instituti i Shëndetit Publik i qëndron observimit me nr 1026/26 datë 06/08/2021 për Akt konstimin nr 8 datë 30/07/2021, dhe vlen të theskojmë referuar edhe paragrafit nr.5 të Njoftimit të APP-së me nr 9773/9 datë 05.04.2019, nuk kemi hasur në ndonjë sjellje të dyshimtë të operatorëve ekonomikë gjatë pjesëmarrjes ne porocedurë dhe pas lidhje së kontratës...., Cdo gjë ka qënë e rregullt në zbatim të MK dhe minikontratës sic është konstatur edhe nga grupi i KLSH-së.*

Marrë në konsidertë dhe spjeguar edhe në observacionin përkatës, gjatë periudhës së pandemisë ka patur një dinamikë të cmimeve të produkteve që i përkisnin testimeve covid, madje vetë OBSH nëpërmjet dhurimeve ka sjellë këtë produkt me cmime të ndryshmë brenda një periduhe kohore 6-

9 muaj. Ky rekomandim nuk zbatohet për sa më lartë, se pse nuk ploteson të gjitha kushtet e njoftimit të APP- nr 9773/9 datë 05.04.2019.
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj për sjellje të dyshimtë nuk qëndron, për arsye se sipas interpretimit ligjor të APP (Njoftimi nr. 9773/9, datë 05.04.2019), rast i tillë përbën një rast të dyshimtë të denjë për verifikim nga Autoriteti i Konkurencës.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1026/77 prot., datë 08.10.2021, protokolluar në KLSH me nr. 527/2, datë 11.10.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga S.Q, S.B., L.S., M.D., H.M. dhe A.B., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi i subjektit**: Grupi i KLSH-së i referohet gabim me kontratës së furnizimit me nr 224/13, datë 11.05.2018, sepse është kontrata e furnizimit me nr. 373/9, datë 14/05/2020.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*
***Pretendimi i subjektit**: Grupi i punës së ISHP-së mban të njëjtin qëndrim sic ka mbajtur në observacionit nr.1026/28 prot. datë.06.08.2021. të akt kontstatimit nr.10 datë 30.07.2021, ku skadencat nga grupi i marrjes në dorëzim janë shprehur qartësisht se i plotësojnë kushtet e skadences. Nuk ka asnje baze ligjore ku bazohet grupi i KLSH-së që mallrat kanë ardhur të skaduara.*
Sqarojmë se fatura tatimore është format i miratuar nga Ministria e Financave dhe nuk ka asnje seksion në lidhje me skadencat, për më tepër dhe tashmë që janë fatura të fiskalizuara. Ky është edhe argumentimi që mblidhet dhe grupi i marrjes ne dorëzim që kryen verifikimin në vend të produkteve të ardhura sipas kushteve të kontratës.Për të cilën grupi i marrjes në dorëzim është shprehur fare qartë.
Nuk kuptohet se cili është efekti negativ kur produketet dhe madhrat e ketyre faturave kanë ardhur madje një pjesë e tyre janë ende ne laborator (psh HIVetj), për tu përdorur sepse janë brenda kushteve të skadencës. (bashkëlidhur kopje raporti).
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 77, pika 1 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 47. Gjithashtu grupi i auditimi në asnjë rast nuk ka thënë se këto produkte kanë skaduar, por ka cituar se nuk mund të shprehet mbi ligjshmërinë e materialeve të furnizuara.*
***Pretendimi i subjektit**: U ngrit grupi i punës për verifikimin e skadencave me nr.202 datë.01.10.2021 sipas shkresës me 1026/46 datë 01.10.2021, të cilët kanë kthyer përgjigjë sipas raportit nr.1026/56 datë 05.10.2021, kanë evidentuar që mallrat e ardhura nën kontratën e furnizimit me 373/9 datë 14.05.2020, i gjen të rregullta plotësojnë kushtet e skadencës dhe ky rekomandim është i realizuar, vlera prej 6 624 600 nuk është efekt negativ.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Titullari i AK me anë të Urdhrit nr. 202, nr. 1026/46 prot., datë 01.10.2021, ka ngritur grupin e punës për verifikimin e skadencave të kontratës së furnizimit nr. 373/9, datë 14.05.2020, ku me anë të relacionit nr. 1026/56, datë 05.10.2021, grupi i punës ndër të tjera ka përcaktuar se grupi i marrjes në dorëzim (i ngritur me anë të Urdhrit nr. 82, nr. 373/12 prot., datë 28.05.2020), ka identifikuar datat e skadencave për faturat e cituara në projektraportin e auditimit dhe ka identifikuar se data e skadencës për këto artikuj është në përputhje me kushtet e kontratës. Për pasojë pretendimi juaj qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*
***Pretendimi i subjektit:** Në gjetjen 3.2:*
1. sa i takon përdorimit të tog fjalësit "ose ekuivalent" ISHP i qëndron observacionit të tij me nr. 1026/25 prot., datë 06.08.2021, "Në lidhje me Akt –konstatimin nr.7" dhe observacionint me nr. 1026/28 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt – konstatimin nr. 10", për shtimin e togfjaleshit "Ose ekuivalent". Në procedurat e prokurimit, njësia e prokurimit <u>në asnjë rast nuk ka përmendur emër te veçantë "marke"</u>, duke ritheksuar se nuk ka përdorur emërtime në procedurë, <u>por ka</u>

përdorur shprehjen "i përshtatshëm për llojin e teknologjisë dhe pajisjen që Instituti i Shëndetit Publik ka në pronësi".
Instituti i Shëndetit Publik i qëndron observimit të tij nr. 1026/28 prot., datë 06.0/8.2021 "Në lidhje me Akt-Konstatimin nr. 10" datë 30/07/2021 dhe observimit nr. 1026/25 prot., datë 06/08/2021 "Në lidhje me Akt-Konstatimin nr. 7" datë 30/07/2021. Dhe për më tepër shtojmë se, ky interpretim nuk mund të bëhet shkas dhe precedencë jo pozitive për të konfonduar Operatorët Ekonomikë, në një kohë që Institucioni përdor këto pajisje dhe teknika pune në laboratoret e tij, të cilat janë blerë dhe janë kapital i Institucionit.
Ju lutemi për analogji do t'ju sjellim në vëmendje interpretimin me Njoftimin nr. 6504/3 prot., datë 26.09.2018, që vetë Agjencia e Prokurimit Publik ka bërë në lidhje me problematikën e blerjes së tonerave, për përdorimin e ekuivalencës.
***2.** Sa i takon auditimit të ligjshmërisë së hartimit të specifikimeve teknike ISHP (**në 4 raste** AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por **nuk** i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,) i qëndron observimeve me: nr. 1026/30 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt – konstatimin nr. 12, protokolluar me nr. 1026/31 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt – konstatimin nr. 13", me nr. 1026/32 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt – konstatimin nr. 14", si dhe observacionit me nr. 1026/33 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt – konstatimin nr. 15", nr. 1026/26 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 8" dhe observacionit nr. 1026/27 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 9"; me nr. 1026/28 prot., datë 06.08.2021, "Në lidhje me Akt Konstatimin nr. 10 datë 30.07.2021".*
***3.** Sa i takon hartimit të kërkesave për kualifikim jo në përputhje me Rregullat e Prokurimit në 3 raste: në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Blerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19", me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh; në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Blerje kite/reagent, materiale konsumi për ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid - 19", me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh; në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPV", me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh. ISHP i qëndron observacionit me nr. 1026/26 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt - konstatimin nr. 8", observacionit nr. 1026/27 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt-konstatimin nr. 9" dhe observacionit nr. 1026/28 prot., datë 06.08.2021, "Në lidhje me Akt Konstatimin nr. 10 datë 30.07.2021".*
Qëndrimi i grupit të auditimit:
1. Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 23, pika 5.
2. Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
3. Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27, pika 4.

***Pretendimi i subjektit:** Në gjetjen nr. 3. 4 argumentimit dhe dokumentimit të përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet janë konstatuar raste kur nga AK **nuk** është argumentuar përzgjedhja e OE-ve, që do të japin ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku specifikohet se "Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet". në procedurat si më poshtë:*
- në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19", zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000

lekë pa TVSH;
- në procedurën prokurimit me objekt "Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV", zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH;
- në procedurë e prokurimit me objekt "Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë", zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH. ISHP i qëndron observimeve me nr.1026/30 prot. date 06.08.2021 " Në lidhje me akt konstatimin nr. 12", observimit nr. 1026/32 prot. datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt konstatimin nr.14" si dhe observimit me nr.1026/34 prot. datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt konstatimin nr.16".
Është e papranueshme që të merret në konsideratë ky fakt kur në listat e përllogaritjes së fondit limit, ka qenë vetëm një produkt nga e gjithë lista që është marrë ofertë tregu, për më tepër dhe nga OE të cilët kanë punuar me ISHP.
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi juaj nuk qëndron pasi është në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*
***Pretendimi i subjektit:** Në gjetjen 3.5 sa i takon dokumentimit të nevojave prokurim të mallrave apo shërbimeve ISHP i qëndron observacionit nr. 1026/32 prot., datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt konstatimin nr 14.",observacionit nr.1026/33 datë 06.08.2021 "Në lidhje me Akt konstatimin Nr. 15" dhe Observacionit 1026/34 datë 06.08.2021 "Në lidhje Akt konstatimin Nr.16" (Bashkëlidhur kopje të kërkesave).*
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi juaj nuk pranohet pasi për dy procedurat cituar në gjetjen e sipërpërmendur në dosjet përkatëse mungonte dokumentimi i nevojave për prokurim. Dokumentimi duhet të jetë gjithmonë prezent në dosjen e prokurimit.*

***Pretendimi i subjektit:** Për gjetjen nr. 20 paragrafi i dytë për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan", zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH, ISHP ka ngritur grupin e punës me urdhrin nr. 198, datë 28.09.2021 dhe ka kryer verifikimet përkatëse edhe për adresën dytësore sipas QKB dhe ka rezultuara se OE nuk ka kontratë tjetër për adresën dytësore (magazinë me shumicë).*
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi juaj mund të qëndrojë, por në datën e kryerjes së vlerësimit nga KVO ky OE nga dokumentacioni i paraqitur prej tij në SPE për këtë procedurë nuk duhej kualifikuar. Institucioni duhet të tregohet edhe më i kujdesshëm në të ardhmen në verifikimit e dokumentacioneve të prodhuara nga OE gjatë vlerësimit të ofertave duke marrë të gjitha hapet e duhura për të kryer verifikimet përkatëse.*

14. Titulli i gjetjes:	**Përcaktim i personit përgjegjës për prokurimet në kundërshtim me Ligjin**
Situata:	Nga auditimi i përcaktimit të personit përgjegjës për prokurimet publike në ISHP, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, është caktuar si PPP znj. A.M.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, e cila është **Nëpunës Zbatues i ISHP**, si dhe në cilësinë e PPP është anëtare e Njësisë së Prokurimit për të gjitha procedura e zhvilluara nga ISHP, e për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, si dhe nenin 22, pika 3/b, ku parashikohet se veprimtaritë e kontrollit duhet të përmbajnë minimalisht ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3 dhe nenin 22, pika 3/b, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56.
Ndikimi/Efekti:	Mos Ushtrimi i Kontrollit Nga Nëpunësi Zbatues
Shkaku:	Caktimi nga titullari i AK

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Drejtori i ISHP të marrë masa për ndryshimin e Urdhrit nr. 1, nr. 13 prot., datë 06.01.2021, me qëllim heqjen e caktimit si Person Përgjegjës për Prokurimet, të Nëpunësit Zbatues znj. A.M.. - Për të gjitha rastet në vijim, drejtori i ISHP të marrë masa për ngritjen e sistemeve efektive të kontrollit, të tilla që të parashikojnë ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

15. Titulli i gjetjes:	**Regjistrat e prokurimit**
Situata:	Nga auditimi i Regjistrave të Prokurimit Publik u konstatua se: **-** në disa raste, regjistrat e parashikimit të prokurimeve dhe/ose ndryshimet e tyre, nuk janë depozituar në thesar/ose organin qendror, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. Depozitimi i regjistrit të prokurimeve në thesar, është një masë e nevojshme kontrolli që forcon disiplinën financiare, diktuar kjo edhe në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimitò. Konkretisht: - Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP **për vitin 2018**, është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 56, datë 15.01.2018. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2018, janë kryer gjithsej 21 ndryshime të regjistrit, për të cilat janë dërguar shkresat respektive në MSHMS, por jo në Degën e Thesarit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. - Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP **për vitin 2019**, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 43/1, datë 17.01.2019. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2019, janë kryer gjithsej 12 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se: - Vetëm 3 prej këtyre ndryshimeve i janë dërguar MSHMS si institucion qendror që vë në dispozicion fondet, por jo në Degën e Thesarit. -Për 9 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK, si dhe këto ndryshime **nuk** janë dërguar në Degën e Thesarit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. - Me anë të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 121, datë 08.01.2018 ñMbi dërgimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2018 dhe regjistrin e realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2017ò, dërguar autoriteteve kontraktore në varësi të MSHMS, ndër të tjera, në pikën 3 përcakton që ñ*Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem, ndaj ndryshimet nuk do të dërgohen më në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore*ò. Në zbatim të kësaj shkrese, ISHP nuk i ka dërguar ndryshimet e regjistrave të parashikimit pranë MSHMS. Përcaktimi i kryer më sipër, nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. **-** Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për **vitin 2020**, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 50, datë 10.01.2020. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për gjatë vitit 2020, janë kryer gjithsej 25 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se: - Për 10 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe **nuk j**anë të miratuara nga titullari i AK. - Vetëm 3 prej 25 ndryshimeve të regjistrit, i janë dërguar MSHMS, si institucion qendror që vë në dispozicion fondet; por - Asnjë prej këtyre ndryshimeve nuk i është dërguar Degës së Thesarit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, si dhe Rregulloren e Brendshme të ISHP, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ISHP nr. 512, nr. 1906/1 prot., datë 31.12.2019, pika 6.3 ñDrejtoriò, nënpikat (i) dhe (iv). - Nga verifikimi i regjistrave të parashikimeve dhe ndryshimeve të tyre për periudhën objekt

	auditimi, u konstatua se ISHP ka kryer 6 ndryshime në RPP pas datës 15 tetor, me vlerë totale 28,694,815 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò, pika 1.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. Rregullorja e Brendshme të ISHP, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ISHP nr. 512, nr. 1906/1 prot., datë 31.12.2019, pika 6.3 ñDrejtoriò, nënpikat (i) dhe (iv). VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Regjistrat nuk i janë dërguar Degës së Thesarit, Janë marrë angazhime të reja buxhetore në tejkalim të afateve ligjore.
Shkaku:	Mos dërgimi i tyre nga ISHP
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	- Me qëllim forcimin e disiplinës financiare, si një masë e nevojshme kontrolli për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, nga ISHP të merren masa që për të gjitha rastet në vijim, regjistrat e prokurimeve të depozitohen në thesar, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe sa herë ndodhin rishikimet e tyre gjatë vitit. - Drejtori i ISHP të marrë masa që për ndryshimet e mundshme në Regjistrin e Parashikimeve Publike pas datës 15 tetor, të argumentohet në mënyrë të detajuar nevoja e tyre dhe përputhshmëria me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò.

16. Titulli i gjetjes:	**Mangësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik**
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatua sa më poshtë: **-** sa i takon ndarjes së detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, u konstatua se për procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, Tetor 2020, si dhe ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi për ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid -19 ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, Tetor 2020; Titullari i AK, ka ngarkuar znj. A.R., me detyrë shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, e cila për këto procedura: - Ka hartuar kërkesën për materiale. - Ka hartuar fondin limit limit dhe specifikimet teknike. - Është anëtare e KVO. - Është caktuar si personi përgjegjës për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër. Sa më sipër ka bërë që detyrat e mësipërme të jenë përqendruar tek i njëjti nëpunës, duke e ngarkuar me përgjegjësi në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin dhe kontrollin, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 20, pika 1 dhe pika 2/c, si dhe neni 22, pika 3/b. **-** Nga auditimi i ligjshmërisë së hartimit të specifikimeve teknike, u konstatua se: - **në 2 raste**, nga njësia e prokurimit janë përdorur emra markash, të tilla si teknologjia Hybrid Capture, teknologjia TaqMan, si dhe sistemi Rapid Capture, **por pa shtuar tog - fjalëshin "*ose ekuivalent*",** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e konkretisht: në procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt: *(1)* ñBlerje e kiteve dhe materialeve te konsumit për Depistimin e HPV-sëò, me fond limit 26,663,857 lekë pa tvsh, Tetor 2018; dhe *(2)* në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt:ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh, Shkurt 2018. - **në 4 raste** AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por **nuk** i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, në procedurat me objekt: *(1)* ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH; *(2)* ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH; *(3)* ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH; dhe *(4)* ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH. **- në 3 raste** kërkesat për kualifikim janë hartuar jo në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publike (RRPP), e konkretisht: ***(I)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh,

në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një* ***vlerë jo më e vogël se 40%*** *e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiros jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë* ***jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/*** *vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashme me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4. ***(2)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid - 19ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiro jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet...*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashmë me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4. ***(3)*** Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt:ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh: Në Shtojcën 9, pika 2.2.1.b, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet te zotëroje vlerën monetare prej 10% te fondit limit të lotit/loteve për të cilat ofrojnë e cila do të mbuloje shpenzimet paraprake për fillimin e zbatimit te kontrates. Kjo vertetohet me anën e një Deklarate të Gjendjes Financiare të tij të lëshuar nga një ose më shumë banka jo më shumë se 20 ditë përpara datës së hapjes së procedurës së tenderit.*ò. Vendosja e kësaj kërkese, duke qenë se nuk parashikohet më në Rregullat e Prokurimit Publik si rezultat i ndryshimit të tyre në vitin 2017, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27.

- Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, **me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh**, Tetor 2020, u konstatua se në këtë procedurë prokurimi, kanë ofertuar 10 OE. Nga këta 10 OE, 6 prej tyre kanë qenë gjithashtu pjesë e OE-ve të përzgjedhur në procesin e studimit të tregut, gjatë hartimit të fondit limit. Për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se kontrata është lidhur me 25.12% të vlerës së fondit limit të përllogaritur **(ose rreth 74.88% më pak nga fondi limit),** pasi 6 nga OE - të e përzgjedhur përgjatë fazës së studimit të tregut, rezultuan të kenë ofertuar vlera shumë më të larta duke fryrë artificialisht vlerën e fondit limit, ndërsa gjatë fazës së tenderimit, po të njëjtët OE kanë ofertuar vlera më të ulëta, e konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Operatori Ekonomik	**F.N**	**O.D.**	**M.**	**B.A.**	**K.**	**E. (shpallur fitues)**
Studim Tregu	171,660,000	177,300,000	152,400,000	172,800,000	141,600,000	181,800,000
Procedurë prokurimi	56,862,000	50,280,000	64,560,000	55,500,000	93,810,000	41,760,000
%	**33%**	**28%**	**42%**	**32%**	**66%**	**23%**

Kjo sjellje e OE të mësipërm, konsiderohet si një sjellje e dyshimtë dhe mund të përbëjë shkak për ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në oferta, sipas interpretimit zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ku në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë, përcaktohet se: ñ*Marrëveshjet e ndaluara në oferta çojnë në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar. Referuar sa më sipër, mbajtur në konsideratë parimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, sjellim në vëmendje të operatorëve ekonomikë që të jenë sa më të përgjegjshëm gjatë përllogaritjes së vlerës së fondit limit, me qëllim përllogaritjen sa më të saktë të tij. Paraqitja nga operatorët ekonomikë të ofertave me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender për të njëjtin objekt prokurimi,* ***mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t`i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës, në rast të konstatimit të këtyre diferencave***.ò.

ISHP, me konstatimin e këtyre diferencave duhej tëi ishte drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, për kryerjen e verifikimit e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në oferta, në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019.

	- Sa i takon argumentimit dhe dokumentimit të përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet janë konstatuar raste kur nga AK **nuk** është argumentuar përzgjedhja e OE-ve, që do të japin ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku specifikohet se ñ*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*. në procedurat si më poshtë: - në procedurën e prokurimit me objekt ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH; - në procedurën prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH; - në procedurë e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH. **-** Sa i takon nevojave për prokurim të punëve shërbimeve apo mallrave është konstatuar se **nuk** gjenden në dosjen përkatëse *procesverbale ku të ketë një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, **ose** të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës (*në këtë rast, kërkesa për furnizim sipas nevojave të institucionit, për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së procedurave përkatëse), në kundërshtim me nenin 12, pika 2, gërma a të LPP në procedurat si më poshtë: - në procedurën prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH është konstatuar se: - në procedurën me objekt ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH; - në procedurë e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH. **-** Në procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH është konstatuar se në procesverbalin për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur mbajtur më datë 28.08.2019, njësia e prokurimit në këtë procedurë ka vendosur të miratojë kriteret e përcaktuara në DST, të procedurës me nr REF ï 30861-07-09-2019, <u>pa dokumentuar analizimin e shkaqeve të dështimit të procedurave të prokurimit publik,</u> të cilat kërkojnë dokumentimin e analizimit të shkaqeve të dështimit të procedurës së mëparshme me anë të një procesverbali të veçantë të mbajtur nga njësia e prokurimit me qëllim korrigjimin e shkaqeve që kanë çuar në dështimin e procedurës së parë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 73, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Kriteri:	Njoftimi i APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019
Ndikimi/Efekti:	Zhvillim i procedurave të prokurimeve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.
Shkaku:	Mungesa e trajnimeve në fushën e prokurimeve publike. Mos ndjekja e proceduraqve ligjore në zhvillimin e procedurave të prokurimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	**-** Me qëllim përmirësimin e mjedisit të kontrollit për procedurat e prokurimit publik, Titullari i AK të marrë masa që të sigurojë një ndarje të qartë dhe të drejtë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve, të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. **-** Nga Njësia e Prokurimit të merren masa që për procedurat e zhvilluara në të ardhmen, të shmanget përdorimi markave dhe aty ku nuk është e mundur, gjithmonë të përdoret tog-fjalëshi ñ*ose ekuivalent*ò, me qëllim rritjen e konkurrencës e sigurimin e eficiencës në përdorimin e fondeve publike. **-** Me qëllim shmangien e problematikave në argumentimin teknik të kërkesave të veçanta për kualifikim, grupi i përllogaritjes se fondit limit në ISHP të marrë të gjitha masat, që në të gjitha rastet në vijim të dokumentojë në procesverbalet përkatës, argumentimet teknike nga specialistët e fushës për secilën kërkesë të veçantë për kualifikim. **-** Për rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, Titullari i AK të marrë masa që t`i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt. - ISHP menjëherë të drejtohet Autoritetit të Konkurrencës, për të marrë masa për verifikimin e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, nga Operatorët Ekonomikë F.N.SHPK, O.D. SHPK, M. SHPK, B.A. SHPK, K. SHPK dhe E. SHPK, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje

	Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, për arsye se këta 6 OE, gjatë fazës së studimit të tregut kanë ofertuar vlera shumë të larta, ndërsa gjatë fazës së tenderimit kanë ofertuar vlera më të ulëta. **-** Në vijim, grupi i përllogaritjes se fondit limit në ISHP, të marrë të gjitha masat e duhura që në çdo rast të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës në të gjitha aspektet thelbësore të tij, përfshirë këtu edhe OE të përzgjedhur për të ofertuar, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet, në mënyrë që të studimi paraprak i tregut të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të reflektojë vlerën reale të kontratës. **-** Me qëllim argumentimin e nevojave për prokurimin në përputhje me kërkesat e bazës ligjore në fuqi, njësia e prokurimit në SHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim përfshirjen e kërkesës për prokurimit të mallit, shërbimit apo punëve, në dosjet përkatëse të prokurimit. - Në vijim, njësia e prokurimit në ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në çdo rast të dokumentojë analizimin e shkaqeve të dështimit të procedurave të prokurimit publik nëpërmjet dokumentacioneve përkatëse, duke promovuar përgjegjshmërinë dhe përmirësimin e rrjedhshmërisë së procedurave të prokurimit në institucion.

17. Titulli i gjetjes:	**Mangësi në zbatimin e kontratave**
Situata:	**-** Nga auditimi i procesit të zbatimit të Marrëveshjes Kuadër për Lotin 1 nr. 24/27, datë 27.04.2020 dhe Marrëveshjes Kuadër për Lotin 4 nr. 15/4, datë 29.01.2020, u konstatua se ndjekja e zbatimit fizik të këtyre kontratave të shërbimit kryhet nga Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, në bashkëpunim me përfaqësues të ISHP. Në zbatim të këtyre marrëveshjeve kuadër, titullari i ISHP, me anë të Urdhrave nr. 56, nr. 15/9, datë 16.04.2020 (për Lotin 1) dhe nr. 67, nr. 24/29, datë 28.04.2020 (për Lotin 4), ka ngritur grupin e punës për monitorimin e zbatimit të kontratave, të përbërë nga: A.M.(kryetar), A.C. dhe B.K.(anëtare). Në lidhje me këto urdhra, konstatohet se vendosja e zj. A.M.në cilësinë e kryetarit të grupit të monitorimit të marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, e cila është **Nëpunës Zbatues** i ISHP, është kryer në kundwrshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e; nenin 22, pika 3/b; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, pasi punonjwsja duke u vendosur në grupet e monitorimit të zbatimit të kontratave rezulton të jetë përgjegjës njëkohësisht edhe për zbatimin edhe për kontabilitetin dhe kontrollin, duke mos i shërbyer kështu forcimit të kontrolleve në këtë proces. **-** Nga auditimi i kontratës nr. 92/11, datë 14.05.2018 me vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH, ose 9,667,800 lekë me TVSH nënshkruar nga ISHP në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt me objekt ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me procesverbalin nr. 1 të datës 18.07.2018 dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 8, datë 18.07.2018, dhe me fletë hyrjen nr. 9, datë 27.07.2018 marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2018 si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Sasia (kite)	Skadenca	Lloji i paketimit	Çmimi pa TVSH	Vlera Totale
	Procesverbal nr.1, datë 18.07.2018					
1	HCV Test version 2.0	6	31.10.2019	48 teste	480,000	2,880,000
2	HIV 1 Test v.2	2	30.11.2019	48 teste	525,000	1,050,000
3	HBV Test Version 2.0	7	30.11.2019	48 teste	460,000	3,220,000
4	AmpliLute Liquid Media Extraction Kit	15	06.06.2019	48 teste	54,000	54,000
	Total pa VSH					7,204,000
	TVSH					1,440,800
	Total me TVSH					8,644,800
	Procesverbal nr. 2, datë 27.07.2018					
5	Tube k Box Pack	1		12 x 96/kuti	140,000	140,000
6	High Pure Sistem Viral Nuvleic Acid	1		15 teste	47,500	712,500

	Kit					
	Total pa VSH	1	0			852,500
	TVSH	1	0			170,500
	Total me TVSH	1	0			1,023,000
	TOTAL me TVSH					**9,667,800**
	TVSH					**1,611,300**

Në procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2019, komisioni i marrjes në dorëzim është shprehur se malli i marrë në dorëzim e plotëson kushtin e skadencës mbi 8 muaj **por** në dokumentacionin bashkëlidhur **nuk** ka gjurmë të verifikimit të datës së skadencës sikundër ka ndodhur në rastin e furnizimit të parë nga OE, i cili faturën tatimore e ka shoqëruar me një faturë shitjeje ku janë vendosur edhe datat e skadencave për secilin artikull të furnizuar. Në rastin e procesverbalit nr. 2 dhe të dokumentacionit shoqërues të tij deklarohet vetëm që përmbushet kushti, por nuk ka prova nga OE dhe AK për përmbushjen e tij, për më tepër kur bëhet fjalë për mallra konsumi të cilat **nuk** mund të verifikohen më, në momentin e këtij auditimi nëse e përmbushnin apo jo këtë kriter.

- Për kontratën nr. 1190/17, datë 04.10.2019 nënshkruar nga ISHP në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH, mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje L.S., A.M., E.S., sipas urdhrit nr. 434, datë 08.10.2019 të miratuar nga titullari i institucionit. Lidhur me sa më sipër konstatohet se znj. A.M., përgjegjëse e sektorit të financës dhe nëpunëse zbatuese e institucionit e cila nënshkruar urdhër shpenzimet, është anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim, ndërkohë që është edhe PPP i institucionit, situatë kjo e cila K. konflikt dhe mbi vendosje në detyrat e përgjegjësit të sektorit të financës, e që cenon veprimtaritë e kontrollit brenda institucionit, në kundërshtim me nenin 22, pika 3/b të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Mundësia e marrjes në dorëzim të mallrave të skaduara
Shkaku:	Mos verifikimi nga komisioni i marrjes në dorëzim
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Titullari i institucionit, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e situatës mbi datat e skadencave të mallrave, analizën e shkaqeve dhe nxjerrjen e përgjegjësive, me qëllim marrjen e masave për situatën e paraqitur në këtë material. - Titullari i institucionit, në cilësinë e NA, të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që komisionet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara të dokumentojnë dhe të shprehen specifikisht për respektimin e afateve të skadencave për çdo artikull të furnizuar në ISHP me qëllim që të dokumentohet saktësisht ky fakt, për të shmangur në të ardhmen riskun e skadencës së parakohshme të mallrave të furnizuara për shkak të mos respektimit të afatit të skadencës me pasoja efekte në buxhetin e shtetit. **-** Titullari i institucionit në cilësinë e NA të marrë të gjitha masat e duhura për të shmangur në të ardhmen përfshirjen e NZ në procese të punës të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, kjo në përfitim të qëndrueshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm që duhet të funksionojnë në një institucion.

III. 7 MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT DHE VLERËSIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.

Në zbatim të programit të auditimit vlerësimi i menaxhimit finaciar dhe kontrollit është trajtuar sipas komponentëve përkatës si vijon:

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit, i cili përbëhet nga elementët si më poshtë.

a. ***Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike****;*

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se ó*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje'*. Për vitin 2018 ï prill 2020 rezulton se ISHP nuk ka disponuar një kod etike si dhe çështjet e etikës nuk kanë qenë pjesë e rregullores së brendshme. ISHP ka hartuar dhe miratuar kodin e etikës nëpërmjet Urdhrit nr. 54, datë 15.04.2020 të Drejtorit të ISHP, znj. A.F..

b. Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***a)*** *miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*ô. Për sa më sipër rezulton se ISHP ka hartuar një strategji institucionale ñPlani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2019-2022ô, në të cilin të paraqiten prioritetet dhe objektivat. Por në këtë strategji nuk paraqiten të detajuara planet e veprimit për arritjen e objektivave duke përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***b)*** *ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*ô. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ó*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen*

gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave'. Grupit të auditimit i është paraqitur Urdhri nr.35/1154 datë 17.08.2018 "Për zbatimin e rekomandimit nr.15 të KLSH, të ngrihet grupi i punës për Menaxhimin Strategjik dhe për rishikimin dhe përditësimin e risqeve" me anëtarë: z. G.B.(kryetar), znj. A.A., znj. S.B., z. A.L., z. E.T., znj.G.Q., z. E.K., znj. A.M., z. D.H., znj. A.K., znj. E.G.. Nga sa më sipër, konstatohet se GMS nuk ka në përbërje tituallarin e institucionit, znj. A.F., në kundërshtim me nenin 27 të ligjit për MFK.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se "*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'*. Për sa më sipër, për periudhën 2018, 2019, 2020 dhe tre mujori i parë 2021, nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016.

c. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Struktura organizative e ISHP për periudhën 2018-2019 përbëhej nga 204 punonjës, ndërkohë me shkresën nr. 1280, prot datë 04.11.2020 të Drejtorit të ISHP është përcjellë pranë MSHMS kerkësa për kryerjen e një ndryshimi në strukturën e ISHP për kryerjen e një shtese në strukturë për shkak të volumit të madh të punës si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, përkatësisht të një specialisti në Sektorin e Laboratorit të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive, Laboratori i Biologjisë Molekulare. Në vijim të saj, me urdhrin nr. 635, datë 19.11.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar ndryshimi, duke e cuar numrin total të punonëjsve të ISHP-së nga 204, në **205 vetë.** Me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHP", është përcjellë struktura organizative e institucionit dhe organika. Një tjetër ndryshim, po pa një efekt në numrin total të punonjësve është kryer me urdhrin nr.753, datë 22.11.2019 të Ministrit të MSHMS për shtesën e një specialisti në Drejtorinë e Mbrojtes nga Rrezatimi, dhe reduktimin e një specialisti në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Organizimi dhe veprimtaria administrative e ISHP mbështeten në rregulloren e brendshme nr.512, datë 31.12.2019 e cila është miratuar nga Drejtori i ISHP znj. A.F.. Rezulton se kjo rregullore nuk është miratuar nga ministria e linjës që është MSHMS, sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", ku përcaktohet se: "*Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij"*. Gjithashtu, rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pas ndryshimit në strukturën organizative të miratuar me urdhrin nr. 635, datë 19.11.2020 të MSHMS.

ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Përshkrimet e punës së specialistëve të ISHP nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme, pasi në këtë rregullore janë vetëm përshkrimet e punës në nivel Departamenti dhe sektori. Përshkrimet e punës së specialistëve janë në dosjet e punonjësve, të miratuara nga eprori direkt i tyre, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 18, germa "c", kreu IV, të VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruara", sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë nën varësinë e të cilit është institucioni, në këtë rast MSHMS. ISHP edhe pse nuk është një institucion tanimë me status civil, është nën varësinë e një ministrie. Gjithashtu ISHP nuk disponon një program trajnimi vjetor për punonjësit.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Për t'i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit*.ô Për sa më sipër, në zbatim të urdhrit nr.154, datë 17.08.2018 të Drejtorit të ISHP, Grupi i Menaxhimit Strategjik ka përgatitur Strategjinë e riskut, nr. 581/26 prot, datë 22.02.2019. Për vitin 2020 nuk kemi përditësim të risqeve, sikurse përcaktohet më sipër.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuarô ku përcaktohet se ó*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*ô.

ISHP nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Mungesa e regjistrit të riskut dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eleminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 22/3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar përcaktohet se veprimtaritë e kontrollit përmbajnë minimalisht ndër të tjera edhe sistemin e dy nënshkrimeve i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë. Aktualisht, funksioni i nëpunësit autorizues kryhet nga Drejtori i ISHP znj. A.F. e cila nuk e ka deleguar këtë detyrë, ndërsa funksioni i nëpunësit zbatues kryhet nga znj. A.M., përgjegjëse e sektorit të buxhetit dhe finances. Nëpërmjet shkresës nr.1627 prot, datë 19.12.2017, Nëpunësi Autorizues i ISHP znj. A.A. ka autorizuar znj. A.M. përgjegjëse e sektorit të financës si nëpunës zbatues deri në emërimin e Drejtorit të ri të Institucionit. Drejtori i ri i institucionit është emëruar me shkresën nr. 266 datë 28.03.2018 të Ministrit të MSHMS. Ndërkohë, që nëpunësi zbatues vazhdon të kryejë funksionin në bazë të një shkrese e cila ka qenë e vlefshme deri me datë 08.03.2018.

Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se është caktuar si PPP znj. A.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, e cila është Nëpunës Zbatues i ISHP, e për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, si dheVKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56.

4. Informacioni dhe komunikimi

Drejtori i ISHP informohet nga përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme të brendshme.

5. Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se ISHP nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual'*. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim rezulton se nëpunësi autorizues i ISHP nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

2. Përsa i përket auditit të brendshëm, rezulton se ISHP nuk ka njësi auditi në organikën institucionale dhe auditohet vetëm nga MSHMS. Për periudhën nën auditim, rezulton se ISHP nuk është audituar asnjëherë nga MSHMS.

18. Titulli:	**Mangësi në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit**
Situata:	Nga auditimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në ISHP është konstatur se: - Për periudhën 2018 ï prill 2020 rezulton se ISHP nuk ka disponuar një kod etike si dhe çështjet e etikës nuk kanë qenë pjesë e rregullores së brendshme. ISHP ka hartuar dhe miratuar kodin e etikës nëpërmjet Urdhrit nr. 54, datë 15.04.2020 të Drejtorit të ISHP, znj. A.F.. - ISHP ka hartuar një strategji institucionale ñPlani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2019-2022ò, në të cilin të paraqiten prioritetet dhe objektivat, por në këtë strategji nuk paraqiten të detajuara planet e veprimit për arritjen e objektivave duke përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK. - me urdhrin nr.35/1154 datë 17.08.2018 óPër zbatimin e rekomandimit nr.15 të KLSH, të ngrihet grupi i punës për Menaxhimin Strategjik dhe për rishikimin dhe përditësimin e risqeveò është ngritur GMS me anëtarë: z. G.B.(kryetar), znj. A.A., znj. S.B., z. A.L., z. E.T., znj.G.Q., z. E.K., znj. A.M., z. D.H., znj. A.K., znj. E.G., por, konstatohet se GMS nuk ka në përbërje tituallarin e institucionit, znj. A.F., në kundërshtim me nenin 27 të ligjit për MFK. - në udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 óPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ó*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'*. Për sa më sipër, për periudhën 2018, 2019, 2020 dhe tre mujori i parë 2021, nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016. - organizimi dhe veprimtaria administrative e ISHP mbështeten në rregulloren e brendshme nr. 512, datë 31.12.2019 e cila është miratuar nga Drejtori i ISHP znj. A.F.. Rezulton se kjo rregullore nuk është miratuar nga MSHMS, sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*ò, ku përcaktohet se: ñ*Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij"*. Gjithashtu, rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pas ndryshimit në strukturën organizative të miratuar me urdhrin nr. 635, datë 19.11.2020 të MSHMS. - përshkrimet e punës së specialistëve të ISHP nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme,

	pasi në këtë rregullore janë vetëm përshkrimet e punës në nivel Departamenti dhe sektori. Përshkrimet e punës së specialistëve janë në dosjet e punonjësve, të miratuara nga eprori direkt i tyre, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 18, germa ñcò, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë nën varësinë e të cilit është institucioni, në këtë rast MSHMS. ISHP edhe pse nuk është një institucion tanimë me status civil, është nën varësinë e një ministrie. Gjithashtu ISHP nuk disponon një program trajnimi vjetor për punonjësit. - Grupi i Menaxhimit Strategjik ka përgatitur Strategjinë e riskut, nr. 581/26 prot, datë 22.02.2019. Për vitin 2020 nuk kemi përditësim të risqeve, sikurse përcaktohet më sipër. Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuarô ku përcaktohet se ó*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*ô. ISHP nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Mungesa e regjistrit të riskut dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eleminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale. - Nëpërmjet shkresës nr.1627 prot, datë 19.12.2017, Nëpunësi Autorizues i ISHP znj. A.A. ka autorizuar znj. A.M. përgjegjëse e sektorit të financës si nëpunës zbatues deri në emërimin e Drejtorit të ri të Institucionit. Drejtori i ri i institucionit është emëruar me shkresën nr. 266 datë 28.03.2018 të Ministrit të MSHMS. Ndërkohë, që nëpunësi zbatues vazhdon të kryejë funksionin në bazë të një shkrese e cila ka qenë e vlefshme deri me datë 08.03.2018. Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se është caktuar si PPP znj. A.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, e cila është Nëpunës Zbatues i ISHP, e për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, si dheVKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56. - ISHP nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual'*. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim rezulton se nëpunësi autorizues i ISHP nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në. - Të ardhurat nga licenca dhe dhënie aprovimi janë gjeneruar nga ISHP në vijim të udhëzimit të MSHMS nr. 713, datë 11.10.2018 ñ*Për tarifat e licencimit të veprimtarive që përdorin burime të rrezatimit jonizues*ò në të cilin përcaktohen tarifat përkatëse të licencimit dhe lëshimit të aprovimeve përkatëse për import eksport dhe transport të burimeve të rrezatimit jonizues, por aktivitetet e kontrollit që janë implementuar nga ISHP për garantimin e likuidimit nga ana e përfituesve të shërbimeve që institucioni kryen kundrejt pagesës (analiza, licenca, etj), konsistojnë në bashkëlidhjen e mandatit të pagesës përpara dhënies së cdo vërtetimi të firmosur nga titullari. Likuidimi i pagesës rezulton të kryhet pasi janë kryer analizat përkatëse nga ISHP, moment ky që kryhet dhe përllogaritja e detyrimit përkatës. Pas kryerjes së pagesës nga përfituesit e shërbimeve, ISHP vijon me dhënien e miratimeve zyrtare të këtyre dokumentacioneve. Megjithatë nga ana e institucionit nuk është kryer asnjë monitorim për periudhën nën auditim në regjistrat e vërtetimeve/licencave/analizave sipas departamenteve respektive të ISHP për të garantuar se për të gjitha këto shërbime është kryer likudimi sipas tarifave përkatëse. Gjithashtu, për shkak të mos kryerjes së pagesave përpara se të vijohet me analizat, ekziston risku për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe mos likuidimin e tyre nga ana e përfituesve.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ó Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeô.

	Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Institucioni nuk ka krijuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Shkaku:	Mungesë angazhimi institucionave në ngritjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si edhe mbikëqyrjen e efektivitetit të tyre në ecuri.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- ISHP të veprojë menjëherë duke ndritur një grup pune të posaçëm me qëllim rishikimin e strategjisë institucionale duke përfshirë në të planet e veprimit për arritjen e objektivave duke përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit. - ISHP të marrë të gjitha masat e duhura brenda kompetencave të veta me qëllim rishikimin e përbërjes së GMS, duke përfshirë në të titullarin e institucionit, si edhe të dokumentojë në vijimësi mbledhjet e GMS në përfitim të punës së institucionit kundrejt menaxhimit strategjik. - ISHP të veprojë menjëherë duke përditësuar strategjinë e riskut, hartuar njëkohësisht regjistrin e riskut institucional dhe krijuar procedura specifike për menaxhimin e tij në përfitim të mirëmenaxhimit të institucionit kundrejt situatave që mund të dëmtojnë veprimtarinë e tij. - ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar në vijimësi pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion. - ISHP të marrë tëgjitha masat e duhura me qëllim që detyrimi financiar kundrejt institucionit për kryerjen e analizave apo dhënien e licencave përkatëse nga sekori i zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet të bëhet para kryerjes së shërbimit nga ana e institucionit me qëllim shmangien e risqeve për moslikuidim të detyrimeve kundrejt institucionit nga operatorët ekonomik,

Subjekti ka paraqitur observacionin nr. 1026/74, prot., pa datë, *protokolluar me tonën me nr. 527/24, datë 11.10.2021 ku shpreh dakordësinë me gjetjen dhe rekomandimin mbi plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe mënyrën e likuidimit të analizave të kryera nga zyra për mbrojtjen nga rrezatimet.*

III. 8 AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM.

Auditimi i fundit i ushtruar në Institutit të Shëndetit Publik është zhvilluar sipas Programit të auditimit nr. 544/1, dt. 07.05.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017.

- *Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Instituti i Shëndetit Publik, *ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.*

- Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* është lëshuar nga titullari i institucionit urdhri i Brendshëm nr. 372, datë 27.06.2018 *"Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit"* dhe hartuar plani i veprimeve mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Në vijim të kësaj faze, KLSH ka kryer auditimin e zbatimit të rekomandimeve në bazë të Autorizimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së nr. 450/4, datë 26.06.2019 me objekt: ñ*Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve*ò, si dhe Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 ñ*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"*. i cili u krye nga:

1. J.G., përgjegjës grupi,
2. K.F., anëtar.

Nga ky auditimi është konstatuar se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **17** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 17, janë zbatuar 13 dhe në proces 4.

b. Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, i është rekomanduar Drejtorit të ISHP të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit i ka kërkuar Institutit të Shëndetit Publik vendosjen në dispozicion të dokumentacionit përkatës me anë të të cilit të raportohet mbi statusin aktual të 4 rekomandimeve të cilat kanë rezultuar në proces nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve dhe vlerësimit të përgjegjësive për dhënie të masave disiplinore si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi i lënë nga KLSH.

1. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në pasqyrat financiare të ISHP për vitet 2016 dhe 2017, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre, nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (*janë evidentuar për vleftën zero lekë*). Sipërfaqja totale e tokës që ka ISHP në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që ISHP ka në dispozicion, plani i rilevimit (*kadastral dhe topografik*), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore. Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ñ*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë*ò, *(Harta sipas Fletores Zyrtare nr. 14, viti 2016, faqe 961),* vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (*referuar çmimeve të vitit 2014*), për zonën kadastrale nr. 8120, përcaktohet me çmimin prej 29,106 lekë/m^2. Nga përllogaritjet për sipërfaqen të tokës truall prej 20,035 m^2 që administron ky institucion me çmimin për zonën kadastrale nr. 8120, në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 rezulton vlera 583,138,710 lekë, e cila duhej pasqyruar në AQT (*zëri "toka, troje e terrene")* të ISHP.

Rekomandojmë: Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të ISHP bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e Institutit të Shëndetit Publik i vlerave të këtyre pasurive bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesi i pavarur.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit gjatë verifikimit të zbatimit të rekomandimeve

Në lidhje me këtë rekomandim nga ISHP sqarohet se ñNë bazë të rekomandimeve nr. 1 për pasqyrimin e drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve, terreneve në pronësi dhe administrim të ISHP-së do të zbatohet pasi të jetë kryer procesi i inventarizimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në zbatim të Vendimit Këshillit të Ministrave nr. 500, date 14.8.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësite e qeverisjes vendoreò, nenit 27 ñ*Rregullimet kontabël*" për pronat që do të mbeten në pronësi të qeverisë qendrore do të trajtohen me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministraveò. Për sa më sipër ky rekomandim do të zbatohet pasi Institucioni jonë të jetë pajisur me certifikatë pronësie, pasi të kryhet regjistrimi i tyre nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. (Bashkëlidhur do të gjeni dhe shkresën që i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) Urdhri i brendshëm me nr.

146, datë 17.08.2018 Realizuar Raporti i detajuar nga Komisioni përkatës me shkresën nr 581/20, date 03.12.2018, por ende nuk është kryer inventarizimi nga ana e MSHMS.

Lidhur me këtë problematikë nga ky auditim konstatohet se: ISHP i është drejtuar MSHMS me shkresën nr. 906/5, prot., datë 30.09.2019 me një informacion në lidhje me regjistrimin e pasurive dhe vlerat e pasurive të paluajtshme si toka, troje, terrene dhe godina ku ka bashkëlidhur shkresa të mëparshme mbi zbatimin e VKM nr. 500, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si edhe të gjithë dokumentacionin mbi pasuritë që ndodhen brenda territorit të institucionit. Me shkresën nr. 906/6, prot., datë 30.09.2019 ISHP i ka dërguar MSHMS "Rikërkesë për regjistrimin e pronave të Institutit të Shëndetit Publik" së bashku me listën përfundimtare sipas formularit të inventarizimit të pronave të paluajtshme, plan vendosjen, planimetritë për çdo kat etj, duke kërkuar regjistrimin e pronës me qëllim kryerjen e rivlerësimit të tyre. Me shkresën nr. 906/7, prot., datë 16.10.2019 ISHP i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me qëllim kryerjen e regjistrimit për të vijuar me rivlerësimin. Në vijim të kësaj shkrese, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka kthyer përgjigje ISHP me shkresën nr. 16154/1, prot., datë 06.11.2019, për dijeni MSHMS, ku shprehet se nga shqyrtimi i praktikës dhe dokumentacionit bashkëlidhur bëjnë me dije institucionin se kërkesa për inventarizimin e pasurive në administrim të pushtetit qendror duhet të iniciohet nga institucioni qendror nga i cili ISHP ka varësinë, pra nga MSHMS. Për sa i përket formularëve të inventarizimit bashkëlidhur praktikës, bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 30.04.2002, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit dhe plotësimin e formularëve" këto duhet të siglohen nga identifikuesi, supervizionuesi dhe në cilësinë e aprovuesit nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili është titullari i institucionit që harton formularët. Vetëm pas reflektimit të këtyre kërkesave dokumentacioni dërgohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vijimin e procedurave. MSHMS nuk ka kthyer përgjigje shkresave cituar më sipër.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga ISHP janë marrë të gjitha masat për realizimin e këtij rekomandimi, por ende mbetet finalizimi i zbatimit të tij nga MSHMS.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***por në proces.***

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i të dhënave të evidencës analitike të ndërtesave rezulton se, në pasqyrat analitike që shoqërojnë bilancin kontabël të vitit 2016 dhe 2017, gjendja e nënllogarisë 212 "*Ndërtesa e konstruksione*", përputhet me shumën e vendosur në llog. 212, në Aktiv të Bilancit Kontabël, e cila detajohet si vijon:

lekë

Ndërtime konstruksione	Viti 2016	Viti 2017
1.Godina qendër	35,006,040	35,006,040
2.Godina laboratori mikrobik	31,996,293	31,996,293
3.Qendra e trajnimeve	347,000	347,000
4.Godina e magazinës	1,204,675	1,204,675
5.Godina e garazheve	20,500	20,500
6.Godina e klubit	7,500	7,500
7.Godina e vivariumit	725,000	725,000
8.Muri rrethues	968,199	968,199
Shuma	**70,245,207**	**70,245,207**

Burimi: Sektori i Financës, ISHP.

Nga auditimi konstatohet se, për tre zëra të paraqitura në nën llogarinë "*Ndërtesa e konstruksione*", si "*Godina e Klubit*" në vlerën 7,500 lekë, "*Godina e Garazheve*" në vlerën 20,500 lekë dhe "*Qendra e Trajnimeve*" në vlerën 347,000 lekë, vlerësimet në AQT janë jo realiste, me vlera simbolike dhe të paargumentuara, duke mos pasqyruar vlerën reale të aktiveve.

Rekomandojmë: Të merren masat nga ana e ISHP për kryerjen e procesit të rivlerësimit të ndërtesave, për zërat e paraqitur në nën llogarinë ñ*Ndërtesa e konstruksione*ò, me ekspertë të fushës, për të siguruar një pasqyrim sa më real të vlerës së këtyre aktiveve. Mungesa e kryerjes së vlerësimeve dhe regjistrimit të pasurisë me vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet shton rrezikun që informatat e prezantuara në regjistrin e pasurisë të mos përmbushin kërkesat e raportimit financiar. Për sa sipër, të ndërtohen kontrollet dhe procedurat e brendshme në përputhje me cilësimet e paragrafit 18, të Standardit Kombëtar Kontabël nr. 5, që nënvizojnë se, *"Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos (i cili shpjegohet në paragrafin 19), ose modelin e rivlerësimit (i cili shpjegohet në paragrafët 20-28) dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet",* nisur nga struktura e çdo prone, vlera e tyre efektive sipas çmimeve të tregut dhe masës së amortizimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit gjatë verifikimit të zbatimit të rekomandimeve

Në lidhje me këtë rekomandim nga ISHP sqaron se për kryerjen e rivlerësimit të ndërtesave për zërat e paraqitura në nënllogarinë ñNdërtesa konstruksioneò, me ekspertë të fushës do të zbatohet kur ISHP do të pajiset me certifikatë pronësie nga Ministria e e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, siç u paraqit sqarimi dhe në rekomandimin nr. 1. Nga ISHP është ngritur grupi me Urdhri i brendshëm me nr. 146, datë 17/08/2018, ku është realizuar raporti i detajuar nga Komisioni përkatës me shkresën nr 581/20, datë 03/12/2018, por ende nuk është kryer inventarizimi nga ana e MSHMS, ende nuk është regjistruar ne ZRPP dhe ISHP nuk është pajisur me certifikatë pronësie, që të bëhet i mundur rivlerësimi ndërtesave. Është dërguar edhe shkresa në MSHMS me nr. 110, datë 15.08.2018.

Lidhur me këtë problematikë nga ky auditim konstatohet se qëndron përsëri komenti i gjetjes së mësipërme, pasi shkresave cituar më sipër drejtuar MSHMS nga ISHP nuk u është kthyer përgjigje.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga ISHP janë marrë të gjitha masat për realizimin e këtij rekomandimi dhe mbetet finalizimi i zbatimit të tij nga MSHMS.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***por në proces.***

11. Gjetje nga auditimi: *Regjistrimi i pasurisë:* Ndonëse nga ana e Institutit të Shëndetit Publik është zbatuar detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, ñ*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*ò, i ndryshuar, meqenëse është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, si dhe i janë përcjellë Ministrisë se linjës, ende nga ISHP nuk janë dërguar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP) listat e inventarit, për tëu dërguar më tej për miratim Këshillit të Ministrave. Nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohet AITPP në Ministrinë e Brendshme, regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Gjithashtu konstatohet se, nuk është finalizuar procesi i miratimit të listës së pronave dhe nuk është vijuar me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP.

Sa më sipër, në kushtet që nga ana e ISHP nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 ñ*Për pasuritë e paluajtshme shtetërore*ò, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 ñ*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*ò,

Rekomandojmë: Drejtori i ISHP, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me

Ministrinë e Shëndetësisë dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për vlerësimin e trojeve dhe të pronave që ky Institut ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.
- Të riaplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve të ISHP.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit gjatë verifikimit të zbatimit të rekomandimeve
Në lidhje me këtë rekomandim nga ISHP sqaron se: Aplikimin në AITPP në bazë të Vendimit Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.8.2001 ñPër inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, ku dhe janë përcjelle dokumentet përkatëse me shkresën nr. 1489/1, datë 08/11/2016, po Instituti do ta përcjelli këtë dokumentacion edhe ne AITPP sipas rekomandimit tuaj.
Nga institucioni është ngritur urdhëri i brendshëm me nr. 146, datë 17/08/2018, ku është bërë një raport i detajuar nga komisioni me shkresën nr 581/20, datë 03/12/2018 dhe është aplikuar edhe tek AITPP, por ende nuk është kryer inventarizimi nga ana e MSHMS, e cila e kryen procesin e regjistrimit të tyre.

Lidhur me këtë problematikë nga ky auditim konstatohet se me shkresën nr. 906/7, prot., datë 16.10.2019, ISHP i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me qëllim kryerjen e regjistrimit për të vijuar me rivlerësimin.

Komenti i grupit të Auditimit
Nga ISHP janë marrë të gjitha masat për realizimin e këtij rekomandimi është zbatuar.
Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar ***dhe i zbatuar.***

12. **Gjetje nga auditimi:** Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve (*llog. 214 Ins. Teknike makineri pajisje 414,088,967 lekë dhe llog. 218 Inventar ekonomik 133,535,349 lekë*) për vitin 2016 është hartuar një informacion për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e ISHP-së, për vitin 2016. Gjithashtu nga komisioni i inventarizimit të aktiveve (*llog. 214 "Ins. Teknike makineri pajisje" 419,545,605 lekë dhe llog. 218 "Inventar ekonomik" 143,513,238 lekë*) për vitin 2017 është hartuar një informacion për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e ISHP-së, për vitin 2017.
Nga auditimi u konstatuan se:
- Në një informacionin e inventarizimit 2017 nuk janë pasqyruar diferencat e konstatuara për *"Ins. Teknike makineri pajisje"* në vlerën **1,854,601** lekë.
- Nga ISHP për vitin 2016 dhe 2017 nuk janë inventarizuar e kontrolluar për ekzistencën dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, në kundërshtim me nenin 7, ñ*Inventari i aktiveve dhe detyrimeve*ò, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, Inventarizimi i aktiveve. *Pika 74, që nënvizon se, "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një here në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës".*
- Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë *jashtë funksionit*, mirëpo *nga ana e*

kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit sipas UMF nr. 30, datë 27/12/2011 për të vijuar procedurat dhe praktikat me: ñ*procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; hartimin e proces verbalit të vlerësimit; evidentimin e listës së aktiveve të identifikuara për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme".*

- Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. *Nuk ka një evidentim te situatës së inventarizimit për çdo llogari, krahasim të gjendjeve kontabël dhe fizike për gjithë asetet (aktivet materiale dhe jomateriale), arsyetimi i shkaqeve mbi diferencat, inventari jashtë funksioni, arsyet për këtë, qëndrimi i titullarit/disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.*
- Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve për vitin 2016 dhe 2017 nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, (*ekziston vetëm informacioni mbi inventarin në përdorim të punonjësve në zyrat dhe ambientet e ISHP*), në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që sanksionon detyrimin e komisionit, ñ*të përpilojë një raport lidhur me: inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues".*
- Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30/2011, që përcakton se ñ*ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale"*, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.

Rekomandojmë: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar *procesin e vlerësimit të aktiveve* të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

- Drejtuesi i ISHP të analizojë diferencat e inventarit të konstatuara për *"Ins. Teknike makineri pajisje"* në vlerën **1,854,601** lekë, si dhe të kryhen regjistrimet e nevojshme në kontabilitet pas adresimit të përgjegjësive përkatëse.
- Nga strukturat e menaxhimit të ISHP të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, *nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre*, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, ... duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve *të përpilojnë një raport përmbledhës* mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

- Drejtori i ISHP duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që tu vejë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasitë fizike.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit gjatë verifikimit të zbatimit të rekomandimeve

Në lidhje me këtë rekomandim nga ISHP sqaron se: Do të ngrihen grupet e punë për fillimin e proceseve te vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi, dhe asgjësimin e tyre në njësinë shpenzuese bazuar në UMF 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Ka nisur procesi i nxjerrjes i vlerësimit të aktiveve të magazinës së Kimikateve për (kimikate dhe reagente).regjistrimi i inventarit ñIns. Teknike makineri dhe paisjeò në vlerën 1 854 601 është sistemuar në Janar të vitit 2018, me flete daljen nr. 1, datë 23.01.2018.

- Ngritur: komisioni i inventarizimit me nr. 168, prot., datë 24.09.2018 për inventarizimin e pajisjeve kompjuterike, laboratorike dhe mobiljeve.
- Është realizuar raporti i inventarizimit me shkresën nr. 1299/1, date 02.11.2018 në lidhje me inventarizimet.

Është miratuar urdhri i vlerësimit të kimikateve dhe raegenteve për nxjerrje jashtë përdorimit me nr. 100, datë 04.06.2018.

Raporti i vlerësimit realizuar me shkresën nr. 762/1, datë 10.09.2018 është dërguar për miratim në MSHMS me shkresën nr. 762/2, datë 13.09.2018 dhe përsëritur me shkresën nr. 762/3, datë 29.10.2018, shkresë kjo e bazuar në pikën 113 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publikò. Procesi i vlerësimi, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre është në pritje të miratimt nga ana e MSHMS.

Lidhur me këtë problematikë nga ky auditim është konstatuar se:

- janë kryer sistemimet përkatëse në bilanc sipas Relacionit Sqarues Për Pasqyra Vjetore dhe vlera prej **1,854,601** lekë.
- janë ngritur grupet për vlerësimin e aktiveve në ISHP përkatësisht me urdhrat nr. 412, datë 12.09.2019 (pajisje mobilimi), nr. 413, datë 12.09.2019 (pajisje kompjuterike), nr. 414, datë 12.09.2019 (pajisje laboratorike).
- bazuar në relacionet përkatëse të grupeve të punës është kryer procesi i nxjerrjes jashtë përdorimi i aktiveve (pajisje mobilimi) për të cilin është ngritur komisioni me urdhër nr. 497, datë 13.12.2019 dhe është mbajtur relacioni përkatës duke shpjeguar procesin e asgjësimit të tyre. Ndërkohë që ende nuk janë kryer proceset e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit për pajisjet kompjuterike dhe pajisjet laboratorike, pasi në gjykimin e grupit të punës sipas urdhrave cituar më sipër këto duheshin kryer në një moment të dytë. Për pajisjet kompjuterike në ato momente AKSHI kishte lidhur kontratë për kompjutera për ISHP dhe procesi u shty me qëllim marrjen në dorëzim të pajisjeve të reja e vijimin më vonë me nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre. Për pajisjet laboratorike procesi u shty pasi ambienti ku ato ndodheshin u boshatis për të liruar ambientet për AKBPM (Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore) godina e së cilës po rikonstruktohej dhe finalizimi i procesit në ato momente do të K.te konfuzion. Procesi do të vijoj në një moment të dytë nga ISHP.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga ISHP janë marrë të gjitha masat për realizimin e këtij rekomandimi, i cili aktualisht rezulton të jetë zbatuar pjesërisht.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar *dhe i zbatuar pjesërisht.*

C. MASA DISIPLINORE:
Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të ISHP: Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga ñ*Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*ò deri në ñ*Largim nga puna*ò për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.
<u>Lidhur me këtë problematikë nga ky auditim</u> është konstatuar se nuk është marrë parasysh nga ISHP.

III. 9 TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT
1. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të periudhës janar ï mars 2021 grupi i auditimit evidentoi tre urdhër shpenzime parapagim për vaksinat covid dhe në vijim të kësaj për të kryer auditimin e tyre, ë zbatim programit të auditimit nr. 527/1, datë 14.05.2021, i ndryshuar, grupi i auditimit ka kërkuar me emailin e datës 15.06.2021 vendosjen në dispozicion të dokumentacionit që ka të bëjnë me pagesat, marrjen në dorëzim dhe shpërndarjen e vaksinave kundër Covid ï 19.
Pas kësaj kërkese të grupit të KLSH - së (kërkesë kjo e protokolluar në ISHP me nr. 581/17, prot., datë 17.06.2021) nga ISHP është vendosur në dispozicion sa më poshtë:
- shkresa nr. 581/20, datë 18.06.2021, e drejtorit të ISHP-së, drejtuar znj. A.N. në MSHMS "Kërkesë për mendim";
- përgjigja me email e znj. N., ndaj shkresës zyrtarë të ISHP, datë 18.06.2021, ora 10:59
(për dijeni cc: zj. G.P. dhe zj. E.H.);
- emaili i datës 21.06.2021 ku ftohemi të shkojmë në zyrën e znj. F., Drejtore e ISHP, për të parë dokumentacionin e përgatitur nga ISHP lidhur me këtë çështje.
Bazuar në sugjerimet e znj. N., grupit të KLSH iu garantua një akses i kufizuar në dokumentacionin e përgatitur nga subjekti sikundër citohet edhe në emailin nga MSHMS si më poshtë: *"KLSH ti krijohet mundësia të lexojë kontratën në prezencën e një përfaqësuesi të ISHP, pa smartfone dhe pa laptop, pa shënime dhe pa mundësi fotokopjimi, pra vetëm të njihen me kontratën."*
Pretendimi kryesor i subjektit, i cili ka çuar edhe në garantimin e një aksesi të kufizuar në dokumentet zyrtare të kërkuara nga grupi i auditimit, ka të bëjë me faktin se marrëveshjet e nënshkruara për furnizimin me vaksina anti covid, sikundër citohet në emailin e znj. N. (e cila i referohet vetëm marrëveshjes me P. E. BV) për shkak të sekretit tregtar dhe konfidencialitetit nuk lejohet të publikohen në asnjë website apo në Fletoren Zyrtare.
Lidhur me sa më sipër, KLSH ju bën me dije se, referuar Ligjit nr. 154/2014 ""Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Neni 26 ""Aksesi në dokumentet zyrtare" parashikohet se:
1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, ***që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial*** *dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore; dhe se*
2. ***Të gjithë subiektet*** *e* ***audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit ti! Lartë të Shtetit akses në dokumentet zvrtare sipas paragrafit të mësipërm.*** *(.. .)".*
Nga sa më sipër, KLSH është ende në fazë auditimi në terren, ndërsa çështja e publikimit që MSHMS dhe ISHP ngre, i takon një faze të mëvonshme, e cila do të respektohet në përmbushje të kuadrit ligjor në fuqi. Si fillim, subjekti duhet të përmbushë detyrimin ligjor për tô garantuar KLSH akses të pakufizuar dhe të pa kushtëzuar në dokumentacionin e kërkuar me qëllim krijim e mundësisë për të audituar në mënyrë të pavarur këto dokumente.

Për problematikën e shpjeguar më sipër grupi i auditimit ka mbajtur aktkonstatimin nr. 1, datë 29.06.2021 me titullarin e Institutit të Shëndetit Publik, znj. A.F., në cilësinë e personit përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar.

2. Në këtë auditim është trajtuar **ankesa nga OE**
E.M. shpk me nr. 248 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 782 prot., datë 13.07.2021.

Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefekturat Shkodër, Lezhëò, me fond limit 9,943,883 lekë pa tvsh, Gusht, 2018.
Procedura e prokurimit zhvilluar me objekt: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 4 ñPrefektura Vlorëò, me fond limit 30,509,969 lekë pa tvsh, Gusht, 2018.

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ““Shërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, i ndarë në 2 (dy) lote”</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 29, nr. 1176, datë 07.08.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapur - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçareò</td><td>3. Njësia e prokurimit
E.R.
A.M.
B.A.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 380, nr. 1176/1, datë 07.08.2019.
A.A.
S.B.
E.D.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa tvsh)
Loti 1: 9,943,883 lekë
Loti 4: 30,509,969 lekë</td><td>6. Oferta Fituese (pa tvsh)
Loti 1: Shumatore çmimesh 51,010 lekë pa tvsh.
Loti 4: Shumatore çmimesh 74,010 lekë pa tvsh.</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave
09.09.2019, ora 09:00</td><td>9. Burimi i Financimit
Buxhetit i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
<table>
<tr><th>Loti 1</th><th>Oferta (shumatore çmimesh)</th><th>Shënime</th></tr>
<tr><td>N. SHPK</td><td>51,010.00</td><td>Kualifikuar</td></tr>
<tr><td>Akademia e Shëndetit Publik SHPK</td><td>34,402.50</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>A.SHPK</td><td>35,005.00</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>P.S SHPK</td><td>41,004.00</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>P.F F.L.</td><td>46,110.00</td><td>Skualifikuar</td></tr>
<tr><td>A.P. SHPK</td><td>50,035.00</td><td>Skualifikuar</td></tr>
</table>
<table>
<tr><th>Loti 4</th><th>Oferta (shumatore çmimesh)</th><th>Shënime</th></tr>
</table></td></tr>
</table>

		N. SHPK	74,010.00	Kualifikuar
		A. SHPK	44,005.00	Skualifikuar
		PF FL	73,705.00	Skualifikuar

11. Ankimime PO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** PO	**13. Përgjigje ankesës nga KPP** PO

b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave

14. Lidhje e kontratës: Marrëveshja Kuadër për Lotin 1 nr. 24/27, datë 27.04.2020. Marrëveshja Kuadër për Lotin 4 nr. 15/4, datë 29.01.2020.	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** Loti 1 me shumatore çmimesh 61,212 lekë me tvsh. Loti 4 me shumatore çmimesh 88,812 lekë me tvsh.		**16. Likuiduar:** Loti 1: 8,411,364 lekë. Loti 4: 25,886,844 lekë.	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Në proces zbatimi	**18. Afati i kontratës:** Loti 1: 24 muaj Loti 4: 24 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** N/A	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. Procesverbal i marrjes në dorëzim Në proces zbatimi	**23. Grupi i marrjes në dorëzim** Loti 1: Urdhri nr. 67, nr. 24/29, datë 28.04.2020: A.M., A.C. dhe Blerina Kodra. Loti 4: Urdhri nr. 56, nr. 15/9, datë 16.04.2020: A.M., A.C. dhe Blerina Kodra.		**24. Fletë Hyrja**: N/A	

Me anë të Urdhrit nr. 377, nr. 1142, datë 02.08.2019, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për përllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò. Sipas këtij urdhri, kjo procedurë është ndarë në 2 Lote:
-LOTI 1: òShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë dhe
-LOTI 4: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Vlorë.

Grupi i punës përbëhet nga:
1. ER, specialist/entomolog, kryetar,
2. A.M., ekonomiste, anëtare dhe
3. B.A., ekonomiste, anëtare.

Me anë të Procesverbalit nr. 1, nr. 1142/1, datë 07.08.2019, grupi i punës ka përllogaritur fondin limit në vlerat:

- Loti 1 në vlerën 9,943,883 lekë pa tvsh;
- Loti 4 në vlerën 30,509,969 lekë pa tvsh.

Në këtë procesverbal, grupi i punës është shprehur se ky është një përllogaritje e afërt, për arsye se:
-Është e pamundur të përcaktohen saktë sasitë e sipërfaqeve që duhen trajtuar. Përcaktimi i tyre është bërë bazuar në kontratat e realizuara në periudhën 2016-2018 dhe në kërkesat dhe rezultatet e monitorimeve të NJVKSH dhe Operatori përkatëse dhe respektive dhe Institutit të Shëndetit Publik. Përcaktimi i saktë i sipërfaqeve bëhet në vendin dhe kohën kur është i nevojshëm trajtimi i tyre.
-Është e pamundur të përcaktohen saktë numri i trajtimeve, pasi kjo është në funksion të kohës së fillimit të trajtimeve, të përhapjes dhe zhvillimit të mushkonjave si dhe në funksion të kushteve të motit.
-Është e pamundur të përcaktohen saktë koha kur duhet të bëhet shërbimi, pasi edhe kjo varet nga kushtet e motit (temperatura minimale e muajit më të fohtë), sidomos për zonat e reja, të cilat nuk kanë qenë eksperiencë e viteve të mëparshme dhe teknikat e reja në zona ekzistuese përgjatë bregdetit jugor.
-Varësia e shërbimit nga koha, temperatura, reshjet dhe lloji i insekteve (mushkonjave) që mund te identifikohen në valër, të cilat mund të ndryshojne nga eksperiencat e viteve të mëparshme.
Për këtë arsye, grupi i punës ka sugjeruar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër për këtë procedurë prokurimi.

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 29, nr. 1176, datë 07.08.2019, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, i *ndarë në 2 (dy) lote, si më poshtë vijon:*
-LOTI I: "Shërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë
*-LOTI IV: "Shërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Vlorë*ò, me fond limit Loti 1 në vlerën 9,943,883 lekë pa tvsh dhe Loti 4 në vlerën 30,509,969 lekë pa tvsh, me procedurë ñMarrëveshje Kuadër, me disa operatorë ekonomikë ï ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara ï me afat 2 vjeçarò, si dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga E.R, A.M.dhe B.A..
Me hartimin e urdhrit të prokurimit, është nisur zyrtarisht procedura e re e prokurimit, pas dështimit të të procedurës së parë. Sipas procesverbalit të analizimit të shkaqeve të anulimit të procedurës së parë për Lotet 1 dhe 4, konstatohet se:
Për Lotin 1 është kualifikuar vetër OE P.S.SHPK.
Për Lotin 4 është kualifikuar vetëm OE PF F.L..
ISHP nuk ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për arsye të lëndës A të ofertuar nga këta 2 OE të kualifikuar.
Me shkresën nr. 755/1, datë 03.06.2019, ISHP i është drejtuar MSHMS, në lidhje me produktin A në procesin e dezinsektimit.
Me shkresën nr. 3159, datë 11.06.2019 ñAnullim i Autorizimit të Importit për produktet A DF 3000 dhe A 200Gò, protokolluar në ISHP me nr. 755/12, datë 12.06.2019, MSHMS ka njoftuar ISHP mbi anulimin e autorizimit të importit për këto 2 produkte.
Bazuar në këtë shkresë, ISHP ka skualifkuar OE P.S.SHPK dhe OE PF F.L., si dhe nisur nga fakti që këta OE ishin të vetmit të kualifikuar, ka vijuar me anulimin e procedurës. Pas procesit të ankimimit, këto Lote janë anuluar përfundimisht me Vendimet e KPP nr. 490/2019, datë 24.07.2019 për Lotin 1 dhe dhe nr. 488/2019, datë 24.07.2019 për Lotin 4.

Me Urdhrin nr. 380, nr. 1176/1, datë 07.08.2019, titullari i AK ka ngritur KVO, të përbërë nga A.A., S.B. dhe E.D..
Njësia e Prokurimit, me anë të Procesverbalit nr. 1176/2, datë 07.08.2019 ñPër hartimin e

kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, ka miratuar kërkesat e përgjithshme dhe veçanta për kualifikim. Nga verifikimi i këtyre kritereve, u konstatua se:

-Në argumentimin e të gjithë kritereve të veçanta për kualifikim, NJP ka përdorur si argument nenit 28 ñKontratat e shërbimeveò, po pa argumentuar teknikisht vendosjen e tyre.

-Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.2, ndër të tjera është kërkuar që: ñ*Vlera mesatare e xhiros së 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë 40% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron*ò, po pa argumentuar se përse kërkon 40% të xhiros.

-Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.3.7, ndër të tjera është kërkuar që: ñ*a. OE duhet të ketë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren. Për këtë OE duhet të paraqesë:...*ò, kërkesë e cila është e pargumentuar dhe diskriminuese, për aryse se përveç pajisjeve kërkohet dhe punonjës që do kryerjnë kalibrimin e tyre, ndërkohë që kalibrimi është objekt fushëveprimi i institucioneve dhe/ose laboratorëve të certifikuar.

-Nuk është argumentuar teknikisht nga Njësia e Prokurimit, se përse kërkohet vetëm listëpagesa e muajit Korrik 2019 dhe çfarë sigurie do i ofronte AK vendosja e kësaj kërkese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, pika 1, e cila ndër të tjera përcakton se:

> *1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

> *Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*

-Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.7.e, janë kërkuar gjithsej, 1 Drejtues Teknik (Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1), 4 Teknikë Aplikimi (1 Loti 1 dhe 3 Loti 4) dhe 8 Aplikues (2 Loti 1 dhe 6 Loti 4), pra minimumi 13 punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri, OE ofertues duhet të paraqesin:

-CV (për Drejtuesin Teknik, Teknikun e Aplikimit dhe Aplikuesit);

-dhe listëpagesën e-sig 0-25, të paktën për muajin korrik 2019.

Por nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar asnjë dokumentacion provues për kualifikimet e këtyre punonjësve (si kontrata punësimi, certifikata kualifikimi, licenca përkatëse etj.), kërkesa të cilat në procedurën e mëparshme të anuluar për këto 2 lote i ka kërkuar (*Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të licencuar/certifikuar. Për secilin punonjës kompania duhet të paraqesë licencën/certifikatë, kontratën e punës, CV e Drejtuesit Teknik dhe Teknikut të Aplikimit, si dhe listpagesën e-sig.*). Mos kërkimi i këtyre kritereve paraqet risk për ISHP, pasi OE i shpallur fitues mund të mos ketë kualifikimet e duhura, por mjafton të paraqesi një CV për tu kualifikuar për këtë procedurë.

Veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërma a dhe b, të cilat përcaktojnë se:

> *5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*
> *a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
> *b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose*

komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Formulari i Njoftimit të kontratës nr. 1176/3, datë 07.08.2019, publikohet në Buletinin e APP datë 13.08.2019. Data e hapjes së procedurës do jetë data 02.09.2019, ora 09:00.
Me anë të shkresës datë 12.08.2019, protokolluar në ISHP me nr. 1176/4, datë 14.08.2019, O.N.SHPK ka kërkuar sqarim për vlerën e xhiros së kërkuar, nëse do kryhet vetëm për këtë procedurë apo të për 4 lotet sipas procedurës së pare të anuluar. Me shkresën nr. 1176/10, datë 16.08.2019, titullari i AK i kthen përgjigje OE për kërkesën për sqarim, duke e informuar se xhiro kërkohet vetëm për 2 lotet për të cilat është shpallur dhe jo për procedurën e anuluar.
Me anë të shkresave nr. 1176/5 dhe nr. 1176/6, datë 14.08.2019, OE A SHPK ka paraqitur ankesat e tij në lidhje me DT e publikuara për Lotin 1 dhe për Lotin 4, si dhe ka kërkuar sqarime mbi disa kërkesa.
Me anë të Urdhrit nr. 389, nr. 1176/7, datë 14.08.2019, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit në zbatim të ankesave të mbërritura. Ndërsa me Urdhrin nr. 390, nr. 1176/8, datë 14.08.2019, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës (KSHA) të përbërë nga E.B., G.Q. dhe P.K..
Me anë të procesverbalit të datës 15.08.2019, KSHA ka vendosur të pranojë pjesërisht ankimimet e OE.
Me anë të relacioneve drejtuar titullarit të AK nr. 1176/12, për Lotin 1 dhe nr. 1176/13, për Lotin 4, KSHA e informon titullarin e AK mbi vendimet e marra.
Me anë të shkresës nr. 1176/14 për Lotin 1, nr. 1176/15 për Lotin 4 dhe nr. 1176/16 për kërkesën për sqarim, datë 16.08.2019, titullari i AK e ka informuar mbi vendimin e KSHA për ankesat e dorëzuara, si dhe ka dërguar sqarimet e kërkuara.
Me anë të procesverbalit të datës 20.08.2019, njësia e prokurimit ka kryer ndryshimet në DT sipas procesit të ankimimit. Data e re e hapjes së procedurës, do jetë data 09.09.2019, ora 11:00. Ndërsa me shkresën nr. 1176/17, datë 20.08.2019, drejtuar titullarit të AK, i ka dërguar Shtojcën mbi ndryshimin e DST. Me shkresën nr. 1176/18, datë 20.08.2019, drejtuar APP, titullari i AK ka miratuar ndryshimin në DST.
Me Urdhrin nr. 389/1, nr. 1244, datë 26.08.2019, titullari i AK ka vendosur heqjen e pezullimit për Lotin 1 dhe Lotin 4.
Në lidhje me këtë procedurë shqyrtimit të ankimimeve, nuk konstatohet arsyeja që Njësia e Prokurimit ka miratuar ndryshimet në DST, më datë 20.08.2019, në kushtet kur titullari i AK ka miratuar vendimet e KSHA në datën 16.08.2019, ose 4 ditë me vonesë.

Sipas procesverbalit të vlerësimit të datës 12.09.2019, si dhe sistemit elektronik të APP, në datën e hapjes së ofertave (09.09.2019), konstatohet se kanë paraqitur ofertë OE si më poshtë vijon:
Për Lotin 1:

1. OE A. SHPK ka paraqitur ofertën me shumatore çmimesh në vlerën 35,005 lekë pa tvsh (vetëm ofertë asnjë dokumentacion tjetër),
2. OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK me shumatore çmimesh në vlerën 34,402.5 lekë pa tvsh ose me vlerë oferte 9,934,400 lekë pa tvsh,
3. OE A.P. SHPK me shumatore çmimesh në vlerën 50,035 lekë pa tvsh,
4. OE PF F.L. me shumatore çmimesh në vlerën 46,110 lekë pa tvsh,
5. O.N. SHPK me shumatore çmimesh në vlerën 51,010 lekë pa tvsh dhe
6. OE P.S. SHPK me shumatore çmimesh në vlerën 41,004 lekë pa tvsh ose me vlerë 7,728,840 lekë pa tvsh.

Për Lotin 4:

1. OE A. SHPK ka paraqitur ofertën me shumatore çmimesh në vlerën 44,005 lekë pa tvsh (vetëm ofertë asnjë dokumentacion tjetër),

2. OE PF F.L. me shumatore çmimesh në vlerën 73,705 lekë pa tvsh dhe
3. O.N. SHPK me shumatore çmimesh në vlerën 74,010 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 1, datë 12.09.2019, KVO ka vendosur ti drejtohet zyrtarisht OSHEE për arsye se sipas ekstraktit historik të tij, OE ekonomik PF F.L. ka dy adresa dhe ka paraqitur Vërtetimin e OSHEE nr. 7175, datë 14.08.2019, ku vërteton se nuk ka detyrime për adresën kryersore. Ndërsa për adresën tjetër, ka paraqitur kontratën e qiramarrjes datë 01.02.2019, nënshkruar me OE D.S. SHPK, me anë të së cilës këtë ambinet ja ka marrë me qira këtij OE për një periudhë 1 vjeçare, si dhe për këtë ambient ka paraqitur Vërtetimin e OSHEE nr. 18041/1, datë 02.09.2019, ku vërteton se nuk ka detyrime. Sipas kësaj kontrate, në nenin 2 të saj, parashikohet se detyrimet e energjisë elektrike dhe ujit, paguhen nga qiradhënësi (D.S.SHPK).
KVO do i drejtohet OSHEE për 2 pyetje: 1) Nëse numri i kontratës TR1C03039280950 të OE D.S.është i lidhur me adresën sekondare të OE PF F.L., si dhe 2) Kërkon shpjegime nga OSHEE se përse në vërtetimin e debisë së OE PF F.L. nuk figurojnë 2 numra kontrate.
Kërkesa i është përcjellë OSHEE me shkresën nr. 1176/20, datë 12.09.2019. Në shkresën e OSHEE nr. 7846/1, datë 17.09.2019 ñKthim përgjigjeò, protokolluar në ISHP me nr. 1176/21, datë 19.09.2019, përcaktohet se: ñ*1. Operatori ekonomik F.L. tek kerkesa e paraqitur nga vete ai ka kerkuar vertetim vetem per kontraten me kod TR1C030392254403 (titullar i se ciles eshte F.L.),e cila eshte dhe kontrata e selise qendore ku ushtron aktivitetin.*
2. Per adresen tjeter qe ka ne ekstraktin historik personi fizik F.L. ka paraqitur kontrate qeraje me subjektin D.S.ku deklarohet qe detyrimi per dritat do te paguhet nga qeradhensi ne rastin konkrret nga D.S.prandaj nuk ka deklaruar kontrate tjeter.
Kontrata me kod TR1C030392180950 titullar i se ciles eshte D.S.perkon me adresen sekondare te personit fizik F.L..
*Vertetimi i debise i leshuar nga OSHEE eshte i sakte dhe konform te gjitha rregullave*ò.
Pra OSHEE rikonfirmon dokumentacionin e paraqitur nga OE PF F.L.. Në zbatim të kësaj përgjigje, me anë të Procesverbalit të vlerësimit nr. 2, datë 23.09.2019, KVO e kualifikon OE PF F.L. për këtë kriter.

Në lidhje sa më sipër, kërkimi i sqarimeve dhe kryerja e verifikimeve, është një e drejtë e KVO e bazuar në nenin 66/2, të RRPP. Por nuk konstatohet arsyea e këtij verifikimi nga KVO për këtë OE, në kushtet kur OE PF F.L. në dokumentet e paraqitura në datën e hapjes së procedurës, i ka parqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar (konfirmuar dhe me shkresën e kthim përgjigje ardhur nga OSHEE). Për më tepër, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE e tjerë, konstatohet se:
-OE A.P. SHPK, ka paraqitur Vërtetimin e OSHEE nr. 3792, datë 23.08.2019, me anë të së cilit vërteton se nuk ka detyrime për kontratën nr. DU0A020109121862. Ndërkohë nga verifikimi i Ekstraktit historik të këtij OE, konstatohet se ka adresën kryesore dhe adresat e tjera, por ndërkohë ka paraqitur vërtetimin e OSHEE vetëm për 1 kontratë, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter, fakt të cilin KVO nuk e ka përmendur në kualifikimin e kryer.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 66, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

...komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO.

Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 3, datë 23.09.2019, KVO vendosi:
Për lotin 1: Skualifikimin e ofertave të OE A SHPK, A.P. SHPK, PF F.L., P.S.SHPK dhe Akademia e Shëndetit Publik SHPK, si dhe kualifikimin pa rezerva të ofertës së O.N.SHPK.
Për Lotin 4: Skualifikimin e ofertave të OE A SHPK dhe PF F.L., si dhe kualifikimin pa rezerva të ofertës së O.N. SHPK.

Pas procesit të vlerësimit, në ISHP kanë mbërritur ankesat e OE si më poshtë vijon:
Me shkresën nr. 1176/22, datë 27.09.2019, OE P.S.SHPK.
Me shkresën nr. 1176/23, datë 27.09.2019, OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK.
Me shkresën nr. 1176/24, datë 30.09.2019, OE PF F.L..
Në zbatim të këtyre ankesave, titullari i AK me Urdhrin nr. 423, nr. 1176/25, datë 30.09.2019, ka urdhëruar pezullimin e procedurës. Në lidhje me këtë urdhër, nuk konstatohet arsyeja që titullari i AK e ka pezulluar procedurën më datë 30.09.2019, ose 3 ditë pas marrjes së ankesave të OE P.S.SHPK dhe Akademia e Shëndetit Publik SHPK (datë 27.09.2019). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 63, pika 3, e cila përcakton se:

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 78, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-së.

Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK.

Me anë të Urdhrit nr. 424, nr. 1176/26, datë 30.09.2019, titullari i AK ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës (KSHA), të përbërë nga A.Y., E.T. dhe P.K..
Me anë të shkresës nr. 1176/27, datë 03.10.2019, drejtuar titullari të AK, KSHA vendos të mos pranojë ankesën e OE P.S.SHPK. Titullari i AK me anë të shkresës nr. 1176/29, datë 03.10.2019, i ka dërguar OE P.S.SHPK, përgjigjen ku e njofton mbi mos pranimin e ankesës sipas vlerësimit të kryer nga KSHA.
Me anë të shkresës nr. 1176/28, datë 03.10.2019, drejtuar titullari të AK, KSHA vendos të mos pranojë ankesën e OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK. Titullari i AK me anë të shkresës nr. 1176/30, datë 03.10.2019, i ka dërguar OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, përgjigjen ku e njofton mbi mos pranimin e ankesës sipas vlerësimit të kryer nga KSHA.
Me anë të shkresës nr. 1176/31, datë 04.10.2019, drejtuar titullari të AK, KSHA vendos të mos pranojë ankesën e OE PF F.L.. Titullari i AK me anë të shkresës nr. 1176/32, datë 04.10.2019, i ka dërguar OE PF F.L., përgjigjen ku e njofton mbi mos pranimin e ankesës sipas vlerësimit të kryer nga KSHA.
Në përgjigjet e dhëna ndaj ankesave të sipërcituara, AK është vonuar në marrjen e vendimit, e konkretisht;
-Për ankesën e OE P.S.SHPK, dërguar me shkresën nr. 1176/22, datë 27.09.2019, është kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 1176/29, datë 03.10.2019, ose brenda 6 ditësh.
-Për ankesën e OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, dërguar me shkresën nr. 1176/23, datë 27.09.2019, është kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. nr. 1176/30, datë 03.10.2019, ose brenda 6 ditësh.
-Për ankesën e OE PF F.L., dërguar me shkresën nr. 1176/24, datë 30.09.2019, është kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 1176/32, datë 04.10.2019, ose brenda 4 ditësh.

Me anë të shkresës nr. 1176/33, datë 15.10.2019, OE PF F.L. ka dërguar ankesën në KPP për Lotin 1, ndërsa me anë të shkresës nr. 1176/34, datë 15.10.2019, ka dërguar ankesën në KPP për Lotin 4.
KPP ka dërguar Vendimin nr. 1614/1, datë 15.10.2019, me anë të të cilit ka vendosur shqyrtimin në themel të ankesës për Lotin 1 dhe pezulliomin e procedurës. Ndërsa me Vendimin nr. 1620/1,

datë 18.10.2019, me anë të të cilit ka vendosur shqyrtimin në themel të ankesës për Lotin 4 dhe pezulliomin e procedurës
Me anë të shkresës nr. 1176/38, datë 21.10.2019, OE P.S.SHPK ka dërguar ankesën në KPP për Lotin 1.

Ndërkohë, sipas Buletinit të APP datë 28.10.2019, OE PF F.L., me seli në Tiranë, përjashtohet ï 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, duke filluar prej datës 23.10.2019 ï 23.04.2021.

ISHP me shkresat nr. 1176/48, nr. 1176/49 dhe nr. 1176/50, datë 04.12.2019, drejtuar KPP, i kërkon marrjen e masave për shqyrtimin e ankesës brenda afatit të përcaktuar.
Sërisht, ISHP me shkresat nr. 1176/52, nr. 1176/53 dhe nr. 1176/54, datë 16.12.2019, drejtuar KPP, i kërkon marrjen e masave për shqyrtimin e ankesës brenda afatit të përcaktuar, në kushtet kur nuk ka një përgjigje nga ky institucion.
Ndërsa me anë të emailit të datës 20.12.2019, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (info@shendetesia.gov.al), i kërkohet asistencë për hapat e mëtejshëm, në kushtet kur nga KPP nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

KPP me anë të shkresës nr. 798/1, datë 20.12.2019, protokolluar në ISHP me nr. 1176/56, datë 24.12.2019, dërgon Vendimin nr. 798/2019, me anë të të cilit, ndër të tjera ka vendosur që: ñ*1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me nr. REF-33068-08-07-2019, me objekt: LOTI 1: "Shërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë", me fond limit 9,943,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.09.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.*
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "P.S." sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "F.L." p.f. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k., si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
*5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*ò.
Ndërsa me anë të shkresës nr. 799/1, datë 20.12.2019, protokolluar në ISHP me nr. 1176/57, datë 24.12.2019, KPP dërgon Vendimin nr. 799/2019, me anë të të cilit, ndër të tjera ka vendosur që: ñ*1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "F.L." p.f.. për procedurën e prokurimit, "Procedurë e hapur", me nr. REF-33070-08-07-2019, me objekt: LOTI 4: "Shërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Vlorë", me fond limit 30,509,969 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.09.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.*
*2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit të sipërcituar.*ò.
KPP në vendimmarjen e mësipërme, e ka tejkaluar afatin ligjor 15 ditor, në kundërshtim me - Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 63, pika 9, e cila përcakton se:

9. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar.
Përjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15-ditor, duhet t'i bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mosmarrjes së

këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik.

Në zbatim të vendimeve të mësipërme të KPP, titullari i AK me anë të Urdhrit nr. 509, nr. 1176/58, datë 26.12.2019, ka vendosur vendosur heqjen e pezullimit për Lotin 1 dhe vazhdimin e procedurës sipas përcaktimeve ligjore, ndërsa me anë të Urdhrit nr. 510, nr. 1176/59, datë 26.12.2019, ka vendosur vendosur heqjen e pezullimit për Lotin 4 dhe vazhdimin e procedurës sipas përcaktimeve ligjore.
Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 4, datë 30.12.2019, si dhe me shkresën nr. 1176/60, datë 30.12.2019, KVO ka informuar titullarin e AK, se KPP gjatë vendimmarjes së tij për OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, në lidhje me kriterin e kapacitetit teknik, pika 2.b, i është referuar gabimisht kriterit 2.a.
Titullari i AK me anë të shkresës nr. 1176/61, datë 30.12.2019 ñKërkesë për rishikim të vendimit të KPP-së me nr. 798/2019, datë 20.12.2019ò, i ka dërguar kërkesën për rishikim të Vendimit nr. 798/2019, duke marrë parasysh faktet e ISHP. KPP ka dërguar Vendimin nr. 798/3, datë 07.01.2020, me anë të së cilit refuzon kërkesën e ISHP dhe lë në fuqi vendimin nr. 798/2019.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 1176/62, datë 31.12.2019, titullari i AK ka miratuar procedurë, si dhe shpalljen fituese të ofertës së O.N.SHPK me shumatore çmimesh 74,010 lekë pa tvsh.
Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër për Lotin 4, është dërguar me anë të shkresës nr. 15, datë 07.01.2020, për O.N. SHPK.

Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 5, datë 10.01.2020, KVO vendosi ti kërkojë shpjegime OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK për arsye se oferta e tyre është anomalisht e ulët. Me anë të shkresës nr. 24/4, datë 13.01.2020, drejtuar OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, titullari i AK i dërgon kërkesën për shpjegime.
Ndërsa me shkresën nr. 24/5, datë 15.01.2019 ñKthim përgjigje për vendimin e KPP nr. 798/2019, 798/3/2019, datë 07.01.2020ò, titullari i AK i kërkon KPP sqarime të ofertës anomalisht të ulët.

Me anë të procesverbalit të datës 14.01.2020, KVO ka marrë në shqyrtim dokumentacionin fizik të OE të shpallur fitues për Lotin 4 N. SHPK dhe me shkresën nr. 15/2, datë 14.01.2020, drejtuar titullarit të AK, rekomandon lidhjen e kontratës.
Me shkresën nr. 15/3, datë 24.01.2020, drejtuar O.N. SHPK, titullari i AK i dërgon njoftimin për nënshkrimin e marrëveshjes kuadër.

Me anë të shkresës së protokolluar në ISHP me nr. 24/7, datë 16.01.2020, OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK ka dërguar shpjegimet e tij në lidhje me ofertën anomalisht të ulët. Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 6, datë 22.01.2020, KVO vendosi ti ridërgojë kërkesën për sqarime OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, për arsye se në shpjegimin e dhënë nga ky OE, nuk ka shpjeguar ofertën sipas shumatores për njësi për çdo element të saj, si dhe konstatohen gabime aritmetikore në mbledhjen e kostove, kërkesë e cila i është përcjellë këtij OE me shkresën e titullarit të AK nr. 24/9, datë 22.01.2020.
OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK me anë të shkresës së datës 27.01.2020, protokollaur në ISHP me nr. 24/10, datë 27.01.2020, ka dërguar pretendimet e tij në lidhje me kërkesën për sqarime të dërguar nga ISHP. Me anë të Procesverbalit të Vlerësimit nr. 7, datë 31.01.2020, KVO vendosi të mos pranojë shpjegimet e dhëna nga OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, për arsye se të dhënat e këtij OE janë kondradiktore dhe nuk ka dhënë informacion në lidhje me koston anomalisht të ulët për shumatoren e çmimeve për njësi të ofertës së tij 34,402,.5 lekë pa tvsh, e kërkuar qartësisht në dy shkresat për sqarim të dërguara nga KVO. Për pasojë, KVO vendosi

skualifikimin e ofertës së OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK.
Në zbatim të këtij rivlerësimi, OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK ka dërguar ankesën e tij, e cila është protokolluar në ISHP me nr. 24/12, datë 06.02.2020.
Në zbatim të kësaj ankese, titullari i AK me anë të Urdhrit nr. 25, nr. 24/13, datë 07.02.2020, ka vendosur pezullimin e procedurës për Lotin 1, si dhe me anë të Urdhrit nr. 26, nr. 24/14, datë 07.02.2020, ka ngritur KSHA e përbërë nga A.Y., X.M.j dhe V.J..
Me anë të shkresës nr. 24/15, datë 12.02.2020, drejtuar titullarit të AK, KSHA e informon se nuk pranohet ankesa e OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK. Titullari i AK i dërgon përgjigjen e KSHA OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, me anë të shkresës nr. 24/16, datë 12.02.2020.
KPP me anë të Vendimit nr. 208/1, datë 24.02.2020, protokolluar në ISHP me nr. 24/17, datë 27.02.2020, urdhëron pezullimin e procedurës (për Lotin 1) deri në shqyrtimin e ankesës së OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK.
KPP me anë të shkresës nr. 118/1, datë 01.04.2020, protokolluar në ISHP me nr. 24/20, datë 06.04.2020, ka dërguar Vendimin nr. 118/2020, me anë të të cilit vendos të mos pranojë ankesën e OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK dhe lejon ISHP të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
Me anë të Urdhrit nr. 50, nr. 24/21, datë 07.04.2020, titullari i AK ka urdhëruar heqjen e pezullimit të procedurës.
Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 24/22, datë 14.04.2020, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe shpalljen fituese për Lotin 1 të ofertës së O.N. SHPK.

Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm për O.N.SHPK është dërguar me shkresën nr. 24/23, datë 15.04.2020.
Me anë të procesverbalit të datës 22.04.2020, KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin fizik të OE të shpallur fitues N. SHPK dhe me shkresën nr. 24/25, datë 22.04.2020, rekomandon titullarin e AK për lidhjen e kontratës.
Me shkresën nr. 24/26, datë 23.04.2020, drejtuar O.N.SHPK, titullari i AK i dërgon njoftimin për nënshkrimin e marrëveshjes kuadër për Lotin 1.

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë vijon:
Për Lotin 1:
ñ***I. A. shpk***

1. *Nuk eshte paraqitur asnje dokument ne lidhje me permbushjen e kritereve te pergjithshme dhe te vecanta te DST-ve, por eshte paraqitur vetem formulari i ofertes.*

II. A.P. shpk

1. *Në formularin Deklaratë e paraqitjes së ofertës së pavarur, shtojca 1/1 nuk keni plotësuar sipas kërkesave të saj nuk keni klikuar tek pika 6.*
2. *Mungon Autorizimi i prodhuesit/ distributor i atuizuar nga prodhuesi për produkete Bti-ËG dhe Bti-G, nuk ploteson nenpiken 5 e pikes 3.3 "kapacitetit teknik tek shtojca 8*
3. *Mungon certifikatat e rregjistrimit te produkteve, Certifikata e paraqitur nga ana juaj për për produktet biocide, eshte certificate jo e vlefshme,sic është shkruar në gjuhën francize (të papërkthyer nga ana juaj), Kjo certifikatë është jo e vlefshme që prej datës 29 qershor 2018, si për produktin Aquabc DF3000 dhe A 200G.*
4. *Ne foton e paraqitur nga ana juaj është paraqitur foto e makinës bashkë me aparatin mjegullues, i cili në foto ka emrin Flexigun, ndërkohë që juve si skedë teknike keni paraqitur Tifone City 460 DL, për të cilën nuk ka as karakteristika teknike sipas ndonje skede teknike ose katalogu përkatës. Gjithashtu në foto nuk janë të dukshme ndonjë numër identifikimi të aparatit mjegulles*
5. *Dozatorët të paraiqtur vetëm si foto nga ana juaj, nuk janë dozatorë, nuk plotësojnë specifikimet teknike, por janë atomizatorë.*
6. *Nuk keni paraqitur skedë teknik/datalog për atomizatorë me motor për granula*
7. *Nuk keni paraqitur Deklaratën për dozatorët.*

8. *Nuk keni paraqitur as skedë teknike/ catalog të produktit për produktin Film Monomolekular (MMF).*
9. *Totali i cmimeve (tek formulary i shumatores për njësi), sipas sasive të parashikuara kalojnë fondin limit në total (vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër) për Lot 1. Kjo nuk është në përputhje me pikën 4.2* ***Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:****, tek Njoftimi i kontratës së DST-ve.*
10. *Certifikata për kompaninë Alba Energ shpk, është certifikatë inspektimi, e cila nuk mund të provojë kryerjen kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave teknike dhe produktet që do të përdoren në këtë procedure.*

III. F.L. pf

1. *Fatura doganore më dt 04/05/2016 me numër referimi 431 shoqëruar me faturat me nr134 datë 22/04/2016),Vërtetimi i njësisë së kopjes me origjinalin me nr 866 Rep (nuk shpjegon dokumentin që është noterizuar njësi me oprigjinalin sipas nenit 129 të ligjit 110/2018 "për noterinë) Dokumenti është i pasaktë si njësi me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
2. *Vërtetimi njësi me origjinalin me nr Rep 2776 datë 05-09-2019 ka noterizuar sipas shpjegimit të noterit vetëm "Vërtetimin e firme me nr rep 710 datë 19-03-2019, notere R.H.. Dokumentat doganore me nr 431 datë 04/05/2016 dhe faturat shoqëruese me nr134 datë 22/04/2016 e S. T., bashkëlidhur këtij vërtetimit me nr 2776 Rep, nuk janë njësuar me origjinalin dhe nuk janë origjinale. Për sa më sipër, nuk janë njësuar me origjinalin sipas Nenit 129 të ligjit nr 110/2018" për noterinë. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.*
3. *Dokumenti "konformitet i dosjes lidhur me substancën active…." Dt 08/09/2016, është dokument kopje dhe jo njësi me origjinalin (është përkthyer edhe nga përkthyesja përkatëse që është kopje).*
4. *Autorizim nga Distributori C. më datë 13/08/2019 dhe marrëveshja përkatëse midis distributorit C. dhe prodhuesit B. M. products nuk është njësuar me origjinalin. Vërtetimi i noterit (I cili bashkelidh keto dokumenta) me nr 2662 rep datë 29/08/2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm për" Vërtetimin e firmës nr 2080 rep datë 29-08-2019 nga notere R.H." dhe "vërtetimin e firmës nr 2089 rep, datë 28-08-2019 notere R.H.". Noterizimi nuk është kryer konform nenit 129 të ligjit nr 110/2018. Nuk vërteton së është njësi me origjinalin dokumentat Autorizimi i distributorit dhe marërveshja midis distributorit dhe prodhuesit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
5. *Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin A 200G dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2663 datë 29-08-2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm të "Vërtetim firme 2091 rep, dt 29/08/2019 notere R.H." dhe "Vërtetim firme 2088 rep, dt 29/08/2019" notere R.H., pra është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
6. *Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin A DF3000 dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2664 datë 29-08-2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm të Vërtetim firme 2090 rep, dt 29/08/2019 notere R.H. dhe Vërtetim firme 2077 rep, dt 28/08/2019 notere R.H., është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
7. *Dokumenti i të dhënave të sigurisë (skeda teknike) për biocidet A DF 3000 të vitit 2018, janë shoqëruar vetëm më vërtetim përkthimi 2087 Rep datë 29/08/2019, dhe A 200G i shoqëruar vetëm më vërtetim përkthimi me nr 2086 datë 29/08/2019 dhe këto dokumenta nuk janë origjinale ose të njësuar me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8, Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
8. *Deklarata për përbërist aktiv Aquabc 200G dhe A DF 3000, nga C. drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe dokumentat shoqëruese, nuk është vërtetuar njësia me*

origjinalin por është vërtetuar njësi me origjinalin sipas përshkrimit të noteres "Vërtetim firme me nr 1409 datë 17/06/2019 të R.H.", noterizimi nuk është në bazë të nenit 129 të ligjit 110/2018 "Për noterinë". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

9. *Dokumenti "Vendim lidhur me kërkesën për Autorizim për tregëtimin e produktit bioacid", lëshuar nga A. datë 19/08/2019 për A DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe A 200 G me nr. FR 2019-0099., nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Eshtë kryer vetëm "vërtetim firme i përkthyeses me nr. 2116, datë 02/09/2019". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
10. *Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar sespe nuk plotëson specifikimet teknike në DST e tenderit.OE duhet të disponojë Dozator për lëng,* ***i*** *cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m^2. Me dozatorin e paraqitur nga ana juaj nuk mund të verifikohet saktësisht matja 1ml.*
11. *Nuk ka paraqitur asnjë dokument apo informacion për rregjistrimin tek E. te produkteve Biocide për A 200G dhe A DF3000. Nga verifikimet ne ëeb site e E., u verifikua qe produkti A 200G eshte ne statusin e anulluar (cancelled); dhe A DF 300 eshte po gjitashu ne statusin e anulluar (cancelled)(ne France).*
12. *Formulari i ofertës është gabim nuk është paraqitu****r sipas DST-ve per Lot.1***

KVO- ja, ne lidhje me dokumentat e paraqitura për produktet biocide (aquabc200G dhe aquabca DF 3000), te paraqitura nga OE F.L. verifikoi ne ëeb sitet si me poshte me daten 23/09/2019:

- ***site E. në lidhje me rregjistrimin e produkteve biocide*** *në lidhje me produktet, A 200 dhe A DF 3000 https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid dhe https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0009287-0000/authorisationid, rezultuan me statusin anulluar (cancelled) për Francën nga i cili eshte paraqitur dokumentacioni.*
- ***site e distributori C.,*** *lidhje me produktet, A 200G dhe A DF 3000 http://C.-biocide.fr/A-df3000/ dhe http://C.-biocide.fr/A-200g/, vazhdojne te jenë të paraqitur vetëm rregjistrimet FR -2016-0054 për A DF 300 dhe FR -2016-0053 A200G, si dhe skedat teknike jane end te vitit 2016.*
- ***site A. ne lidhje me rregjistrimin e biocideve.*** *Nga verifikimet rezultuan se produktet A DF 3000 ka rregjistrimin FR2016-0054 dhe Vendimi i publikuar ne ëebsite eshte ende i anulluar. Gjitashtu edhe produkti A 200G, i cili ka rregjistrimin FR 2016-0053, Vendimi i publikuara eshte i anulluar. Vendimet e A. te publikuara jane te anulluara qe prej dates 29 June 2018. https://www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/ADF3_PB-13-00424_BAMM_D.pdf dhe https://www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/A200G_PB-13-00422_BAMM_D.pdf*

IV. P.S.shpk

1. *Dokumenti "Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid", lëshuar nga A. datë 19/08/2019 për A DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe A 200 G me nr. FR 2019-0099, nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Ky dokument është shoqëruar vetëm vërtetimi i përkthimit, dhe nuk është paraqitur origjinali ose njësia me origjinalin. Çertifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së mjedist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Bti BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 62637-3, është paraqitur vetëm përkthimi dhe dokumentat nuk janë original dhe njësinë me origjinalin. (Edhe dokumenti i letrës se A. së dt 08 Shtator 2016, është dokument kopje, e cila vërtetohet edhe nga përkthimi). Dokumentat e mësipërme nuk janë të rregullta. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
2. *Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për A 3000DF, është paraqitur vetëm me vërtetim të përkthimit dhe jo origjinal ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2019-03-10; data e prodhimit mars: 2019 dhe data e skadimit Mars 2021. (si dhe jane shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhena keto te cilat nuk jane ne dokumentin ne gjuhen angleze)*

   Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për A 200G, është paraqitur vetëm me vërtetim përkthimi dhe jo origjinali ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2018-12-01;

data e prodhimit Dhjetor: 2018 dhe data e skadimit: Dhjetor 2021. (si dhe jane shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhena këto të cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Pra në dokumentin e përkthyer janë shtuar shënime të cilat nuk janë në dokumentat në gjuhën angleze. Dokumentat e paraqitura më sipër nuk janë njësi me origjinalin ose origjinale Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.

3. *Skedat teknike të A 200 g dhe A DF 3000 të vitit 2018 nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi. Fishat teknike te paraqitura nga C., të vitit 2019 (edhe pse Fishat teknike të viti 2019 nuk janë hartuar nga kompania prodhuese), nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.*
4. *Nuk është paraqitur asnje informacion apo dokumentacion në lidhje me rregjistrimin në E. të produkteve Biocideve A 200 G dhe A DF 3000.. U verifikua edhe në sistemin e E. dhe produktet e ofruara sipas ëeb site janë ne statusin e anulluar, për Francën*
5. *Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar. Dozatori i parqitur nga ju nuk plotëson specifikimet teknike të cilat kërkohen nga DST e tenderit "shtojca 9 ", ku kërkohet se "….. OE duhet të disponojë Dozator për lën**g, i** cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m². Skeda teknike e paraqitur nga ana e P.S.shpk është dozator mekanik i rregullueshëm (D.gr), e cila tregon qartësisht tek fusha e aplikimit të pasijes e cila përdoret për produkte me formulime granule me doze (nga 2gr -10 gr), ndërkohë që DST e kërkojnë për perdorim me formulim leng deri ne 1ml. Nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim ne lidhje paisjen Dozatore MMF dhe specifikimet teknike per Dozatorin per MMF.*
6. *Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën(2), më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e cmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit, dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP "Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër".*

KVO- ja, ne lidhje me dokumentat e paraqitura për produktet biocide (aquabc200G dhe aquabca DF 3000), te paraqitura nga OE P.S.verifikoi ne ëeb sitet si me poshte me daten 23/09/2019:

- *site E. në lidhje me rregjistrimin e produkteve biocide në lidhje me produktet, A 200G dhe A DF 3000 https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid dhe https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0009287-0000/authorisationid, rezultuan me statusin anulluar (cancelled) për Francën,nga i cili eshte paraqitur dokumentacioni.*
- *site e distributori C., lidhje me produktet, A 200G dhe A DF 3000 http://C.-biocide.fr/A-df3000/ dhe http://C.-biocide.fr/A-200g/, vazhdojne te jenë të paraqitur vetëm rregjistrimet FR -2016-0054 për A DF 300 dhe FR -2016-0053 A200G, si dhe skedat teknike jane end te vitit 2016.*
- *site A. ne lidhje me rregjistrimin e biocideve. Nga verifikimet rezultuan se produktet A DF 3000 ka rregjistrimin FR2016-0054 dhe Vendimi i publikuar ne ëebsite eshte ende i anulluar. Gjitashtu edhe produkti A 200G, i cili ka rregjistrimin FR 2016-0053, Vendimi i publikuara eshte i anulluar. Vendimet e A. te publikuara jane te anulluara qe prej dates 29 June 2018. https://www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/ADF3_PB-13-00424_BAMM_D.pdf dhe https://www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/A200G_PB-13-00422_BAMM_D.pdf*

V. Akademia Shëndetit Publik.

*OE Akademia e Shëndetit Publik shpk, është skualifikuar, për arsye se oferta e tij është anomilsht e ulët, bazuar në formulën përkatëse për përllogaritjen e saj. OE ka paraqiotur sqarime të cilat nuk janë të sakta që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementët e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht (edhe nga KPP në vendimin nr. 118/2020 datë 01.04.2020) është gjykuar se nga ana e OE ankimues nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht i ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, si dhe sipas kërkesave të AK-së.*ò

Për Lotin 4:

"*I. A. shpk*

1. *Nuk ka paraqitur asnje dokument ne lidhje me permbushjen e kritereve te pergjithshme dhe te veçanta te DST-ve, por eshte paraqitur vetem formulari i ofertes.*

II. F.L. p.f –LOT 4

7. *Vërtetimi (I njësisë me origjinalin)me nr 2542 rep, datë 20/08/2019 është paraqitur i njëjtë për tre dokumenta të ndryshme Dokumentat njësi me origjinalin janë të vecanta:*
   - *Fatura doganor datë 04/05/2016 shoqëruar me faturë nga S. T. datë 22/04/2016 me nr 134 është njësuar me Vërtetim njësi me origjinalin me nr. 2542 rep, datë 20/08/2019.*
   - *Fatura doganore datë 13/06/2016 me n. ref 674, shoqëruar nga fatura nga S. T. me nr. 226 datë 31/05/2016, është noterizuar përsëri me të njëjtin Vërtetim njësi me origjinalin me nr 2542 rep, datë 20/08/2019*
   - *Fatura doganore datë 22/05/2014 me nr ref M62, shoqëruar nga fatura nga T. me nr.OX/61 datë 08/05/2014, është noterizuar përsëri me të njëjtin Vërtetim njësi me origjinalin me nr 2542 rep, datë 20/08/2019.*
   - *Edhe për faturën e atomizatorit me shpine me motor per granula është paraqitur po një dokument i vecantë i ili është po vërtetim njësi me origjinalin me nr2542 rep datë 20/08/2019 shoqëruar nga fatura doganore dt 04/05/2016, me faturën S. T. datë 22/04/2016 me nr 134*

Dokumentat janë të ndryshëm dhe Vërtetimi njësisë me origjinalin paraqitet tre herë i njëjtë për dokumenta të ndryshme. Dokumentat janë noterizuar jo në zbatim të ligjit 110/2018 "për noterinë", neni 129. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi, dhe bazuar në shtojcën nr 8.

8. *Foto e makinës ku tregohen të dhënat e numrit të identifikimit të aparatit mjegullues, për makinën me Targa x dhe y është paraqitur e njëjta foto ku tregohet numri i identifikimit të aparatit mjegullues. Aparati në foto është Spray T., ndërsa në foto është OBL me të njëjtat numra TIP RCC 16A95TLMO Serial Numbër 2016P0025. Këto numra janë të njëjta për të dyja makinat të cilat janë të prodhuesit Spray T.. (ndërkohë që në fotot e tjera jepet të dhënta ekzakte referuar nr. të serisë së makinave.).*
9. *Dokumenti "konformitet i dosjes lidhur me substancën active…." Dt 08/09/2016, është dokument kopje dhe jo njësi me origjinalin (është përkthyer edhe nga përkthyesja përkatëse që është kopje).*
10. *Autorizim nga Distributori C. më datë 13/08/2019 dhe marrëveshja përkatëse midis distributorit C. dhe prodhuesit B. M. products nuk është njësuar me origjinalin. Vërtetimi i noterit me nr 2662 rep datë 29/08/2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm për" Vërtetimin e firmës nr 2080 rep datë 29-08-2019" nga notere R.H." dhe "vërtetimin e firmës nr 2089 rep, datë 28-08-2019 notere R.H.". Noterizimi nuk është kryer konform nenit 129 të ligjit nr 110/2018. Nuk vërteton së është njësi me origjinalin Autorizimi i distributorit dhe marërveshja midis distributorit dhe prodhuesit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
11. *Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin A 200G dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2663 datë 29-08-2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm të Vërtetim firme 2091 rep, dt 29/08/2019 notere R.H. dhe Vërtetim firme 2088 rep, dt 29/08/2019 notere R.H., pra është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.*
12. *Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin A DF3000 dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2664 datë 29-08-2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm të Vërtetim firme 2090 rep, dt 29/08/2019 notere R.H. dhe Vërtetim firme 2077 rep, dt 28/08/2019 notere R.H., është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.*
13. *Dokumenti i të dhënave të sigurisë (skeda teknike) për biocidet A DF 3000 të vitit 2018, janë shoqëruar vetëm më vërtetim përkthimi 2087 Rep datë 29/08/2019, dhe A 200G i shoqëruar vetëm më vërtetim përkthimi me nr 2086 datë 29/08/2019 dhe këto dokumenta nuk janë origjinale ose të*

njësuar me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.

14. *Deklarata për përbërist aktiv Aquabc 200G dhe A DF 3000, nga C. drejtuar Ministrisë së Shëndetëssië dhe Mbrojtjes Sociale, dhe dokumentat shoqëruese, nuk është vërtetuar njësia me origjinalin por është vërtetuar njësi me origjinalin sipas përshkrimit të noteres "Vërtetim firme me nr 1409 datë 17/06/2019 të R.H.", noterizimi nuk është në bazë të nenit 129 të ligjit 110/2018 "Për noterinë". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi*
15. *Dokumenti "Vendim lidhur me kërkesën për Autorizim për tregëtimin e produktit bioacid", lëshuar nga A. datë 19/08/2019 për A DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe A 200 G me nr. FR 2019-0099., nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Eshtë noterizuar njësi me origjinalin sipas pershkrimit të noterit vetëm "vërtetim firme i përkthyeses me nr 2116 datë 02/09/2019". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.*
16. *Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar sespe nuk plotëson specifikimet teknike në DST e tenderit.OE duhet të disponojë Dozator për lëng,* ***i*** *cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m^2. Me dozatorin e paraqitur nga ana juaj nuk mund të verifikohet saktësisht matja 1ml.*
17. *Nuk ka paraqitur asnjë dokument apo informacion për rregjistrimin tek E. te produkteve Biocide për A 200G dhe A DF3000. Nga verifikimet ne ëeb site e E., u verifikua qe produkti A 200G eshte ne statusin e anulluar (cancelled); dhe A DF 300 eshte po gjithashtu ne statusin e anulluar (cancelled)*

Për sa më sipër OE F.L. pf, nuk ploteson kriteret e veçanta për kualifikim (pika 2 e shtojces 8); pika 3.3 kapaciteti teknik, pika 2 (për faturat e paisjeve te aparatit mjegullues dhe pompe me presion të lartë, (bazuar ne modifikimet e DST-ve), dhe per faturat e blerjes së atomizatorit të granulave dhe atë për lëng), pika 3 (shkronja a dhe b), pika 4, dhe pika 5 i cili nuk janë të saktë sipas DST-ve (duke përfshirë modifikimet). Dokumentat nuk janë origjinale ose njësi me origjinalin, sipas paragrafit të fundit të shtojcës 8.

KVO- ja, ne lidhje me dokumentat e paraqitura për produktet biocide (aquabc200G dhe aquabca DF 3000), te paraqitura nga OE F.L. verifikoi ne ëeb sitet si me poshte me daten 23/09/2019:

- *site E. në lidhje me rregjistrimin e produkteve biocide në lidhje me produktet, A 200 dhe A DF 3000 https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid dhe https://E..europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0009287-0000/authorisationid, rezultuan me statusin anulluar (cancelled) për Francën nga i cili eshte paraqitur dokumentacioni.*
- *site e distributori C., lidhje me produktet, A 200G dhe A DF 3000 http://C.-biocide.fr/A-df3000/ dhe http://C.-biocide.fr/A-200g/, vazhdojne te jenë të paraqitur vetëm rregjistrimet FR -2016-0054 për A DF 300 dhe FR -2016-0053 A200G, si dhe skedat teknike jane end te vitit 2016.*
- *site A. ne lidhje me rregjistrimin e biocideve. Nga verifikimet rezultuan se produktet A DF 3000 ka rregjistrimin FR2016-0054 dhe Vendimi i publikuar ne ëebsite eshte ende i anulluar. Gjitashtu edhe produkti A 200G, i cili ka rregjistrimin FR 2016-0053, Vendimi i publikuara eshte i anulluar. Vendimet e A. te publikuara jane te anulluara qe prej dates 29 June 2018. https://www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/ADF3_PB-1300424_BAMM_D.pdf dhe https:/www.A..fr/en/system/files/biocides/decisions/A200G_PB-13-00422_BAMM_D.pdf*ö.

Në lidhje me vlerësimin e kryer për O.N.SHPK, konstatohet se:
-O.N. SHPK ka paraqitur listëpagesën për muajin korrik ku vërteton se ka 14 punonjës, nga të cilët, D.C.me detyrë Menaxhere e Përgjithshme, D.R.me detyrë nëpunës informacioni dhe A.P. me detyrë ekonomiste, pranë këtij OE. Për të tre këta punonjës, sipas CV së paraqitur, kanë kryer një trajtim 5 ditor (mars 2019), me temë Teknik Shërbimesh DDD, pranë Akademisë së Shëndetit Publik.
Në kërkesat e parashikuara në Shtojcën 8, për Lotin 1 dhe Lotin 4, kërkohen gjithsej, 1 Drejtues Teknik (Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1), 4 Teknikë Aplikimi (1 Loti 1 dhe 3 Loti 4) dhe 8 Aplikues (2 Loti 1 dhe 6 Loti 4), pra minimumi 13

punonjës.
O.N.SHPK ka paraqitur, 2 Drejtues Teknik G.M.dhe F.N.), ndërsa ka paraqitur edhe CV për 12 punonjësit e tjerë, ku është përcaktuar që kanë kryer një trajnim 4-6 ditor me objekt Teknik Shërbimesh DDD, ku 3 nga këta punonjës e kanë kryer pranë OE G. srl ndërsa 9 të tjerët pranë OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, sipas formatit të mëposhtëm:

Nga 07 deri me 11 mars 2019 trajnim me temë **Teknik Sherbimesh DDD** prane **Akademia e Shendetit Publik.** Trajnimi konsiston ne luften kunder infestuesve dhe teknikat e perdorimit te pajisjeve.

Si konkluzion, *OE do e kryerjë shërbimin e Dezinsektimit të këtyre procedure, me punonjës për të cilët ISHP nuk ka asnjë siguri mbi kualifikimet, certifikatat dhe licencat e tyre, dhe për më tepër, ka paraqitur si teknikë/aplikues, menaxheren e përgjithshme, nëpunësin e informacionit dhe ekonomisten e shoqërisë*. Ndikimi në këtë situatë, ka patur fakti i mos kërkimit në DT të kërkesave të tilla nga Njësia e Prokurimit.
Për sa më sipër, ky OE nuk duhej kualifkuar për këtë kriter. Këto veprime janë në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 55, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 66, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit

Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte O.N.SHPK e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se:

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO dhe Njësisë së Prokurimit (për kriterin vetëm).

O.N. SHPK ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Kontratës nr. 058418, datë 09.01.2020, me vlerë 3,661,196.28 lekë.
Marrëveshja Kuadër për Lotin 4 nr. 15/4, datë 29.01.2020, me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit, si dhe sipas kushteve të përcaktuara në procedurën e prokurimit, është nënshkruar nga znj. A.F. për AK dhe znj. D.C.për O.N. SHPK.

O.N.SHPK ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Kontratës nr. 059147, datë 20.04.2020, me vlerë 1,193,266 lekë.
Marrëveshja Kuadër për Lotin 1 nr. 24/27, datë 27.04.2020, me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit, si dhe sipas kushteve të përcaktuara në procedurën e prokurimit, është nënshkruar nga znj. A.F. për AK dhe znj. D.C.për O.N. SHPK.

Me anë të Urdhrit nr. 67, nr. 24/29, datë 28.04.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për monitorimin e zbatimit të kontratave të nënshkruara në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 24/27, datë 27.04.2020, për Lotin 1, të përbërë nga A.M.(kryetar), A.C. dhe B.K.(anëtare).

Me anë të Urdhrit nr. 56, nr. 15/9, datë 16.04.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për monitorimin e zbatimit të kontratave të nënshkruara në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 15/4, datë 29.01.2020, për Lotin 1, të përbërë nga A.M.(kryetar), A.C. dhe B.K.(anëtare).
Në lidhje me këto urdhra, konstatohet se vendosja e A.M.në cilësinë e anëtarit të grupit të monitorimit të marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, e cila është **Nëpunës Zbatues** i ISHP, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, të cilat përcaktojnë se:

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:
a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit;
e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

Si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi titullarët e AK sipas shkresave të sipërcituara dhe A.M.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës.

Në lidhje me zbatimin e kësaj procedure, për Lotin 1 janë nënshkruar Minikontratat sipas tabelës së mëposhtme:

Trajtimi	Data e trajtimit	Minikontrata Nr.	Vendi	Nr. Prot i minikontratës	Data e minikontratës
Trajtimi 1	14.05.2020	1	Shkodër	24/36	14/05/2020
Trajtimi 1	19.05.2020	2	Lezhë	24/43	19/05/2020
Trajtimi 2	27.05.2020	3	Shkodër	24/51	27/05/2020
Trajtimi 2	02.06.2020	4	Lezhë	24/58	02/06/2020
Trajtimi 3	11.06.2020-12.06.2020	5	Shkodër	24/69	11/06/2020
Trajtimi 3	16.06.2020-17.06.2020	6	Lezhë	24/75	16/06/2020
Trajtimi 4	25.06.2020-26.06.2020	7	Shkodër	24/84	24/06/2020
Trajtimi 4	30.06.2020-01.07.2020	8	Lezhë	24/91	30/06/2020
Trajtimi 5	09.07.2020-10.07.2020	9	Shkodër	24/102	08/07/2020
Trajtimi 5	14.07.2020-15.07.2020	10	Lezhë	24/108	14/07/2020
Trajtimi 6	23.07.2020-24.07.2020	11	Shkodër	24/118	23/07/2020
Trajtimi 6	28.07.2020-29.07.2020	12	Lezhë	24/124	28/07/2020
Trajtimi 7	07.08.2020-08.08.2020	13	Shkodër	24/135	06/08/2020
Trajtimi 7	11.08.2020-12.08.2020	14	Lezhë	24/141	11/08/2020

Trajtimi 8	20.08.2020-21.08.2020	15	Shkodër	24/152	20/08/2020
Trajtimi 8	25.08.2020-26.08.2020	16	Lezhë	24/158	25/08/2020
Trajtimi 9	03.09.2020-04.09.2020	17	Shkodër	24/168	03/09/2020
Trajtimi 9	08.09.2020-09.09.2020	18	Lezhë	24/174	08/09/2020
Trajtimi 10	17.09.2020-18.09.2020	19	Shkodër	24/186	17/09/2020
Trajtimi 10	22.09.2020-23.09.2020	20	Lezhë	24/192	22/09/2020
Trajtimi 11	01.10.2020-02.10.2020	21	Shkodër	1087/7	01/10/2020
Trajtimi 11	06.10.2020-07.10.2020	22	Lezhë	1087/133	06/10/2020

Ndërsa për Lotin 4, janë nënshkruar Minikontratat sipas tabelës së mëposhtme:

Trajtimi	Data e trajtimit	Minikontrata Nr.	Vendi	Nr. Prot i minikontratës	Data e minikontratës
Trajtimi 1	11.05.2020-12.05.2020	1	Sarandë	15/15	11/05/2020
Trajtimi 1	11.05.2020-12.05.2020	2	Vlorë	15/20	11/05/2020
Trajtimi 2	26.05.2020-27.05.2020	3	Sarandë	15/32	26/05/2020
Trajtimi 2	26.05.2020-28.05.2020	4	Vlorë	15/36	26/05/2020
Trajtimi 3	08.06.2020-09.06.2020	5	Sarandë	15/50	08/06/2020
Trajtimi 3	08.06.2020-10.06.2020	6	Vlorë	15/57	08/06/2020
Trajtimi 4	22.06.2020-23.06.2020	7	Sarandë	15/67	22/06/2020
Trajtimi 4	22.06.2020-24.06.2020	8	Vlorë	15/71	22/06/2020
Trajtimi 5	06.07.2020-07.07.2020	9	Sarandë	15/83	06/07/2020
Trajtimi 5	06.07.2020-08.07.2020	10	Vlorë	15/87	06/07/2020
Trajtimi 6	20.07.2020-21.07.2020	11	Sarandë	15/100	20/07/2020
Trajtimi 6	20.07.2020-22.07.2020	12	Vlorë	15/106	20/07/2020
Trajtimi 7	03.08.2020-05.08.2020	13	Sarandë	15/117	03/08/2020
Trajtimi 7	03.08.2020-05.08.2020	14	Vlorë	15/123	03/08/2020
Trajtimi 8	17.08.2020-19.08.2020	15	Sarandë	15/133	17/08/2020
Trajtimi 8	17.08.2020-19.08.2020	16	Vlorë	15/137	17/08/2020
Trajtimi 9	31.08.2020-02.09.2020	17	Sarandë	15/149	31/08/2020
Trajtimi 9	31.08.2020-02.09.2020	18	Vlorë	15/153	31/08/2020
Trajtimi 10	14.09.2020-16.09.2020	19	Sarandë	15/167	14/09/2020
Trajtimi 10	14.09.2020-16.09.2020	20	Vlorë	15/171	14/09/2020
Trajtimi 11	28.09.2020-30.09.2020	21	Sarandë	15/183	28/09/2020
Trajtimi 11	28.09.2020-30.09.2020	22	Vlorë	15/187	28/09/2020

Ndjekja e zbatimit fizik të këtyre kontravave të shërbimit kryhet nga Drejtoritë Rajonale të Shëndettit Publik, në bashkëpunim me përfaqësues të ISHP.
Kërkesat për dezinsektim gjithashtu, vijnë nga Drejtorië Rajonale të Shëndetit Publik.
Ndërsa likuidimet për kontratat e dezinsektimit, për të 4 Lotet, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Përshkrimi i loteve	Fondi Limit me TVSH	Shpenzuar në vitin 2019 (me TVSH)	Shpenzuar në vitin 2020 (me TVSH)
LOTI 1: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhëò.	11,932,660	0	8,411,364
LOTI 2: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrësò.	52,312,493	11,517,420	22,025,458
LOTI 3: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Fierò.	24,879,744	7,067,770	10,840,176
LOTI 4: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Vlorëò.	36,611,963	0	25,886,844
SHUMA	**125,736,859**	**18,585,190**	**67,163,842**

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1026/77 prot., datë 08.10.2021, protokolluar në KLSH me nr. 527/2, datë 11.10.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga A.F., ER, A.M., B.A., A.A., S.B., E.D., S.Q., E.A., A.M., X.M.dhe B.V., sqarojmë si më poshtë vijon:

***Pretendimi i subjektit**: Për sa më sipër duket qartësisht se nuk janë shprehur fare qëndrimet të shpjeguara të ISHP, sipas observacionit nr1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimin nr11 datë 30/07/2021.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron, për arsye se grupi i auditimit ka shprehur qëndrimin e tij mbi observacionet e dërguara nga ju.*

***Pretendimi i subjektit**: Dukë qenë se kjo procedurë është fragmentizuar dhe trajtuar në disa pjesë të projekt raportit jemi të detyruar të përgjigjemi gjatë për sa referuar në Gejtje nr. 20, Referuar tabelës 19: Titulli i i gjetjes: Procedura e prokurimit të dezinsektimit, si dhe faqes nr 132 të këtij raporti ku paraqiten përgjigjet e grupit Auditues.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj qëndron e për pasojë do merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*

***Pretendimi i subjektit**: 1. Sqarim në lidhje me pretendimin nr 1 të grupit të KLSH – së për sa më lartë nga grupi i auditimit nuk argumenton saktësisht dispozitën ligjore të shkelur, nen, pikë, germë etj por citon në mënyrë të përgjithshme Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se në argumentimin e shkeljes përkatëse të konstatuar është evidentuar neni, pika, gërmat etj., përkatëse që është shkelur.*

***Pretendimi i subjektit**: Për sa më sipër ISHP-ja i qëndron observacionit të paraqitur për Akt konstatimin nr 11 datë 30/07/2021 ku edhe në këtë rast grupi i auditimit nuk argumenton saktësisht dispozitën ligjore të shkelur dhe për më tepër nuk argumenton ndikimin dhe cfarë është shkaktuar nga ky veprim në lidhje hapjen, zhvillimin dhe pjesemarrjen e Operatoreve ekonomike.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se në argumentimin e shkeljes përkatëse të konstatuar është evidentuar neni, pika, gërmat etj., përkatëse që është shkelur.*

***Pretendimi i subjektit:** 2. Sqarim në lidhje me pretendimin nr 2të grupit të klsh-së, " Së dyti, pretendimi juaj se datat 17 dhe 18 kanë qenë e shtunë dhe e dielë, nuk qëndron për arsye siç vetë e keni përmendur në datën 16.08.2019 kur jeni njohur me vendimin e KSHA, duhet t'i kishit kryer*

ndryshimet sipas këtij vendimi (po më datë 16.08.2019).
Për sa më sipër ISHP-ja i qëndron observacionit të paraqitur për Akt konstatimin nr 11 datë 30/07/2021 ku edhe në këtë rast grupi i auditimit nuk argumenton saktësisht dispozitën ligjore të shkelur dhe për më tepër nuk argumenton ndikimin dhe cfarë është shkaktuar nga ky veprim në lidhje hapjen, zhvillimin dhe pjesemarrjen e Operatoreve ekonomike.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se në argumentimin e shkeljes përkatëse të konstatuar është evidentuar neni, pika, gërmat etj., përkatëse që është shkelur.*
Pretendimi i subjektit: *3. Sqarim në lidhje me Pretendimin nr 3- i qëndrojmëobservacionit të paraqitur për Akt konstatimin nr 11 date 30/07/2021. Sqarojmë edhe njëherë se për F.L.n KVO-ja kishte nje arsye pasi në kontratën e qiradhënies nuk ekzistone adressa në Ekstraktin Historik të subjektit D.S.shpk që kishte dhënë me qira objektin, (edhe njehere bashkëlidhur kërkesa që i është dërguar OSHEE) . Pra në kontratën e qiradhënies ishte një adresë e cila nuk figuronte në ekstraktin historik të Qiradhënësit. Pra qëllimi nuk ka qënë verifikimi i adresës dytësore i F.L.t për adresat dytësore, por fakti që ajo adresë nuk qëndronte tek qiradhënësi. Sqarim në lidhje me Pretendimin nr 3- i qëndrojmëobservacionit të paraqitur për Akt konstatimin nr 11 date 30/07/2021. Sqarojmë edhe njëherë se për F.L.n KVO-ja kishte nje arsye pasi në kontratën e qiradhënies nuk ekzistone adressa në Ekstraktin Historik të subjektit D.S.shpk që kishte dhënë me qira objektin, (edhe njehere bashkëlidhur kërkesa që i është dërguar OSHEE) . Pra në kontratën e qiradhënies ishte një adresë e cila nuk figuronte në ekstraktin historik të Qiradhënësit. Pra qëllimi nuk ka qënë verifikimi i adresës dytësore i F.L.t për adresat dytësore, por fakti që ajo adresë nuk qëndronte tek qiradhënësi.*
Në lidhje me A.P.n, i qëndrojmëobservacionit nr1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimin nr11 datë 30/07/2021 duke ju ritheksuar se është detyrë e OSHEE-si furnizues i energjisë elektrikevërtetojë sipas deklarimeve të Opertorëve në se këta kanë detyrime pranë OSHEE sapo jo për të gjitha kontratat.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se pretendimi juaj se kërkesa për verifikim është një e drejtë e KVO, por grupi i auditimit ka cilësuar se përse ju nuk e keni kryer këtë verifikim dhe për OE A.P. SHPK për këtë kriter, kur nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, nuk vërtetohej plotësisht plotësimi i këtij kriteri.*
Pretendimi i subjektit: *Qëndrimi i ISHP-së për sa mësipër cilësojmë se baza ligjore e vendosur nga grupi i klsh-sëështë vendosur gabim nga ana juaj.*
Neni i cituar nga ju shprehet "Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP.Në rastin e procedurave me mjete elektronike, procesi i pezullimit bëhet…….
Pra për sa më sipërkjo bazë ligjore i përket pezullimittë procedurës pas ankimimit, ku dhe ISHP_ja e ka kryer të rregullt procesin e pezullimit.
Konkluzion i ISHP_sëkjo bazë ligjore nuk ka të bëjë me afatet kohore të hedhjes në sistem të vendimeve të KSHA-së, ose modifikimin e DST-ve.
Qëndrimi i grupit të auditimit*: Pretendimi juaj qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*
Pretendimi i subjektit: *Qendrimi i ISHP_së në lidhje me pretendimin nr. 7, grupi i auditimit nuk kashpjeguar fare qëndrimin e subjektit (në këtë rast ISHP sipas observacionit të akt-konstatimit nr11) , po është shprehur...*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj nuk qëndron, për arsye se pretendimet e juaja janë në observacionet e dërguara nga ju, pjesë e dosjes së auditimit, ndërsa në projektraportin e auditimit janë cilësuar qëndrimi i grupit të auditimit ndaj këtyre observacioneve.*
Pretendimi i subjektit: *Qëndrimi i ISHP_së për këtë konstatim, është shpjeguar më së miri nëobservacioninnr1026/29 datë 06/08/2021 tëAkt Konstatimit nr11 datë 30/07/2021 dhe po ju*

theksojmëse baza ligjore e vendosur nga ana juajështë gabimpasi VKM 914 datë 29/12/2014, neni 27, i përket prokurimeve per mallra, ndërsa për shërbimet shprehet nenit 28, dhe grupi i auditimit nuk ka paraqitur pretendimet e tij bazuar mbi shpjegimet tona. Edhe në referim të nenit 28 "Kontratave të shërbimeve".

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj qëndron e për pasojë do merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Në Projektraportin e auditimit, në pjesën e trajtimit të procedurave të dezinsektimit është përdorur si bazë ligjore neni 28 "Kontratat e shërbimeve", ndërsa te kutitë "19. Titulli i gjetjes", është vendosur gabimisht neni 27.*

Pretendimi i subjektit: *Përveç sa më lartë referuar gjithë legjsilacionit për prokurimin publik është e drejtë e AK, të gjykojë dhe përcaktojë kriteret të veçanta të kualifikimit referur objektit të prokurim , duke vepruar brenda kornizave ligjore. Në asnjë rast nuk janë shkelur limitet e këtyre neneve në Kërkesat për kualfikim dhe nuk ka si të ketë shmangur konkurencën, siç shprehet grupi i KLSH-sënë përshkrimin e situatës fq 196.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është e drejtë e juaj vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikim, por pasi të keni kryer argumentimin teknik e ligjor të tyre. Grupi i auditimi ka evidentuar faktin se ju nuk keni kryer argumentimin teknik të këtyre kërkesave.*

Pretendimi i subjektit: *Për paragrafin më lartë i Grupi i ISHP_së , i qëndron observacionit nr.1026/29 datë 06/08/2021 tëAkt Konstatimit nr11 datë 30/07/2021. Baza ligjore e vendosur nga ana juaj referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1 , është e gabuar sepse këtu nuk ka patur asnjë elemente diskriminues, madje nuk ka patur as edhe ankesa nga OE gjatë zhvillimit të procedurës.*

Për më tepër, kjo kërkesëështëvendosur po nëzbatim tëLigjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar nenin 46 pika (b) i cili shprehet

b)aftësiateknike:operatorëtekonomikëvërtetojnësezotërojnëkualifikimete nevojshme teknike,profesionale,kapacitetetorganizative,makineritë,pajisjeteasetetë tjerafizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personeline nevojshëm,përtëzbatuarkontratën,siçështëpërshkruarngaautoriteti kontraktornënjoftimineobjektittëkontratës;ku njësia e prokurimit ka kërkuar njëdëshmi nga OEnëpërmjet të cilës vërteton aftësinë teknike qëtë paktën një përfaqësues i shoqërisë të jetë i aftë të kryejë procesin e kalibrimit të paisjes.

Për më tepër të theksojmë se Njësia e Prokurimit ka kërkuar Licencën e Operatorit ekonomik nga QKL për tek seksioni i DST-ve 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Liçensë nga QKL-ja për kategorinë II.8.B "Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare", me emërtimin përshkrues të veprimtarisë "Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore si dezinfektim, deratizim, dezinsektim", në zbatim të nenit 46 pika 1 shkronja(a).

Sqarojmë në mënyrë të përsëritur si në observacionet e akt konstatimit të cilat nuk i keni marrë në konsideratë , se në lidhje me kalibrimin e paisjeve për përdorimin e produkteve biocide , nuk ka ndonjë institucion shtetëror/ privat që ta kryejë këtë proces, e për më tepër nuk mund të kërkohen licenca dhe certifikata per kalibrim të paisjeve që përdoren në procesin dezinsektimit. Në lidhje me zatueshëmrinë e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2", i përmbahemi observacionit nr.1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimin nr11 datë 30/07/2021.

Ju sjellim nëvëmendje për të mos lejuar në të ardhmen precedenca të gabuara në lidhje meprocesin e kalibrimit të paisjes. Kalibrimi i pasijeve dhe i produktit që përdoret nëprocesine edzinsktit të programit të kontrollit të mushkonjave /vektorëve, bëhët rast pas rasti në terren sipas kushteve teknike të shpjeguar në specfikimet teknike.

Nuk ka asnjë Institucion shtetëror / privat që kryen kalibrime për përdorimin e produkteve biocide në paisjet e dezinsektimit, sic është spjeguar teknikisht edhe në specifikimet teknike të përcaktuara në DST-të.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me*

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2.

***Pretendimi i subjektit**: Për paragrafin më lartë Grupi i ISHP-së i qëndron observacionit të observacionit nr. 1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimit nr. 11 datë 30/07/2021 Baza ligjore e vendosur nga ana juaj referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1, është e gabuar sepse këtu nuk ka patur asnjë element diskriminues, përkundrazi ka qënë një kriter shumë minimale, thjesht për të provuar që punonjësit e kërkuar janë të rregjistruar në këtë shoqëri si punonjes, për të eleminuar evazionin fiskal.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2.*

***Pretendimi i subjektit**: Për sa më sipër është grupi i ISHP_së ka paraqitur dhe i qëndron observacionit nr.1026/29 datë 06/08/2021 të Akt Konstatimit nr11 datë 30/07/2021, për mëtepër ju cilësojmë se kjo nuk është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërma (b) shprehet:*

b) njëlistë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin eprokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet tëpërfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

Pra neni mësipërm nuk është obligues për licenca profesionale dhe CV e personelit ishte më se e mjaftueshme për të mos theksuar se për drejtuesit teknik CV i cili është personi më i rëndësishëm në këtë proces sherbimi,Drejtuesit teknikeështëshoqëruar dhe me certifikatat përkatëse të trajnimeve (pjesë në dosjen e procedurës në sistem apps).

Sqarojmë se për këtë shërbim është vendosur kiteri i paraqitjes se "Licensë nga QKL-ja për kategorinë II.8.B "Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare", me emërtimin përshkrues të veprimtarisë "Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore si dezinfektim, deratizim, dezinsektim". ", e cila është e plotësuar ngë OE dhe merr përgjgjësinë për zbatimin e shërbimit.

Për sa shpjegoni juve në lidhje me kualifikimet e punonjësve nuk qëndrojnë dhe e kemi sqaruarqartësisht disa herë më lartë dhe vlen të theksojmë se kontrata është kryer me sukses, dhe për më tepër ky operator ekonomik ka realizuar edhe kontrata të tjera të sukseshme më këtëobjekt.

Në këto kushtë nuk mund të pretendohet për nivel risk dhe nuk mund të pranohet që ISHP-së i është shkaktuar një efekt ekonomik negativ në shumën 34,298,208 lekë siçështë trajtuar nga grupi i auditimit.

Për realizimin e shërbimit dhe marrjen në dorëzim të tij janë ngritur grupet e punës në terren në bashkëpunim me NjVKSh-të e rretheve, si dhe grupete monitorimit entomologjik që kryejnë monitorimin entomologjik pas çdo trajtimi dhe grupittë monitorimit të kontratës që finalizon kryerjen e shërbimit në të gjitha fazat. (sic e ka trajtuar edhe grupi auditimit).

Kontratat janë realizuar me sukses referuar të gjithë dokumentacionit justifikues të mbajtur për ndjekjen e shërbimit gjatë realizimit të mini kontratave, sipas urdhërave përktës

***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se mos kërkimi i këtyre kritereve paraqet risk për ISHP, pasi OE i shpallur fitues mund të mos ketë kualifikimet e duhura, por mjafton të paraqesi një CV për tu kualifikuar për këtë procedurë. Veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërma a dhe gërma b.*

***Pretendimi i subjektit**: Është sqaruar më lartë në sqarimet që ka dhënë grupi i ISHP-së për këtë pikë nëpretendimet e grupit të KLSH-së nr. 3 (më lartë shpjeguar qartë) dhe nëobservacionin e Akt konstatimit nr 11 dhe ritheksojmë se VKM nr 914 dt 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni28*

Pika ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit

ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.
OE- A.P. nuk kishte ndonje të dhënë apo dyshim për vërtetimin e Debisë së tij arsyetuar nga KVO-ja.
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron, për arsye se OE A.P., mund të mos kishte dyshim për për vërtetimin e debisë së tij, por që në këtë procedurë nuk e plotësonte këtë kriter, por KVO e ka kualifikuar për plotësimin e këtij kriteri, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66, pika 3.*
***Pretendimi i subjektit**: Ky Operator ekonmik është'kualifikuar, për mosplotësim tëshumëkritereve të tjera dhe statusi do të vazhdonte të qëndronte po i tillë i s'kualfikuar mbështetur nëVKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se: "...komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuar në dokumentet e tenderit".*
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Është e vërtetë që ky OE është skualifkuar, por në këtë rast kufilifikimi i këtij OE për këtë kriter është rast tregues i mos zbatimit të plotë të LPP nga ana juaj si KVO.*
***Pretendimi i subjektit**: Është sqaruar nëobservacionin nr.1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimin nr11 datë 30/07/2021përkatës , për këtë pikë grupi i KLSH-së nuk ka paraqitur fare pretendimet e tij në faqen 132-133 dhe e ka përsëritur përsëri këtu tek situata në këtë rubrikë*
Për më tepër pikërisht siçështë shprehur edhe vetë grupi i KLSH-sëLigjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 63, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 78, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: "me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-së".
Titullari e ka nxjerrë urdhërin e pezullimit.
i. Mund të na thotë Grupi i KLSH-së se ku përdoret fjala "menjëherë", fjalë kjo e përsëritur gjithandej si shkelje nga ana e titullarit për nxjerrjen e urdhërit të pezullimit???
ii. Cili ka qënë efekti negativ në procesin e kthimit të përgjigjeve të ankesave , ku vetë grupi i KLSH-së e ka pranuar në faqen 132-133 se afatet e procedurës së kthimit të përgjigjes pas ankimimit i ka pranuar si të rregullta (dhe ka marrë në konsideratëobservacionin nr.1026/29 datë 06/08/2021 për Akt Konstatimin nr11 datë 30/07/2021), të cilat janë kryer brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës
***Qëndrimi i grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 63, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 78, pika 2. Fjala "menjhëherë" nënkupton nxjerrjen eurdhrit brenda ditës, ndërsa efekti negativ është se nuk është zbatuar ligji i prokurimit publik.*
***Pretendimi i subjektit**: -Grupi i ISHP-së i ka riparë dhe njëherëdhe ka vlerësuar të gjitha faturat e paraqitura (të cilat janë edhe në sistemin e app-së), nga ky Opertor ekonomik, nga ka rezultuar se OE ka sjellë vlerën e përrreth 793 faturave në shumën:*
Lot 1: 5 097 570 Lekë me TVSH
Lot 2: 18 059 232 Lekë me TVSH
TOTALI = 23 156 802 lekë me TVSH dhe pa TVSH 19 297 335 lekë,
të cilat plotësojnë kriterin e kërkuar nëDST-të e tenderit për kontratat e ngjashme gjatë 3 viteve të fundit, pra është më shumë se 16 181 540 lekë pa tvsh
Bashkëlidhur gjeni tabelat e detajuara të faturave për secilin lot sipas folderave qëjanë në

sistemin e www.app.gov.al (gjithsej 45 fq bashkelidhur).
Nuk arrijmë ta kuptojmë qëndrimin e audituesit pse ka shtrëmbëruar vërtetësinë e shumës së kontratës së ngjashme , kur mund të diskutonte me specialistët e ISHP-së, edhe në zbatim të rregullores së KLSH-sëpër t'u sqaruar gjatë procesit tëauditimi dhe ballafaqimit.
KVO-ja ka vlerësuar me të drejtë O.N.shpk i cili në bazë të nenit 66 të VKM-së nr 914 datë 29/12/2014, i ndryshuar, i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe nuk plotësohen kushtet e nenit 24 të ligjit të Prokurimeve publike, për të anulluar procedurën, aq më tepër të rëndësishme për jetën e popullatës.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Pretendimi juaj qëndron e për pasojë do merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*
Pretendimi i subjektit*: Në lidhje më Ankimimin e E.M. shpk, për të cilën nuk jemi vënë në dijeni dhe as jemi njohur me përmbajtjen, por ju theksojme se E.M. shpk nuk ka qënë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi as përson i intersuar.*
Qëndrimi i grupit të auditimit:
E.M. SHPK me administrator z. F.L. ka paraqitur në KLSH ankesën nr. nr. 248 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 782 prot., datë 13.07.2021, për të cilën KLSH ka pasur detyrimin t'i përgjigjet zyrtarisht. ISHP si subjekt i audituar nuk është i autorizuar të ketë dijeni për të.

19. Titulli i gjetjes:	**Procedura e prokurimit të dezinsektimit**
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit zhvilluar me objekt: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefekturat Shkodër, Lezhëò, me fond limit 9,943,883 lekë pa tvsh dhe ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 4 ñPrefektura Vlorëò, me fond limit 30,509,969 lekë pa tvsh, Gusht, 2018, u konstatua se: Me hartimin e urdhrit të prokurimit, është nisur zyrtarisht procedura e re e prokurimit, pas dështimit të procedurës së parë. Sipas procesverbalit të analizimit të shkaqeve të anulimit të procedurës së parë për Lotet 1 dhe 4, konstatohet se: Për Lotin 1 është kualifikuar vetëm OE P.S.SHPK. Për Lotin 4 është kualifikuar vetëm OE PF F.L.. ISHP nuk ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për arsye të lëndës A të ofertuar nga këta 2 OE të kualifikuar. Me shkresën nr. 755/1, datë 03.06.2019, ISHP i është drejtuar MSHMS, në lidhje me produktin A në procesin e dezinsektimit. Me shkresën nr. 3159, datë 11.06.2019 të MSHMS ñAnullim i Autorizimit të Importit për produktet A DF 3000 dhe A 200Gò, protokolluar në ISHP me nr. 755/12, datë 12.06.2019, MSHMS ka njoftuar ISHP mbi anulimin e autorizimit të importit për këto 2 produkte. Bazuar në këtë shkresë, ISHP ka skualifikuar OE P.S.SHPK dhe OE PF F.L., si dhe nisur nga fakti që këta OE ishin të vetmit të kualifikuar, ka vijuar me anulimin e procedurës. Pas procesit të ankimimit, këto Lote janë anuluar përfundimisht me Vendimet e KPP nr. 490/2019, datë 24.07.2019 për Lotin 1 dhe dhe nr. 488/2019, datë 24.07.2019 për Lotin 4. - Nga auditimi i hartimit të Dokumenteve të Tenderit për këto procedura, u konstatua se këto DT janë hartuar jo në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, duke mos u argumentuar dhe duke vendosur kërkesa për kualifikim diskriminuese, e konkretisht Njësia e Prokurimit, me anë të Procesverbalit nr. 1176/2, datë 07.08.2019 ñPër hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, ka miratuar kërkesat e përgjithshme dhe veçanta për kualifikim. Nga verifikimi i këtyre kritereve, u konstatua se: -Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.2, ndër të tjera është kërkuar që: ñVlera mesatare e xhiros së 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë 40% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurronò, por pa argumentuar se përse kërkon një xhiro 40% të fondit limit, në një kohë që neni 28, pika 5/b kërkon xhiro vjetore nuk mund të tejkaloje 40% të vlerës së kontratës, duke kufizuar kështu konkurencën, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 28. -Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.3.7, ndër të tjera është kërkuar që: ña. OE duhet të ketë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e pajisjeve sipas kërkesave

të teknikave dhe produkteve që do të përdoren. Për këtë OE duhet të paraqesë:...ò, kërkesë e cila është e paargumentuar dhe diskriminuese, për arsye se përveç pajisjeve kërkohet dhe punonjës që do kryejnë kalibrimin e tyre, ndërkohë që kalibrimi është objekt fushëveprimi i institucioneve dhe/ose laboratorëve të certifikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2.
-Nuk është argumentuar teknikisht nga Njësia e Prokurimit, se përse kërkohet vetëm listëpagesa e muajit Korrik 2019 dhe çfarë sigurie do i ofronte AK vendosja e kësaj kërkese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2.
-Në shtojcën 8, për të dy Lotet, pika 3.7.e, janë kërkuar gjithsej: 1 Drejtues Teknik (Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1), 4 Teknikë Aplikimi (1- Loti 1, dhe 3 - Loti 4) dhe 8 Aplikues (2 - Loti 1, dhe 6 - Loti 4), pra minimumi 13 punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri, OE ofertues duhet të paraqesin:
-CV (për Drejtuesin Teknik, Teknikun e Aplikimit dhe Aplikuesit);
-dhe listëpagesën e-sig 0-25, të paktën për muajin korrik 2019.
Por nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar asnjë dokumentacion provues për kualifikimet e këtyre punonjësve (si kontrata punësimi, certifikata kualifikimi, licenca përkatëse etj.), kërkesa të cilat në procedurën e mëparshme të anuluar për këto 2 lote janë kërkuar (Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të licencuar/certifikuar. Për secilin punonjës kompania duhet të paraqesë licencën/certifikatë, kontratën e punës, CV e Drejtuesit Teknik dhe Teknikut të Aplikimit, si dhe listpagesën e-sig.). Mos kërkimi i këtyre kritereve paraqet risk për ISHP, pasi OE i shpallur fitues mund të mos ketë kualifikimet e duhura, por mjafton të paraqesë një CV për tu kualifikuar për këtë procedurë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 28, pika 5.

Pas publimit të Dokumenteve të Tenderit për këtë procedurë, OE kanë ankimuar vendosjen e kërkesave për kualifikim. Nga verifikimi i këtyre ankesave dhe masave të ndërmarra nga ISHP për shqyrtimin, vlerësimin dhe kthimin e përgjigjeve për këtë ankesave, u konstatua se:
Me anë të Urdhrit nr. 389, nr. 1176/7, datë 14.08.2019, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit në zbatim të ankesave të mbërritura. Ndërsa me Urdhrin nr. 390, nr. 1176/8, datë 14.08.2019, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës (KSHA). Me anë të procesverbalit të datës 15.08.2019, KSHA ka vendosur të pranojë pjesërisht ankimimet e OE.
Me anë të shkresës nr. 1176/14 për Lotin 1, nr. 1176/15 për Lotin 4 dhe nr. 1176/16 për kërkesën për sqarim, datë 16.08.2019, titullari i AK e ka informuar OE A SHPK mbi vendimin e KSHA për ankesat e dorëzuara, si dhe ka dërguar sqarimet e kërkuara.
Me anë të procesverbalit të datës 20.08.2019, njësia e prokurimit ka kryer ndryshimet në DT sipas procesit të ankimimit, 4 ditë pas miratimit të ndryshimeve të tyre nga titullari i AK.
Në këto kushte, nuk konstatohet arsyeja që Njësia e Prokurimit ka miratuar ndryshimet në DST, më datë 20.08.2019, në kushtet kur titullari i AK ka miratuar vendimet e KSHA në datën 16.08.2019, ose 4 ditë me vonesë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 78, pika 2.

- Nga auditimi i procesit të vlerësimit dhe ankimimeve ndaj këtij procesi, u konstatua se:
- Me anë të procesverbalit të vlerësimit nr. 1, datë 12.09.2019, KVO ka vendosur tô drejtohet zyrtarisht OSHEE për vërtetimin e lëshuar për OE ekonomik PF F.L.. Me shkresën nr. 7846/1, datë 17.09.2019 ñKthim përgjigjeò, protokolluar në ISHP me nr. 1176/21, datë 19.09.2019, OSHEE rikonfirmon dokumentacionin e paraqitur nga OE PF F.L.. Në lidhje me sa më sipër, kërkimi i sqarimeve dhe kryerja e verifikimeve, është një e drejtë e KVO e bazuar në nenin 66/2, të RRPP. Por nuk konstatohet arsyeja e këtij verifikimi nga KVO për këtë OE, në kushtet kur OE PF F.L. në dokumentet e paraqitura në datën e hapjes së procedurës, e ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar (konfirmuar dhe me shkresën e kthim përgjigje ardhur nga OSHEE). Për më tepër, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE e tjerë, konstatohet se:
-OE A.P. SHPK, ka paraqitur Vërtetimin e OSHEE nr. 3792, datë 23.08.2019, me anë të së cilit vërteton se nuk ka detyrime për kontratën nr. DU0A020109121862. Nga verifikimi i Ekstraktit historik të këtij OE, konstatohet se ka adresën kryesore dhe adresat e tjera, por

	ndërkohë ka paraqitur vërtetimin e OSHEE vetëm për 1 adresë por jo për adresat e tjera, për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter, fakt të cilin KVO nuk e ka përmendur këtë fakt në kualifikimin e kryer (ky OE është skualifkuar, por për këtë kriter nuk është skualifikuar). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 66, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se: ñ...komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderitò. - Në përfundim të procesit të vlerësimit, pas ankesave të mbërritura, titullari i AK me Urdhrin nr. 423, nr. 1176/25, datë 30.09.2019, ka urdhëruar pezullimin e procedurës. Në lidhje me këtë urdhër, nuk konstatohet arsyeja që titullari i AK e ka pezulluar procedurën më datë 30.09.2019, ose 3 ditë pas marrjes së ankesave të OE P.S.SHPK dhe Akademia e Shëndetit Publik SHPK (datë 27.09.2019). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 63, pika 3 dhe ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 78, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: ñme marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-sëò. - O.N.SHPK, ka paraqitur fatura tatimore në vlerën totale 15,039,964 lekë pa tvsh (ose 18,047,956 lekë me tvsh), për të vërtetuar shërbime e ngjashme, për të dy lotet. Ndërkohë që në zbatim të pikës 3.3.1, kërkohej: ñshërbime e ngjashme në masën 40% të lotit/loteve për të cilin/at oferton, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderitò, që përkon me vlerën 16,181,541 lekë pa tvsh. Pra O.N.SHPK, ka 1,141,577 lekë më pak shërbime të ngjashme, në kundërshtim me pikën 3.3.1 të Shtojcës 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me -Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 55, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 66, pika 3. Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte O.N.SHPK, e në kushtet kur ky OE mbetej i vetmi i kualifikuar, të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se ñAutoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligjiò. Si konkluzion, OE do e kryerjë shërbimin e Dezinsektimit të këtyre procedurave, me punonjës për të cilët ISHP nuk ka asnjë siguri mbi kualifikimet, certifikatat dhe licencat e tyre, dhe për më tepër, ka paraqitur si teknikë/aplikues, menaxheren e përgjithshme, nëpunësin e informacionit dhe ekonomisten e shoqërisë. Ndikimi në këtë situatë, ka patur fakti i mos kërkimit në DT të kërkesave të tilla nga Njësia e Prokurimit, si dhe vlerat e likuiduara për kontratat respektove për lotin 1: 8,411,364 lekë dhe për lotin 4 25,886,844 lekë **në total 34,298,208 për bëjnë menaxhim jo efektiv i fondeve vendosur në dispozicion nga buxheti i shtetit.**
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Procedurë e zhvilluar jo në përputhje me RRPP
Shkaku:	Mos ndjekja e procedurave ligjore nga ISHP
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse sa i takon mospërcaktimit në DT të kërkseave mbi kualifikimin, trajnimin, certifikatat dhe licencat e punonjëave të OE fitues të cilët do të kryejnë shërbimin e dizinsektimit. Të shmanget në të ardhmen nga Njësia e prokurimit vendosja e kritereve evazive sa i takon kapacitetit profesional të punonjësve që angazhohen nga OE në kryerjen e këtij shërbimi.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET
A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përcaktimit të personit përgjegjës për prokurimet publike në ISHP, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, është caktuar si Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) znj. A.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, dhe njëkohësisht Nëpunës Zbatues i ISHP, si dhe në cilësinë e PPP është anëtare e Njësisë së Prokurimit për të gjitha procedura e zhvilluara nga ISHP. Për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, si dhe nenin 22, pika 3/b, ku parashikohet se veprimtaritë e kontrollit duhet të përmbajnë minimalisht ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Rekomandimi 1.1: Drejtori i ISHP të marrë masa për ndryshimin e Urdhrit nr. 1, nr. 13 prot., datë 06.01.2021, me qëllim heqjen si Person Përgjegjës për Prokurimet, të Nëpunësit Zbatues znj. A.M..

Menjëherë

Rekomandimi 1.2: Për të gjitha rastet në vijim, drejtori i ISHP të marrë masa për ngritjen e sistemeve efektive të kontrollit, të tilla që të parashikojnë ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Regjistrave të Prokurimit Publik u konstatua se:
- në disa raste, regjistrat e parashikimit të prokurimeve dhe/ose ndryshimet e tyre, nuk janë depozituar në thesar/ose organin qendror, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4. Depozitimi i regjistrit të prokurimeve në thesar, është një masë e nevojshme kontrolli që forcon disiplinën financiare, diktuar kjo edhe në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimitò. Konkretisht:
- Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP **për vitin 2018**, është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 56, datë 15.01.2018. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2018, janë kryer gjithsej 21 ndryshime të regjistrit, për të cilat janë dërguar shkresat respektive në MSHMS, por jo në Degën e Thesarit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4.
- Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP **për vitin 2019**, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 43/1, datë 17.01.2019. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se për gjatë vitit 2019, janë kryer gjithsej 12 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se:
- Vetëm 3 prej këtyre ndryshimeve i janë dërguar MSHMS si institucion qendror që vë në dispozicion fondet, por jo në Degën e Thesarit.
- Për 9 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe nuk janë të miratuara nga titullari i AK, si dhe këto ndryshime **nuk** janë dërguar në Degën e Thesarit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e

rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4.
- Me anë të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 121, datë 08.01.2018 ñMbi dërgimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2018 dhe regjistrin e realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2017ò, dërguar autoriteteve kontraktore në varësi të MSHMS, ndër të tjera, në pikën 3 përcakton që ñ*Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem, ndaj ndryshimet nuk do të dërgohen më në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore*ò. Në zbatim të kësaj shkrese, ISHP nuk i ka dërguar ndryshimet e regjistrave të parashikimit pranë MSHMS. Përcaktimi i kryer më sipër, nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4.
- Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për ISHP për **vitin 2020**, është dërguar në MSHMS dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 50, datë 10.01.2020. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për gjatë vitit 2020, janë kryer gjithsej 25 ndryshime të regjistrit, për të cilat konstatohet se:
- Për 10 raste, ndryshimet janë kryer (nënshkruar) vetëm nga Personi Përgjegjës për Prokurimet dhe **nuk j**anë të miratuara nga titullari i AK.
- Vetëm 3 prej 25 ndryshimeve të regjistrit, i janë dërguar MSHMS, si institucion qendror që vë në dispozicion fondet; por
- Asnjë prej këtyre ndryshimeve nuk i është dërguar Degës së Thesarit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 4, pika 4, si dhe Rregulloren e Brendshme të ISHP, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ISHP nr. 512, nr. 1906/1 prot., datë 31.12.2019, pika 6.3 ñDrejtoriò, nënpikat (i) dhe (iv).
- Nga verifikimi i regjistrave të parashikimeve dhe ndryshimeve të tyre për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ISHP ka kryer 6 ndryshime në RPP pas datës 15 tetor, me vlerë totale 28,694,815 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò, pika 1.

Rekomandimi 2.1: Me qëllim forcimin e disiplinës financiare, si një masë e nevojshme kontrolli për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, nga ISHP të merren masa që për të gjitha rastet në vijim, regjistrat e prokurimeve të depozitohen në thesar, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe sa herë ndodhin rishikimet e tyre gjatë vitit.

Në vijimësi

Rekomandimi 2.2: Drejtori i ISHP të marrë masa që për ndryshimet e mundshme në Regjistrin e Parashikimeve Publike pas datës 15 tetor, të argumentohet në mënyrë të detajuar nevoja e tyre dhe përputhshmëria me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatua sa më poshtë:
3.1 Sa i takon ndarjes së detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, u konstatua se për procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt:
- ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, Tetor 2020, si dhe
- ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi për ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid -19 ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, Tetor 2020;
Titullari i AK, ka ngarkuar znj. A.R., me detyrë shefe e sektorit të survejancës laboratorike të sëmundjeve emergjente virale, e cila për këto procedura:

- Ka hartuar kërkesën për materiale.
- Ka hartuar fondin limit limit dhe specifikimet teknike.
- Është anëtare e KVO.
- Është caktuar si personi përgjegjës për hartimin e kërkesave për të lidhur minikontratat në zbatim të Marrëveshjes Kuadër.

Sa më sipër ka bërë që detyrat e mësipërme të jenë përqendruar tek i njëjti nëpunës, duke e ngarkuar me përgjegjësi në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin dhe kontrollin, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 20, pika 1 dhe pika 2/c, si dhe neni 22, pika 3/b.

Rekomandimi 3.1: Me qëllim përmirësimin e mjedisit të kontrollit për procedurat e prokurimit publik, Titullari i AK të marrë masa që të sigurojë një ndarje të qartë dhe të drejtë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve, të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në vijimësi

3.2 Nga auditimi i ligjshmërisë së hartimit të specifikimeve teknike, u konstatua se:

- **në 2 raste**, nga njësia e prokurimit janë përdorur emra markash, të tilla si teknologjia Hybrid Capture, teknologjia TaqMan, si dhe sistemi Rapid Capture, **por pa shtuar tog - fjalëshin "*ose ekuivalent*",** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e konkretisht: në procedurat e prokurimit zhvilluar me objekt: *(1)* ñBlerje e kiteve dhe materialeve te konsumit për Depistimin e HPV-sëò, me fond limit 26,663,857 lekë pa tvsh, Tetor 2018; dhe *(2)* në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt:ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh, Shkurt 2018.
- **në 4 raste** AK ka argumentuar ligjërisht vendosjen e të gjitha kritereve të veçanta për kualifikim, por **nuk** i ka argumentuar teknikisht ato në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, në procedurat me objekt: *(1)* ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH; *(2)* ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH; *(3)* ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH; dhe *(4)* ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH.
- **në 3 raste** kërkesat për kualifikim janë hartuar jo në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publike (RRPP), e konkretisht:

(1) Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh, në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një **vlerë jo më e vogël se 40%** e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiros jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë **jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/** vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashme me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4.

(2) Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje kite/reagent, materiale konsumi per ekstraktorin automatik QIA symphony për testimet e Covid - 19ò, me fond limit 163,020,375 lekë pa tvsh, në Shtojcën 9, pika 2.2.1, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Vlera mesatare e xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet*ò. Vendosja e xhiro jo më të vogël se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma b. Në Shtojcën 9, pika 2.3.a, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*a) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kryerjen e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me vlerë jo më pak se 40% të vlerës se fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet...*ò. Vendosja e furnizimit të ngjashmë me vlerë jo më pak se 40%, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27, pika 4.
(3) Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPVò, me fond limit 13,743,700 lekë pa tvsh: Në Shtojcën 9, pika 2.2.1.b, ndër të tjera është parashikuar që: ñ*Operatori ekonomik duhet te zotëroje vlerën monetare prej 10% te fondit limit të lotit/loteve për të cilat ofrojnë e cila do të mbuloje shpenzimet paraprake për fillimin e zbatimit te kontrates. Kjo vertetohet me anën e një Deklarate të Gjendjes Financiare të tij të lëshuar nga një ose më shumë banka jo më shumë se 20 ditë përpara datës së hapjes së procedurës së tenderit.*ò. Vendosja e kësaj kërkese, duke qenë se nuk parashikohet më në Rregullat e Prokurimit Publik si rezultat i ndryshimit të tyre në vitin 2017, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 27.

Rekomandimi 3.2:
-Nga Njësia e Prokurimit të merren masa që për procedurat e zhvilluara në të ardhmen, të shmanget përdorimi markave dhe aty ku nuk është e mundur, gjithmonë të përdoret tog-fjalëshi ñ*ose ekuivalent*ò, me qëllim rritjen e konkurrencës e sigurimin e eficiencës në përdorimin e fondeve publike.
-Me qëllim shmangien e problematikave në argumentimin teknik të kërkesave të veçanta për kualifikim, grupi i përllogaritjes se fondit limit në ISHP të marrë të gjitha masat, që në të gjitha rastet në vijim të dokumentojë në procesverbalet përkatës, argumentimet teknike nga specialistët e fushës për secilën kërkesë të veçantë për kualifikim.
-Për rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, Titullari i AK të marrë masa që t`i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Në vijimësi

3.3. Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tamponë + terren) dhe tamponë orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, **me fond limit 166,260,000 lekë pa tvsh**, Tetor 2020, u konstatua se në këtë procedurë prokurimi, kanë ofertuar 10 OE. Nga këta 10 OE, 6 prej tyre kanë qenë gjithashtu pjesë e OE-ve të përzgjedhur në procesin e studimit të tregut, gjatë hartimit të fondit limit. Për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se kontrata është lidhur me 25.12% të vlerës së fondit limit të përllogaritur (**ose rreth 74.88% më pak nga fondi limit),** pasi 6 nga OE - të e përzgjedhur

përgjatë fazës së studimit të tregut, rezultuan të kenë ofertuar vlera shumë më të larta duke fryrë artificialisht vlerën e fondit limit, ndërsa gjatë fazës së tenderimit, po të njëjtët OE kanë ofertuar vlera më të ulëta, e konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Operatori Ekonomik	F.N	O.D.	M.	B.A.	K.	E. (shpallur fitues)
Studim Tregu	171,660,000	177,300,000	152,400,000	172,800,000	141,600,000	181,800,000
Procedurë prokurimi	56,862,000	50,280,000	64,560,000	55,500,000	93,810,000	41,760,000
%	**33%**	**28%**	**42%**	**32%**	**66%**	**23%**

Kjo sjellje e OE të mësipërm, konsiderohet si një sjellje e dyshimtë dhe mund të përbëjë shkak për ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në oferta, sipas interpretimit zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ku në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë, përcaktohet se: ñ*Marrëveshjet e ndaluara në oferta çojnë në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar. Referuar sa më sipër, mbajtur në konsideratë parimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, sjellim në vëmendje të operatorëve ekonomikë që të jenë sa më të përgjegjshëm gjatë përllogaritjes së vlerës së fondit limit, me qëllim përllogaritjen sa më të saktë të tij. Paraqitja nga operatorët ekonomikë të ofertave me vlera shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender për të njëjtin objekt prokurimi,* ***mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t`i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës, në rast të konstatimit të këtyre diferencave***.ò.
ISHP, me konstatimin e këtyre diferencave duhej tôi ishte drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, për kryerjen e verifikimit e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në oferta, në zbatim të Njoftimit të APP nr. 9773/9, datë 05.04.2019.

Rekomandimi 3.3: ISHP menjëherë tôi drejtohet Autoritetit të Konkurrencës, për të marrë masa për verifikimin e ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, nga Operatorët Ekonomikë F.N.SHPK, O.D. SHPK, M. SHPK, B.A. SHPK, K. SHPK dhe E. SHPK, në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje Kit (tampone + terren) dhe tampone orofaringeal e nazofaringeal, për marrjen e mostrave të testimeve Covid-19ò, për arsye se këta 6 OE, gjatë fazës së studimit të tregut kanë ofertuar vlera shumë të larta, ndërsa gjatë fazës së tenderimit kanë ofertuar vlera më të ulëta.

Brenda datës 31.12.2021

3.4 Sa i takon argumentimit dhe dokumentimit të përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet janë konstatuar raste kur nga AK **nuk** është argumentuar përzgjedhja e OE-ve, që do të japin ofertë për artikullin për të cilin nuk ka pasur çmim reference në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku specifikohet se ñ*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*. në procedurat si më poshtë:
- në procedurën e prokurimit me objekt ñ*Blerje Kite dhe materiale të tjera për manipulimin në biologjinë molekulare për kryerjen e testimeve Covid 19*ò, zhvilluar në ISHP në vlerë 50,515,000 lekë pa TVSH;
- në procedurën prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH;
- në procedurë e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò,

zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH.

Rekomandimi 3.4: Në vijim, grupi i përllogaritjes se fondit limit në ISHP, të marrë të gjitha masat e duhura që në çdo rast të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës në të gjitha aspektet thelbësore të tij, përfshirë këtu edhe OE të përzgjedhur për të ofertuar, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet, në mënyrë që të studimi paraprak i tregut të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të reflektojë vlerën reale të kontratës.

Në vijimësi

3.5 Sa i takon nevojave për prokurim të punëve shërbimeve apo mallrave është konstatuar se **nuk** gjenden në dosjen përkatëse *procesverbale ku të ketë një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, **ose** të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës (*në këtë rast, kërkesa për furnizim sipas nevojave të institucionit, për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së procedurave përkatëse), në kundërshtim me nenin 12, pika 2, gërma a të LPP në procedurat si më poshtë:
- në procedurën prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH është konstatuar se:
- në procedurën me objekt ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH;
- në procedurë e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH.

Rekomandimi 3.5: Me qëllim argumentimin e nevojave për prokurimin në përputhje me kërkesat e bazës ligjore në fuqi, njësia e prokurimit në SHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim përfshirjen e kërkesës për prokurimit të mallit, shërbimit apo punëve, në dosjet përkatëse të prokurimit.

Në vijimësi

3.6 Në procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim i Mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë*ò, zhvilluar në ISHP me vlerë 8,463,263 lekë pa TVSH është konstatuar se në procesverbalin për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të procedurës së hapur mbajtur më datë 28.08.2019, njësia e prokurimit në këtë procedurë ka vendosur të miratojë kriteret e përcaktuara në DST, të procedurës me nr REF ï 30861-07-09-2019, pa dokumentuar analizimin e shkaqeve të dështimit të procedurave të prokurimit publik, të cilat kërkojnë dokumentimin e analizimit të shkaqeve të dështimit të procedurës së mëparshme me anë të një procesverbali të veçantë të mbajtur nga njësia e prokurimit me qëllim korrigjimin e shkaqeve që kanë çuar në dështimin e procedurës së parë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 73, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Rekomandimi 3.6: Në vijim, njësia e prokurimit në ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në çdo rast të dokumentojë analizimin e shkaqeve të dështimit të procedurave të prokurimit publik nëpërmjet dokumentacioneve përkatëse, duke promovuar përgjegjshmërinë dhe përmirësimin e rrjedhshmërisë së procedurave të prokurimit në institucion.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të nënshkruara nga ISHP në përfundim të procedurave të prokurimit publik është konstatuar sa më poshtë:
- Nga auditimi i procesit të zbatimit të Marrëveshjes Kuadër për Lotin 1 nr. 24/27, datë 27.04.2020 dhe Marrëveshjes Kuadër për Lotin 4 nr. 15/4, datë 29.01.2020, u konstatua se ndjekja e zbatimit fizik të këtyre kontratave të shërbimit kryhet nga Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, në bashkëpunim me përfaqësues të ISHP.

Në zbatim të këtyre marrëveshjeve kuadër, titullari i ISHP, me anë të Urdhrave nr. 56, nr. 15/9, datë 16.04.2020 (për Lotin 1) dhe nr. 67, nr. 24/29, datë 28.04.2020 (për Lotin 4), ka ngritur grupin e punës për monitorimin e zbatimit të kontratave, të përbërë nga: A.M.(kryetar), A.C. dhe B.K.(anëtare). Në lidhje me këto urdhra, konstatohet se vendosja e zj. A.M.në cilësinë e kryetarit të grupit të monitorimit të marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, e cila është **Nëpunës Zbatues** i ISHP, është kryer në kundwrshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e; nenin 22, pika 3/b; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56, pasi punonjesja duke u vendosur në grupet e monitorimit të zbatimit të kontratave rezulton të jetë përgjegjës njëkohësisht edhe për zbatimin edhe për kontabilitetin dhe kontrollin, duke mos i shërbyer kështu forcimit të kontrolleve në këtë proces.

- Nga auditimi i kontratës nr. 92/11, datë 14.05.2018 me vlerë 8,056,500 lekë pa TVSH, ose 9,667,800 lekë me TVSH nënshkruar nga ISHP në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt me objekt ñ*Blerje kite, reagentë, materiale të të tjera për teknikat TeqMan Cobas Amplikor*ò, mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me procesverbalin nr. 1 të datës 18.07.2018 dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 8, datë 18.07.2018, dhe me fletë hyrjen nr. 9, datë 27.07.2018 marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2018 si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Sasia (kite)	Skadenca	Lloji i paketimit	Çmimi pa TVSH	Vlera Totale
	Procesverbal nr.1, datë 18.07.2018					
1	HCV Test version 2.0	6	31.10.2019	48 teste	480,000	2,880,000
2	HIV 1 Test v.2	2	30.11.2019	48 teste	525,000	1,050,000
3	HBV Test Version 2.0	7	30.11.2019	48 teste	460,000	3,220,000
4	AmpliLute Liquid Media Extraction Kit	15	06.06.2019	48 teste	54,000	54,000
	Total pa VSH					7,204,000
	TVSH					1,440,800
	Total me TVSH					8,644,800
	Procesverbal nr. 2, datë 27.07.2018					
5	Tube k Box Pack	1		12 x 96/kuti	140,000	140,000
6	High Pure Sistem Viral Nuvleic Acid Kit	1		15 teste	47,500	712,500
	Total pa VSH	1	0			852,500
	TVSH	1	0			170,500
	Total me TVSH	1	0			1,023,000
	TOTAL me TVSH					**9,667,800**
	TVSH					**1,611,300**

Në procesverbalin nr. 2 të datës 27.07.2019, komisioni i marrjes në dorëzim është shprehur se malli i marrë në dorëzim e plotëson kushtin e skadencës mbi 8 muaj **por** në dokumentacionin bashkëlidhur **nuk** ka gjurmë të verifikimit të datës së skadencës sikundër ka ndodhur në rastin e furnizimit të parë nga OE, i cili faturën tatimore e ka shoqëruar me një faturë shitjeje ku janë vendosur edhe datat e skadencave për secilin artikull të furnizuar. Në rastin e procesverbalit nr. 2 dhe të dokumentacionit shoqërues të tij deklarohet vetëm që përmbushet kushti, por nuk ka prova nga OE dhe AK për përmbushjen e tij, për më tepër kur bëhet fjalë për mallra konsumi të cilat **nuk** mund të verifikohen më, në momentin e këtij auditimi nëse e përmbushnin apo jo këtë kriter.

- Për kontratën nr. 1190/17, datë 04.10.2019 nënshkruar nga ISHP në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje Kiteve dhe materiale të konsumit për depistimin HPV*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 26,434,400 lekë pa TVSH, mallrat e furnizuara janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje L.S., A.M., E.S., sipas urdhrit nr. 434, datë 08.10.2019 të miratuar nga titullari i institucionit. Lidhur me sa më sipër konstatohet se znj. A.M.,

përgjegjëse e sektorit të financës dhe nëpunëse zbatuese e institucionit e cila nënshkruar urdhër shpenzimet, është anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim, ndërkohë që është edhe PPP i institucionit, situatë kjo e cila K. konflikt dhe mbi vendosje në detyrat e përgjegjësit të sektorit të financës, e që cenon veprimtaritë e kontrollit brenda institucionit, në kundërshtim me nenin 22, pika 3/b të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
-Nga auditimi i procedurës së prokurimit zhvilluar me objekt: ñBlerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e Biologjisë Molekulare, sëmundjeve infektive emergjente si dhe HIV, HEP, HPV, etjò, me fond limit 8,159,500 lekë lekë pa tvsh, Mars 2020, u konstatua se nga verifikimi i Urdhër-Shpenzimeve të Kontratës së Furnizimit nr. 373/9, datë 14/05/2020, si dhe dokumentacionit përkatës, konstatohet se për Urdhër-Shpenzimet nr. 420, datë 13.10.2020, me vlerë **1,386,000 lekë**, nr. 464, datë 29.10.2020, me vlerë **1,269,600 lekë** dhe nr. 570, datë 28.12.2020, me vlerë **3,969,000 lekë**, nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues të praktikave, **nuk** konstatohet të jetë e dokumentuar data e skadencës së mallrave të furnizuar. Në procesverbalet e marrjes në dorëzim, grupi i marrjes në dorëzim është shprehur vetëm se malli është në përputhje me skadencën, **por që një fakt i tillë nuk provohet** nga dokumentacioni shoqërues i faturave tatimore të sipërcituara, nisur nga fakti që data e skadencës duhet të jetë 6-8 muaj nga data e marrjes së mallit në dorëzim. Për sa më sipër, gjatë fazës së auditimit në terren, grupi i auditimit nuk mundi të shprehej mbi ligjshmërinë e materialeve të furnizuara nga OE B.A. SHPK **në vlerën 6,624,600 lekë**, për arsye të mos identifikimit të datës së skadencës së këtyre mallrave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 1.

Rekomandimi 4.1:
-Titullari i institucionit, në cilësinë e NA, të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që komisionet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara të dokumentojnë dhe të shprehen specifikisht për respektimin e afateve të skadencave për çdo artikull të furnizuar në ISHP me qëllim që të dokumentohet saktësisht ky fakt, për të shmangur në të ardhmen riskun e skadencës së parakohshme të mallrave të furnizuara për shkak të mos respektimit të afatit të skadencës me pasoja efekte në buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

Rekomandimi 4.2: Titullari i institucionit në cilësinë e NA të marrë të gjitha masat e duhura për të shmangur në të ardhmen përfshirjen e NZ në procese të punës të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, kjo në përfitim të qëndrueshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm që duhet të funksionojnë në një institucion.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kërkesat e hartuara nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Shëndetit Publik në zbatim të urdhrit të titullarit për përgatitjen e projektbuxhetit dhe përcjelljen e tij pranë MSHMS, u konstatuan disa mangësi ku përmendim:

- Njësitë e institucionit që kanë përcjellë kërkesat për buxhet për përgatitjen e PBA-ve, në disa raste kanë përcjellë shkresat e kërkesave për buxhet të cilat i përkisnin kërkesave për buxhet për përgatitjen e PBA-ve të periudhave të mëparshme, të pa argumentuara, dhe në disa raste me diferenca në përllogaritjen e totalit, duke mos siguruar përcjelljen e kërkesave reale për hartimin e projektbuxhetit.

- Në shumicën e rasteve kërkesat e drejtorive/departamenteve respektive janë përcjellë vetëm për vitin e parë të projekt buxhetit dhe jo për periudhën tre vjeçare sikundër ky dokument duhet të hartuar, dhe gjithashtu në hartimin e projekt buxhetit në vitin pasardhës nuk merren

parasysh kërkesat e argumentuara në vitin e dytë të PBA-ve të mëparshme, duke mos siguruar një planifikim afatmesëm efektiv.

- Në PBA-në e konsoliduar përgatitur nga MSHMS ku përfshihen edhe njësitë e varësisë së saj, për programin e shëndetit publik konstatohet se kryesisht **nuk** është marrë në konsideratë **asnjë** prej kërkesave për investime të bëra nga ISHP gjatë fazës së përcjelljes së projekt buxhetit të hartuar nga kjo e fundit. Gjithashtu në PBA-në e 2020-2022 dhe 2021-2023 të hartuar nga MSHMS, projekti i vetëm i planifikuar nga MSHMS me përfitues ISHP, përkatësisht 18BB701 ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi*ò, **nuk** rezulton i përfshirë në listën e investimeve të propozuar nga ISHP në projekt buxhetin e vitit 2020 dhe atë të vitit 2021, duke reflektuar kështu mangësi në procesin e planifikimit dhe koordinimit mes institucioneve të varësisë dhe MSHMS.

Rekomandimi 5.1: Ekipi i ngritur pranë ISHP për hartimin e kërkesave gjatë fazës së projekt buxhetit, të marrë masat për kryerjen e një planifikimi më efektiv, duke marrë në konsideratë nevojat prioritare dhe buxhetin historik të institucionit, në mënyrë që ky proces të mos kryhet formalisht në përmbushje të një detyrimi ligjor, por të reflektojë konkluzionet e analizave të hollësishme në drejtim të një plani afatmesëm efektiv.

Në vijimësi

Rekomandimi 5.2: Strukturat përgjegjëse për hartimin e PBA-së pranë MSHMS të marrin masat për të përfshirë në programin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar të konsoliduar, edhe kërkesat e njësive të varësisë dhe rritjen e bashkëpunimit me to, në mënyrë që të shmangen situatat e konstatuara në këtë projektraport, ku projektet e propozuara dhe çelur për ISHP faktikisht nuk janë propozuar nga kjo e fundit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh në buxhetin e ISHP, që kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së MSHMS për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin e ISHP, duke ia alokuar këto fonde njësive vendore të shëndetit publik, apo institucioneve të tjera nën varësinë e ISHP, situata këto që reflektojnë një rol pasiv të institucionit në planifikimin buxhetor të saj.

- Nga auditimi i shpenzimeve të kryera në kuadër të **pandemisë COVID-19,** me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është përcaktuar krijimi i fondit anti-Covid-19 prej 2,500 milion lekë, i cili është detajuar me VKM nr. 249/2020, ku është përcaktuar se 150 milionë lekë i kalojnë ISHP në programin ñShërbimet e shëndetit publikò për shpenzime korente. Në zbatim të VKM-së nr. 249/2020, ISHP-së i janë alokuar në llogarinë 600, konkretisht projektit me kod 91305AG ñPersonel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19ò fondet në vlerë 150 milion lekë, një pjesë e të cilave përgjatë vitit është shpërndarë në njësitë vendore të shëndetit publik për shpërblimin e personelit të angazhuar për përballimin e situatës së pandemisë në këto njësi (76.9 milion lekë); një pjesë është përdorur nga ISHP për shpërblimin financiar të stafit të angazhuar gjatë pandemisë (26.6 milion lekë); dhe një pjesë ka mbetur e pa realizuar (46.5 milion lekë).

Konkretisht, nëse i referohemi planit fillestar buxhetor, atij të rishikuar dhe realizimit nga ISHP për këtë fond, konstatohet se nga ky fond janë përdorur gjithsej 26,625 mijë lekë, ose **46,558 mijë lekë më pak** se fondet disponibël deri në fund të vitit (ose 36%). Nga ISHP nuk është inciuar asnjë kërkesë për kryerjen e rialokimeve të këtyre fondeve, në institucione të tjera të programit të shëndetit publik, apo produkte të tjera ku nevoja për fonde ka qenë më e lartë.

Për sa i përket fondeve për shpenzime operative përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID, në buxhetin e ISHP, për blerjen e tamponeve, kiteve dhe reagenteve me 2 operatorët ekonomikë

nuk janë alokuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit për kryerjen e likuidimit të kontratës së lidhur (trajtuar më hollësisht në pikën e prokurimeve) dhe nuk është përdorur buxheti i pa realizuar i alokuar nga fondi Anti Covid për shpenzime shpërblimi personeli, por **institucioni ka përdorur tepricat e disponueshme në dispozicion, alokuar për aktivitetin rutinë, duke kryer ri-alokime brenda programit të institucionit, në produkte të ndryshme, pa efekt në totalin e vlerës së buxhetit në dispozicion për vitin 2020**. Më hollësisht, kanë qenë në dispozicion rreth 60 milion lekë nga produkti i çelur për kryerjen e pagesave për vaksina sipas Programit Kombëtar të Vaksinimit me kod 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò (rialokimi në SIFQ i datës 23.11.2020), 4.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e gjiritò, me kod 91305AD (rialokimi i datës 18.11.2020), dhe rreth 10.5 milion lekë nga produkti ñGra te depistuara për kancerin e qafës së mitrësò, me kod 91305AF (rialokimi i datës 18.11.2020). Nga këto fonde janë likuiduar më pas dy fatura me vlerë rreth 50 milion lekë për blerje tamponësh, reagent dhe kite në zbatim të kontratës së lidhur. Këto shpenzime janë kryer nën projektin ñNumër kontrollesh për situatat epidemiologjikeò, duke mbartur kështu riskun e mos përllogaritjes së tyre në totalin e shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë, për të cilin duhet të ishte çelur kodi jo vetëm në llogarinë 600 për dhënie shpërblimesh të personelit, por edhe për blerje mallrash apo shërbimesh në funksion të situatës shkaktuar nga Covid (602), sikundër është realizuar edhe shpenzimi i trajtuar më sipër për blerje tampon kite, reagent.

Pra, nga auditimi rezultoi se buxheti fillestar total (shpenzime korente dhe kapitale) për vitin 2020, për ISHP ka qene 788,262 mije leke ose 85,746 mijë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019 (702,516 mijë lekë), konkretisht: me shkresën e MSHMS nr. 247/2, prot datë 28.01.2020, është bërë çelja e buxhetit fillestar për shpenzime korrente të ISHP, në vlerë totale 775,262 mijë lekë (nga 695,953 mijë lekë **të realizuara** fillimisht 1 vit më parë); ndërsa me shkresën nr. 307/3, prot datë 28.02.2020 të MSHMS janë çelur shpenzime për investime në vlerën 13,000 mijë lekë për vetëm 1 projekt investimi (nga 49,752 mijë lekë të planifikuara fillimisht 1 vit më parë).
Pavarësisht se planifikuar me rritje (rreth 86 milionë lekë më shumë nga buxheti faktik i vitit 2019), ky buxhet, si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, në fund të vitit 2020 rezultoi në rënie, në vlerën 707,532 mijë lekë (ose rreth 81 milion lekë më pak **më pak** nga sa u parashikua me ligjin nr.88, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò).
Në fund të vitit 2020, buxheti i ISHP u realizua në vlerën 648,670 mijë lekë, ose 58,862 mijë lekë më pak nga sa planifikuar, dhe 53,846 mijë lekë më pak nga sa realizuar një vit më parë, pavarësisht shtesës në fonde për llogari të Covid19.

Në kushtet kur buxheti i ISHP jo vetëm që nuk ka pësuar rritje nga viti i mëparshëm, po dhe shtesat që iu alokuan në buxhet si pasojë e Covid (150 milionë leke vetëm me **VKM nr. 249, date 27.03.2020**) nuk reflektuan rritje ne buxhet, përkundrazi buxheti i ISHP u tkurr me 81 milionë leke nga plani fillestar dhe me rreth 5 milion leke më pak nga fakti i vitit 2019), për shkak të mos realizimit të projekteve të planifikuara që lidhen me aktivitetin normal të ISHP si :

5. 91305AD ñ*Gra te depistuara për kancerin e gjirit*ò, planifikuar fillimisht 14,302 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 9,772 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 9,284 mijë lekë (488 mijë lekë më pak).

6. 91305AF ñ*Gra te depistuara për kancerin e qafës së mitrës*ò planifikuar fillimisht 40,560 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 62 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 62 mijë lekë.

7. 91305AA ñ*Fëmijë të vaksinuar 0-18*ò planifikuar fillimisht 400,000 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 271,000 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 270,760 mijë lekë (240 mijë lekë më pak).

8. 91305AB ñ*Numër kontrollesh për situatat epidemiologjike*ò për paga dhe sigurime të personelit të institucionit (llog 600,601) planifikuar fillimisht 193,100 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 179,630 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 172,023 mijë lekë (7,607 mijë lekë më pak); dhe për këtë produkt për shpenzime për shërbime (llog 602) planifikuar fillimisht 127,300 mijë lekë dhe sipas planit të rishikuar 172,076 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 168,446 mijë lekë (3,630 mijë lekë më pak)

6.1 Nga auditimi u konstatua se Projekti **18BB701** ñ*Blerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-së (Parazitologji,preparatory, Hiv Aids etj), si dhe pajisje për rrezatimit jo jonizues te zyrës se mbrojtjes nga Rrezatimi"* është planifikuar në PBA 2020-2022 të MSHMS në vlerën 13,000 mijë lekë dhe është çelur në buxhetin e vitit 2020 po në atë vlerë. Përgjatë vitit nga MSHMS janë kryer ndryshime në buxhetin në dispozicion të ISHP dhe ky projekt deri në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 0, shkak për të cilin sipas ISHP është bërë situata e pandemisë dhe ky projekt është gjykuar të përfshihet në planin buxhetor të viteve pasardhëse. Nga auditimi konstatojmë se kërkesa për rishpërndarje fondesh nuk është bërë nga ISHP, por është kryer nga organi epror ï MSHMS; e si pasojë ISHP si njësi shpenzuese që menaxhon këtë projekt nuk ka nja analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, sikundër dikton Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, paragrafi 74.

6.2 Në vitin 2021 janë konstatuar se ekzistojnë diferenca në disa produkte mes planit që rezulton në rakordimin mujor me degën e thesarit, dhe planit të rishikuar që rezulton pas shtesave dhe pakësimeve që janë kryer gjatë vitit. Më hollësisht, diferencat në llogarinë e pagave 600 janë sistemuar në rakordimin e muajit Prill, ndërsa diferenca e konstatuar në projektin e investimit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, ka vijuar të mbartet. Më hollësisht u konstatua se referuar shkresës së përcjellë nga MSHMS me nr.142/3, prot datë 02.02.2021 ñ***çelja e fondeve për këtë projekt është kryer për vitin 2022 dhe 2023 respektivisht me nga 13,680 mijë lekë"*****, dhe jo për vitin 2021, ndërsa vëmë re se, referuar** rakordimit mujor me degën e thesarit, për periudhën Janar-Mars 2021, faktikisht këtë projekt rezulton si plan buxheti për vitin 2021, vlera prej 13 milion lekë, duke mbartur riskun e fillimit të procedurave të prokurimit pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion.

Rekomandimi 6.1: ISHP të marrë masat për një monitorim më efektiv të fondeve buxhetore, duke identifikuar produktet që janë me realizim më të ulët në mënyrë që të përcillen kërkesat pranë MSHMS për rishpërndarjen e këtyre fondeve në produkte apo institucione të tjera brenda programit sipas nevojës, në funksion të përmbushjes së misionit të institucionit.

Në vijimësi

Rekomandimi 6.2: Për sa i përket buxhetit për financimin e investimeve kapitale, strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit pranë ISHP dhe MSHMS, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit me tyre veçanërisht në kuadër të buxhetit për investimet kapitale në mënyrë që të shmangen fenomenet e rishikimeve të shpeshta të fondeve situata këto me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

Rekomandimi 6.3: Strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS të marrë masa të menjëhershme për të sistemuar planin buxhetor të vitit 2021, të projektit me kod 18BB701 ñBlerje pajisje diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëò, duke rakorduar me degën e thesarit, me qëllim shmangien e risqeve të marrjes së angazhimeve, pa pasur realisht fonde buxhetore në dispozicion.

Menjëherë

Rekomandimi 6.4: ISHP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të buxhetit pranë MSHMS dhe MFE, të marrin masat në vijim për të sistemuar fondet e shpenzuara në funksion të situatës së shkaktuar nga Covid-19, në dallim me ato që i përkasin veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese, me qëllim që ato të evidentohen me kod produkti të identifikueshëm më vete me qëllim monitorimi dhe raportimi.

Deri në fund të vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën Janar-Mars 2021, nga ISHP është kryer likuidimi i pagesave për vaksinat kundër Covid-19 në vlerë **1,074,862 mijë lekë**, sipas 3 urdhër shpenzimeve, por nëse i referohemi rakordimit me degën e thesarit, vlera e shpenzimeve të kryera deri në këtë periudhë në projektin 91305 AH ñPersona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19ò është 1,083,538 mijë lekë. Diferenca prej rreth 8.7 milionë lekë leke, e raportuar më shumë sipas thesarit vjen si pasojë e përfshirjes së gabuar në këtë produkt të urdhër shpenzimit të kryer në vlerë 8,673,987 lekë të pagesës së shiringave në kuadër të programit kombëtar të vaksinimit, i cili faktikisht duhet të raportohej si shpenzim në kodin 91305AA ñFëmijë të vaksinuar 0-18ò. **Si rezultat, raportimi për shpenzimet buxhetore për personat e vaksinuar nga Covid 19, është i gabuar duke u raportuar rreth 8.7 milion lekë më shumë se niveli faktik i shpenzimeve,** me impakt kjo në analizën e indikatorëve të buxhetit bazuar në të dhënat e konsoliduara nga MSHMS në rang spitalor për programin e shëndetit publik.

Rekomandimi 7.1: ISHP të marrë masat për raportimin e saktë të shpenzimeve sipas produkteve ku është çelur plani buxhetor, në mënyrë që edhe analiza e performancës së produktit të reflektojë nivelin real të realizimit të planit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, janë përcaktuar pozicionet dhe klasat sipas së cilave do të kryhet edhe trajtimi financiar i tyre, duke përfshirë edhe rastet në të cilat pozicioni do të jetë përfitues i trajtimit financiar për shkak të disponimit të doktoraturave apo specializimit. Pra, brenda të njëjtit sektor/drejtori në strukturë parashikohet punësimi i specialistëve me të njëjtin titull në pozicionin e emëruar (pra specialist apo përgjegjës sektori) por për disa pozicione është parashikuar shtesa për shkak të pajisjes me një specializim/doktoraturë, dhe për disa të tjera jo. Ky përcaktim në strukturën e miratuar **nuk** është shoqëruar me hartimin dhe miratimin e përshkrimit të pozicionit të punës dhe detyrave në mënyrë që të identifikohet edhe se ku do të konsistojë detyra që lidhet me punën kërkimore për të cilën është parashikuar edhe përfitimi financiar.
- Nga auditimi konstatohet se për emërimin e nëpunësit zbatues të ISHP nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ñ*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", ku* cilësohet se, ñ*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë.* Më hollësisht, referuar strukturës organike dhe organigramës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me urdhrin nr . 159, datë 15.02.2019 të Ministrit të MSHMS ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPò, nëpunësi zbatues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës) **nuk** është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues (Drejtori i Përgjithshëm i ISHP) pasi në strukturën e miratuar përgjegjësi i sektorit të financës ndodhet nën varësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, i cili nga ana e tij përgjigjet dhe raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm të ISHP.
-Në strukturën e miratuar të ISHP evidentohet mungesa e Sektorit të Prokurimeve dhe e pozicionit të juristit, situatë kjo me impakt cënimin e menaxhimit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik dhe zhvillimin, ndjekjen apo zbatimin e kontratave të nënshkruara.
-Nga auditimi konstatohet se për 3 vitet e fundit ISHP ka patur vakanca në masën **rreth 10% të totalit (20 punonjës).** Këto pozicione përfshijnë si specialistë, ashtu edhe përgjegjës sektori të

cilat rezultojnë vakante për periudha relativisht të konsiderueshme kohore, dhe për të cilat ISHP **nuk** ka kryer shpalljen e pozicioneve vakante. Konstatohet se shpalljet janë kryer nga institucioni vetëm për punonjësit për të cilët procedura e rekrutimit ka konkluduar me një emërim, dhe jo për të gjitha vakancat që disponohen në institucion. Për vitin 2020, në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, rezulton se janë emëruar rishtas vetëm 2 punonjës arkivist, 1 punonjës për specialist në sektorin e monitorimit dhe vlerësimit, 1 specialist në Sektorin e DPSHP, 1 shofer dhe vetëm 2 pozicione laborantësh, përkatësisht një specialist laborant dhe një përgjegjës departamenti laboratori.

Rekomandimi 8.1: ISHP të marrë masat për saktësimin dhe evindentimin e detyrave me karakter kërkimor të personelit qe përfiton nga shpërblimi financiar për shkak të specializimeve shtesë, ndryshe nga pjesa tjetër e stafit që nuk përfiton nga ky shpërblim pavarësisht nëse stafi i punësuar i disponon ose jo këto kualifikime, në mënyrë që të diferencohet pozicioni i tyre sipas strukturës së miratuar të institucionit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

Rekomandimi 8.2: ISHP të rishikojë pozicionin e nëpunësit zbatues, në mënyrë që varësia nga nëpunësi autorizues të plotësohet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë

Rekomandimi 8.3: ISHP të marrë masat për shpalljen e procedurave të rekrutimit për të gjitha pozicionet që ekzistojnë vakante në mënyrë që të bëhet plotësimi i tyre dhe të mos cënohet aktiviteti dhe objektivat e institucionit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

Rekomandimi 8.4: MSHMS të rishikojë strukturën e miratuar të ISHP në mënyrë që të parashikohet pozicioni i një juristi që do të monitorojë kontratat ekzistuese dhe asistojë gjatë procedurave të prokurimit; detyra këto që aktualisht mbulohen nga sektori i financës.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në Rregulloren e Brendshme të ISHP nuk janë miratuar përshkrimet e pozicioneve të punës për pozicionet e specialistëve. Në dokumentacionet e përshkrimit të pozicioneve sipas dosjeve rezulton se këto dokumente nuk janë të miratuara nga titullari i institucionit. Përshkrimet e punës së punonjësve janë firmosur në disa raste vetëm nga eprori direkt, dhe në disa të tjera nga vetë punonjësi për të cilën është bërë përshkrimi. Përshkrimi i pozicionit të punës është kryer në varësi të eksperiencës, aftësive dhe shkollimit që punonjësi i punësuar disponon, dhe jo sipas objektivave dhe detyrave të pozicionit në varësi të sektorit/njësisë ku bën pjesë.

- Administrimi i dosjeve të personelit nuk është bërë plotësisht sipas kuadrit ligjor në fuqi pasi janë konstatuar disa mangësi të dokumentacionit si raportet mjeko ligjore, përshkrimet e pozicioneve të punës apo vlerësimet; dhe dosjet nuk ishin të inventarizuara. Vlerësimet e punonjësve kanë qenë vjetore.
- Nga auditimi i elementëve të kontratës së punës, u konstatua se në të nuk është përfshirë data e dhënies së pagës sipas nenit 21 të Kodit të Punës, dhe në kontratat e stafit nuk është si referencë kontrata kolektive në fuqi.
-ISHP nuk aplikon Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore për automatizimin dhe konsolidimin e këtij procesi.

Rekomandimi 9.1: ISHP të hartojë dhe miratojë përshkrimet e pozicioneve të punës së personelit në përputhje me kriteret ligjore, dhe të inventarizojë dosjet me të gjithë dokumentacionet e nevojshme.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

Rekomandimi 9.2: ISHP të marrë masat për hedhjen e të dhënave në sistemin HRMIS në bashkëpunim me DAP, si dhe të automatizojë mënyrën e përllogaritjes të pagave, duke përfshirë te

gjithë elementët e pagës bazë, me qëllim të lehtësohet procesi i hartimit të pagës, kontrollet e brendshme dhe të jashtme, si dhe të minimizohet risku operacional. Gjithashtu në kontratat e punës të reflektohet data e pagës dhe kontrata kolektive si referencë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi:

10.1 Nga auditimi i Gjendjes së Inventarit qarkullues i paraqitur në pasqyrat financiare në vitin 2020 me vlerën 246,503 mijë lekë është konstatuar se aktivet me vlerë 4,349 mijë lekë dhe vlerë 861 mijë lekë janë aktive të qëndrueshme të trupëzuara të cilat ndodhen në magazinë dhe jo aktive qarkulluese. Konkretisht vlera 4,349 mijë lekë përfshinë pajisje kompjuterik, tavolina, varëse rrobash, etj të rikthyera në magazinë kurse vlera 861,409 lekë përfshinë dy frigorifer të magazinuar të cilët ndodhen në magazinën e vaksinave. Këto pajisje edhe pse janë aktive afatgjata materiale janë klasifikuar si aktive afatshkurtra: Inventari Qarkullues. Ky klasifikim i gabuar është bërë në të tre vitet objekt auditimi. Nisur nga kjo referuar udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 këto aktive duhet të ishin klasifikuar në klasën 2 të aktiveve si Aktive Afatgjata të magazinuara dhe jo në klasën 3 siç janë pasqyruar në këto pasqyra.

16.2 Nga auditimi i regjistrimeve kontabël për llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria e debitorëve: 411 ñklientë e llogari të ngjashmeò në vlerën 1,239 mijë lekë ka si kundërparti të saj në pasiv llogarinë e kreditorëve: 467 ñKreditor të ndryshëmò. Për aq kohë sa një llogari i përket debitorëve dhe tjetra kreditorëve këto regjistrime kontabël nuk qëndrojnë dhe nuk janë paraqitur drejtë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 10.1: Personi përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të merrë masa për riklasifikimin e drejtë të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra duke iu referuar bazave ligjore në fuqi.

Në vijimësi

Rekomandimi 10.2: Personi përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të merrë masa për korrigjimin e kreditimit të llogarisë 411 dhe pasqyrimin e drejtë të kësaj llogarie në pasqyrat financiare të vitit pasardhës.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit justifikues për regjistrimet kontabël rezultoi se:

11.1 *Llogaria 520 "Disponibiliteti në Thesar"* është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 679 mijë lekë dhe është shuma e fondeve të ardhura në formën e sponsorizimeve dhe granteve që trashëgohen por në të treja vitet objekt auditimi nuk ka pasur shkresë rakordimi me Drejtorinë e Thesarit për këtë vlerë.

11.2 *Llogaria 468 "Debitor të ndryshëm"* është paraqitur në vlerën 8,862 mijë lekë. Kjo llogari përbëhet nga ñdetyrime personeliò të konstatuara nga auditimi i KLSH në vitin 2014. Nga sektori i financës nuk janë marr veprimet e nevojshme për ndjekjen e debitorëve si dhe nuk administrohet informacion i plotë për ecurinë e çështjeve drejtuar gjykatës dhe vendimin për likujdimin e këtyre vlerave.

Rekomandimi 11.1: Sektori i financës, në fund të çdo viti ushtrimor të bëjë rakordimin e llogarisë 520 ñDisponibiliteti në thesarò me Drejtorinë e Thesarit referuar udhëzimit të MFE.

Në vijimësi

Rekomandimi 11.2: Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa, duke krijuar një grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet, për ndjekjen e procesit të arkëtimit të detyrimeve të këtyre debitorëve ose në rast se ka procedura gjyqësore të fituara nga këta debitor, në favor të tyre, të

merren masa për fshirjen e detyrimeve nga kontabiliteti.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit në vitin 2020, është konstatuar se vlera fizike e Inventari Ekonomik ishte në shumën 163,429 mijë lekë *ndërkohë që vlera kontabël e pasqyruar në PF* në vlerë bruto është 164,214 mijë lekë duke rezultuar një diferencë prej 784 mijë lekë më shumë në PF. Nga verifikimi i dokumentacionit grupi i auditimit konstatoi se kjo diferencë vjen si pasojë e llogaritjes së gabuar gjatë mbledhjes së Inventarit Ekonomik pasi për ñInventarit të Imët Ekonomikò (një nga tre komponentët e IE) është mbledhur vlera që ka rezultuar në PF e vitit 2019 pa marrë në konsideratë ndryshimet gjatë vitit 2020. Vlera 18,623 mijë lekë është Inventari i Imët i rezultuar nga inventarizimi i vitit 2019 ndërkohë që vlera që ka rezultuar nga inventarizimi në vitin 2020 është 17,838 mijë lekë. Ky gabim ka bërë që vlera e aktiveve (në vlerë historike) të pasqyrohet 784 mijë lekë më shumë në PF.

Rekomandimi 12.1: Personi përgjegjës për kontabilitetin dhe hartimin e Pasqyrave financiare të merrë masa duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2021.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fletë hyrjes nr. 17, datë 17.12.2020 për furnizimin me kite reagonte, materiale konsumi për QIA Symphony, janë bërë hyrje në magazinë artikujt sipas faturës tatimore nr. 2765, datë 17.12.2020, me nr. serial 84227763 në vlerën 28,499,088 lekë me TVSH, të OE B.A. shpk. Po në të njëjtën ditë, me fletë daljen nr. 113, datë 17.12.2020 është konstatuar se ISHP ka bërë dalje të gjithë sasinë e furnizuar, në laboratorin e virologjisë, në mungesë të fletë kërkesës së laboratorit, apo plan shpërndarjes ose kartelës limit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 38, ku citohet se: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve".* Nga ana e institucionit dalja e kësaj sasie në mënyrë të menjëhershme për në laborator është justifikuar me kushtet e situatës së paparashikueshme Covid-19 dhe kushtet e këqija të gjendjes fizike të magazinës, pra nuk janë tërhequr për përdorim laboratorik, por për tu ñmagazinuar përkohësishtò në laborator deri në përdorim. Nisur nga sa më sipër, nga institucioni **nuk** është marrë asnjë masë për inventarizimin e këtyre sasive dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Gjatë auditimit, grupi i auditimit kërkoi në rrugë zyrtare nga laboratori i virologjisë gjendjen e sasisë së kite reagentëve në datën 31.12.2020, nga ku u konstatua se gjendja e kiteve dhe reagenteve ishte në **vlerën e konsiderueshme 40,793 mijë lekë**, pasi në laborator gjendeshin sasi dhe nga blerje të mëparshme. Dalja në mënyrë të menjëhershme, pa kërkesë dhe pa iu nënshtruar procesit të inventarizimit për sasitë e furnizuara si më sipër, shtrembëron pasqyrimin e saktë të gjendjes së magazinës në fund të vitit me impakt në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 13.1:
Titullari i institucionit të marr masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e gjendjes së kiteve dhe reagenteve që ndodhen aktualisht në Laboratorin e Virologjisë, dhe që janë transferuar në këtë laborator nga magazina pa fletë kërkesë, me qëllim rakordimin e vlerës aktuale me sasinë gjendje në fillim të periudhe, sasinë e bërë hyrje, dhe sasinë e përdorur. Pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse, dhe nxjerrja e përgjegjësive dhe marrja e masave për mosrakodrime (nëse do të konstatohen), e gjithë sasia e këtyre artikujve:

- ose të ribëhet hyrje në magazinën qendrore, sipas rregullave që parashikon Udhëzimi nr. nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

- ose nëse magazina qendrore nuk plotëson kushtet e magazinimit, si dhe për shkak të situatës Covid 19, këto artikuj të bëhen hyrje në Laboratorin e Virologjisë, vetëm pasi Nëpunësi Autorizues i ISHP të miratojë procedura te qarta të lëvizjes së tyre, te shoqëruara me përgjegjësitë respektive.

Në secilin prej rasteve që do të konkludohet, sasitë gjendje në këtë laborator të inventarizohen me qëllim paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Në asnjë rast të mos bëhet më, dalje e menjëhershme e sasive të furnizuara për laboratorët, por dalja nga magazina të jetë gjithmonë e justifikuar nga kërkesat përkatëse, bazuar në konsumin real të kiteve, materialeve dhe reagenteve.

Brenda datës 28.02.2022 dhe në vijimësi

Rekomandim 13.2

Në kushtet kur magazina nuk plotëson kushtet për magazinimin e artikujve, MSHMS si institucion epror të marr masa për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së ISHP për fonde për investime, për rregullimin e magazinës në mënyrë që të plotësohen kushtet e nevojshme për magazinimin e kiteve dhe reagentëve dhe/ose artikujve të tjerë laboratorik për qëllime të shëndetit publik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se *Llogaria 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim"* paraqitet në shumën 5,460 mijë. Për këto aktive nuk është zbritur vlera e amortizimit vjetor për tu paraqitur me vlerën neto në PF referuar udhëzimit nr. 8 datë 23.3.2018 por janë paraqitur me koston historike **(**vlera me të cilën këto aktive janë marrë në përdorim).
Konkretisht nëse për këto aktive do ishte llogartitur amortizimi vlera e tyre në PF duhet të ishte:

- Automjetet e marra në përdorim me akt përdorimin nr.169 datë 12.12.2018 nga ñNjësia e menaxhimit të programit të fondit Global - PMU me vlerë 1,817 mijë lekë duhet të ishte 1,163 mijë lekë. Vlera e devijimit për këtë aktiv është 654 mijë lekë.

- Kompjuterat e marra në përdorim me shkresën nr.1671/2 datë 06.02.2018 me Vlerë 187,200 duhet të ishin paraqitur në vlerën 105,300 lekë. Vlera e devijimit për këtë aktiv është 82 mijë lekë.

Dhe Sistemin e integruar të informacionit për programin e parandalimit të transmetimit të HIV marrë në përdorim me shkresën nr.298 datë 24.12.2019 me vlerë 3,456,000 lekë duhet të ishte paraqitur në vlerën 2,592,000 lekë. Vlera e devijimit për këtë aktiv është 864 mijë lekë.

Rekomandimi 14.1: Personi përgjegjës për kontabilitetin dhe hartuesi i pasqyrave financiare të marrë masa për llogaritjen e amortizimit të këtyre aktiveve dhe kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2021.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar mangësi në dokumentacion vërtetues dhe verifikues për likuidimin e urdhër shpenzimeve si më poshtë:
- Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 375, datë 16.10.2018 është likuiduar fatura e muajit shtator të telefonit fiks ndaj operatorit A. në vlerën 53,766 lekë. Ky shërbim dhe faturim nga operatori A., nuk është i bazuar në një kontratë apo marrëveshje. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me pikën 61 të Udhëzimit nr 30 në të cilën përcaktohet se ó*Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës*ô.

- Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 70, datë 28.03.2018, është kryer pagesa ndaj operatorit A.P. shpk për largimin e mbeturinave të muajit shkurt, në vlerën **18,180 lekë**. Ky shërbim është kryer në bazë të kontratës nr. 82 datë 18.01.2018, në të cilën përcaktohen ditët e javës së kur duhet të kryhet pastrimi si dhe mënyra se si duhet të kryhet Bashkëngjitur urdhër shpenzimit mungojnë dokumentet e marrjes në dorëzim të shërbimit si procesverbalet ose një dokument ku një komision ose përfaqësues i ISHP të jetë shprehur për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet e kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 35 të Udhëzimit nr. 30 në të cilin përcaktohet se ó*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe ne mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet*, mandat pagesat, proçesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimiôô

Rekomandimi 15.1: ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të shmangen në të ardhmen situata në të cilat subjekti të likuidojë vlera angazhimesh financiare në mungesë të kontratës/ave të nënshkruara për këtë qëllim.

Në vijimësi

Rekomandimi 15.2: Instituti i Shëndetit Publik të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim evidentimin e arsyeve për të cilat largimi i mbeturinave kryer nga OE A.P. është likuiduar pa verifikuar dhe/ose dokumentuar nëse subjekti ka kryer punën e kërkuar në përputhje me kushtet e dakordësuara.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar mangësi në dokumentacionin hyrës dhe dalës të magazinës si më poshtë:
- Nga auditimi i fletë hyrjeve në magazinë është konstatuar se subjekti harton fletë hyrjet e magazinës pa bashkëlidhur kopje të dokumentacioneve shoqëruese të cilat të përshkruajnë saktësisht arsyen e hyrjes së aktivit në magazinë sikundër kërkohet edhe nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 37 e cila parashikon se: *"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)."* Në të gjitha rastet fletë hyrja nuk është e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE dhe me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit.
- Nga auditimi është konstatuar se subjekti ka një kuptim të gabuar të mënyrës se si duhen hartuar dokumentacionet shoqëruese dhe vërtetuese të lëvizjeve të magazinës. Për këtë arsye konstatohet se në të gjitha fletë daljet e audituara për periudhën objekt auditimi dalja e aktivit nga magazina shoqërohet me një format urdhër dorëzimi në të cilin lëshuesi i urdhrit të dorëzimit është shefi i departamentit ose laboratorit, ndërkohë që ky duhet të nënshkruhet nga nëpunësi i cili autorizon magazinën për të bërë daljen e aktivit. Shefi i departamentit dhe/ose laboratorit duhet të jetë personi i cili bën kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar e jo ai që nënshkruan urdhrin e dorëzimit. Asnjë nga fletë daljet nga magazina nuk është e shoqëruar me kërkesën për furnizim me aktivin e kërkuar. Në shumë raste është konstatuar gjithashtu se personi i autorizuar për të tërhequr aktivin nga magazina nuk është i njëjtë me atë që ka tërhequr në fakt aktivin. Konstatohet se nëpërmjet kësaj praktike të krijuar në institucion, janë ndërthurur në një dokument (pra në urdhër dorëzimin cituar më sipër) edhe vendimmarrja për dorëzimin e aktivit edhe kërkesa duke krijuar konfuzion dhe duke mos lënë gjurmë të qarta auditimi mbi arsyet dhe mënyrën e lëvizjes së aktiveve nga magazina. Lidhur me sa më sipër udhëzimi 30, në pikën 38 kërkon sa më poshtë: *"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të*

shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve." Pra fletë dalja duhet të shoqërohet gjithmonë me urdhër dorëzim nënshkruar nga punonjësi i institucionit i cili autorizon magazinën për nxjerrjen e aktivit, nga fletëkërkesa për furnizimin me atë aktiv, si edhe me planin e shpërndarjes në raste kur ka një të tillë. Në asnjë rast fletë daljet nga magazina shoqërohen me kërkesën përkatëse.

Rekomandimi 16.1*:* ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen hyrja e aktiveve në magazinë të dokumentohet në çdo rast jo vetëm me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, por të jetë edhe e shoqëruar me kopje të faturës tatimore të prerë nga OE, me kopje të procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim të aktivit, për të evidentuar saktësisht arsyen e hyrjes së aktiveve në magazinë.

Në vijimësi

Rekomandimi 16.2: ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim në të ardhmen dalja e aktiveve nga magazina të bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe të dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve, ku të jenë lehtësisht të identifikueshëm kërkuesi, miratuesi, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i aktivit për një menaxhim sa më efektiv të këtij procesi.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në ISHP është konstatuar se:
- Për periudhën 2018 ï prill 2020 rezulton se ISHP nuk ka disponuar një kod etike si dhe çështjet e etikës nuk kanë qenë pjesë e rregullores së brendshme. ISHP ka hartuar dhe miratuar kodin e etikës nëpërmjet Urdhrit nr. 54, datë 15.04.2020 të Drejtorit të ISHP, znj. A.F..
- ISHP ka hartuar një strategji institucionale ñPlani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2019-2022ò, në të cilin të paraqiten prioritetet dhe objektivat, por në këtë strategji nuk paraqiten të detajuara planet e veprimit për arritjen e objektivave duke përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
- me urdhrin nr. 35/1154 datë 17.08.2018 ó*Për zbatimin e rekomandimit nr. 15 të KLSH, të ngrihet grupi i punës për Menaxhimin Strategjik dhe për rishikimin dhe përditësimin e risqeveò* është ngritur GMS me anëtarë: z. G.B.(kryetar), znj. A.A., znj. S.B., z. A.L., z. E.T., znj. G.Q., z. E.K., znj. A.M., z. D.H., znj. A.K., znj. E.G., por, konstatohet se GMS nuk ka në përbërje tituallarin e institucionit, znj. A.F., në kundërshtim me nenin 27 të ligjit për MFK.
- në udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 ó*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò*, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ó*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'*. Për sa më sipër, për periudhën 2018, 2019, 2020 dhe tre mujori i parë 2021, nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016.
- organizimi dhe veprimtaria administrative e ISHP mbështeten në rregulloren e brendshme nr. 512, datë 31.12.2019 e cila është miratuar nga Drejtori i ISHP znj. A.F.. Rezulton se kjo rregullore nuk është miratuar nga MSHMS, sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*ò, ku përcaktohet se: ñ*Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij"*. Gjithashtu, rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pas ndryshimit në strukturën organizative të miratuar me urdhrin nr. 635, datë 19.11.2020 të MSHMS.
- përshkrimet e punës së specialistëve të ISHP nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme,

pasi në këtë rregullore janë vetëm përshkrimet e punës në nivel Departamenti dhe sektori. Përshkrimet e punës së specialistëve janë në dosjet e punonjësve, të miratuara nga eprori direkt i tyre, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 18, germa ñcò, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë nën varësinë e të cilit është institucioni, në këtë rast MSHMS. ISHP edhe pse nuk është një institucion tanimë me status civil, është nën varësinë e një ministrie. Gjithashtu ISHP nuk disponon një program trajnimi vjetor për punonjësit.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik ka përgatitur Strategjinë e riskut, nr. 581/26 prot, datë 22.02.2019. Për vitin 2020 nuk kemi përditësim të risqeve, sikurse përcaktohet më sipër.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuarô ku përcaktohet se ó*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*ô.

ISHP nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Mungesa e regjistrit të riskut dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

- Nëpërmjet shkresës nr. 1627 prot, datë 19.12.2017, Nëpunësi Autorizues i ISHP znj. A.A.ka autorizuar znj. A.M. përgjegjëse e sektorit të financës si nëpunës zbatues deri në emërimin e Drejtorit të ri të Institucionit. Drejtori i ri i institucionit është emëruar me shkresën nr. 266 datë 28.03.2018 të Ministrit të MSHMS. Ndërkohë, që nëpunësi zbatues vazhdon të kryejë funksionin në bazë të një shkrese e cila ka qenë e vlefshme deri me datë 08.03.2018. Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se është caktuar si PPP znj. A.M.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, e cila është Nëpunës Zbatues i ISHP, e për pasojë përcaktimi i saj si PPP, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 56.

- ISHP nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual'*. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim rezulton se nëpunësi autorizues i ISHP nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

- Të ardhurat nga licenca dhe dhënie aprovimi janë gjeneruar nga ISHP në vijim të udhëzimit të MSHMS nr. 713, datë 11.10.2018 ñ*Për tarifat e licencimit të veprimtarive që përdorin burime të rrezatimit jonizues*ò në të cilin përcaktohen tarifat përkatëse të licencimit dhe lëshimit të aprovimeve përkatëse për import eksport dhe transport të burimeve të rrezatimit jonizues, por aktivitetet e kontrollit që janë implementuar nga ISHP për garantimin e likuidimit nga ana e përfituesve të shërbimeve që institucioni kryen kundrejt pagesës (analiza, licenca, etj), konsistojnë në bashkëlidhjen e mandatit të pagesës përpara dhënies së çdo vërtetimi të firmosur nga titullari. Likuidimi i pagesës rezulton të kryhet pasi janë kryer analizat përkatëse nga ISHP, moment ky që kryhet dhe përllogaritja e detyrimit përkatës. Pas kryerjes së pagesës nga përfituesit e shërbimeve, ISHP vijon me dhënien e miratimeve zyrtare të këtyre dokumentacioneve. Megjithatë nga ana e

institucionit nuk është kryer asnjë monitorim për periudhën nën auditim në regjistrat e vërtetimeve/licencave/analizave sipas departamenteve respektive të ISHP për të garantuar se për të gjitha këto shërbime është kryer likuidimi sipas tarifave përkatëse. Gjithashtu, për shkak të mos kryerjes së pagesave përpara se të vijohet me analizat, ekziston risku për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe mos likuidimin e tyre nga ana e përfituesve.

Rekomandimi 17.1: ISHP të veprojë menjëherë duke ndritur një grup pune të posaçëm me qëllim rishikimin e strategjisë institucionale duke përfshirë në të planet e veprimit për arritjen e objektivave duke përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit.

Menjëherë

Rekomandimi 17.2: ISHP të marrë të gjitha masat e duhura brenda kompetencave të veta me qëllim rishikimin e përbërjes së GMS, duke përfshirë në të titullarin e institucionit, si edhe të dokumentojë në vijimësi mbledhjet e GMS në përfitim të punës së institucionit kundrejt menaxhimit strategjik.

Menjëherë

Rekomandimi 17.3: ISHP të veprojë menjëherë duke përditësuar strategjinë e riskut, hartuar njëkohësisht regjistrin e riskut institucional dhe krijuar procedura specifike për menaxhimin e tij në përfitim të mirëmenaxhimit të institucionit kundrejt situatave që mund të dëmtojnë veprimtarinë e tij.

Menjëherë

Rekomandimi 17.4: ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar në vijimësi pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion.

Në vijimësi

Rekomandimi 17.5: ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që detyrimi financiar kundrejt institucionit për kryerjen e analizave apo dhënien e licencave përkatëse nga sektori i zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet të bëhet para kryerjes së shërbimit nga ana e institucionit me qëllim shmangien e risqeve për moslikuidim të detyrimeve kundrejt institucionit nga operatorët ekonomik.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar mangësi në dokumentacionin dalës të karburanit në magazinën e ISHP si më poshtë:

Për vitin 2018, nga auditimi i fletë daljeve të karburantit dhe dokumentacionit shoqërues nga magazina për muajt prill, shtator dhe tetor është konstatuar se: përgjegjësi i sektorit të financës nuk ka nënshkruar urdhër dorëzimet përkatëse; praktika e daljes nga magazina të karburantit nuk shoqërohet nga kërkesa apo autorizimi për kryerjen e shërbimit. Këto dokumente menaxhohen në një set tjetër dokumentacioni i cili përpilohet nga secili shofer për makinën që ka në përdorim. Pavarësisht kësaj, ky dokumentacion ka mangësi pasi, shumica e kopjeve të autorizimeve për kryerjen e shërbimit janë pa numër protokolli, një pjesë e tyre janë edhe pa datë. Në rastin e automjetit me targë x fleta përmbledhëse e konsumit të karburantit për muajin prill 2018 është mbajtur me korrigjime të shumta, disa rreshta janë fshirë me korrektor, gjë kjo e cila le shkas për gabime në raportimin e lëvizjeve të automjetit.

Fletë daljet pa nënshkrimin e sektorit të financës të evidentuara me këtë problematikë janë **146 në numër** për një total prej **5483 litrash në vlerën 922,443 lekë, e cila përbën menaxhim jo efektiv për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi 19.1: ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse dhe arsyeve të cilat kanë çuar në menaxhimin e gabuar të daljes së karburantit nga magazina në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në vitin 2018.

Menjëherë

Rekomandimi 19.2: ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që procesi i daljes së karburantit nga magazina të jetë gjithmonë i dokumentuar me autorizimin përkatës, fletë kërkesën, urdhër dorëzimin dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që të justifikojnë këtë veprim.

Në vijimësi

Rekomandimi 19.3: ISHP të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim që plotësimi i fletëve përmbledhëse të karburantit nga përgjegjësit për automjetet në ISHP të kryet duke respektuar kushtet minimale të një dokumenti të lexueshëm, të kuptueshëm dhe të auditueshëm, me qëllim promovimin e përgjegjshmërisë institucionale për daljen e aktiveve nga magazina si edhe konsumin e tyre.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefekturat Shkodër, Lezhëò, me fond limit 9,943,883 lekë pa tvsh dhe ñShërbim dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbaneò, Loti 1 ñPrefektura Vlorëò, me fond limit 30,509,969 lekë pa tvsh, Gusht, 2018, në lidhje me vlerësimin e kryer për O.N. SHPK u konstatua se:

- O.N. SHPK ka paraqitur listëpagesën për muajin korrik ku vërteton se ka 14 punonjës, nga të cilët, D.C. me detyrë Menaxhere e Përgjithshme, D.R. me detyrë nëpunës informacioni dhe A.P. me detyrë ekonomiste, pranë këtij OE. Për të tre këta punonjës, sipas CV së paraqitur, kanë kryer një trajtim 5 ditor (mars 2019), me temë Teknik Shërbimesh DDD, pranë Akademisë së Shëndetit Publik.

Në kërkesat e parashikuara në Shtojcën 8, për Lotin 1 dhe Lotin 4, kërkohen gjithsej, 1 Drejtues Teknik (Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1), 4 Teknikë Aplikimi (1 Loti 1 dhe 3 Loti 4) dhe 8 Aplikues (2 Loti 1 dhe 6 Loti 4), pra minimumi 13 punonjës.

O.N. SHPK ka paraqitur, 2 Drejtues Teknik G.M.dhe F.N.), ndërsa ka paraqitur edhe CV për 12 punonjësit e tjerë, ku është përcaktuar që kanë kryer një trajnim 4-6 ditor me objekt Teknik Shërbimesh DDD, ku 3 nga këta punonjës e kanë kryer pranë OE G. srl, ndërsa 9 të tjerët pranë OE Akademia e Shëndetit Publik SHPK, sipas formatit të mëposhtëm:

> Nga 07 deri me 11 mars 2019 trajnim me temë **Teknik Sherbimesh DDD** prane **Akademia e Shendetit Publik.** Trajnimi konsiston ne luften kunder infestuesve dhe teknikat e perdorimit te pajisjeve.

Si konkluzion, OE do e kryerjë shërbimin e Dezinsektimit të këtyre procedurave, me punonjës për të cilët ISHP nuk ka asnjë siguri mbi kualifikimet, certifikatat dhe licencat e tyre, dhe për më tepër, ka paraqitur si teknikë/aplikues, menaxheren e përgjithshme, nëpunësin e informacionit dhe ekonomisten e shoqërisë. Ndikimi në këtë situatë, ka patur fakti i mos kërkimit në DT të kërkesave të tilla nga Njësia e Prokurimit, si dhe vlerat e likuiduara për kontratat respektove për lotin 1: 8,411,364 lekë dhe për lotin 4 25,886,844 lekë **në total 34,298,208 për bëjnë menaxhim jo efektiv i fondeve vendosur në dispozicion nga buxheti i shtetit.**

- Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në SPE krahasuar me DST për procedurën e

prokurimit me objekt ñ*Blerje kite dhe reagent e materiale të tjera për teknikat Cobas TeqMan*ò, zhvilluar në ISHP ne vlerë 7,992,500 lekë pa TVSH është konstatuar se:
- vërtetimi i debisë nr. 5880, datë 27.06.2019 lëshuar nga OSHEE është vetëm për kontratën nr. TR1F020069171986, ndërkohë që nga ekstrakti historik i këtij subjekti vërehet se ky subjekt ka dy adresa të ushtrimit të aktivitetit të tij të deklaruara: zyra qendore; Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit ï Magazinë shitje me shumicë. Lidhur me sa më sipër, OE ka paraqitur vërtetim debie vetëm për njërën nga dy adresat në të cilat ushtron aktivitetin pa specifikuar se cilës prej tyre i përket kontrata e cituar në vërtetimin e paraqitur. Ky veprim bie në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në shtojcën 8, pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, 1/d, e për pasojë nuk duhet të ishte kualifikuar për këtë kriter. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, pika 1 e LPP i cilin përcakton se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese"*, si edhe me nenin 66, pika 3 e VKM nr. 914 e cila citon se: *"Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit."* Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte OE S. shpk e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se: ñ*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*.ò e për rrjedhojë vlera prej **7,992,500 lekë pa TVSH përbën menaxhim jo efektiv të buxhetit të shtetit.**

Rekomandimi 20.1: ISHP të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim evidentimin e përgjegjësive përkatëse sa i takon mospërcaktimit në DT të kërkesave mbi kualifikimin, trajnimin, certifikatat dhe licencat e punonjëave të OE fitues të cilët do të kryejnë shërbimin e dizinsektimit. Të shmanget në të ardhmen nga Njësia e prokurimit vendosja e kritereve evazive sa i takon kapacitetit profesional të punonjësve që angazhohen nga OE në kryerjen e këtij shërbimi.

Në vijimësi

Për sa më sipër mbahet ky raport auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT
1. Xh.C., Përgjegjëse e Grupit të Auditimit,
2. A.G.,
3. J.T.,
6. A.N.,
5. M.K.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. J.

V. ANEKSE

ANEKSI III - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH

ANEKSI IV - QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

ANEKSI III - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinioneve të aplikuara nga KLSH.

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do tëi tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si ñtheksimi i çështjesò përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
    - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
    - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e

përshkruara më poshtë:

Opinioni i modifikuar. Opinioni i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe konçize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinioni qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI IV - QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1,5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tâu audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1,5%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602 dhe me llogarinë 231 u vlerësuan me 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Struktura buxhetore (2018)	Shuma	Risk Factor (can be 0.7 or 2 or 3)	Çeshtjet për shqyrtim
Paga (600)	158,157,411	0.70	17

Sigurime Shoqërore dhe shendetsore(601)	26,074,980	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	116,182,219	2.00	35
Transferime korente me jashte (605)	302,741,597	2.00	92
606	261,335	2.00	0
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	6,379,477	2.00	2

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2018, grupi i auditimit mori në shqyrtim 240 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 20 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.
Gjithashtu u shqyrtuan 140 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 129 çështje të llogarive 602, 605, 606 dhe 231 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.
Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Struktura buxhetore (2019)	**Shuma**	**Risk Factor (can be 0.7 or 2 or 3)**	**Çeshtjet për shqyrtim**
Paga (600)	153,263,477	2.00	40
Sigurime Shoqërore dhe shendetsore(601)	25,313,645	2.00	7
Mallra e Shërbime (602)	154,627,904	2.00	41
Transferime korente me jashte (605)	364,957,061	2.00	96
606	796,232	2.00	0
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	6,563,074	2.00	2

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2019, grupi i auditimit mori në shqyrtim 240 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 47 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.
Gjithashtu u shqyrtuan 150 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 137 çështje të llogarive 602, 605, 606 dhe 231 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.
Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Struktura buxhetore (2020)	**Shuma**	**Risk Factor (can be 0.7 or 2 or 3)**	**Çeshtjet për shqyrtim**
Paga (600)	174,080,788	0.70	17
Sigurime Shoqërore dhe shendetsore(601)	24,568,082	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	180,111,985	2.00	51
Transferime korente me jashte (605)	270,760,802	2.00	77
606	434,600	2.00	0
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	1,411,188	2.00	0

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2020, grupi i auditimit mori në shqyrtim 240 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 19 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.
Gjithashtu u shqyrtuan 226 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë mbi llogarinë 602, nga 23 çështje dhe llogarinë 231 me minimumi 122 çështje për të dhënë siguri të arsyeshme.

Vlera totale e gabimit të konstatuar për vitin 2020 nga regjistrimet kontabël në pasqyrat financiare është:
-Nga auditimi i zërave ka rezultuar se mjetet në përdorim janë paraqitur në vlerën bruto dhe jo në vlerë neto me një devijim në vlerë 1,600 mijë lekë më shumë.
-Nga auditimi i zërave ka rezultuar se Inventari Ekonomik është pasqyruar më shumë në vlerën 597 mijë lekë (neto).
- Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2019 dhe 2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë.

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Në mijë lekë

Klasa 6 (llog 600,601)	Paga	Sig Shoqërore	Total	Mbuluar me auditim
Viti 2018	158,157	26,075	184,232	184,232
Viti 2019	153,263	25,314	178,577	178,577
Viti 2020	174,080	24,568	198,648	198,648
Janar-Mars 2021	50,748	6,700	57,448	57,448

2018: Grupi i auditimit mori në shqyrtim pagat e 20 punonjësve të ISHP për çdo muaj (nga totali prej 199 punonjësish që institucioni ka patur deri në fund të vitit), e cila e përkthyer në transaksione/cështje (20*12=240) e tejkalon numrin e cështjeve përcaktuar në kampion për këtë vit (20).
2019: Grupi i auditimit mori në shqyrtim pagat e 20 punonjësve të ISHP për çdo muaj (nga totali prej 185 punonjësish që institucioni ka patur deri në fund të vitit), e cila e përkthyer në transaksione/cështje (20*12=240) e tejkalon numrin e cështjeve përcaktuar në kampion për këtë vit (47).
2020: Grupi i auditimit mori në shqyrtim pagat e 20 punonjësve të ISHP për çdo muaj (nga totali prej 183 punonjësish që institucioni ka patur deri në fund të vitit), e cila e përkthyer në transaksione/cështje (20*12=240) e tejkalon numrin e cështjeve përcaktuar në kampion për këtë vit (19).
2021: Grupi i auditimit mori në shqyrtim pagat e 30 punonjësve të ISHP për periudhën 3 mujore (Janar-Mars) të vitit 2021.

Një vëmendje të shtuar në auditim kishin pagesat e shpërblimeve të dhëna në kuadër të pandemisë të cilat u audituan 100%, për të gjithë punonjësit përfitues, përgjatë gjithë periudhës kur janë dhënë këto shpërblime, si më poshtë:

Në lekë

Nr	Muaji	Shpërblimi në total	Shperblimi sipas pagesave të kryera	Numri i punonjësve
1	Mars	2,755,323	2,755,323	34
2	Prill	2,920,000	2,920,000	36
3	Maj	2,854,677	2,854,677	32
4	Qershor	2,890,833	2,890,833	32
5	Korrik	2,772,097	2,772,097	34
6	Gusht	2,945,167	2,945,167	46
7	Shtator	2,605,167	2,605,167	48
8	Tetor	3,498,227	3,498,227	52
9	Nentor	3,981,001	3,383,851[12]	62
Totali i pagesave nga buxheti i vitit 2020		**27,222,492**	**26,625,342**	
10	Dhjetor	4,012,581	4,012,581	72
11	Janar-21	2,214,677	2,214,677	36
12	Shkurt-21	3,359,824	3,359,824	50
13	Mars-21	2,338,065	2,338,065	51

[12] *Pagesa e shperblimeve te muajit Nëntor është kryer në muajin Dhjetor, por deklarimi i tatimi prej 597,150 lekë është bërë në muajin Janar 2021.*

2. Mbulimi me auditim i shpenzimeve të realizuara nga institucioni , veprimet me bankën. (llogaria 602, 605, 606)

Dokumentacioni i audituar i shpenzimeve të bankës është përzgjedhur bazuar në vlerën më të lartë:

Nr	Viti 2018	Vlera
1	Mars	184,606,880
2	Tetor	157,413,412
	Viti 2019	
1	Prill	216,800,198
2	Shtator	205,022,082
	Viti 2020	
1	Prill	145,238,960
	Gusht	71,112,577
	Tetor	140,742,516
	Dhjetor	88,203,109
	Viti 2021	
	Janar	322,385,357
	Shkurt	19,620,719
	Mars	924,095,364

Shpenzimet sipas secilit muaj objekt auditimi janë si më poshtë:

NR	Pershkrimi	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021
1	*JANAR*	17,024,837	18,821,237	14,577,055	322,385,357
2	SHKURT	18,262,753	24,672,863	18,195,424	19,620,719
3	MARS	184,606,880	17,492,699	14,842,934	924,095,364
4	PRILL	17,172,055	216,800,198	145,238,960	
5	MAJ	18,877,551	33,903,831	23,927,577	
6	QERSHOR	23,347,590	20,554,978	32,082,607	
7	KORRIK	30,665,159	17,800,192	36,263,967	
8	GUSHT	29,451,325	21,741,756	71,112,577	
9	SHTATOR	26,597,775	205,022,082	39,169,855	
10	TETOR	157,413,412	43,604,787	140,742,516	
11	NENTOR	24,188,826	29,404,847	24,692,998	
12	*DHJETOR*	53,023,942	52,696,905	88,203,109	
	SHUMA	**600,632,105**	**702,516,373**	**649,049,579**	**1,266,101,440**

Mbulimi me auditim për shpenzimet e realizuara nga institucioni është:

2018	2019	2020	2021	Mbulimi total
342,020,292	421,822,280	445,297,161	1,246,480,721	2,455,620,454
57%	60%	69%	98%	76%

Në vitin 2018 janë audituar 140 transaksione, në vitin 2019 janë audituar 150 transaksione, në vitin 2020 janë audituar 226 transaksione dhe në vitin 2021 janë audituar 78 transaksione.

3. Mbulimi me auditim i të ardhurave dytësore

Grupi i auditimit ka audituar të gjithë rakordimet me Degën e Thesarit për vitet objekt auditimi: 2018, 2019, 2020 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2021. Konkretisht:

Në mijë lekë

Viti	Të ardhurat e realizuara
Viti 2018	18,759
Viti 2019	12,001
Viti 2020	11,558
Janar-Mars 2021	3,093

4. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja[13] e prokurimeve u krye duke patur parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlera e procedurave të realizuara;
- Lakimi në median e shkruar;
- Risku që shoqëron procedura të caktuara nisur nga niveli i gjetjeve në auditimet e tjera, etj.:

Viti	Procedura zhvilluar		Procedura Audituar		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Përqindje
Viti 2018	51	89,970,168	3	48,167,500	53.54%
Viti 2019	36	138,186,296	6	91,365,275	66.12%
Viti 2020	43	477,615,524	4	387,944,875	81.23%
Viti 2021[14]	4	1,022,667	0	0	2.06%
SHUMA	**134**	**706,794,655**	**13**	**527,477,207**	**74.63%**

[13] *Trajtuar më hollësisht në Letrën e Punës nr. 5, datë 30.07.2021.*

[14] *Për 3-mujorin e I të vitit 2021, janë realizuar vetëm 4 procedura me blerje me vlerë të vogël*